

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration Intérimaire des  
Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT  
**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPT**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 DHE 20 MAJ 2005**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 19. I 20. 05. 2005. GODINE**

---

**QERSHOR 2005**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**R E N D I D I TË S**

W

H

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për Odën Ekonomike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurat kontestimore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbeturinat,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet,
9. Shqyrtimi i propozim-Rregullores së punës të Kuvendit,
10. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.



**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

W

**"DNEVNI RED"**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Razmatranje programa Vlade Kosova o reformi lokalne vlasti,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o opštoj sigurnosti proizvoda,
4. Razmatranje Izveštaja Komisije za privredu, trgovinu i industriju u vezi sa primedbama UNMIK-a na Zakon o Privrednoj komori,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o parničnom postupku,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o otpacima,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o verskoj slobodi i pravnom položaju verskih zajednica na Kosovu,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o dugovima,
9. Razmatranje Predlog Poslovnika Skupštine,
10. Razmatranje predloga Parlamentarne grupe LDK-a o zameni članova parlamentarnih komisija.

**KUVENDI KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**AGENDA**

1. Approval of minutes from the previous meeting,
2. Deliberation of the Program of Government of Kosovo on reformation of local authority Administration,
3. Second reading of the Draft Law on General Insurance of products,
4. Deliberation of the report by the Committee of Economy, Trade and Industry related to UNMIK remarks on the Law of Economic Chamber,
5. First reading of Draft Law on Contentious Procedures,
6. First reading of the Draft Law Waste,
7. First reading of the Draft Law on freedom of religion and legal status of religion Communities in Kosovo,
8. First reading of the Draft Law on debts,
9. Deliberation of Working Draft Regulation of the Assembly of Kosovo,
10. Deliberation of the proposal of the LDK Parliamentary Group for replacement of Parliamentary Committees members.

## TRANSKRIPT

### NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 DHE 20 MAJ 2005

Seanca Plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.  
Seanca filloj punë në orën 10,05.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.  
Bashkëkryesues Naim Maloku, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

#### **KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjesi të gjithëve. Mirëseardhje në Seancën e rregullt plenare. Mirëseardhje Kryeministrat zotri Bajram Kosumi dhe ministrave të Qeverisë së Kosovës.

Të pranishëm në sallë janë 94 deputetë. Kemi një ditë të mirë fillimi të punës. Shpresoj se të gjitha materialet e nevojshme i keni marrë me kohë. Prandaj, për të pas një sukses ose punë të imbarë, fillojmë me rend të ditës.

- Miratimi i Procesverbalit nga seanca e mbajtur.

Është praktikë dorëzimi me shkrim i ndonjë vrejtjeje eventuale. Megjithatë, nëse ndokush e ndien të nevojshme, mund ta paraqesë vërejtjen edhe gojarisht. Ju faleminderit.

Meqenëse nuk ka të paraqitur po vazhdojmë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal.

Më lejoni t'i theksoj disa informime hyrëse. Materialet bazë për debatin e sotëm rrëth kësaj teme iu janë shpërndarë deputetëve në muajin mars, dhe atë:

1. Dokumenti komisë i miratuar nga Qeveria e mandatit të kaluar, më 23 korrik 2004; dhe
2. Programi i punës lidhur me reformën e pushtetit lokal, i miratuar nga Qeveria e tashme, më 22 shkurt 2005.

Fjalën hyrëse lidhur me këtë çështje do ta paraqesë Kryeministri zoti Bajram Kosumi, ndërsa prezantimin e Projektit do ta bëjë Ministri i Pushtetit Lokal, zoti Lutfi Haziri.

Para se t'ua jep fjalën Kryeministrit dhe Ministrit, më lejoni të theksoj se unë kam mbajtur dy takime me shefat e grupeve parlamentare. Në takimin e dytë – të fundit - sot, para fillimit të Seancës për shkak të interesimit substancial të të gjithë deputetëve në Parlament dhe të qytetarëve të Kosovës në tërësi, jemi marrë vesh sa vijon, mëqë ishin kërkesa pak të ndryshme në kohëzgjatje në mbledhjen e parë. Përfundimisht, jemi marrë vesh njëzëri që referati kryesor i paraqitur në emër të grupit parlamentar të zgjatë 15 minuta dhe diskutimi i deputetëve të jetë 7 minuta. Ishte një kërkesë në takimin e parë që kryetari ose kryesuesi 5+1 minut t'i jep mundësi diskutimi ndonjë deputeti për të qpnë të gjithë në një trafsh të të drejtave dhe obligimeve. Prandaj, të gjithë deputetët e kanë këtë mundësi.

Do tē doja tē kemi mirëkuptim që, edhe ato parti parlamentare - tē cilat nuk kanë grup parlamentar - ta shfrytëzojnë tē drejtën e kohëzgjatjes aq sa shefat e grupeve parlamentare, sepse duhet tē ravizohen edhe mendimet e partive tjera politike që janë në Parlament.

Prandaj, pa humbur kohë, ftoj Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, zotin Bajram Kosumi të merrë fjalën. Urdhëroni. Është paraqitur më parë, zoti Krasniqi dëshiron fjalën.

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

I nderuari Kryetar, zoti Kryeministër, tē nderuar deputetës,  
Neve na vjen mirë që çështja e reformimit tē pushtetit vendor ose vetëqeverisjes lokale është radhitur në rend dite – edhepse me vonesë. Mirëpo, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka edhe një kërkesë tjetër.

Ka kohë që po flitet për bisedimet Prishtinë - Beograd dhe ditëve tē fundit prononcime pozitive se Presidenti i Kosovës dhe Kryeministri do tē bisedojnë me përfaqësuesit e shtetit serb – pra përfaqësuesit tē Beogradit, dhe kërkojmë edhe nga Presidenti edhe nga Kryeministri tē dimë cila është platforma e bisedimeve; apo a ka platformë për këto bisedime. Nëse nuk ka platformë për këto bisedime, cilat janë pikat e rendit tē ditës për tē cilat do tē diskutojnë, ose cilat janë çështjet tē cilat ata do t'i ngrisin në këto takime dhe në këto bisedime.

Ne konsiderojmë se bisedimet Prishtinë - Beograd kërkojnë një përgatitje dhe për këto bisedime, përveç ne deputetët tē Parlamentit të Kosovës, duhet tē jenë në dijeni se çka do tē bisedohet - edhe qytetarët e Kosovës, do tē thotë tē kenë njohuri më shumë se cilat janë ato arsyë dhe për çka këta përfaqësues tē lartë - që janë zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës dhe i përfaqësojnë institucionet e Kosovës - dëshirojnë tē bisedojnë me Beogradin.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike tē Kosovës kërkon që pas pikës së dytë tē rendit tē ditës tē cilin e shqyrtojmë sot, në rend dite tē jetë pika e tretë – çështja e bisedimeve Prishtinë - Beograd. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Xavit, a e kërkon fjalën për tē njëjtën çështje? Urdhëroni.

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Përveç për ta mbështetur kërkesën e kryetarit tē Grupit, edhe një kërkesë që për këtë çështje tē votojmë se a do tē bëjmë debat apo jo. Kam edhe për një problem krejt tjetër teknik, që po na përsëritet prejse është konstituar ky Parlament. Në i kemi zgjedh, ose Qeveria i ka do zëvendësministra dhe në asnjë parlament tē botës zëvendësministrat nuk ulen në parlament dhe në kushtet kur nuk është ministri. Zëvendësministrat e zëvendëssojnë ministrin në zyrën e tij, por jo në parlament. Prandaj, kjo do tē viente dhe do tē duhej tē viente edhe për zëvendëskryeministrin edhe për zëvendësministrat tē cilët realisht, në kundërshtim me çdo rregull demokratike në botë - vijnë në Parlamentin e Kosovës dhe zënë vend ku s'e kanë vendin.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Do tē informoja deputetët, edhepse besoj tē gjithë e kanë parasysh Rregulloren. Çdo grup parlamentar, pesë apo gjashtë deputetë, në mandatin e kaluar sikur e pasht në Rregullore, në

këtë mandat e kanë të drejtën që të kërkojnë për ndonjë çështje, nëse është si çështje urgjente dhe konsiderohet e rëndësishme - të futet në rendi dite. Prandaj, për këtë duhet të vendos Seanca. Unë nuk kam as interpretim, as mendim.

Do të luja që edhe grupet tjera parlamentare të deklarohen, sepse unë s'do të propozojë asgjë. Urdhëroni. E ka fjalën Kryeministri.

#### KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:

Faleminderit Kryetar. I nderuar shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, unë mirëpres kërkesën tuaj dhe jam i gatshëm të jap sqarime - të gjitha sqarimet e duhura rrëth kësaj çështjeje. Mirëpo, është procedurë që duhet respektuar edhe nga ju, dhe këtë e llogaris si kërkesë zyrtare, por parashihen disa ditë - pasi ta marr unë atë kërkesë - të përgatitem dhe të jap sqarime të duhura. Këtë mund ta bëjmë në seancën tjetër, ose mund të ftoni seancë më herët. Jam i gatshëm në çdo kohë të jap sqarime të duhura. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Kryeministër. Replikë dëshiron zoti Jakup Krasniqi. Mundeni prej vendit, Jakup.

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Do të mund të pajtohesha me propozimin e Kryeministrat, por konsideroj se çështja është shumë e ngutshme. Bisedimet janë paralajmëruar të jenë në ditët e javës, më së largu në ditët e javës së ardhshme dhe konsideroj se nuk ka kohë. Nëse s'është përgatitur për ato bisedime deri më tani, mendoj se nuk ka kohë për ndonjë seancë tjetër.

Megjithatë, ne konsiderojmë që kjo duhet të futet në votim dhe konsiderojmë se është çështje e ngutshme dhe nuk pret seancën tjetër, e aq më pak nëse seancat organizohen një herë në muaj.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Më lejoni t'i them dy-tri fjalë, edhe pse nganjëherë po mundoheni t'ma ndalon interpretimin, por e konsideroj ndihmesën të domosdoshme deri të jam kryetar i Kuvendit.

Çështja e shtruar nga zoti Krasniqi, meriton shqyrtim serioz, vlerësim e respekt. Kjo është e padiskutueshme.

Çështja e dyte, është: Seanca plenare nuk mendoj se duhet të hyjë në një debat për të cilin nuk është caktuar as data e takimit, as agjenda, as vendi i takimit. Mund të them këtë se, sipas nevojës, mund ta ftoj Kryesinë në një takim urgjent kur të paraqitet nevoja dhe të mbajmë seancë, jo të radhës sikur është ajo mujore, por në qoftë se paraqitet nevoja - kur kërkojnë grupet parlamentare. Pra, jam i gatshëm ta ftoj Kryesinë dhe të futemi në proces. E vetmja zgjidhje përmua, është kjo që thash. Urdhëroni zoti Thaci.

#### DEPUTETI HASHIM THACI:

Zoti Kryetar,

Përsëri rrëth çështjes së ngritur për t'u futur në rend të ditës të çështjes mjafit të ndjeshme të fillimit të dialogut në mes bartësve të institucioneve të Kosovës dhe autoriteteve të Beogradit.

Ne kemi përvoja të hidhura nga e kaluara, dhe jo më larg se nga takimi i vjetëm. Pastaj, mendoj se do të ishte edhe shumë me rëndësi që pëlqimi të kuptohet qartë: se është dhënë për takim në mes Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Kosovës me presidentin e Serbisë dhe kryeministrin e Serbisë.

Kryeministri ynë deklaroi se është shumë i kënaqur dhe i emocionuar që Beograd ka pranuar për takim. Ne do të duhej ta kuptonim cila është ajo kënaqësi e tij, për çka do të bisedohet, cilat janë pikat, rendi i ditës, agjenda, ku do të ndodhë takimi, pse do të ndodhë, cila do të jetë platforma, sepse kjo çështje nuk është çështje e individit, nuk është çështje personale, nuk është çështje as e një apo dy partive por është çështje në nivel vendi, në nivel të popullit.

Për këtë arsy, do të ishte me rëndësi që të futet në rendin e ditës, sepse mund të ndodhë shumë leht, pasi që pëlqimi është dhënë pa u diskutuar në Parlament të ndodhin këto takime... Pra, të diskutohet në këtë Parlament, natyrisht edhe të ndërtohet qëndrim i përbashkët nëse vendoset se duhet të ndodhin takime, në mënyrë që të mos kemi tejkalim të Parlamentit apo vendime të njerëzve që i ka zgjedhur ky Parlament për të diskutuar me Beogradin për çështje që janë fare jotransparente për Parlamentin e Kosovës, edhe për popullin e Kosovës. Pastaj, duhet kuptuar se kjo çështje është me rëndësi të na unifikojë në qëndrim dhe jo të na ndajë apo krijojë probleme krejt të panevojshme në këtë moment historik që po kalojmë si popull dhe si vend.

Për këtë arsy, mendoj se do të ishte mjaft me rëndësi që të hapet diskutimi, dhe propozimi i Partisë Demokratike të Kosovës të vihet në votim këtu në Parlament për t'u futur në rend dite. Këtu është Kryeministri dhe me siguri se do ta ndajë kënaqësinë me ne për dialogun me Koshtunicën.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën zoti Ylber Hysa, besoj në emër të ORA-s.

#### DEPUTETI YLBER HYSA:

Po, ju faleminderit. Unë do ta shfrytëzoj fjalën që në emër të Grupit Parlamentar të përkrah këtë iniciativë përfaktin se edhe çështja e decentralizimit – tashmë e shtyrë – në fund ka ndodh në Parlamentin e Kosovës dhe si e tillë ndërlidhet edhe me çështjen e dialogut dhe përgatitjeve për statusin final, andaj logjikisht këto dy pika duhet shtruar këtu.

Unaë e kuptoj se kjo ndodh brenda një procedure, ndonëse e kuptoj edhe fjalën e Kryeministrit kur tha se i duhet kohë të përgatitet përfakt këtë çështje. Mirëpo, duke marrë parasysh paraqitjet e tij në media dhe të njerëzve të tjerë të Qeverisë dhe të Presidencës – kuptoj se, nëse një gatishmëri e tillë ka ndodhur në publik, ajo gatishmëri duhet të ekzistojë dhe të shpjegohet edhe këtu pranë Parlamentit lidhur me platformën. Nuk besoj se është bërë një deklarim pro takimit me udhëheqësit e Beogradit pa pas një platformë ose një koncept. Andaj, ne kishim dashur që ta shohim këtu atë koncept, atë platformë dhe ta debatojmë së bashku. Në këtë aspekt, kisha dashur që ta bëjmë një gjë që tashmë një kohë të gjatë s'e kemi bërë, duke respektuar orarin dhe rendin e ditës. Domethënë, së pari ta pranojmë rendin e ditës dhe mundësisht të votojmë përfakt këtë pikë dhe përfakt rendin e ditës ashtu sikur nuk ndodhi në fillim të hapjes së kësaj mbledhjeje.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit. Më lejoni ta respektoj Rregulloren, nëse nuk paraqitet askush tjetër nga grupet parlamentare. E kam konsideruar si të arsyeshme dhe kam lejuar arsyetimin e propozuesit për pikën e rendit të ditës. Prandaj, tash duhet të marrim vendim për propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që të hapet debat.....Urdhëroni. E ka fjalën profesor Alush Gashi, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

I ndenuari zoti Kryetar,

Ne kemi ardhë me një rend dite për Seancën e sotme, por natyrish respektojmë edhe procedurat aktuale. Në nuk kuñdërshtojmë propozimin që në Kuvendin e Kosovës të debatohen çështje të ndryshme, në veçanti çështje të rëndësishme. Fatmirësish ne sot këtu kemi Kryeministrin, i cili deklaroi publikisht se i nevojitet kohë për t'u përgatitur për këtë çështje. Prandaj, ne i jepim kohë dhe e mbështesim kërkesën e tij që t'i jepet kohë përgatitje për debat. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit. E ka fjalën Gjylnaze Syla – nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:**

Faleminderit, zoti Kryetar.

Grupi Parlamentar i Aleancës, pikërisht duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje - mbështet mendimin e Kryeministrit se duhet përgatitur për një seancë tjetër dhe se i duhet kohë për t'u përgatitur, por gjithashtu edhe atë që ju e propozuat se në qoftë se është nevoja atëherë mund të mbahet seancë e posaçme ku do të debatohet vetëm për atë pikë të rendit të ditës. Faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Faleminderit Profesor Kuçi paraqitet për fjalë. Jakup, po t'bëhen tri herë paraqitje... Urdhëro Hajredin.

**DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:**

Unë e kuptoj se është çështje e tij që mund të thotë - duhet përgatitje apo mospërgatitje, por nuk mund ta kuptoj konfirmimin para këtyre përgatitjeve. Do të thotë, është shumë me rëndësi që në Kuvend të flitet a duhet të ketë bisedime apo jo dhe më pastaj edhe përmbytjen e atyre bisedimeve. Do të thotë, është shumë me rëndësi që Kuvendi ta japë dritën e gjelbërt - ose jo - për këto bisedime dhe më pastaj do t'i japim kohë edhe Kryeministrin, edhe Kryetarin të Kosovës se çfarë bisedime dhe në cilin nivel, për cilat çështje do të bisedohet. Pra është shumë me rëndësi se ky konfirmim ka ndodh në mënyrë jolegale të mundur, për arsy se është dashur paraprakisht në Kuvend të merret drita e gjelbërt dhe më pastaj të konfirmohet një bisedim i tillë. Përbajtja do të jetë çështje tjetër. Është çështje e Kryeministrin, dhe e Kryetarin që i ofrojnë në Kuvend dhe pastaj Kuvendi me diskutimet e tij, me siguri do të kontribuojë për atë përbajtje të bisedimeve. Por është shumë me rëndësi edhe të dihet pse është dhënë pëlqimi para se Kuvendi të jep pëlqimin për një gjë të tillë. Ndoshta Kuvendi do të mendojë se s'ka nevojë për bisedime të tillë? Pra, gjërat kanë shkuar aq larg që Kuvendi e ka vështirë ato t'i kthejë në pikën zero. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Edhe një herë e kërkon fjalën Jakupi, ndoshta përfundimisht. Urdhëroni.

DEPUTETI JAKUP KRASNIOI:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike tërheq kërkesën për votim sot me një kusht që debati për bisedime mos të zhvillohet pas bisedimeve dhe të caktohet data kur Kryeministri apo dikush tjeter sot të caktojë datën kur do të mbahet seanca, dhe ne e pranojmë atë kërkesë të Kryeministrat.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit shumë. Besoj se u qartësuam. Ishte sqarim imi dhe më vjen mirë që u kuptua si duhet. Do të thotë, pas fjalës së Kryeministrat dhe të grupeve parlamentare, shihet se për sot hiqet dorë. Unë, edhe një herë po cek – në rast kërkese të grupeve parlamentare, Kryesia do të ftohet dhe do të caktohet seancë e nevojshme. Do të thotë do duhej ndjekur këtë procedurë. Ju faleminderit. Kërkoi falje Gjergj, e kisha në plan me ua dhënë fjalën, por tani e lash për më vonë.

Prandaj, ftoj Kryeministrin, zotin Bajram Kosumi që për pikën e rendit të ditës – reformën, ta paraqesë fjalën hyrëse. Foltorja është e juaja, Kryeministër.

KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:

Faleminderit Kryetar i Kuvendit, zoti Daci. Të nderuar ministra, të nderuar deputetë, Fillimi, më lejoni të shpreh falenderimet e Qevit isë për interesimin dhe angazhimin e Kuvendit të Kosovës që të debatojë për procesin e decentralizimit.

Qeveria ime dhe unë personalisht, e mirëpresim këtë diskutim. Dëshirojmë që, nëse e sheh të arsyeshme Kuvendi, të miratojë edhe rekomandime për procesin e decentralizimit, kurse Qeveria t'i përfshijë ato në projektin e vet përfundimtar.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që tash të paraqes disa të dhëna të arritura, por edhe vështirësitet rrith procesit të decentralizimit, si dhe për projektin e pilot-komunave.

Reforma e pushtetit lokal, është një proces, të cilin e kanë ndërmarrë – pothuaj – të gjitha vendet evropiane. Në veçanti, me këtë çështje, gjatë dekadës së fundit, janë marrë vendet që kanë kaluar nëpërt procesin e transicionit nga sistemi komunist në atë demokratik. Kjo çështje tashmë është shtrirë në gjithë rajonin dhe ka arritur edhe në Kosovë.

Pushteti lokal në Kosovë ka një traditë më të gjatë se gjysmë shekulli dhe një histori të ndërlidhur politike. Ky sistem i pushtetit lokal rrjedh prej bazës socialiste jugosllave.

Ndryshimi i sistemit politik, ndryshimi i gjendjes demografike dhe perspektivat e integrimit evropian të Kosovës, janë arsyet që shtyjnë në drejtim të procesit të reformave. Këta faktorë e bëjnë të domosdoshëm këtë segment dhe proces të reformimit.

Nisma e procesit të reformës së pushtetit lokal në Kosovë, në përputhje me Rekomandimet, të cilat erdhën nga Këshilli i Evropës, është nisur dhe aprovuar nga Qeveria Rexhepi. Një nga segmentet e kësaj kornize, është decentralizimi si dhe projekti për pilot-komunat. Për këto

angazhime, më duhet ta falënderoj ish kryeministrin Rexhepi dhe ish ministrin e shërbimeve publike zotin Jakup Krasniqi.

Të nderuar deputetë,

Decentralizimi paraqet vetëm një segment të reformës së pushteti lokal. Decentralizimi ka përqelli krijimin e qasjes më të mirë të qytetarit në zyrat e administratës së pushtetit dhe vendimarrjen sa më të drejtpërdrejtë të qytetarëve për çështje të tyre të përditshme jetike e administrative. Kjo është ofertë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Decentralizimi është proces administrativ e kushtetues, dhe ai nuk është koncipuar që të bartë konsekuenca negative territoriale për Kosovën. Ky është argumenti i parë pse duhet bërë decentralizimi.

Decentralizimi, nga ana tjetër, është një ofertë serioze për bashkësitet e vogla etnike në Kosovë. Në disa njësi komunale, shumicën e qytetarëve do ta përbëjnë bashkësitet e vogla etnike – serbët, turqit e tjerë. Dhe, si rezultat, shumica e anëtarëve të asambleve komunale do të janë serbë, turq, romë, hashkali, bosnjakë e tjerë. Kryetari i komunës do të jetë njëri nga këto komunitete. Të gjitha këto janë mesazhe për bashkësitet etnike në Kosovë, e sidomos për serbët se Qeveria e Kosovës ofron zgjidhje për problemet e tyre dhe ka ofertë për vizionin e tyre për të jetuar në një Kosovë të lirë e demokratike. Ne po bëjmë veprime konkrete për të bindur ata se ne nuk i konsiderojmë si një pakicë të futur në një skutë por si një pjesë të nderuar të tërësisë, si pjesë të qeverisjes në Kosovë. Me këtë proces, ne duam të dërgojmë mesazhin tonë se serbët kanë të ardhme të sigurtë në Kosovë dhe se Qeveria e Kosovës është e aftë të gjejë zgjidhje të duhura për ta dhe garanton realizimin e atyre zgjidhjeve. Ky është argumenti i dytë pse duhet bërë decentralizimi.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni tash të flas për atë që është folur publikisht lidhur me decentralizimin, që në fakt Qeveria nuk punon që të njëjtat të ndodhin.

Pra, dhe së pari:

- Nuk do të ketë komuna artificiale njëetnike;
- Nuk do të ketë copëtim apo enklavizim të ri të territorit të komunave;

Qëndrimi i Grupit të Kontaktit për moscopëtimin e territorit të Kosovës na e forcon këtë bindje tonë. Decentralizimi tenton hapjen e enklavave dhe integrimin e tyre në tërësinë e Kosovës.

- Nuk do të ketë polici dhe gjykata të veçanta lokale. Sistemi policor dhe ai gjyqësor janë dhe do të janë unik në tërë territorin e Kosovës;
- Nuk do të ketë ndryshim jo të ligjshëm të territorit të komunave.

Ju e dini se për ndryshimin e territorit të komunave vendimin definitiv do ta marrë Kuvendi i Kosovës e jo dikush tjetër.

Po ashtu, dua t'i them edhe dy aspekte politike të çështjes.

E para. Përveç projektit të përgjithshëm për integrim të bashkësise etnike serbe në shoqërinë e re të Kosovës, ky është projekt i parë konkret që iu ofron atyre mundësi të mira për integrim. Politika e Kosovës ka humbur gjashtë vjet kohë kot duke u marrë me Beogradin apo edhe me lojtarët e tyre politik në Kosovë, në vend se të merret me vetë qytetarët serb të Kosovës.

Unë kam folur drejtpërdrejt me qytetarët serb të Kosovës dhe jam siguruar se ata kanë pikëpamje tjeter për Kosovën nga që kanë politikanët e Beogradit apo edhe nga disa politikanë serb të Kosovës. Këta njerëz, do të thotë qytetarët serb të Kosovës, besojnë në të ardhmen e tyre në Kosovë dhe nc duhet t'i ndihmojmë ata që të integrohen në të gjitha strukturat e shoqërisë.

E dyta. Në kohë kur do të bisedohet për krijimin e shtetit të Kosovës, çështja e serbëve të Kosovës do të jetë një nga çështjet e rëndësishme për diskutim. Unë jam shumë i bindur se ky projekt për decentralizim, nëse do të ketë implementim të suksesshëm të tij, do të jetë baza e atij diskutimi. Ky është një projekt i Kosovës dhe si i tillë mënjanon projektet jokosovare. Ne, me qasje proaktive i marginalizojmë projektet tjera të disfavorshme për shoqërinë e Kosovës. Prandaj, çdo abstenim yni do të zëvendësohet me projekte tjera, të bëra nga tjetërkush dhe për interesat e hartuesit të tyre.

Pilot-projektet, për njësitë komunale, janë vetëm një provë për të vërtetuar se si duhet të përgatitet në të ardhmen decentralizimi i pushtetit. Gjatë kësaj periudhe, varësisht prej përvojave praktike, do të përgatiten ligje për reformën e pushtetit, ku do të përfshihet edhe decentralizimi. Kjo don një periudhë më të gjatë kohore, por ky nuk është argument se ne nuk duhet t'i bëjmë pilot-komunat.

Ligji për decentralizim obligon decentralizimin në gjithë territorin dhe nënkupton një buxhet shumë më të madh. Këto nuk mund të bëhen tash. Besoj se me këtë fakt pajtohet edhe opozita, sepse është një fakt i theksuar prej shumë institucioneve financiare ndërkombëtare – si Fondi Monetar Ndërkombëtar, e tjera.

Reforma rrënjosore dhe decentralizimi i vërtetë do të bëhen vetëm pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës, atëherë kur do të janë të gatshme ligjet, buxheti dhe pushteti stabil i shtetit të Kosovës.

Populli dhe Qeveria, besojnë dhe presin se gjatë këtij viti do të fillojë procesi i definimit të statusit final të Kosovës. Për ne - pritja ka qenë tepër e gjatë. Nëse vendimet e nevojshme kyçë shtyhen, atëherë ne trezikojmë që të humbim diçka për çka kemi punuar dekada me radhë, e sidomos në gjashtë vitet e fundit.

Ne, e dimë të gjithë, se vullneti i popullit të Kosovës është pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës. Kjo çështje bartë me vete edhe pyetje të mëdha. Për shembull: cilat do të janë garanciat për minoritetet në Kosovë. Ne besojmë se me procesin e decentralizimit, pos që do të krijojmë një bazë të mirë për një fillim gjithëpërfshirës të reformës së pushtetit lokal, do të krijojmë edhe kushte të cilat do t'i inkurajojnë të gjitha grupet etnike që të kontribuojnë fuqishëm në krijimin e ardhmërisë demokratike të Kosovës.

Procesi i decentralizimit vërteton se Kosova dhe institucionet e saj janë të gatshme të fillojnë një proces të tillë.

Qëndrimet e Grupit të Kontaktit për statusin final të Kosovës janë inkurajuese për të gjithë ne, në mënyrë që sa më shpejt që është e mundur ta përgatisim funksionimin e Kosovës si shtet demokratik e evropian, ku të gjithë qytetarët kanë të drejta dhe obligime të njëjta. Të gjitha projektet e Qeverisë së Kosovës shkojnë në këtë drejtim. Konsideroj se edhe ky projekt është i tillë.

Në fund, lus deputetët e Kuvendit që të përkrahin procesin e pilot-komunave dhe mundësishët të bëjnë rekomandime që do ta ndihmonin këtë proces, në mënyrë që procesi – si i tillë – të

jetë i suksesshëm dhe të shërbejë si bazë për reformën e tërësishme të pushtetit lokal, e cila do të ndodhë pas përcaktimit të statusit final të Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACH:

Kryeministër, ju faleminderit. Ptoj Ministrin e pushtetit lokal, zotin Lutfi Haziri ta marrë fjalën. Urdhëroni Ministër.

#### MINISTRI LUTFI HAZIRI:

Faleminderit. I nderuari Kryetar, të nderuar deputetë, i nderuar zoti Kryeministër, ministra, zonja dhe zotërinj,

Tema, për të cilën do të diskutohet sot, është ngjarje dhe një ndër projektet më të rëndësishme që po kalon Kosova. Megjithëse në opinion ky proces i reformimit të pushtetit lokal është prezantuar si risi dhe projekt i dizajnuar nga kjo Qeveri aktuale, ky plan ka një gjenezë e cila fillet i ka në punën e qeverisë së kaluar.

Ministria, të cilën unë e udhëheq, e që është themeluar pas zgjedhjeve të fundit, ka trashëguar dokumentin bazik – komizën ligjore për qeverisjen lokale, si dhe obligimet politike të cilat kjo Ministri sot është duke i implementuar.

Më lejoni që në pikë të shkurta dhe pa hyrë në detaje t'i prezantoj disa momente të rëndësishme të cilat i kanë paraprirë punës së Ministrisë.

Raporti i Përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, ambasadorit Kai Aide, pas ngjarjeve të marsit të vitit të kaluar, e ka rikthyer çështjen e decentralizimit në agjendë, duke kërkuar që ky proces të përshtaptohet. Bashkësia ndërkombëtare ka adaptuar, në bazë të kërkesës së Prishtinës së Këshillit të Sigurimit, të Grupit të Kontaktit dhe atëherë Qeveria ka thënë se jemi në presion të ndarjes së Kosovës. Duke ecur në këtë proces, kjo Qeveri ka bërë këta hapa. Andaj, Qeveria e udhëhequr në mandatin e kaluar, në korrik të vitit 2004 ka miratuar dokumentin kornizë për reformën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, me një marrëveshje që puna e ekspit të jetë e myllur dhe pa pjesëmarrje politike, por në nivel teknik.

Ajo që Ministria e pushtetit lokal, pa zgjedhjeve të fundit ka bërë, në dhjetor të vitit të kaluar është se ka hapur dhe ka bërë procesin transparent për publikun. Ky dokument, i cili është punuar nën përkujdesjen e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe UNMIK-ut - është dokument kyç, në bazë të të cilit është dizajnuar edhe projekti i krejt reformave.

Më lejoni t'ju them se, prej momentit, në të cilin është themeluar Grupi punues, ka bërë edhe me shumë projekte, të cilat Kosova, në atë kohë i ka pas në qarkullim. Tri nga gjashë projektet që kanë qarkulluar në administratën e Kosovës, në dy nivele – kanë qenë të dizajnuara nga fqinji ynë verior Beograd, një nga Këshilli i Evropës dhe tri projekte tjera në nivel të Kosovës. Kësaj çështjeje i ka paraprirë edhe një dialog në nivel politik i myllur dhe një dialog teknik i organizuar nga OSBE-a me ftesë të Përfaqësuesit special i cili ka diskutuar shumë për atë se cilat janë nevojat e pushtetit lokal të Kosovës. Këto nivele politike kanë sjellë si kërkesë nevojnë e reformimit të pushtetit lokal në tërësi, dhe procesin e decentralizimit si nevojë e të ardhmes së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Qëllimet e përgjithshme strategjike të projektit për reformën e vetëqeverisjes lokale, siç janë formuluar në dokumentin kornizë në vitin 2004, janë që kjo reformë të përmirësojë shërbimet në nivel lokal dhe me këtë të kontribuojë në sigurimin e Qeverisë së qëndrueshme për kushte

të jetesës për të gjithë njerëzit e Kosovës; për integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës; për themelimin dhe konsolidimin e institucioneve funksionale demokratike në Kosovë që njëkohësisht është edhe pjesë e standardeve për Kosovën.

Decentralizimi është një proces nëpër të cilin kanë kaluar të gjitha demokracitë në regjion dhe është bazuar në përvojën ndërkombëtare mbi reformën e qeverisjes lokale, proces i cili ka qenë shumë i gjatë, shumë i ndërlidhur dhe shumë i shtrenjtë.

Ministria për Administratën e Qeverisjes Lokale, si një organ përgjegjës përbrenda institucioneve të Kosovës, propozon një qasje sipas fazave që synon implementim të plotë të reformave të propozuara për qeverisjen lokale deri në vitin 2008.

Më lejoni t'ju them se është punuar shumë në eliminimin e defekteve që ka pas dokumenti komizë i miratuar në mandatin e kaluar.

Gjatë fazës së parë, dhe paralelisht me krijimin e njësive të reja të vetëqeverisjes lokale të gjitha njësive ekzistuese dhe njësive të reja të vetëqeverisjes lokale - do tu besohen në mënyrë progresive kompetenca shtesë ekzekutiveve dhe detyra të deleguara, të cekura sipas Dokumentit komizë.

Në vitin 2005, puna do të përqendrohet dhe mbështetet në: zhvillimin e planit të dizajnuar të projektit që mbulon të gjitha fazat e reformës, përfshire edhe kalimin gradual të kompetencave fiskale të komunave, duke marrë parasysh përvojat rajonale dhe praktikat më të mira për nevojat e pushtetit lokal të Kosovës; përpilimin dhe miratimin e legjisacionit të ri dhe amendamenteve legislative prioritare.

Ligji për qeverisje lokale do të hartohet gjatë këtij viti dhe shpresojmë do të miratohet nga Parlamenti i Kosovës së shpejti.

Hartimi i parë i ligjit për financat lokale do të jetë i gatshëm të prezantohet në fund të këtij viti, pastaj edhe ligjet tjera, siç është ligji për zgjedhjet lokale, i cili duhet të miratohet deri në fund të këtij viti, për arsy se janë paraparë zgjedhjet lokale në nëntor të vitit të ardhshëm. Po ashtu, gjatë këtij viti do të punohet paralelisht përvëç në ndërtimin e infrastrukturës ligjore, edhe në: zbatimin e menjëherëshëm të pilot-projekteve; fillimin e bartjes së kompetencave; ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të domosdoshme dhe të duhura administrative.

Gjatë vitit 2006 duhet të kryhen të gjitha punët legislative. Do t'u besohen kompetenca të reja njësive; do të kryhet regjistrimi i popullatës dhe do të mbahen zgjedhjet lokale, në bazë të ligjit të ri për zgjedhje, duke krijuar kështu organe që janë të afta të marrin mbi vete përgjegjësi të shtuara.

Në vitin 2007, Ministria e Administratës Lokale, në emër të Qeverisë, do të bëjë të gjitha përgatitjet teknike të domosdoshme për zbatimin e plotë të reformës për të lejuar dhe krijuar mundësi që në janar të vitit 2008 të fillojë procesi i reformimit të plotë të administratës lokale në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'i them edhe disa fjalë rrëth pilot-njësive apo pilot-projekteve si pjesë testuese të këtij procesi të rëndësishëm që po kalon Kosova.

Siq thash më herët, puna e Ministrisë bazohet në dokumentin e Qeverisë së kaluar dhe Kornizës kushtetuese. Dokumenti komizë, i miratuar në korrik të vitit 2004, parasheh krijimin e pilot-projekteve, faqë 7, paragrafi 5.

Qëllimi i plotë i pilot-projekteve është që të testojë krijimin e njësive të reja të vetëqeverisjes lokale. Në të njëjtën kohë, pilot-projektet do të nxisin shpërbërjen e strukturave paralele ekzistuese dhe integrimin e plotë të gjitha institucioneve në kornizën institucionale të Kosovës, ato struktura paralele të injoruara gjatë viteve të kaluara duke bërë pamundësi që të ndikohet apo të punohet më shumë në integrimin e plotë të komuniteteve.

Përmes një monitorimi 18 mujor do të shikohet nga afér zbatimi i ligjit dhe ushtrimi i detyrave vetëqeverisëse lokale, mbi bazë të rezultateve të treguara, dhe grupet punuese të Qeverisë, në përputhje me ligjin - që do të miratohet, do të vendosin për procesin e mëtejshëm.

Pilot-projektet do të propozohen si pilot-njësi komunale, që janë krijuar brenda një numri të kufizuar të komunave ekzistuese dhe pa dëmtuar apo cenuar kufijtë aktual komunal.

Kufijtë administrativ të pilot-njësive komunale, vendosen duke marrë parasysh kriteret, siq janë dhënë në dokumentin kornizë, duke eliminuar si defekt nga ai dokument ndryshimin e kufijve aktual, përfshirë numrin e banorëve, tiparet gjeografike, infrastrukturën, qëndrueshmërinë ekonomike, kulturën, gjuhën dhe në bazë të regjistrat civil listës së votuesve brenda zonës kadastrave.

Gjatë fazës përgatitore, nuk do të lejohet ndryshimi i kufijve aktual komunal. Shpjegimi i pasuesit të fundit që e paraqes para jush, është se dokumenti kornizë ka pas defekte serioze.

Pilot-njësitë janë të shpërndara gjeografikisht dhe në mënyrë të ndryshme sa i përket strukturës, përbëjes etnike, gjendjes ekonomike e tjera. Kjo do t'na ndihmojë që të vlerësohet efekti i reformave në Kosovë në të gjithë terrenin e saj të shumëlojshme.

Të nderuar deputetë, i nderuari zoti Kryetar,

Siç përmenda edhe më herët, ky proces është shumë i ndërlikuar dhe i ndejshëm politikisht në fazën në të cilën po kalon Kosova. Ky proces nuk është marrë si iniciativë partiake apo ideologjike. Është kërkesë e bashkësisë ndërkombëtare dhe kërkesë e kohës në kuadër të zhvillimeve që u përmendën për të kaluarën e aférme, varësish nga administrimi apo niveli politik që ka udhëhequr Kosovën në këtë fazë. Prandaj, jam i vetëdijshëm për implikime politike dhe do të jam i kujdeshëm që ky proces të ketë mbarëvajtje dhe të zbatohet në principin e përfitimit të të gjithë qytetarëve të Kosovës. I kuptoj shqetësimet dhe brengat e të gjithëve, por megjithatë ky proces i rëndësishëm duhet të ecë përpëra dhe Qeveria nuk heziton të marrë mbi vete dhe të udhëheqë mendimin, kuptohet dhe autoritetin e madh që ka Asamblea apo Parlamenti i Kosovës.

Tentimi që ky proces të politizohet për nevoja të marketingut ditor politik dëmton rënd interesat e qytetarëve. Qytetarët janë të vetëdijshëm për obligimet që ka Kosova dhe obligimet që janë marrë nga bashkësia ndërkombëtare në kuadër të arrijeve tona edhe në pushtetin lokal.

Ju lus, dhe kërkoj nga ju që të mbështetni procesin, duke kuptuar rëndësinë dhe obligimet që kemi marrë në të kaluarën e aférme dhe përgatitjet që ka bërë Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal. Ju faleminderit, sinqersisht.

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju faleminderit. Para se tē hap debatin, t'ju them se nē sallë janë 109 deputetë. Lus deputetët që nuk kanë plotësuar formularin e paraqitjes për debat ta bëjnë këtë dhe dorëzojnë. Nëse e kam tē pasqyruar kështu, do ta shfrytëzojmë edhe kohën si duhet.

Hapim debatin për çështjen e shtruar në rend dite. Për fjalë është paraqitur Alush Gashi, nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Urdhëroni profesor.

## DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuar zotëri Kryetar, Kryeministër dhe ministra, të çmuar deputetë, zonja dhe zotërinj, vëzhgues vendor dhe ndërkombëtar,

Gjatë vitit të fundit, me kujdes tē posaçëm kemi përcjellur nga distanca aktivitetin e Qeverisë lidhur me decentralizim apo reformën e pushtetit lokal.

Zoti Ministër i pushtetit lokal, ju falënderoj për prezantim të dokumentit tuaj sot në Seancë plenare.

Ne, bisedojmë për proces. Ne e mbështem procesin dhe jemi tē angazhuar në gjetje tē rrugës më tē mirë që t'i shërbejmë qytetarit të Kosovës. Kemi vullnet tē mirë për këtë çështje dhe që në fillim ripërsërisim përcaktimin tonë për angazhim institucional për sigurim tē barazisë së plotë para ligjit dhe tē dhëniec së mundësisë së njëjtë zhvillimore për tē gjithë qytetarët e Kosovës.

Fatmirësisht, jemi duke hyrë në një fazë tē zhvillimeve demokratike sikur edhe vendet në transicion. Jemi duke bërë përpjekje që tē gjithë qytetarët t'i shërbimë demokratike tē kohës në tē cilën jetojmë, me anë të përkufizimit të kompetencave të qeverisjes lokale. Dallimi qëndron në atë se vende në transicion janë shtete sovrane, me njohje ndërkombëtare dhe janë anëtare të Kombeve të Bashkuara. Ndërsa, Kosova, ende është pa njohje ndërkombëtare, por fuqimisht e përcaktuar në realizim tē drejtës për vetëvendosje, gjë që, për shumicën dërmuese të qytetarëve të Kosovës - është pavarësia.

Aktualisht, Kosova ka institucionë tē përkohshme demokratike, ku fjalën e fundit e ka Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm të OKB, që njëherit është edhe në krye të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mision ndërkombëtar i pareformuar, me mandat tē përkohshëm, i cili në vitin e parë, dhe shpresoj në këtë tē fundit tē misionit tē vet, ishte i suksesshëm.

Zoti Kryetar, nuk është fshehtësi se qëllimi politik i vendorëve - me qëllimin politik tē ndërkombëtarëve - ndryshon. Shumica dërmuese e qytetarëve të Kosovës dhe tē zgjedhurit e tyre, angazhimin e tyre e kanë për pavarësi. Ndërsa, institucionet ndërkombëtare në Kosovë, vendimet tona tē marrura këtu në Kuvendin e Kosovës - i skulpturojnë për kornizë tē paanësise.

Minoriteti serb, në këtë fazë, ashiqare është kundër pavarësisë. Ata kërkojnë "kthimin e ushtrisë dhe policisë serbe në Kosovë dhe lidhje kushtetuese me Serbinë" - gjë që, shumica shqiptare: për t'gjallë - nuk e pranon. Minoriteti serb vazhdon me deklarata se, nëse nuk plotësohen këto kërkesa, ata tē gjithë do tē shkojnë.

Në këtë atmosferë të tri qëndrimeve të ndryshme politike, të shqiptarëve dhe të pakicave dhe të grupeve etnike joserbe për pavarësi, të institucioneve ndërkombëtare për paanësi dhe të minoritetit serb kundër pavarësisë – është vënë në rend dite reforma e pushtetit lokal, ku ende nuk është bërë transformim i kompetencave nga Misioni i Kombeve të Bashkuara te institucionet demokratike të Kosovës, dhe ende nuk është bërë regjistrimi i popullsisë.

Edhe përkundër kësaj, duket se ekziston përkushtim i fuqishëm i Qeverisë, që në Kosovë disa e quajnë edhe laborator, ky eksperiment të ketë rezultate të dobishme për qytetarët e Kosovës.

Ne, gjithnjë kemi menduar se reforma e qeverisjes lokale duhet bërë për të kënaqur të gjithë qytetarët e Kosovës pavarësisht përkatësisë së tyre etnike. Por tani, botërisht dihet se decentralizimi është shndërruar në mjet për kënaqje të pakicës serbe. Edhe këtë e kuptojmë, se miqësish na është thënë në vazhdimësi vitin e fundit edhe nga ata që përfaqësojnë shtete, të cilat – me dekada – nuk kanë arritur ta përfundojnë këtë proces në vendet e tyre. Ritheksoj se nuk dyshojmë në qëllimin e mirë të tyre kur na inkurajojnë në proces.

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Kosovës botërisht e ka thënë dhe tani e rikonfirmon se ky proces do të zhvillohej më lehtë dhe më mirë në Kosovë të pavarur.

Megjithatë, të shtyrë nga domosdoja për arritje të qëndrueshmërisë demokratike, ne jemi duke bërë përpjekje për të gjetur zgjidhje sa më të mirë edhe në këto rrëthana. Ju sigurojmë angazhimin tonë që Kosova të udhëhiqet bazuar në kushtetutë ku garantohen të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit sipas standardeve më të larta për të gjithë qytetarët e Kosovës pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, racore, gjinore, të gjuhës, religjionit, bindjeve politike dhe statusi social, por njëkohësisht këmbëngulim në parime ndërkombëtare lidhur me këtë çështje.

Gjatë kësaj kohe, kemi mësuar se reforma e pushtetit lokal është proces i gjatë, për të cilin duhet pyetur popullata të cilës i dedikohet dhe se nevojitet mbështetje financiare për realizim.

Duke pas parasysh nivelin e hezitimit të minoritetit serb që në këtë fazë t'iu besojë institucioneve të Kosovës, ne shprehim gatishmëri për ofrim të argumenteve se singlerisht jemi të përcaktuar që me ta dhe bashkësinë ndërkombëtare të gjemë mënyrën më të përshtatshme për adresim të të gjitha çështjeve. Nuk ka bazë përfrikë se në Kosovë të pavarur ne do t'i harrojmë obligimet lidhur me shërbim të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në vendin tonë nuk do të lejojmë asnjë lloj të diskriminimit. Kërkojmë reformë të pushtetit lokal, të bazuar në të dhëna shkencore dhe empirike. E kemi një përvojë të vendit tonë, ekziston përvoja e vendeve fqinje, por edhe të vendeve demokratike. Të gjithë na thonë, se reforma nuk arrihet për një kohë të shkurtër. Ne jemi të singertë në përcaktimin tonë përfshi gjetur rrugën më të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Ndoshta kjo është arsyaja se para miratimit të ligjeve është mirë të studiohen mirë nevojat e vendit tonë dhe përvojat e të tjera. Ndoshta është mirë të testohen në veprim, e pastaj të fillohet me ligje. Apo, së pari të caktohet komiza ligjore, e pastaj të shikohet se a e pranon atë përditshmëria jonë këtu në Kosovë.

Natyrisht kjo është çështje e vendigjit se cilës rrugë duhet shkuar, por përfshi gjë nuk kemi dyshim: Nuk dyshojmë në përcaktimin tonë që të punojmë intensivisht përfshi gjetje të rrugës më të mirë përfshi organizim të qeverisjes lokale.

Zotëri Kryetar,

Forca e një vendi nuk varet vetëm nga madhësia e tij gjeografike dhe pasuritë natyrore, por nga qëndrueshmëria e institucioneve të tyre demokratike dhe mirëqenia e të gjithë qytetarëve. Ju flojmë të mos ndalemi derisa së bashku të gjemjë zgjidhje, e cila do të siguron shërbime efikase për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit. E ka fjalën zotëri Jakup Krasniqi, shef i Grupit Parlamentar të PDK, le të përgatitet Gjylnaze Syla, shefe e AAK.

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

†

Zoti Kryetar, zoti Kryeministër, të ndëruar deputetë,

Ka më tepër se një vit tema e përfolur në skenën politike vazhdon të jetë reforma e vetëqeverisjes lokale, kuptohet pas rekomandimeve të Këshillit të Evropës, të hartuar nga ekspertë që ishin ngarkuar nergut për këtë qëllim. Ata i dhanë pesë rekomandime, prej të cilave rekomandimi i tretë është më i studiuari në të gjitha aspektet - përfshirë edhe faktorin demografik, faktorin ekonomik e financiar dhe faktorin gjeografik.

Qeveria Rexhepi, pas miratimit që më parë e kishin dhënë liderët e partive politike në rezidencën e shefit të UNMIK-ut, zotit Hollker, merr vendim që të formojë një grup të punës, të cilin duhet ta udhëhiqja unë, pasi asokohe isha ministër në Ministrinë e Shërbimeve Publike, në kuadër të së cilës ishte Departamenti i administratës lokale. Pas më tepër se dy muaj të punës sistematike nga grupei i punës, nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, të UNMIK-ut, të Këshillit të Evropës, të USAID-it, të minoriteteve dhe të shoqërisë civile hartoherë projektkorniza për reformën e qeverisjes lokale. Në fillim ishte prezant edhe përfaqësuesi i serbëve të Kosovës, por më vonë - si duket - nuk pat nevojë sepse kishte kush t'i shtyjë kërkesat e tyre. Në këtë kohë, Kuvendi i Kosovës ishte në pushim. Prandaj, në mandatin e kaluar nuk ka pas mundësi të procesohet në Kuvend. Në Kuvend nuk do të procesojë as Qeveria që doli nga zgjedhjet e 23 tetorit 2004. Me ndërrimet që u bënë në Qeveri, kjo e fundit, i ndërroi të gjithë anëtarët e gruipurit të punës - përfshirë edhe drejtoren e DAL-it, i cili ka qenë ndër njohësit më të mirë të dokumentit kornizë.

Partia Demokratike e Kosovës, pasi të fillojë ky proces, ishte e mendimt se duhet të arrihet një marrëveshje politike në mes shumicës dhe pakicës në Kosovë mbi bazën e së cilës do të krijojë baza kushtetuese dhe ligjore e këtij procesi dhe që do të duhet të mbështetet në Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale, në Rekomandimet e Këshillit të Evropës për reformimin e vetëqeverisjes lokale. Asokohe, propozimi i PDK-së është kundërshtuar ashpër nga partitë politike që tani janë në koalicion. Ishte kërkesë e bashkësisë ndërkombëtare, e Grupit të Kontaktit, e Bashkimit Evropian që të hartohej një dokument kornizë dhe do t'i hapte rrugë reformimit të vetëqeverisjes lokale. Dokumenti nuk ishte i përkryer, ndonëse qëllimi ishte i mirë. Atëherë dhe sot jam i bindur se vetëm Kuvendi i Kosovës e ka të drejtën të vendosë për organizimin e të gjitha pushteteve në Kosovë. Në Kosovë, i vetmi institucion që ka mandatin e qytetarëve të Kosovës, është Kuvendi i Kosovës. Atëherë dhe sot jam i bindur se në Kosovë duhet të ndodhë një reformim i thellë i vetëqeverisjes lokale apo i decentralizimit si një proces që kërkon kohë.

Reformimi apo decentralizimi i vetëqeverisjes lokale, në nenin 2 të shtojcës së Këshillit të Evropës për vetëqeverisjen vendore, shkruan: "Parimi i vetëqeverisjes vendore njihet në legjislacionin vendas dhe atëherë kur kjo praktikohet edhe në kushtetutë", ndërsa në nenin 3 thuhet: "Vetëqeverisja vendore do të thotë e drejtë dhe aftësia e autoriteteve vendore brenda

kufijve të ligjit për të rregulluar dhe drejtuar një proces të konsiderueshëm të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullsisë vendore". Gjithnjë, sipas dokumentit standard për decentralizim, në nenin 5 thuhet: "Ndryshimet e kufijve të autoritetave vendore nuk bëhen pa një konsultim paraprak me bashkësinë vendore përkatëse, mundësishët nëpërmjet një referendumi kur kjo lejohet me statut".

Dokumentin kornizë e kemi prezantuar në Bruksel më 17 shtator 2004 dhe atje, në fjalën time, kam thënë: çdo reformë e pushtetit lokal, e lindur brenda Kosovës, e hartuar nga vetë kosovarët, kishte mundësi që në mënyrë realiste t'u përgjigjej brengave të qytetarëve. Prandaj, edhe mund të konstatojmë se ky proces po ecën ngadalë, se nuk është i përgatitur, se nuk është i paraprirë nga një marrëveshje politike, se nuk ka lindur në Kosovë, nuk është përgatitur nga kosovarët dhe nuk i përgjigjet interesave as politike, as ekonomike dhe as brengave të qytetarëve të Kosovës, e sidomos projekti - pilot i Qeverisë Haradinaj, e tanë të Qeverisë Kosumi nuk iu përgjigjen interesave të askujt - as të shumicës dhe as të pakicës.

Për pengimin e realizimit të reformës së vëtëadministrimit lokal në Kosovë, gjatë viteve të shkuara - kanë ndikuar: mungesa e vizionit për të ardhmen e vëtëqeverisjes lokale në Kosovë; përpjekjet për ndryshimet e pjesshme dhe të njëanshme që nuk përputhen me zhvillimin e brendshëm të Kosovës; konkurenca e administratës së UNMIK-ut dhe e strukturave paralele të finançuara nga Beogradit në raport me organet vendore që kanë dalë nga zgjedhjet e lira; raportet e trashëgura në marrëdhëni shqiptaro-serbe.

#### Çka synonte dokumenti kornizë?

- Qeverisje lokale më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa ndarje etnike;
- Transferim të pushtetit nga qendra në komuna, ndonëse pushteti qendror ishte dhe është i pakonsoliduar;
- Përcaktimi i rregulloreve të qarta, të përcaktuara me kushtetutë e ligje për ndarjen e pushteteve. Nuk i kemi!?
- Krijimi i një sistemi të mbikëqyrjes që ndalon ndërhyrjen nga qendra, krijon mundësinë e mbikëqyrjes dhe mbrojtjen e ligjshmërisë dhe zbatimin e politikave qeveritare;
- Shqyrtimin e mundësisë së krijimit të komunave të vogla, sidomos në ato raste kur komunat ekzistuese, për shkak të madhësisë, krijojnë probleme për qasje të shqiptarëve në shërbime, e kjo vlen sidomos për komunën e Prishtinës. Por, megjithatë, decentralizimi nuk përbëhet për të gjithë qytetarët e komunës së Prishtinës.

Forcimi i kontributit të qytetarëve në procesin e demokratizimit - Projekti pilot-komuna ekzistuese, ka qenë në dokumentin e mëhershëm. Në fazën e parë nuk parashihet krijimi i komunave të reja dhe njëkohësisht gjatë kësaj kohe duhej të miratohej legislacioni përkates. Komuna duhej të ndahej në nënkomuna ose njësi të komunës. Kjo thuhet qartë si në dokumentin kornizë, ashtu edhe në shtojcën numër 2.

#### Parimet që duhet ta udhëheqin këtë proces:

- Vënia e qytetarit në qendër të vëmendjes;
- Afrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët, pa dallime etnike;
- Ngritja e përgjegjësisë së qeveritarëve për qytetarët.

Nga kjo mund të përfundojmë se: çdo shhangje e reformës nga kjo rrugë si instrumentalizim i saj përfitinte politike afatshkurtra ose si përgatitje terreni për ndarje territoriale - mund të shkaktojnë vetëm largimin e qytetarëve nga një proces kaq i nevojshëm për ta, por edhe të prodhojë pasiguri të tjera.

Dokumenti kornizë, është mbështetur shumë në rekomandimet e Këshillit të Evropës për reformën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, përfshirë edhe atë financiar. Deri tani nuk kemi ndonjë dokument më i studiuar në të gjitha aspektet përfshirë edhe atë financiar. Ndoshita është mirë t'i kthehem i rekomandimeve të Këshillit të Evropës për vetëqeverisjen lokale në Kosovë.

Është detyrë dhe obligim i Kuvendit të Kosovës të vendosë për reformimin dhe decentralizimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë mbi bazën e standardeve që i ka vendosur Këshilli i Evropës në Kartën europiane për vetëqeverisjen lokale. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Gjylnazë Syla, le të përgatitet Veton Surroi.

#### DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

Faleminderit. I nderuar zoti Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar, mysafirë të nderuar, deputetë të nderuar,  
Reforma e qeverisjes lokale është një proces i cili është duke u zhvilluar në shumë shtete në transicion, por edhe është duke u implementuar në shumë shtete të zhvilluara.

Në Kosovë, reforma e qeverisjes lokale është identifikuar me termin - decentralizim. Në kohë të fundit kjo është shtjelluar nga shumë politikanë por edhe në media. Meqenëse është shtjelluar nganjëherë nga një aspekt i njëanshëm ose i kufizuar, është krijuar përshtypja e gabuar se ky proces ka për qëllim ndarjen territoriale të Kosovës. Kësaj i kanë kontribuar edhe propozimet e Serbisë për kantonizim, dhe më vonë për decentralizim. Kësaj, gjithashtu, i kanë kontribuar thashethënët se dokumenti për reformën e qeverisjes lokale përmban edhe kërkosat serbe për kantonizim, që i shërben qëllimit të politikave të Beogradit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mirëpret Seancën e sotme si dhe mundësinë për t'u trajtuar çështjet dhe dilemat që mund të paraqiten për reformën e qeverisjes lokale, njëkohësisht të ndriçojmë qëllimet e këtij dokumenti dhe të informojmë opinionin lidhur me përbajtjen e këtij projekti. Dokumenti i Qeverisë së tashme është kontinuitet i dokumentit të Qeverisë së kaluar. Në këtë dokument kornizë, parashihet reforma e qeverisjes lokale.

Më lejoni t'i shqyrtoj dhe t'i theksoj dy çështje – qëllimin dhe parimin që mbështet dokumenti kornizë. Qëllimi është që kjo reformë t'i ofrojë perfitime të gjitha komuniteteve; të adresojë nevojat e tyre për siguri e mbrojtje dhe të kontribuojë në integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës, kurse parimi i këtij dokumenti – parimi kryesor - pasqyron dëshirën për të përmirësuar kushtet e sigurisë dhe jetesës për të gjitha komunitetet në Kosovë. Dokumenti kornizë parasqer krijimin e pilot-projekteve me qëllim të fillimit të procesit para aprovimit të kornizës ligjore të nevojshme për implementimin e reformës. Pra, në bazë të kriterieve të përcaktuara në këtë dokument bazë, do të hartohet edhe legjislativë përkatës. Kjo formë është zgjedh në mënyrë që të mos zvaritet procesi i cili ka qenë i paraparë me standartet për Kosovën. Me fjalë të tjera, dokumenti i tanishëm i Qeverisë është vetëm konkretizim i dokumentit kornizë për qeverisjen lokale.

Tash i kam disa pikë lidhur me decentralizimin, si proces. Decentralizimi është një proces i cili është duke u implementuar në të gjitha shtetet e Evropës. Parimi i decentralizimit është bartja e kompetencave administrative tek administrata në territorin përkatës. Është një sistem që i kontribuon balancimit të sistemit të pushtetit dhe është një proces afatgjatë, siç është

demonstruar nga përvojat e vendeve evropiane. Është i rëndësishëm, sepse iu lejon qytetarëve që të vendosin për çështjet e lindhura me komunat e tyre dhe kështu të ndikojnë në realizimin e interesave të tyre, por edhe të kërkojnë përgjegjësi nga organet të cilat i kanë zgjedh ata në zgjedhjet lokale. Mundëson një qeverisje më efikase në nivel lokal e qendror meqenëse shkarkon përgjegjësitë dhe detyrat nga pushteti qendror, dhe i kthen ato në nivelin komunal. Integron minoritetet në shoqëri, duke iu mundësuar atyre që në nivelin lokal të marrin pjesë në vendimmarje dhe të ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë institucionale. Decentralizimi nuk do të thotë autonomi për minoritetet, por do të thotë autonomi për komuna. Autonomia e komunave është me rëndësi të veçantë për procesin e demokratizimit.

Kur flasim për decentralizimin, duhet pas parasysh dy komponente: reformën e qeverisjes lokale dhe decentralizimin e pushtetit nga ai qendror në atë lokal.

Sa i përket komponentës së parë, duhet të pranojmë se organizimi i tanishëm i pushtetit lokal në 30 komuna nuk i përgjigjet më nevojave të qytetarëve. Struktura dhe organizimi i shoqërisë kanë ndryshuar shumë, sidomos në vitet e fundit. Vërvshimi i popullsisë në qytete ka bërë që struktura e komunave të ndryshojë tërësisht. Nëse e shikojmë Prishtinën, nuk mund të themi më se Prishtina është komunë sipas kriterieve të përcaktuara në organizimin e vjetër të pushtetit lokal. Ajo tani më shumë i ngjanë një qyteti të madh ose edhe një metropoli. Administrati komunale nuk është në gjendje më të përballojë fluksin e qytetarëve. Është e mjaftueshme vetëm të shkojmë në institucionet komunale dhe të shohim tollovinë e kaosin që shkaktohet nga kjo.

Sa i përket komponentës së dytë, mund të thuhet se qeverisja efikase mund të sigurohet vetëm me krijimin e një baraspeshe të arsyeshme në ushtrimin e pushtetit. Jemi dëshmitarë që një banor i Prizrenit, ose i cilitdo vendi tjetër në Kosovë, duhet të vijë në Prishtinë për ta regjistruar biznesin e vet. Jemi dëshmitarë kur për projekte kulturore, ambientale, ekonomike e sociale vendoset vetëm në Prishtinë në pushtetin qendror. Jemi dëshmitarë të një kohe kur komunat nuk kanë asnjë iniciativë autonome për zhvillimin ekonomik, ruajtjen e ambientit, pyjeve, zhvillimin e bujqësisë e të tjera. Kjo ka të bëjë edhe me menaxhimin centralist të buxhetit të Kosovës.

Pra, me qëllim të nxitjes së iniciativave komunale dhe me qëllim të involvimit të qytetarëve në vendimmarje, decentralizimi është një proces i domosdoshëm.

Decentralizimi i pushtetit ka çuar shumë shtete drejt rrjetës së efikasitetit në qeverisje dhe drejt promovimit të ekonomisë dhe vëtëdijesimit politik. Të gjitha shtetet që synojnë të bëhen anëtarë të BE-së duhet të përfundojnë procesin e decentralizimit të pushtetit.

Por, çka do të thotë decentralizimi? Decentralizimi do të thotë që një qytetar i Ferizajt, i Pejës ose i Gjakovës nuk do të udhëtojë deri në Prishtinë për të regjistruar biznesin e tij. Decentralizimi do të thotë se komuna është e autorizuar të mbledhë taksat e tatimet dhe nga to të investojë në infrastrukturën dhe mirëqenien e vetë komunave. Decentralizimi do të thotë se viset e rralla, me bukuri të rralla natyrore, sikur ato në Dukagjin, Sharr e tjerë, do të mund të vendosin në mënyrë të pavarur mbi mirëmbajtjen dhe menaxhimin si dhe zhvillimin e turizmit në ato rajone.

Dua ta shtroj edhe një dilemë. A çon decentralizimi drejt ndarjes territoriale? Reforma e qeverisjes lokale nuk çon deri te ndarja e territorit të Kosovës, por përkundrazi - në integrimin e saj.

Qeveria e Kosovës ka refuzuar planin serb të reformës së qeverisjes lokale dhe nuk i ka inkorporuar ato në planin e saj. Plani serb ka paraparë krijimin e rajoneve të populluara me popullatë serbe, korridore të sigurisë që lidhin këto rajone, krijimin e sistemit të pavarur të policisë dhe gjyqësisë, krijimin e sistemit të pavarur të arsimit në këto rajone e kështu më radhë. Këto kërkesa nuk janë inkorporuar në planin e Qeverisë. Në anën tjetër, jemi dëshmitarë të një fazë të krijimit të sistemeve paralele gjyqësore, policore e tjera në disa rajone të Kosovës, kryesisht të banuara me serb.

Lidhur më metodën e decentralizimit në Kosovë. Qeveria e Kosovës me të drejtë ka zgjedhur metodën e krijimit të pilot-projekteve para hartimit të planit të gjithmbarshëm të decentralizimit. Duhet marrë në konsideratë se krijimi i komunave të reja do të ketë implikime të mëdha buxhetore të cilat buxheti i Kosovës nuk mund t'i përballojë sot. Mirëpo, në anën tjetër, procesi i decentralizimit është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për Kosovën. Fillimi i këtij procesi do të thotë gjithashtu përbushje e standardeve për Kosovën.

Padyshim se korniza ligjore është e domosdoshme. Kjo është edhe e paraparë të bëhet. Mirëpo, miratimi i kësaj kornize do të zgjasë së paku një vit. Sigurimi i mjeteve për implementimin e tërësishëm të reformës së paraparë me ligj do të sfidonte tërë procesin. Në vend të asaj, Qeveria e Kosovës ka zgjedhur metodën tjetër përmes krijimit të planit kornizë, në bazë të të cilit do të hartohet edhe legjislacioni.

Duke pas parasysh nevojën e riorganizimit administrativ të komunave në Kosovë dhe duke pas parasysh nevojën e riintegrimit të rajoneve në Kosovë, të banuara kryesisht nga serbët, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se procesi i reformës së pushtetit lokal në Kosovë duhet të shkojë përparrë dhe i propozon Kuvendit që ta mbështesë. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DAC

Ju faleminderit. Fjalën e ka zotë Surroi. Le të përgatitet Mahir Jakxhillar.

#### DEPUTETI VETON SURROI:

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

ORA konsideron se çështja e reformës së pushtetit lokal është një çështje konsensuale në shoqërinë tonë, njëra prej tri-katër apo pesë çështjeve për të cilat duhet të pajtohem i gjithë.

Po ashtu, më duhet të përgëzoj Ministrin Haziri për një punë voluminoze, si dhe Qeverinë e mëparshme për iniciimin e një procesi - së paku - për të identifikuar se sa e rëndë do të jetë kjo reformë dhe sa nevojë pune do të ketë për këtë reformë. Kjo është një punë shumë ambicioze, që kërkon seriozitet të plote.

Unë mendoj se çështja e reformës së pushtetit lokal ka një dhe të vërtmin parim, i cili mund të ndërtohet, e ky është: shteti funksional. Çështja e reformës nuk duhet të plotësojë këtë apo atë nevojë imediate politike, por duhet të plotësojë nevojën që Kosova të funksionojë si tërësi dhe të integrojë qytetarët e saj brenda këtij funksionimi.

Tri janë të meta themelore në programin e prezantuar nga Qeveria.

E meta e parë, e madhe – e cila është në vijimësi edhe me dokumentin kornizë të Qeverisë së kaluar – është mungesa e trungut juridik. Reforma e pushtetit lokal nuk mund të trajtohet veçmas nga reforma e përgjithshme e pushtetit. Një pushtet i cili ndërtón rendin e vet

kushtetues do të ketë parasysh kompetencat në nivel qendror dhe do të ketë parasysh kompetencat në nivel lokal. Reforma e pushtetit lokal pra nuk mund të bëhet e ndarë nga reforma e përgjithshme e pushtetit në Kosovë, e kjo do të thotë ndërtimi i sistemit të ri kushtetues në Kosovë.

Pasojat e një qasjeje të këtillë nga ana e kësaj Qeverie është se përpinqet të reformojë apo delegojë pushtet qendror edhe aty ku realisht nuk ekziston ky pushtet. T'i lëmë anash të gjitha çështjet etnike, politike e tjera. Të marrim vetëm çështjen e pronësisë dhe disponimit të pronës. Ky pushtet qendror realisht nuk ka çka të delegojë në nivel komunal, sepse nuk disponon me instrumente juridike për menaxhimin e pronës.

Shembull edhe më eklatant në këtë shkarje në mes ligjshmërisë dhe nevojave politike, janë pilot-projektet apo pilot-komunat<sup>1</sup>, që janë – de fakti – krijuar i njësive të reja juridike brenda sistemit tonë kushtetues. Kjo do të thotë se shkelet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria për hirë të një interes politik. Nuk po e kualifikoj atë interes politik. Thjeshtë, po them se nuk janë brenda kontekstit të tanishëm juridik të Kosovës. Për më tepër, megjithëse reforma kushtetuese në të gjitha vendet, reforma e pushtetit lokal në të gjitha vendet e Lindjes pashmangshmërisht e ka respektuar Kartën evropiane për vetëqeverisje lokale, qasja e Qeverisë së Kosovës për pilot-projektet është de fakti shkelje e pikës 5 të Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale, ku definimi i njësive të reja të pushtetit kërkon ose konsensus, o konsultim, o – së fundi, edhe referendum territorial.

Mungesa e dytë në këtë propozim, është mungesa e kontekstit ekonomik. Jo vetëm që po bëhet reforma e pushtetit lokal në momentet kur Kosova de fakti vetëm sa po varfërohet në menaxhimin e parave të veta publike, por ne kemi një mungesë evidente në sistemin tonë fiskal. Dhe kjo mungesë evidente në sistemin tonë fiskal, mund të ketë shtrirje negative në atë që do të jetë reforma e pushtetit lokal.

Sot për sot, mbushësi kryesor i buxhetit të Kosovës është pika doganore e Hanit të Elezit. Në Kosovë nuk ka shtrirje horizontale të mbledhjes së TVSH. Pra, përfundimisht, edhe komunat e reja sikundër edhe këto ekzistuese do të varen në lidhëni të drejtpërdrejtë nga grandet qeveritare. Dhe, përderisa të mos ketë shtrirje horizontale në mbledhjen e TVSH, do të jetë e pamundur të funksionalizohet pushteti vendor.

Çështja, ose mungesa e dytë - brenda këtij konteksti ekonomik, është mungesa e parametrave ekonomik për formimin e komunave apo riorganizimin e tyre. Njëra prej problemeve themelore të reformës së pushtetit lokal në Maqedoni, për shembull, ka qenë fakti i distancimit të komunave urbane prej komunave rurale dhe varfërimi i mëtutjeshëm i komunave rurale.

Mungesa e tretë, është mungesa e kontekstit politik. Çdo reformë, pra edhe kjo e pushtetit lokal, e cila synon të përmirësojë apo të trisë cilësi të marrëdhënieve ndëretnike, kërkon një proces negociator. Ky proces ka munguar edhe në fazën fillore, edhe në fazën e tanishme – jo përfqijë të Qeverisë së Kosovës, por përfqijë të realitetit ekzistues politik në Kosovë.

Produkt i mungesës së procesit negociator është çfarëdo oferte që të bëhej nga Qeveria e Kosovës - edhe e miratuar - do të duhej të rinegociohej në fazë të mëtutjeshme, posaçërisht kur vjen çështja e statusit përfundimtar. Nuk do të thonë atëherë: pse pesë komuna, por pse shtatë, pse jo tri, pse jo dy mbëdhjetë - të reja. Dhe kemi faktin e krijuar të komunave fantome, siç është Parteshi ku aktiviteti më i madh kulturor, shoqëror, ekonomik e tjera, është mbledhja te kafeneja e fshatit.

Kjo Qeveri dhe ky proces kërkon një mbështetje dhe kjo mbështetje duhet të sigurohet në tri rrugë, shpresoj. E para është konteksti kushtetues – rruga e kontekstit kushtetues. Në duhet t'i hyjmë reformës së pushtetit lokal njëkohësisht me reformën e plotë kushtetuese, sepse kjo vëtëkuptohet. Dhe, për këtë, ky Parlament duhet të krijojë një komision ad hoc, i cili do t'i ndihmojë Qeverisë që të ecën më tutje në procesin e decentralizimit.

Çështja e dytë - është konteksti politik. Unë mendoj se kjo Qeveri dhe ky Parlament duhet t'i hyjnë decentralizmit në formë shumë më ambicioze. E kjo do të thotë se brenda këtij viti ne duhet t'i kemi të përcaktuara jo pilot-komunat por territoret e komunave të reja në sistemin e ri kushtetues të Kosovës. Dhe, kjo do të thotë që, jo vetëm të definohet forma e këtyre komunave, territori i tyre por edhe përbajtja dhe kompetencat që do t'i kenë këto komuna. Kjo nënkuption një proces shumë dinamik negociator, për të cilin do të duhej të ishte e aftë edhe Qeveria, dhe e mbështetur nga ky Parlament.

Çështja e tretë - është konteksti ekonomik, i cili, në radhë të parë: në radhë të parë duhet të shikojë çështjen e pronës, të disponimit dhe menaxhimit të pronës nga ana e komunave, sepse kjo do të jetë arteria për gjallërimin e tyre në të ardhmen.

Po qe se ky Parlament miraton një rezolutë të tillë, mbështetëse për Qeverinë dhe programin e vet qeverisës, në të cilin do të hiqet çështja e pilot-projekteve, si një çështje redundante, e panevojshme dhe t'i hyhet një qasjeje më serioze – shprehim gatishmërinë tonë që të marrim pjesë me kontributin tonë saqë mund të jetë ai. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën zoti Mahir Jakxhillar, le të përgatitet Emrush Xhemajli.

#### DEPUTETI MAHIR YAGCILAR:

Faleminderit zoti Kryetar. Saygideğer Meclis Başkanı, sayın Başbakan, bakanlar ve milletvekilleri,

Konuşmanın başında parlamente 6+Grubu adına da, sizi selamlamak istiyorum. Grubumuz, Lokal Yönetim Reformu ile ilgili konuyu ciddiyetle görüştü ve Kosova'nın geleceği ve Kosova'da yaşayan topluluklar için çok önemli olan bu konu ile ilgili düşüncesini vermek istiyor. Bu konu somut olarak temsil ettiğimiz Türk ve Boşnak toplulukları için çok önemlidir.

Reformların Lokal seviyedeki hizmetleri canlandıracağına dair gerçekten başlanarak şu konularda başarı bekliyoruz:

- Kosova'da daha elverişli yaşamın ve yönetim koşullarının sağlanması
- Kosova'daki tüm toplulukların daha etkili entegrasyonuna
- Kosova'da işlevsel demokratik enstitülerin kurulması ve pekiştirilmesine katkı sunmasını bekliyoruz.

6+ Parlamente Grubu, Kosova'da Lokal Yönetim Reform Programı'nın gerçekleşmesi yönünde Hükümetin çabalarını desteklemektedir.

Bu konunun Kosova Meclisi'nde tartışıldığından ve Lokal Yönetimin yasal akıdlerinin hazırlanmasına bizi de katmalarından dolayı memnuniyet duyuyoruz. Biz pilot projelere katılmaktan da memnun olduğumuzu belirtirken, ortakça anlaştığımız ve aldığımız karar üzere, bizim tarafımızdan pilot projeye Mamusa'nın dahil olması, projenin ilerideki safhalarında ise Reçan ve Vitomiriça ve daha bazılارının kapsanmasını öngördük.

Bizim tutumlarımız, gelişigüzel önerilerden ibaret değil, bu projenin derin ve temelli incelemelerinin sonucudur. Bizim topluluklarımız bu projeyi, Kosova demokratik enstitülerine daha yoğun ve güçlü entegrasyonu için bir şans olarak görüyor. Amacımız, Lokal Yönetimin reformu sayesile başarılı olduğumuzu tasdiklamak ve bununla, Kosova'da Kosova'nın kalkınması yönünde tam destek sunmak ve Kosova ile kendi topluluklarının geleceği hakkında sorumlu olmaya da hazır olduğumuzu tasdiklamaktır. Reformların geçerli not alması, tüm topluluklar ile birlikte Kosova'nın, AB ve diğer dünya örgütlerinin üyesi olması sağlayacaktır.

Grup olarak, Hükümetin program önergesini incelerken, Lokal Yönetime ait Program Önergesinde, bazı konuların sonuna kadar ayan olmadığını sezdirik ve dolayısıyla Programla ilgili bazı uyarıları ortaya atmak istiyoruz. Bize göre Programda, somut olarak, pilot programların gerçekleştirilmesi için finansi ve araç kaynakları konusunda belirsizlik mevcut. Ayrıca, yeni belediye birimleri hakkında pilot projelerin yöresel kapsamı ve bu konunun hagi sahada belirleneceğinin de pek ayan olmadığını düşünüyoruz. Özellikle, gelecek belediye seçimleri ile ilgili konuya ilgilenmekteyiz, daha doğrusu, pilot projeleri ile diğer belediye topluluklarının da kapsanıp kapsanmayacağı, dolayısıyla seçimlerin ne şekilde uygulanacağı, yani bu belediyelere özel seçimlerin mi yapılacağı, yoksa önceki belediyeler kapsamında mı düzenleneceği konularının daha ayan olmasını isterdik.

6+ Grubu, ilkesel olarak Kosova Meclisi'nde bu konuda yapılacak tartışmaları destekliyor ve Hükümetin, tartışmalardan sonra, Lokal Yönetim Reformunun nasıl ve ne şekilde gerçekleşeceği hakkında son sözünü söylemesini isterdik. Dikkatinize teşekkürler.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën zoti Emrush Xhemajli. Le tē përgatitet Gjergj Dedaj.

#### DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI:

I nderuari Kryetar i Kuvendit, i nderuari Kryeministër, tē nderuar ministra, tē nderuar kolegë deputetë, tē pranishëm në sallë,  
Për mendimin tonë, në programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e qeverisjes lokale që është ofruar sot, ka pasur nevojë tē thuhet dy fjalë për praktikën e deritashme tē qeverisjes lokale në Kosovë, në mënyrë që tē vërehet se ku dallon reforma e tashme nga ajo mëparshmjë.

Ka rëndësi tē thuhet se në tē kaluarën, sa ishte Kosova e okupuar, Serbia e pat bëre krijimin e komunave tē reja tē banuara me shumicë me serbë. Janë krijuar komunat e banuara me serb në qytetat e Zveçanit, Zubin-Potokut, Fushë-Kosovës, Shtërpcës, Obiliqit, Novobërdës dhe nuk është krijuar asnjë komunë e re ku shumicë do tē ishin joserbët. Edhepse janë krijuar komuna tē reja, ky nuk ka qenë decentralizim, por forcim i pushtetit lokal, përkatësisht një decentralizim edhe më i madh. Këtu kanë dominuar kriteret diskriminuese, me qëllime strategjike për tē ndërruar strukturën etnike të Kosovës, për tē dominuar mbi shqiptarët dhe përfjetësuar pushtimin në Kosovë.

Pse i thash këto? Sepse, kjo praktikë duhet ndërpërre. Ne nuk mund t'i marrim asnjë nga këto kritere për tē bëre reformimin e pushtetit lokal. Më nuk mund tē vazhdohet me krijimin e komunave tē vogla në baza etnike ku do tē përfitonin nga buxheti në mënyrë tē paarsyeshme dhe në mënyrë tē padrejtë vetëm disa qytetarë të Kosovës. Nga ana tjetër, ne si subjekt në vazhdimësi po edhe në programin elektoral tē vitit 2001 kemi kërkuar që tē bëhet reformimi i qeverisjes lokale.

Për mendimin tonë, reforma duhet të jetë legale nga pikëpamja kushtetuese, që u tha edhe këtu, dhe ligjeve të vendit të dala nga Kuvendi i Kosovës. Ajo duhet të mbështetet në baza zhvillimore, me kritere që do të respektohen në gjithë territorin e Kosovës, ku do të përfshihen të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe sipas modeleve zhvillimore të vendeve të Evropës Perëndimore – të modelit që parasheh Karta evropiane për vetëqeverisjen lokale.

Ne nuk mund t'i marrim për bazë pretendimet e Serbisë, jo vetëm se po saboton zhvillimet në Kosovë, por edhe përfshirë këtu edhe dokumentin kornizë të bërë në kohën e kabinetit të Kryeministrit - të PDK - Bajram Rexhepi, është shumë e qartë se nuk ka kriter zhvillimin ekonomik, por është një program me karakter politik dhe etnik, pa asnjë logjikë zhvillimore. Ka fakte se së paku, në mos i téri, është hartuar jashtë Qeverisë së Kosovës dhe është përkthyer në gjuhën shqipe. Më lejoni të dëshmohet kjo. Në faqen 5, të materialit që na është dhënë, ku është tabela e pilot-komunave dhe rubrika, përshkrimi duket qartë. Aty: me "KS" kuptojmë krijimin e komunës serbe, me "KT" kuptojmë formimin e komunës së re turke ndërsa me "KA" krijimi e komunës "albaner" ose "allbansku". Duket se është harruar dhe është kopjuar tekstualisht, pa u përkthyer fare shkronja "a" në shkronjën "sh".

Kjo dhe çështjet tjera - tregojnë gjithash tu se komunat janë duke u krijuar në baza etnike dhe jo në baza zhvillimore. Nga këtu del se dëshirohet të normalizohen tri enklava, plus një enklavë Juniku. Madje kjo e fundit, ende pa i rikthyer kolonët. Kjo prapavijë synohet të mbulohet me krijimin e një komune shqiptare dhe një turke. Juniku, në këtë fazë, mund të bëhet vetëm enklavë. Pse dikujt po i ngutet ta bëje Junikun komunë? Vetëm se AKM-ja dhe Habitati i ka në zotërim shtëpitë e ish-kolonëve në Junik dhe vendbanimin e dëshmorëve të kombit në Baballoç të banuar me shqiptarë, të cilët tash kanë marrë shkresa nga Habitati - siç është bërë edhe publike - përfshirë shtëpitë që dikur regjimi serb i pat ndërtuar si koloni me 12 milionët e Fondit humanitar të Komisariatit të lartë të refugjatëve, duke i shpërdoruar përfshirë kolonët dhe paramilitarët serb të ardhur në vitet e 90-ta nga anë të ndryshme jashtë Kosovës. Se çfarë baze ushtarake kanë qenë në realitet këto dy vendbanime që përmenda, nuk është koha këtu të shpjegohet, sepse merr shumë kohë.

Në kushtet e tashme të vendit, projekti duhej dhe duhet të përfshijë të gjithë territorin e Kosovës, por këtu nuk është në projekt. Të gjitha propozimet përfshirë krijimin e komunave të reja janë në pjesët tjera të Kosovës, ndërsa nuk ka asnjë projekt në veri të Kosovës. Për të parë edhe atje efektet që përmenden në faqe 3 të tekstit, si kriter përfshirë komunat, përmendet po ashtu edhe përbërja e ndryshme etnike. Po citoj, shumë me vend: "që do të lejojë eventualisht të vlerësohet efekti i reformave në Kosovë në të gjithë territorin e saj të shumëlojshëmërisë...". Por, përfshirë kuptuar drejt dhe përfshirë kuptuar drejt, nuk është fjala përfshirë kuptuar drejt.

#### (Ndërpërje nga regjia)

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Regjia, të gjitha diskutimet në vijim janë 15-minuteshe, por kur të vijnë te diskutimet e deputetëve jemi marrë vesh duhet të zgjasin 7 minuta. Prandaj, ju lus ta mundësoni kohën 15

minutëshe për të gjithë diskutantët në radhë që vijnë derisa nuk ju informojmë se aty vazhdon 7-minutëshi.

#### DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI:

... Por për t'u kuptuar drejt dhe për t'u hequr dyshimet e bazuara se nuk është fjala për obstruksion kundër Kosovës dhe në favor të strukturave paralele të Serbisë, atëherë në logjikën që është ndjekur nga hartuesit, megjithëse ne nuk jemi me këtë logjikë, është dashur të parashihet edhe një komunë pilot në veri, bie fjala që do të përfshinte Çabrën, Kushtovën, Vinarcin ose ndonjérën prej tyre, dhe një pjesë të Shipolit. Kjo është e domosdoshme për të qenë mesazhi i qartë se reformimi i pushtetit lokal nuk bëhet për të ndarë Kosovën dhe nuk ka për qëllim që artificialisht të ndërrrojë strukturën territoriale dhe etnike të Kosovës.

Rreth numrit të banorëve.- Numri minimal i banorëve që ka të drejtë të formojë një komunë, përmendimin tonë, duhet të jetë minimum 10 mijë banorë. Numri 5 mijë, që është paraparë në materiale, është i vogël dhe pasi të ndërpitet financimi pilot nga donacionet e bashkësisë ndërkombëtare, këto komuna nuk mund t'u përballojnë taksave për plotësimin e pjesës së buxhetit që duhet të mbledhen nga vetë banorët e komunës që krijohet. Është e qartë se edhe për një kohë shumë të gjatë nuk pritet që ato të mbijetojnë në formën që është përshkruar në këto materiale me numër aq të vogël të banorëve.

Rreth financimit.- Lartësia e shumës së grandeve nga buxheti i Kosovës për komuna duhet të bëhet në një formë për kokë të banorëve, përndryshe ne do të kemi komunat politike, si dikur fabrika politike që bëhen barrë e buxhetit qendor. Tash, ndarja buxhetore, e dimë të gjithë, për komuna është shumë e padrejtë dhe në dëm të komunave që kanë numër të madh të banorëve.

Rreth përfshirjes territoriale.- Në Projektin e propozuar nuk precizohen kufijtë e komunave të propozuara duke lënë vend për urdhëresa administrative që prekin në përbajtje. Në fakt, askush sigurt rreth kësaj nuk e ka thënë. Ministria e pushtetit lokal, dhe sot këtu Kryeministri, thotë se komunat e ardhshme do të kenë kufijtë të tashëm të fshatrave të sotme, pa qenë i siguri se a do t'i prishë këtë qëndrim kryeadministratori. Ndërsa, janë dëgjuar edhe pretendime që të jetë krejtësisht ndryshe. Përfshirja e Marecit në komunën e Graçanicës bashkë me disa fshatra tjera në atë drejtim, mund të ketë vetëm karakter gjeostrategjik ushtarak si vend malor që është edhe afër kufirit me Serbinë. Përndryshe, kjo pjesë nuk ka as numër të konsiderueshëm të banorëve, as nuk është faktor që ndihmon zhvillimin. Ngjashëm spekulohet edhe me Parteshin.

Rreth përgjegjësive të komunave.- Me këtë program dhe me dokumentin kornizë propozohet në mënyrë kontradiktore që komunave t'u jepen të drejta që nuk i ka Kosova si tërësi, si pushtet qendor, që u tha edhe nga të tjerët. Kosova, ende nuk ka vendosur përfatim e integritetit territorial të vetë, ndërsa tanë po vendos përfshirë territorial ndaras në baza etnike. Kosova si tërësi dhe Kuvendi qendor i Kosovës nuk e ka të drejtën e referendumeve të asnjë lloji, ndërsa kërkohet të bëhet ligj përfshirë referendumet lokale. Komunave kërkohet që t'u sigurohen forca të reagimit të shpejtë, përfshirë cilat nuk flitet qartë se përfshirë fjala.

Kështu, përfshirë sistemu i ato që mendojmë se do t'ishin me vlerë, reforma duhet të jetë legale dhe në pajtim me procedurat e legjislacionit – kushtetutës, ligjeve të vendit - të aprovuara nga Kuvendi.

Të hijet pretendimi që territori dhe banorët e komunës të kenë përgjegjësi, të cilat ende nuk i ka Kosova. Në fillim të krijohen pesë komuna, që do të përfshinin sadopak strukturën e popullatës së përfshirë që e ka Kosova. Dihet se ka minoritete në Kosovë në rapport se sa minoritete ka në Kosovë me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Konkretnisht të formohen 3

komuna, ku shumica e banorëve të janë shqiptarë, një komunë ku shumica të janë serbë dhe një ku shumicë janë turq. Numri i banorëve të komunave të reja që do të krijohen të jetë 10 mijë, komuna e Junikut të krijohet më vonë, ndërsa në vend të saj të krijohet komuna e Çabrës. Komunat që krijohen duke përfshirë vendbanime që sigurojnë numër të mjaftueshëm të banorëve dhe jo territorë që pretendojnë prapavijë ushtarako-strategjike, siç është rasti i Graçanicës dhe Parteshit. Në fazën në vijim të formohen këto komuna: Mramuri, Matçani - Prishtinë, Has, Zhur, Rogovë - Prizren, Mushtishti - Suharekë, Bresan - Sharri, Bec, Shiponjë - Gjakovë, Komaran - në komunë të Drenasit, Orlani, Sllatina dhe Pozharani, Komogllava, Gaçka, Gadimja, Magurja, Shala, Rugova, Barani, Krusha e Madhe, Isniqi, Juniku, Glogjani, Runiku dhe komuna tjera që do t'i vlerësonin ekspertët se a i plotësojnë kriteret zhvillimore.

Shefi i ekzekutivit të jetë banor i komunës, së paku 6 muaj, para se të konkurojë për këtë post. Ju e keni pa se, ai as që ka nevojë të qenë banor i komunës, kurse don me u bë i pari në komunë!

Është e panevojshme që komuna të ketë shërbim të reagimit të menjëherëshëm siç parashihet në faqe 6. Njësi të tillë ka TMK, janë zjarrfikësit – po kuputohet.

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve duhet të jetë ai që vlerëson rëndësinë e monumenteve historike në Kosovë. Menaxhimi i tyre duhet të jetë kompetencë e deleguar për komunat, jo siç është propozuar në faqen 5 të dokumentit kornizë.

Financimi i komunave, përkatësisht grandet për to të jepen për krye të banorit. Banorë të Kosovës të janë të gjithë ata që mund të dëshmojnë këtë në bazë të shumë kritereve. Nuk mund të merret kriteri viti 1998 siç është në dokumentin kornizë.

Programi i reformës, për mendimin tonë, duhet t'i kthehet Qeverisë dhe të ripunohet.

Të eliminohen të gjitha propozimet që ja. Kundërshtim me sundimin e ligjit dhe me vërejtjet e paraqitura të kthehet përmiratim uefinitiv në Kuvend në kohën më të shpejtë të mundshme.

Nuk do të ishte mirë që në këtë formë të imponohen komunat pilot. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën zoti Gjergj Dedaj, le të bëhet gati Ferid Agani.

#### DEPUTETI GJERGJ DEDAJ:

Së pari, po më vjen mirë që pas 6 muajve kam këtë kënaqësi me dal këtu në foltore me iu drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Inderuari Kryetar i Kuvendit, inderuari Kryeministër, ministra, deputetë, zonja dhe zotërinj, shumë të respektuar mysfirë, monitorues të Kuvendit të Kosovës, Dola këtu vetëm që të jap një opinion që ndoshta nuk do të jetë shumë diferent me parafolësit, të cilët sinqerisht në mënyrë substanciale shtruan çështjen e reformimit të pushteti lokal si një nevojë imediate që është edhe njëri prej standardeve që duhet të plotësojë Kosova për të ecë drejt rrugëtimit dhe drejt arritjeve deri te zgjidhja e statusit final politik të Kosovës, e cila me siguri se është premtuar që do të ndodhë gjatë vitit 2005, pra gjatë këtij viti.

Është bërë pak-shumë zhurmë për këtë çështjen e decentralizimit, ndoshta më tepër sesa që është dashur, ndoshta më shumë për marketing politik se sa për një qasje serioze, thelbësore ndaj këtij procesi i cili thash është imediat dhe duhet të ndodhë.

Kosova, jo që ka nevojë për reformimin e pushtetit komunal vendor por mbi të gjitha Kosova ka nevojë për një reformim komplet të gjithanshëm, eksplisit duke filluar nga niveli qendror dhe deri te niveli komunal, në të gjitha segmentet, në të gjitha institucionet, në të gjitha strukturat dhe mekanizmat të cilët përbëjnë shoqërinë demokratike të Kosovës.

Duke pasur parasysh se edhe dokumentet e Këshillit të Evropës, Kartës së Këshillit të Evropës, të Parlamentit Evropian dhe strukturave tjera parashohin dhe rekomandojnë reformim të pushtetit vendor në Kosovë, atëherë për liberalët kjo nënkuption që ky reformim nuk duhet të bëhet vetëm sa për një marketing medial por edhe në vija etnike ose për çështje të politikës ditore, por mbi të gjitha duhet të bëhet për të mundësuar një jetë më të mirë, më funksionale, më pragmatike të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha minoriteteve dhe të të gjitha bashkësive etnike në Kosovë.

Po të themi se programi i Qeverisë së Kosovës ka paraparë disa pilot-projekte, mendoj se kjo nuk do të kishte pas qenë të ndodhë me një gjë të tillë, sepse nuk mund të bëhet fjalë vetëm për çështje eksperimentale dhe projekte-pilote për reformimin e pushtetit komunal, por duhet të bëhet një program shumë më gjithëpërfshirës dhe shumë më serioz që do të rekomandohej nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës dhe ndoshta nuk do të ishte i gabueshëm një propozim që në kuadër të Kuvendit të Kosovës të formohet një komision ad hoc i cili do të merrej me rekomandimet dhe dhënen e këshillave në asambletë komunale, të cilat po ashtu përveç që në Kuvendin e Kosovës, në të gjitha kuvendet komunale, në të gjitha komunat e Kosovës ta shtrojnë në mënyrë të gjithanshme procesin e decentralizimit dhe bashkë me Qeverinë e Kosovës dhe me një grup që do të formohej në Kuvendin e Kosovës të bashkëpunojnë ngusht me asambletë komunale që decentralizimi të jetë vërtetë funksional dhe të jetë domethënë përmbytjesor, pragmatik dhe në dobi të të gjitha komunave. Sepse po të përmendim tash se cili vend a bashkësi lokale, ose cili fshat – Mamusha, Juniku, Graçanica do të duhej të bëhen komuna, mendoj se do të ishte tash për tash herët, sepse aty duhet një shqyrtim dhe një debat në mos ndoshta edhe një referendum në nivele komunale për të vendosur se cilat vendbanime do të duhej të gjëzonin të drejtën për të qenë komuna dhe për t'u bërë komuna.

Mirëpo, e kam të paqartë një gjë, në mesin e shumë gjërave që janë këtu dhe që duhet të shtrohen shumë më seriozisht – çështjen se kush e definon dhe si definohet territori i një komune, si do të mbështetet ekonomikisht nga buxheti, a është buxheti i Kosovës që ka kapacitet për të mbuluar shpenzimet për formimin e shumë komunave të reja dhe kështu me radhë... Nuk është ide e keqe që ndoshta edhe qytetet e mëdha, siç është edhe Prishtina, që u përmend se është metropol, e unë mendoj se është shumë larg metropolit, sepse siç e dini nuk ka asnjë WC publike. Domethënë kisha dashtë me thënë se edhe kryeqyteti i Kosovës do të duhej të kishte ndoshta 5 a më shumë komuna dhe kjo çështje mendoj duhet të shtrohet mirë. Është mirë që është shtruar sot, ndoshta me pak vonesë, në Kuvendin e Kosovës por do të duhet të jetë shumë më mirë që këto çështje mos t'i marrim si politika ditore, por si çështje të rendësishme, si çështje të referendumit në nivele komunale, si çështje të një debati të gjithanshëm. Ju falënderoj për mirëkuptim dhe durim.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DAKI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Ferid Agani, le të përgatitet Bajri Numan.

## DEPUTETI FERID AGANI:

I nderuari Kryetar i Kuvendit, i nderuari Kryeministër, tē nderuar deputetë, anëtarë tē kabinetit qeveritar, tē respektuar zonja dhe zotërinj, vëzhgues vendor dhe ndërkombëtar, Nëse në lidhje me këtë çështje diskutojmë në rrafshin teorik dhe akademik, mendoj se s'ka asnjë deputet këtu i cili nuk do tē pajtohej në lidhje me përparësitet e mëdha tē cilat i ofron zbatimi i reformës së pushtetit lokal dhe decentralizimi kur zbatohet në baza tē parimeve të verifikara shkencore, profesionale dhe në bazë tē përvjohës së shteteve tē tjera.

Në Kosovë, megjithatë, kemi tē bëjmë me një situatë konkrete. Ngjarja zhvillohet në kohë dhe vend tē caktuar dhe ka dimensionet e saja specifike. Vetëm disa muaj para fillimit të bisedimeve për statusin juridik dhe politik, skena politike e Kosovës cilësohet me disa veçori që nuk janë shumë tē volitshme. Endë nuk është përpiluar platforma dhe strategjia e përbashkët për realizimin e synimit të përgjithshëm për pavarësi, ndërsa njëkohësisht subjektit politike që përfaqësojnë serbët e Kosovës - tē instrumentalizuar skajshëm nga qeveria e Serbisë - vazhdojnë tē injorojnë institucionet legjitime të Kosovës, përfshirë edhe këtë Kuvend. Situata e tendosur deri në skajshmëri javëve tē fundit, filloj tē ngjallë pasiguri, ankth dhe frikë tek qytetarët se historia e hidhur e fillimit të shekullit 20 mund t'na përsëritet.

Në këtë mjedis politik sot diskutohet programi i punës së Qeverisë së Kosovës për reformën e pushtetit lokal. Më lejoni që lidhur me këtë çështje t'i paraqes disa fakte. Në esencë, nuk bëhet fjalë vetëm për reformën e pushtetit lokal, por edhe për procesin e decentralizimit të kompetencave kushtetuese të organeve qendrore, gjë që është shumë e qartë nga përbajtja e programit, por nuk është e qartë nga titulli i dokumentit, që për mua nuk paraqet kontribut për transparencë tē dokumentit dhe në këtë drejtim kisha sugjeruar që tē korrigojet.

Para nesh kemi një program politik tē kërkuar dhe në masë tē madhe tē dizajnuar nga faktori ndërkombëtar, që u paraqiten disa argumente për këtë edhe nga parafolësit, program ky që ka për qëllim dhëni e garancioneve tē veçanta politike për pakicën serbe në Kosovë. Ky program për Partinë e Drejtësisë, në momentin e tanishëm është i imponuar, është i parakohshëm dhe shumë i shtrenjtë për mundësitet ekonomike të Kosovës. Në situatën kur ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar, hiq më larg se dje, parashohin deficitin buxhetor prej 130 milion eurove në vitin 2005 mu për shkak tē tejkalimit të pagave tē punëtorëve në administratën shtetërore dhe në shërbimet publike, vijmë në një situatë e cila në aspektin logjik është kontradiktore. Në tē njëjtën kohë, siç e dimë, nevojat elementare për shumicën e popullatës së Kosovës mbisin tē paplotësuara deri në masën shumë serioze.

Në një aspekt tjetër, ky program e ka një potencial destabilizues. Në rrethana kur subjektit politike me mospjesëmarrjen e tyre qartë e mohojnë legitimitetin e këtij Kuvendi, gjë që po ndodhë edhe në këtë seancë, në këtë situatë është shumë e logjikshme që tē pritet që pilot-njësität e reja komunale, ta marrim – tē Graçanicës dhe Parteshit, në situata tē caktuara tē zhvillimeve politike, veçanërisht në periudhën e bisedimeve për statusin e Kosovës, tē shfrytëzojnë kompetenca tē reja administrative e politike për tē bllokuar jetën politike, ekonomike dhe institucionale në këto pjesë të Kosovës.

Me zbatimin e këtij programi, ende pa u definuar qartë kompetencat e Qeverisë qendrore, që në shumë sféra vitale tē jetës shoqërore ende janë pjesë e fuqive tē rezervuara tē administratës ndërkombëtare, hapet rruga për enklavizimin e Kosovës - në përmasa shumë më tē mëdha sesa sot - nëpërmjet krijimit tē strukturave tē reja administrative dhe politike nga komunitat e banuara me shumicë tē popullatës serbe nën pretekstin e përfaqësimit më tē plotë tē interesave tē qytetarëve tē këtyre komunave.

Gjithëkëtë që po e them, po e them me qëllim konstruktiv që të tjerheq vëmendjen në mënyrë që dokumenti i propozuar të plotësohet me mekanizma të cilët do të parandalonin këto rrëziqe të mundshme.

Se çka do të thonë rajonet ose bashkësitë e komunave, si struktura administrative dhe politike serbe në Kosovë në periudhën e bisedimeve për statusin e Kosovës, po ua lë të konkludoni vetë të nderuar deputetë dhe anëtarë të kabinetit qeveritar. Përvoja e Bosnjës nuk është as e largët dhe as e panjohur për ne.

Për shkak të këtyre rrëthanave, çështja për të cilën diskutohet sot paraqitet veçanërisht kompleksë dhe kërkon shqyrtim të kujdeshëm. Konsideroj se decentralizimi në momentin e tanishëm, në mënyrën si është përgatitur dhe tenton që të zbatohet, do të ketë implikime dhe pasoja serioze për zhvillimet e mëtutjeshme politike në Kosovë, natyrisht në qoftë se ky dokument nuk plotësohet me sugjerimet që dalin nga ky debat.

Të nderuar deputetë,

Përkundër gatishmërisë së plotë për të bashkëpunuar dhe dëgjuar me kujdes këshillat e miqve tanë nga bashkësia ndërkombëtare, nga perspektiva e interesave shtetërore të Kosovës, konsideroj se decentralizimi në këtë moment, në mënyrën si është propozuar, paraqet një shkurtpamësi politike të udhëheqjes sonë. Në këtë kuptim, shpresoj se ky debat që do të zhvillohet do të shërbet si një impuls që dokumenti të plotësohet me vërejtje – me të vërtetë konstruktive, dhe të përmirësohet në mënyrë substanciale.

Ne do ta kishim një situatë krejtësisht tjeter sikur sot, në këto bangë të ishin të ulur edhe përfaqësuesit legjitim të popullit serb të Kosovës dhe së bashku të punonim për t'i formuluar garancitë e ndërsjella për një bashkëjetesë konstruktive. Mirëpo, kjo nuk është e rastit. Ky është realiteti ynë. Përkundër të gjitha dëshirave tona, realiteti është se ata nuk janë këtu me ne. Jam i bindur se gatishmëria për bashkëjetesë nuk blehet me komuna të reja, dhe lojaliteti ndaj shtetit, nuk formohet me formimin e komunave të reja. Këto janë zgjidhje jokreative politike që do të krijojnë më shumë probleme sesa dobë.

Koshient përmundësinë e madhe që ky program të fillojë të zbatohet nga Qeveria, ashtu siç është thënë disa herë në mënyrë publike, si dhe mbështetur në faktet e lartpërmendura, unë kisha propozuar ndërmarrjën e disa veprimeve që së paku do të zgjedhon pasojat e mundshme të veprimeve të lartpërmendura.

Nën një. Të kërkohet transferimi urgjent i kompetencave mbi çështjet e minoriteteve nga administrata ndërkombëtare në Qeverinë e Kosovës;

Nën dy. Të fillojë puna në legjislacionin e lidhur me reformën e pushteti lokal, por si pjesë e punës gjithëpërfshirëse në përpilimin e kushtetutës së re të Kosovës;

Nën tre. Që Kuvendi i Kosovës të merr vendim të qartë se nuk mund të ketë asnjë kalim nga faza e pilot-programeve në zgjidhje përfundimtare pa miratimin e ligjit të veçantë nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Dhe, nën katër. Një çështje, që mendoj se mungon në dokumentin e propozuar, e ky është se Kuvendi i Kosovës në një mënyrë është lënë anash në procesin e zbatimit të pilot-projekteve. Është definuar ekzistimi i bordit drejtues, i cili do të jetë kompetent për menaxhimin e të gjitha fazave të këtij programi. Konsideroj se Kuvendi ka nevojë të formojë një komision ad hoc i cili do të mbikëqyrë në mënyrë të rregullt të gjithë zbatimin e këtij programi, ndërsa njëkohësisht zbatuesi i programit - Qeveria e Kosovës - të obligohet që në mënyrë të rregullt në baza

tremujore të raportojë para Kuvendit në lidhje me vëçoritë dhe specifikat tjera të dinamikës së zbatimit të tij.

Për fund, megjithë dëshirën më të sinqertë që qytetarët serb t'i gëzojnë të gjitha të drejtat, të cilat i gëzojnë edhe qytetarët tjerë të Kosovës, në momentin e tanishëm të zhvillimeve politike mu para fillimit të zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës ... po e përsëris - konsiderojmë se ky program në rast se zbatohet si i tillë në mënyrën e propozuar, pa plotësimë të nevojshme, mund të jetë me potenciale serioze destabilizuese për procesin e bisedimeve rreth statusit të Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Më duhet t'ju informoj për atë që si duket deputetët nuk e kanë hetuar apo nuk e kanë në dijeni. Në sallë janë të pranishëm edhe dy deputetë ti GIS-it, prandaj deputeti Sasha Gjokiq, ka kërkuar replikë. Urdhëroni, foltorja është e juaja zoti deputet.

#### DEPUTETI SAŠA DJOKIĆ:

Ja sam Saša Djokić, poslanik Gradjanske iniciative Srbije. Ja se u potpunosti ne slažem sa gospodinom poslanikom. Ja ne znam da on o ovome ne zna i nije tačno da nema predstavnika Srpske zajednice. Mi u ovoj Skupštini imamo legalno dva poslanika. I ja molim gospodina da više ne zloupotrebljava ovu govornicu ove Skupštine. Toliko sam imao da kažem. Prijatno.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Numan Baliq, dhe i fundit para pushimit Sabit Rahmani.

Baliq, kërkoi falje, vetëm një sekond. Dëshiron replikë të shkurtër Feridi.

#### DEPUTETI FERID AGANI:

Unë, kërkoi falje nga deputeti, meqë si deputet i ri - deri tani nuk kam pas rast që të takohem personalisht me të. Kur e adresova Kuvendin, u nisa nga perspektiva e bojkotimit të institucioneve të Kosovës nga subjektit të tjera politike, nga shumica e madhe e deputetëve për të cilët ky Kuvend i ka vendet e rezervuara. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Baliq, urdhëroni. Le të bëhet gati Sabit Rahmani.

#### DEPUTETI NUMAN BALIĆ:

Faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit. Dozvolite mi najprije da selamim sve koji su prisutni u mbretëri - zoti. Da kažem nekoliko riječi nastojeći da budem objektivan, mada je u ovim okolnostima jako teško reći ono što treba.

Ako je u pitanju decentralizacija, trebamo postaviti to pitanje u svjetlu dva problema. Ako se pitamo da li je potrebna decentralizacija Kosovu trebamo se složiti da je decentralizacija Kosovu i da se ona treba i mora obaviti. Naravno da se treba obaviti što je moguće bolje i da ona bude pravedna i da bude u interesu svih zajednica, jer to je i cilj decentralizacije u skladu sa potrebama svih zajednica koje postoje na Kosovu i u skladu sa time da omogućimo ravnopravan tretman i jednak pristup svim zajednicama i naravno u slučaju decentralizacije

gde se nove opštine formiraju osim ekonomskih, geografskih, kulturnih i drugih kriterijuma – obavezno treba da se uzimaju naravno i etnički kriterijumi. I mislim da nikome od nas ne treba biti tjesno ako će se u okviru ovoga posla, koji treba da bude jedan proces, jer će zaista ovo biti proces nešto što treba trajati dugo vremena i naravno da će imati jako puno nedostataka. Dakle nikome od nas ne treba biti tjesno i ne treba smetati ako bude opština koja će biti i za Turke, i za Bošnjake, i za Rome, Haškalije, Gorance i tako dalje. Naravno i za Srbe, zaboravio sam da kažem i ne želim da udjem u ove polemike kao što smo maloprije čuli.

Uprkos svim nedostacima koji su pomenuti i koji stoje, a nedostataka ima i oni se tiču najprije načina organiziranja procesa odlučivanja o decentralizaciji. Mislim da je kao prvo, ovaj razgovor u sali zakasnio najmanje dva mjeseca i da je nepotrebno dugo odlagana rasprava o decentralizaciji, da je ona morala biti mnogo prije. Ali, šta je tu je i trebamo ići dalje.

Dalje, mislim da je u procesu odlučivanja trebalo obavezno voditi računa o dogovaranju i slušanju i predstavnika svih političkih partija i naravno predstavnika svih zajednica. U ovom slučaju to je izostalo. Imam utisak da naravno jedan deo albanskih političkih partija nije bio uključen niti u dogovaranje, niti u odlučivanje i to nije dobro. Mislim da svaka dobra vlast treba voditi računa oko toga da svi akteri u jednoj zemlji treba uzeti učešća u odlučivanju o stvarima koji su od izuzetnog značaja kao što je decentralizacija.

I naravno moram da napomenem da zajednice, posebno manjinske zajednice medju koje spadaju i takozvane ostale zajednice, mada se ne slažem ni sa imenom manjinskih niti ostali. Bošnjaci, Romi, Haškalije, Goranci moram da kažem da su do sada bili gotovo isključeni iz procesa dogovaranja. Dakle, jedan veoma ozbiljan momenat koji na samome startu pruža mogućnosti i zapostavljanja, i manipulacija i diskriminacija ovih zajednica što to uopšte nije potrebno ovoj Vladi. Dakle, jedan mali gest dobre volje i spremnost vladajuće strukture da razgovara sa predstvincima ovih zajednica i da udovolji njihovim potrebama, uopšte neće biti na štetu nego na samo dobro Kosova. I ja sa najboljim željama, i ovom prilikom, kažem ono što smo govorili tokom nedavnog razgovora sa gospodinom Dacijem kada smo mislim pružili ruku saradnje i budućeg zajedničkog djelovanja gde sada trebamo dokazati da to tako trebamo uraditi. Riječi nisu dovoljne. Dijela su važna i po dijelima se trebamo mjeriti. Mi očekujemo da se prestane sa zapostavljanjem pojedinih zajednica posebno zaslужnih pojedinaca koji su zaslужili za ovu zemlju i koji trebaju odlučivati o mnogim važnim pitanjima ne samo svoje zajednice nego i svih zajednica koje žive na Kosovu.

Da se vratim na pitanje same decentralizacije i novih opština. Donijeta je odluka, koja je naravno nepotpuna i koja se nadam biće dio jednog procesa koji će trajati dugo vremena i naravno samo u dobrom smjeru, ali za početak je doneta odluka da se formiraju – da uslovno kažem dvije albanske opštine, dvije srpske opštine i jedna, dakle turska opština koja bi trebala predstavljati, da tako kažem ostale zajednice. Što želim ovde spomenuti? Ono što je vrlo bitno. O ovim opštinama koje su, da tako kažem uslovno, albanske bilo je puno govoru i ne bi trebalo govoriti, sa tim što naravno treba voditi računa da decentralizacija mora biti sveobuhvatan postupak i da naravno treba biti i baziran i na ustavnost i na svim onim kriterijumima koji su pomenuli veoma argumentirano prethodnici. A što se tiče srpskih opština i opština za ostale zajednice, ja nisam siguran da je za srpske opštine obavljen jedan transparentan i da tako kažem dobar vidljiv način dogovaranja o odlučivanju oko ovih opština. I posebno želim da kažem ono što se tiče ostalih zajednica odnosno donošenje odluke da u prvoj fazi bude izabrana Mamuša kao turska zajednica, kao turska opština odnosno opštinska jedinica koja će kasnije prerasti u opštinu.

Čuli smo iz izlaganja predstavnika Grupe 6+ da je to navodno bio proizvod dogovora izmedju te Parlamentarne grupe i Vlade. Mi ne pristajemo na takve dogovore, ne zato što je u pitanju ta

opština, ne zato što su isključene druge opštine nego zato što mislimo da je moralo obavezno da se vodi računa i o opštinama koja su bili na listi, koje su bile predložene i koje su bile preče da budu prije, ali nemamo ništa protiv da i Mamuša bude sa njima. Dakle, i Vitomirica, i Rečane, i Mamusha i sve one druge opštine koje su bile stavljene na listu. Dakle, te vrste dogovaranja između jedne parlamentarne grupe, za koju sam već na prvu sjednicu Parlamenta rekao da ona predstavlja dio jedne zajednice i drugu zajednicu a zapostavljene su najmanje četiri zajednice: Goranci, Haškalije, Romi i Bošnjaci, koje smatram sebe autentičnim predstavnikom tih Bošnjaka, dakle oni su potpuno zapostavljeni ili isključeni iz procesa dogovaranja.

Ja apelujem na vas da postupite u skladu sa zadnjim razgovorima koji smo vodili i da se sa punim uvažavanjem razmotrite predlog koji smo mi dali u ime Bošnjačke zajednice, prijedloge za Vitomiricu i Rečane da se bar jedna od te dvije opštine... Mi imamo pismeni predlog za opštine Vitomirica da se uključi među opštinama koje će biti usvojene u prvom krugu, u prvom ciklusu, zato što su preče i zato što su zaslužile. Naravno nije isključujući, neka ostane Mamuša. I na kraju krajeva može se i proširiti ta lista opština. I ako smo dobro raspoloženi i pravedno raspoloženi jedni prema drugima, oko toga se možemo dogovoriti. U protivnom, ako ostalo ovako, kažem ako ostane ovako, ako Vlada samo što je Vlada bude iskoristila moć jačega i onoga koji vlada, ali kažem onda će biti nepravedna vlast, u tom slučaju doćiće do zapostavljanja, do diskriminacije i ono što mi možemo jedino nazvati – manipulacijom sa manjinskim zajednicama odnosno sa zajednicama Bošnjaka, Roma, Egipćana, Haškalije i tako dalje. Očekujem pravedan odnos i očekujem da se ispravi nanijeta nepravda.

I na kraju da sa nekoliko rečenica samo kažem da smo mi pripremili jedan dopis, u kome стоји zahtjev za Vitomiricu, naravno zahtjev za Rečane će biti kasnije dostavljen ali zahtjev za Vitomiricu koji je temeljno zasnovan na svim kriterijumima, dakle na onom statističkom koji se tiče broja stanovnika, koji je negde oko 10 hiljada, oko toga da je to većinska bošnjačka teritorija, gde naravno ima specifičnost? Vi jako veliki broj Albanaca, Roma, Egipćana i ostalih i jedna prava, da tako kažem, ... tnička, ako se može tako mada ne volim da iskoristim taj izraz i jedna sredina koja ima sve ekonomske opravdanosti. Imamo dakle privredne objekte koje tamo postoje, koje se tiču proizvodjača nameštaja i starih i novih, dalje imamo fabriku sokova i bezalkoholnih pića koja su otvorena na dva mesta, najmanje dva privrednika koji se time bave – fabrika plastike koja je takodje u toku izgradnje, dalje neke druge privredne objekte, potom potrebnu infrastrukturu za centar opštine koji se tiče doma kulture, mjesne zajednice, čak imamo i medicinske objekte, familjarni centar koji može prerasti u glavni familjarni centar, potom i sportski centar, stadion fudbalski koji postoji, zatim naravno jedan plato koji je našim zalaganjima izgradjen u zadnjih nekoliko godina, pijacu, glavnu ulicu, poprečnu ulicu. Dakle sve ono što je potrebno, računajući sve aspekte demografske, ekonomske, kulturne i sve one aspekte koji su potrebni da bi Vitomirica dobila tu opštinu.

I sasvim na kraju, završiću sa jednim možda veoma neprijatnim odnosom naše javnosti, da tako kažem i Bošnjaka i Albanaca u Vitomirici i okolini, koji kažu sledeće: Vi ste bili oni koji ste se godinama zalagali za ovu zemlju, za državu Kosovo, za nezavisno Kosovo jasno i nedvosmisleno prije 15 godina, i dokazali ste. Vi hoćete njima da date državu, oni vama neće da daju opštinu. Ja pitam gospodina Daciju i pitam gospodina Kosumija i pitam ljude, i pitam sve vas o onome o čemu vi veoma dobro znate i dozvolite mi da završim, dakle i bilo naravno mnogo priča oko toga i o manjinskim zajednicama i ostalih i neko je rekao da su manjinske zajednice spremne bez rezerve da podrže nezavisno Kosovo. Pa mi smo nezavisno Kosovo, mi ... i ja koji govorim tražili nezavisno Kosovo pre 15 godina. Oko toga nema priče. Ali molim vas da naše institucije na Kosovu trebaju dati dokaz da su one, onakve, koje se jako razlikuju od onih protiv kojih smo se zajednički borili. Mi smo se borili protiv onih prethodnih zato što nisu davala ravnopravnost svima nama. Mi smo tražili Kosovo u koju će i Bošnjaci, i Goranci,

i Haškaliye biti ravnopravni sa većinskim Albancima. Ako Kosovo, za koju se zajednički borimo, bude se zalagala protiv ravnopravnosti Bošnjaka, Roma, Egipćana, Haškaliye onda mi nećemo biti za takvu instituciju, ta takvu Kosovo. Ja vam kažem veoma jasno, mi tražimo dokaze i tražimo dokaze veoma jasno, dobićete papir u kome stoji predlog za Vitomiricu, dobićete papir o kome će biti predlog za druge opštine. Ja vas molim da ga razmotrimo kao prijatelji i kao braća i da odlučimo onako kako sledi. Hvala vam ljepo.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Edhe Sabit Rrahmani, i fundit para pushimit. Urdhëroni Sabit.

#### DEPUTETI SABIT RRAHMANI:

Ju faleminderit zoti Kryetar. I nderuar Kryeministër, tē nderuar ministra tē kabinetit qeveritar, tē nderuar deputetë, tē nderuar mysafirë,

Në media këtyre ditëve flitet që decentralizimi dhe bisedat me Beogradin do tē jenë kusht drejt proceseve pozitive dhe drejt bisedimeve pér statusin final tē Kosovës. Ne e dëmë që reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi është në favor tē Kosovës, e veçanërisht tē komunitetave, por siç po shihet nē dokumentin kornizë komuniteti serb nē këtë dokument është shumë i privilegjuar edhe teoretikisht por edhe praktikisht, sa është pa nē dokumentin kornizë.

Ju zoti Kryeministër thatë se nē këto pilot-projekte apo njësitë pilot-komuna do tē jetë kryetari nga pakicat që ne absolutisht nuk jemi kundër dhe është nē favor tē tē gjitha komunitetave por edhe komunitetit që unë e përfaqësoj, por a do tē punojnë këto institucionë komunale me planprogram tē Kosovës apo prapë do tē përsëriten institucionet paralele.

Zoti Kryeministër ju disa herë përsëritët se reforma e pushtetit lokal bëhet nē interes tē komunitetave nē përgjithësi, por më shumë dhe shpeshherë thatë se nē interes tē komunitetit serb sepse me decentralizim ata do tē integrohen dhe do tē jenë pjesë e institucionave tē Kosovës. Unë sa dëgjoja këtu, decentralizimi ndodhë 99% pér komunitetin serb, kurse vetëm 1% pér komunitetet tjera. Nuk qëndron ashtu sikur është teoretikisht nē dokumentin kornizë dhe nuk qëndron ashtu si janë parapa ato komuna, praktikisht dy komuna serbe kinse edhe dy komuna shqiptare dhe një turke. Siç dëgjoja deputeti Mahir Jakxhillar tha se na jemi marrë vesh që komuna e Mamushës tē jetë pilot-njësi komunale. Unë nuk di pse, a janë vetëm turqit e serbët këtu apo janë edhe komunitetet hashkali, egyptas, rom, boshnjak e goran. Ne absolutisht as që jemi konsultuar nga përfaqësuesit e këtyre komunitetave që i përmenda nē lidhje me këtë që tha zoti Jakxhillar.

Ju, zoti Haziri thatë, citoj: "Integrimin e tē gjitha komunitetave". Unë nuk e shoh çështjen e integrimit tē komunitetit hashkali. Do tē flas vetëm pér komunitetin që unë e përfaqësoj. Absolutisht nuk është i cekur... Pér shembull, ka mund tē jetë edhe një pilot-njësi komunale dhe fshati Dubravë i komunës së Ferizajt që është me 2 mijë pjesëtarë tē komunitetit hashkali, me lagjen e Sallhanes që përfshin po ashtu 2 mijë dhe me një pjesë tē lagjes së Sharratëve që përafërsisht mbrrin atë territor me 5 mijë banorë që thatë ju dhe do tē ishte një pilot-njësi komunale multietnike edhe nē favor tē shqiptarëve edhe nē favor tē komunitetit hashkali, por edhe nē favor tē tē gjithë qytetarëve tē Kosovës. Nuk do me thënë që tē jetë vetëm pilot-njësi komunale e hashkalive por me multietnicitet që do tē ishte nē favor tē tē gjithë qytetarëve tē Kosovës.

Ju thatë se pér 18 muaj po ashtu do tē bëhet vëzhgim i punës tē pilot-njësive komunale, se a do tē zbatohet ligji apo jo. Nëse do tē vërehen shkelje tē procedurave tē reformimit tē pushtetit

lokal, a është në gjendje Qeveria dhe ky Kuvend ta rikthejë në binar zbatimin e ligjit të paraparë për reformën e pushtetit lokal në këtë njësi komunale të propozuar nga Qeveria, apo se nuk punohet në bazë të programit për reformën e qeverisjes lokale, a do të jetë në gjendje të shpërbejë këtë njësi komunale. Një shembull konkret, flitet këtu për bartjen e kompetencave - kompetencat ekzekutive. Në kompetencat ekzekutive thuhet se emërimi i rrugëve... Një shembull konkret, nëse unë shkoj në Partesh, dëshiroj të takohem me kryetarin e asaj komune. Personalisht, si Sabit Rrahmani, i them se mue do t'më kishte vra shumë po të kisha pyet - ku është selia e kuvendit komunal, e me thënë në rrugën Slobodan Milosheviq!. A do të çonte peshë kjo për Qeverinë. Kush do t'i vendosë ata emra të rrugëve. A do të janë ato emra të rrugëve në favor të gjithë qytetarëve të Kosovës. Apo, le t'më falë zoti Gjokiq dhe zonja Zllatica Kujunxhiq, nuk po flas për ata deputetë që kanë pranuar institucionet e Kosovës, por po flas për ata deputetë që sot nuk i kemi këtu dhe tash po shoh se politikisht kryetari i Komisionit për komunitete dhe kthim paska marrë pjesë në dy mbledhje të fundit të Komisionit për komunitete dhe i ka thirrë vetë - Zoti Rangjell Nojkiq, që qe gjashtë muaj nuk ka qenë dhe nuk e ka udhëhequr këtë Komision por e ka udhëheq zonja Sanije Alijaj, por e ka thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme të Komisionit dhe pikë të rendit të ditës ka pas decentralizimin dhe askush prej komuniteteve pakicë nuk ka përkrah atë rend dite, duke thënë se së pari le të debatohet në Kuvend e pastaj do të debatohet edhe në Komisionin për komunitete. Po këtu po shihet shumë qartë se interes i tyre ka qenë shumë i madh dhe faktikisht me decentralizim unë do të kuptoj se ju do t'i jepni kompetenca edhe më shumë bashkësive komunale serbe që ata me të vërtetë prap të bëjnë institucione paralele dhe të punojnë në favorin e tyre, e jo në favorin e qytetarëve të Kosovës.

Thash, emrat e rrugëve me siguri do të ngrisin tensione, nëse në komunat apo vërtetë në pilot njësitë komunale në Partesh dhe Graçanicë do të emërohen disa rrugë që për shumicën shqiptare nuk do të janë të pranueshme. Nëse pilot-njësitë komunale për juve të komunitetit shqiptar, që jeni shumicë, janë të pranueshme dhe nuk do të çojë peshë dhe nëse ju i çoni nga një dorë unë kam me i çue të dyat. Sepse, nëse për ju janë të pranueshme, do të janë edhe përmua, por unë po kam frikë se kjo do të sjell tensione. Unë kisha përkrah fjalën e zotit Alush Gashi që drejt procesit të statusit final të Kosovës dhe pavarësisë së Kosovës atëherë decentralizimi dhe reformimi i pushtetit lokal do të ishte më i qëndrueshëm, e kurssesi tash. Mandej shërbimet e arsimit fillor dhe të mesëm... A do të jetë në gjendje Qeveria të kontrollojë se me të vërtetë a do të punohet me planprogramin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës apo me planprogramin e ministrisë së arsimit të Serbisë. A do të flitet aty se qys Milosheviqi nuk e ka nënshkruar marrëveshjen e Dejtonit, qys Milosheviqi iu ka thënë paramilitarëve serbe që të masakrojnë apo diçka tjetër... A do të ketë kontroll Qeveria e Kosovës në këto njësi pilot-komunale. Ndoshta për dikend është qesharake, por përmua është realitet dhe me siguri do të përsëritet, kjo do të përsëritet që po flas tash. Unë ju kisha latur dhe preferuar, ju lutem në tokë e në qill, se politika zhvillohet në Kuvend, por unë dua me folë diçka realitet që po na vranë neve. Duane atë që ju don, duani këto komunitete pakicë që dojnë pavarësinë e Kosovës tha zoti Numan Baliq, duane atë që ju mbështetë, duane atë që i mbështetë proceset pozitive, duane atë që gjithmonë ka dhënë për Kosovën, do të jepë për Kosovën dhe kur është nevoja ka me luftuar për Kosovën. Mos i duani ata që sot nuk i keni këtu, nuk do me thënë mos i duani por mos bëni politikë gjenjeshtare për me thënë haptas që tash me dalë në foltore dikush prej tyre do të thotë "Kosovë e metohi", do të thotë "Kosovë e metohi" dhe ato njësi komunale do t'i paraqet si pilot-projekte apo njësi komunale të "Kosovës e metohisë", unë do të thoja "Kosovës së republikës". Nëse bëhet për shembull në Ferizaj, në fshatin Dubravë me lagjen e Sallahanës dhe disa lagjeve tjera që janë të komunitetit hashkali unë do të them se kjo njësi komunale është e "Kosovës dhe republikës", kurse këta prap do të thojnë pilot-njësi komunale të "Kosovës dhe metohisë". S'di sa herë e kanë përsëri në këtë foltore, ata absolutisht nuk kanë pranuar institucionet e përkohshme të vëtëqeverisjes së Kosovës, absolutisht s'i kanë pranuar.

Po t'i kishin pranuar do të ishin këtu, qe 6 muaj ne s'po i shohim ku janë. Dhe faktikisht në teori janë përfshi me të gjitha komunitetet por në praktikë nuk janë. Absolutisht nuk janë.

Zoti Kryeministër, ju para disa dite, keni thënë në një deklaratë në media që Serbia duhet t'i kthejë këto dokumentet kadastrale. A do të paraqesin problem dokumentet kadastrale për territorin e pilot-njësive të komunës që ju nuk i keni, çka do të bëni, a do t'i kërkoni nga kryeministri Koshtunica që t'i kthejë dokumentat kadastrale, por nëse nuk i kthen dokumentet kadastrale ku do të bazoheni për territorin e këtyre njësive komunale.

Po ashtu flitet këtu për disa qëndrueshmëri ekonomike, traditë kulturore dhe gjuhësore si dhe në bazë të të dhënave të regjistrimit civil. Cilit regjistrim civil? Të vitit 1981, apo regjistrimit të vitit 1991 edhe pse nuk e mbaj shumë mend sepse kam qenë nja 12-13 vjeçar, apo regjistrimi civil që do të bëhet tash. Flitet për listën e votuesve. Cilën listë të votuesve? Këto që do të bëhen zgjedhjet lokale të vitit 2006 apo të vitit 2002 apo 2004 që janë mbajtur, nuk është e cekur mirë në dokumentin kornizë. Po ashtu qeveria mbasë ka propozuar disa njësi-pilot komunale ku është marrë si bazë që ato pilot-njësi komunale të kenë qëndrueshmëri ekonomike. Siç tha zoti Surroi, me çfarë zhvillimi ekonomik do të mbahet Parteshi, që tha shumëmirë – vetëm me një kafiteri bëhet ai dhe aty ka zhvillim ekonomik, tjetër kund nuk ka. A ka strategji, a ka plan, a ka hartim për zhvillim ekonomik të mirëfillt. Tjetër nuk di çka të them, por vetëm kisha me preferua që kjo të kthehet prapë, të rishqyrtohet dhe prapë të dalë në Kuvend. Për mua është shumë absurde. Në teori përmenden gjitha komunitetet, në praktikë vetëm komuniteti serb. Unë e di se është nevojë e parashtruar që serbët të integrohen në jetën shoqërore-politike dhe në të gjitha sferat e jetës, por aman për rize të zotit – edhe ne jemi njerëz, a din – me ju thënë kështu shkurt. Edhe na jemi njerëz, mos na merri sa për sy e faqe. Mua vetja në Kuvend po më duket si njeri i kategorisë së dytë. Nuk dua me llogarit veten njeri i kategorisë së dytë. Edhe unë di me hengë, di me pi, di me ecë, di me mendu, di me shkrue si ju. Faktikisht të jemi të gjithë të barabart, nëse jemi për një Kosovë demokratike paqësore për të gjithë qytetarët e Kosovës, atëherë mos të jemi për dikend nënë e për dikend njerëz. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, E ka fjalën Mahir Jakxhillar, replikë.

#### DEPUTETI MAHIR JAGCILAR:

Faleminderit zoti Kryetar. Unë desha vetëm shkurt t'i përgjigjsem zotri Sabitit. Unë jam përfaqësues i Grupit 6+ në të cilin grup janë boshnjakët, shumica e boshnjakëve dhe turqit dhe në emër të Grupit unë kam mbajt fjalimin.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Tani para se të merremi vesh përvazhdimin e punës, një informatë. Deputetët duhet ta dinë se Kuvendi për herë të parë dhe të gjitha organet e saj kyçet në këtë temë sot. Prandaj, mos të manipulohet asnjë deputet dhe askush me ndonjë të dhënë tjetër. Thash, Kuvendi dhe të gjitha organet e Kuvendit.

Tjetra. Për hir të programimit të kohës, ka edhe afër 60 deputetë të paraqitur për debat, prandaj ju kisha lutur t'i kemi dy mundësi për pauzë, ose një pauzë të shkurtër – kafepauzë, ose pauzë pak më të gjatë për drekë dhe për këtë dua ta kam pëlqimin tuaj. Ndoshta do të ishte më efektive të jetë një pauzë më e gjatë dhe të shfrytëzohet për drekë. Si të doni ju. Çfarë mendimi

kanë grupet parlamentare? LDK – po, PDK – po, AAK – po. Prandaj, në orën 14 vazhdojmë punën e Seancës. Ju faleminderit.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

### SEANCËN NË VAZHDIM E KRYESOI NAIM MALOKU, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Po vazhdojmë punën. Për fjalë është paraqitur deputeti Sabri Hamiti.

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

Zotni kryesues i Seancës, kolegë të nderuar, ministra të pranishëm, U avulluan shumica, por do po i shoh këtu. Punën e kanë kryer - mendojnë këta, dhe nuk e kanë mirë.

Tema që është shtruar në Kuvendin e Kosovës të diskutohet, është një temë që është bërë tepër publike para se të bëhet institucionale dhe unë mendoj se tensionet dhe interpretimet që kanë ndodhë në publik kanë qenë të natyrave të ndryshme pikërisht pse është ndërruar rendi normal i diskutimit të çështjeve fundamentale për Kosovën.

Kjo temë e ka një histori, dhe unë nuk do ta përsëris të térën, por vetëm do të them se initialisht kanë ndodhur si dëshirë e shefave të komunave në Kosovë që nëse mendohet që të decentralizohet pushteti do të kenë pushtet më shumë, që ka qenë një rezonim tepër naiv i cili më vonë është derivuar në një kërkësë për ndërrime – do ta quaja unë – sistemore në Kosovë.

Vetë termi është paraqitë në forma të ndryshme, varësisht nga modusi i diskutimit dhe nga diskutuesi. Nganjëherë quhet reformë e qeverisjes lokale, që në të vërtetë nënkuption një çështje sistemore të ndërrimit sistemor të organizimit. Nganjëherë quhet decentralizim që nënkuption bartje të pushtetit nga një qendër kah periferitë, marrje e pushtetit në njësitë më të vogla nga qendra. Nganjëherë është quajtur decentralizim, kryesisht në interpretimin e faktorëve ndërkombëtar në Kosovë si një kusht, një kushtëzim, si një detyrim për të arritur një bisedë për statusin ose statusin e Kosovës. Domethënë, që në nismë të problemit ne kemi akzeptim të ndryshme dhe perceptime të ndryshme të një problemi dhe kjo ka kofoni, ose mosbukur tingëllim i kuptimit duket që ekziston edhe sot dhe në bazë të rja 11 diskutimeve që i dëgjova unë këtu dhe nga referime te Kryeministrit dhe Ministrit të pushtetit lokal.

Ne kemi në dorë dy dokumente qeveritare që kanë të bëjnë me këtë problematikë. Një i Qeverisë së kaluar, që ka datën 19 korrik 2004, që është më shumë teorik e rekomandues, me tendencë për të ngritur çështje në nivel sistemi por që ka edhe dy shtojca: një për një kërkësë të ndërtimit të legjislacionit dhe një i dyti që është për pilot-komunat. Dhe një dokument të dyte, që është i Qeverisë së tashme, me shenjën shkurt 2005 i mbështetur e i derivuar nga dokumenti i parë, pra i Qeverisë tjetër, i propozuar tash si program pune për vitin 2005 duke u zhvilluar më tutje - projekti i pilot-komunave, madje me një emërtim të tyre konkret. Pra, ky që ofron Ministria e tashme e pushtetit lokal dhe Qeveria s'është kurrgjë tjetër përpos eksplikim dhe kërkësë për zbatim të shtojcës së dyte të programit të Qeverisë tjetër.

Të dy dokumentet nuk kanë dalë deri më tash para Kuvendit, si organ më i lartë përfaqësues i Kosovës, por janë rjaftuar me konsultime me UNMIK-un, ndonëse prekin në thelb sistemin politik dhe konstitucional të Kosovës.

Mendojmë që nuk mund të bëhet dhe është vështirë të bëhet reforma e pushtetit lokal pa u zgjidhur statusi politik i Kosovës. Nuk mund të ketë decentralizim të pushtetit që nuk është krijuar as në qendër. Shkurt t'i bie – pushtet në kuptimin e sundimit të Kosovës, e qeverisjes së Kosovës, në kuptimin klasik nuk kanë as institucionet e Kosovës, këto që iu thonë të përkohshme, edhe pse i kanë gjashtë vjet, është pak qesharak emërtimi, por ja qe - kështu quhen.

Nuk bën të bëhen ndryshime sisteme pa një legjislacion paraprak të aprovuar në Kuvendin e Kosovës. Nuk bën të krijohen "komuna etnike", sepse de facto do të bëhet legalizimi i strukturave paralele, e kjo shpie kah ndarjet etnike dhe dezintegrimi i Kosovës që, për pasojë, mund të ketë pikërisht mosintegrimin e minoritetave. Një decentralizim i këtillë, ka funksion të paragjykimit të statusit politik të vendit dhe ky është një problem shumë i madh. Nuk bën të formohen komuna të reja me urdhëresa administrative të PSSP qoftë edhe duke konsultuar Qeverinë, se kështu shkelet komiza kushtetuese që është shumë restiktive edhe kjo. Pra, kërkush nuk e theksoi këtu, as përfaqësuesi i Qeverisë, as Kryeministri atë që është fundamente që mendohet se këto pilot-komuna do të krijohen në bazë të një urdhëri administrativ të administratorit të Kosovës. Kjo do të thotë se i përjashton të gjitha institucionet ligjvënëse në krye me Kuvendin dhe del që ky është një projekt që shkon përskaj Kuvendit në një bashkëmarrëveshje me Qeverinë, kështu që diskutimin tonë e deplason në esencë.

Si përfundim, për decentralizim në formë të pilot-kununave i detyruar qoftë si kushtëzim për definimin e statusit të Kosovës pa miratimin e qytetarëve nuk do të zgjidhë asgjë, vecse do të krijojë konfuzione. Qeveria, ajo e kaluara dhe kjo e tashmja, duhet të deklarohen haptas këtu në Kuvend – kush i detyron që të bëjnë veprime të këtilla, apo është veprim i vullnetit të tyre për ndërrimin e sistemit konstitucional dhe politik në Kosovë. Duhet të bëhen të përgjegjshme e të mos marrin veprime arbitrale sepse në fund të fundit përgjegjësia bie mbi Kuvendin dhe Qeverinë dhe mbi përfaqësuesit e zgjedhësve në Kosovë.

Rregullimi i statusit të pushtetit lokal në Kosovë, është domosdoshmëri por edhe proces që do studim, që do regjistrim të popullsisë dhe do kohë për t'u realizuar dhe nuk është proces ...

(Ndërprerje nga regjia)

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Jemi marrë vesh për 7 minuta, por ju lutem le t'i vazhdohet mundësia e diskutimit zotit Sabri Hamiti.

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

Unë isha duke e përfunduar, sepse edhe ashtu e di që këtofarë forma restiktive janë nganjëherë qesharake por s'kemi çka t'i bëjmë, nëse e pranojmë këtë lojë, krejt formale.

Pra, don regjistrim të popullsisë dhe do kohë për t'u realizuar dhe nuk është proces që mund të kryejë asfarë voluntarizmi politik qoftë të individit apo të institucionit. Kur them voluntarizëm politik, kam parasysh kushtëzimet politike dhe këtu duhet të thuhet menjëherë që të dy projektit në fshinjë implicate tregojnë që janë veprime politike, jokonstitucionale. Merreni programin e Qeverisë së parë, çka thotë paragrafi i parë i faqes së fundit: "Kjo zgjidhje e

përkohshme rekandomohet për shkak të zgjedhjeve të ardhshme dhe formimit të qeverisë së re". Ta keni parasysh – është vera e vitit të kaluar. Ka qenë ndjellje e pjesëmarries në zgjedhje. Nëse ky tip i logikës së veprimit politik, që s'është konstitucional, vazhdon edhe me këtë të dytën ku herë thuhet njësi nënkomunale, herë kommunale, herë e herë janë këto arsyetime, në esencë ne kemi shkurt e shqip kërkesën për të krijuar komuna etnike dhe unë mendoj se në Kosovë nuk duhet të formohen komunat etnike. Faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Falemnderit, zoti deputet. Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi, le të bëhet gati deputeti Fatmir Sejdiu.

#### DEPUTETI BAJRAM REXHEPI:

Faleminderit, i nderuari kryesues. Të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë, Pa dashtë të përsëris çka parafolësit thanë, domosdø diku do të përsëritimi për arsyen se materia është e tillë. Unë nuk do të hyj në elaborimin e dokumentit kornizë por do të lidhem vetëm në pjesën e aneksit ku i propozohet grupit punues që t'i definojë disa kriterë për projektin e pilot-komunave dhe të bëj një sqarim se atëherë është menduar që një komunë të përfshihet komplekt si pilot-projekt me njësi nënkomunale, por jo të nxirren disa pjesë të një komune si mënyrë selektive dhe t'i jepet në një mënyrë gati statusi i komunës.

Kjo ka qenë detyrë e grupit punues që të bazohet në disa kriterë të cilat edhe në shtetet tjera demokratike janë si fundamente, siç janë faktori demografik, ekonomik, gjografik e tjere. Sigurisht se ndoshta ka vend edhe përfaktorin etnik, kulturor e tjerë. Mirëpo, mendoj se të drejtat etnike kulturore, religioze e tjera, ato duhet të garantohen me kushtetutë, gjegjësisht me kornizën kushtetuese dhe me ligje sisteme të mund të garantohen me krijimin e komunave të reja. Tash ka aty të vërtetë edhe Qeveria e mëparshme dhe kjo kanë pasë edhe imponim edhe nga faktori ndërkombëtar. Mirëpo mund të themi pse jo ky tekst ose eksperiment me komunat pilot, që pas një kohe një apo dyvjeçare të shihet sa do të jenë funksionale.

Unë kisha me bë disa, të them kritika, sepse asnjë dokument nuk është perfekt, por kriteret e vetme për këto pesë njësi komunale ose komuna – kriteret që janë përdorë janë kriteret më të papranueshme dhe ai është kriteri politik dhe etnik. Është bërë një balancim.

Unë e di dhe jam i vetëdijshëm se shumica edhe e komunave ekzistuese ato projekte buxhetore të komunave dhe nevojat e tyre nuk i realizojnë as 20-30 për qind dhe kryesisht financohen nga grandet, nga qeveria qendrore. Mirëpo, jam skeptik për këto projekt-komuna si Elez-Hani, Graçanica, Parteshi, Juniku dhe Mëmusha. Prej tyre, ndoshta vetëm Elez-Hani ka një potencial ekonomik që deridiku të ketë një qëndrueshmëri të vetëfinancimit. Ndërsa, Juniku, pa dashur ta injoroj, mendoj përvëç ndoshta një agrikulture, kullave ose diçka tjetër si potencial vend turistik nuk shoh se ka ndonjë potencial ekonomik. Ngjashëm është edhe me Mamushën që përvëç perimtarisë, nuk ka ndonjë potencial të madh që të jetë i qëndrueshëm ekonomikisht. Mos të flas për Parteshin dhe Graçanicën të cilat, ndoshta duket banale këtë që e them, por e kam thënë edhe para Grupit kontakt plus që nganjëherë me veprime irrationale dhe të strukturave paralele ndoshta do të bëhet legjitimimi i tyre dhe nuk duhet të jemi të befasuar që të marrim ndonjë veprim që rrugët magjistrale që çojnë Prishtinë – Gjilan një ditë të qesin taksa për pagimin e trugës në mënyrë që të mbushin buxhetin e tyre, dhe ta qesin në hyrje e dalje një çekpoint dhe të kërkohet pagimi i rrugës për kalim. Kjo duket pak qesharake, por edhe këtë mund ta presim; dhe me qenë të kënaqur nëse kërkohet në euro, por ndoshta do të kërkohet në dinarë dhe atëherë edhe këmbimoret duhet pas afër.

Janë disa konsekuenca për të cilat me të vërtetë ne duhet të kemi kujdes, sepse në bazë të këtyre kriterieve kanë të drejtë të plotë legitime, sikur që u pa edhe sot në Parlament që edhe boshnjakët, hashkalijt, egjiptasit, romët e të tjerët të kërkojnë në një mënyrë dhe në bazë të këtyre kriterieve të formohen komuna tjera. Dhe që të ketë me të vërtetë një reformë dhe të ketë qëndrueshmëri, domosdø, pavarësisht se këto janë pilot-komuna eksperimentale, të përcjellën me lige adekuate, si ligji për administrimin lokal që duhet ta ndërrojë rregulloren 2000/45, ligji për financimin e komunave dhe ligji për organizimin e ri territorial - që lidhet drejtpërdrejt me kushtetutë.

Na nuk e kemi kushtetutën, pra janë dy mundësi, ose të ndërrohet një pjesë e kornizës kushtetuese ose në kushtetutën e ardhshme të parashihet se si bëhet rregullimi territorial i komunave të ardhshme. Edhe një herë po them se është bërë edhe për qëllime politike, është edhe një kërkesë e ndërkombëtarëve mirëpo të drejtat etnike, kulturore, gjuhësore e tjera nuk garanton me krijimin e komunave të reja. Kjo, edhe një herë do të them, garanton me kushtetutë, gjegjësisht ne kemi me kornizën kushtetuese dhe me ligjet sisteme. Prandaj, duhet të jemi koshient se konsekuenca mund të janë të dëmshme për Kosovën. Edhe ai që është tekst ose eksperiment duhet të jemi të kujdeshëm se çka nëse nuk tregohen funksionale këto pilot-komuna. Unë jam shumë i sigurt se nëse Juniku, Elez-Hani ose Mamusha nuk tregohen të suksesshme ose efikase, mund të kthehen prapa, por jam shumë skeptik se Graçanica dhe Parteshi nëse marrin një herë statusin e komunës, qoftë edhe si eksperiment, si projekt testues se mund t'i kthejmë prapa. Do të jesin me siguri dhe do të ketë kërkesa të ngjashme të vendbanimeve serbe që janë edhe më të mëdha se këto që të krijojnë edhe shumë komuna tjera në bazë të kriterit etnik dhe politik. Faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti Deputet. E ka fjalën Fatmir Sejdiu, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

#### DEPUTETI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti kryesues. Tema që po debatojmë është një temë e këruar kaherë, nga dy arsyet themelore. E para, në përpjekjet për të ecë në zhvillimet e mëtejshme të Kosovës këshifi apo paralel me standartet e përgjithshme demokratike ndërkombëtare, ato të cilat janë treguar si të denja dhe që për Kosovën mund të janë adapte. Dhe, e dyta, në këtë proces do të përfolja atë që më herët tha kolegu im Hamiti se ka pas edhe nxitime të vazhdueshme dhe të pandërpresa me qasje të tilla të cilat në një formë apo në formë tjetër kanë hyrë në inercion të projekteve të cilat kanë derivuar të themi një rezultat që nuk ka qenë shumë i kënaqshëm për të arritur finalën e fundit të dy projekteve - do t'i quaja të një filozofie të përbashkët, këtë që është bërë gati si dokument kornizë në Qeverinë e kaluar dhe dokumenti i tanishëm që kemi bazë të debatit sot në Kuvend.

Mendoj se çështja themelore që duhet të kemi, bashkë me këto diskutime t'i quaj të frytshme dhe kujtoj se janë të tilla, është që të bëjmë një distiksion të qartë të asaj se çka është pjesë e idës apo e inkorporuar në kuptim të një projekti apo të një programi që duhet të debatohet, që të marrim mbështetje dhe çka është ajo pjesa esenciale e shndërrimit të saj në legjislacion që duhet të dalë në plan të parë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës për të krijuar bazën e qëndrueshme juridike për ecje më tej.

Mendoj se këtu ka disproporcione në hapa. Hapi i parë është pikërisht se sikur në vetë materien, që e shohim në këto dy projekte dhe marrim projektin e fundit si projekt që përjashton të parin, është se kjo pjesë e formulimeve që gjenden këtu deivon zgjedhjet konkrete, çka juridikisht edhe në aspekt kushtetues nuk është e qëndrueshme. Ne duhet të bëjmë kërkesë që kjo materie,

që Kuvendi do ta pëlqejë si pjesë e një marrëveshjeje të përgjithshme të përbashkët, të jetë pjesë që të shndërrohet në normë dhe prandaj mbështes gjithë thirrjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e legjisacionit dhe posaçërisht të ligjeve bazike duke filluar nga ai mbi qeverisjen lokale, ai mbi organizimin territorial të Kosovës dhe duke pas po ashtu parasysh normën kushtetuese. E para së parës, në dispozitat e Kornizës kushtetuese, një nga formulimet e qëndrueshme që ka qenë nga fillimi deri tash dhe besoj se duhet të respektohet edhe më tej, është çështja e mosndryshimit të kufijve të komunave, që është një obligim i drejtëpërdrejt në këtë rast edhe i Përfaqësuesit special të Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të bashkuara në Kosovë. Mbi këtë bazë, cilësoj se kjo pjesë e përpjekjeve për të nxjerrë një proces që për ne është i nevojshëm si Kosovë, është që të krijojë kontura të nevojshme të tilla të cilat do të pasojnë në vijim e sipër apo në rrugë e sipër pa hy në prerje të përmjëherëshme të cilat do t'i quaja në rast të caktuar edhe të panevojshme apo në njëfarë mënyre që mund të sjellin pasoja, do t'i quaj në efektin e vet të fundit së tē prezikshme.

Nuk jemi në situatë që të krijojmë modelin e parcelave kadastrale për të mbjellë kultura, hibride dhe për të pa se cili do të jetë rezultati. Ne duhet të jemi në kërkim, po them në kërkim esencial të asaj se çka është esencë e ndërtimit të këtyre njësive pilot që quhen në projektin e parë apo të pilot-komunave në projektin e dytë, që esencialisht as njëra as tjetra nuk dallojnë dhe që merren apo barten kompetenca të drejtëpërdrejtë të nivelit të komunave në to duke krijuar mbi këtë bazë, pa një mbështetje legjislativë, partnerë në proceset e mëtejshme të ndërtimit struktural të komunave të Kosovës.

Çështja e dytë. Zoti Hamiti e theksoi, që mendoj se është shumë esenciale, është çështja e decentralizimit të pushtetit në vijën e bartjes së përgjegjësive nga ana e institucioneve ndërkombëtare dhe të Përfaqësuesit special në institucionet e Kosovës. Sikur dëshirohet menjëherë dhe mendoj paarsyeshëm që një bartje e tillë, që besoj se edhe nuk do të ndodhë krejt asisoj, të bartet prej nivelit ta quajmë të Përfaqësuesit special drejtëpërdrejt në nivel të komunave pilot apo edhe të komunave - nëse doni kësosoj - pa e krijuar prap paralelisht një kornizë të nevojshme, e cila do të jetë mbështetëse në proces të mëtejshëm.

Çështja tjetër, që është e rëndësishme dhe mendoj se duhet të jetë në pjesën e përpjekjeve të mëtejshme të Qeverisë për të nxjerrë vërtetë një ide të qëndrueshme bashkë, është çështja e inkorporimit të institucioneve të Kosovës pikërisht në këtë vi të Kuvendit të Kosovës që ai mos të jetë i anashkaluar në proces të martjes së vendimeve dhe shprehjes së qëndrimit të tij në relacione konkrete.

Kemi ta zëmë në faqen 4 – “Themelimi i pilot-njësive komunale do të vëhet në jetë në aspektin ligjor me anë më të mirë të një urdhërese administrative, pas konsultimeve me komunitat në fjalë dhe me pëlqimin e Qeverisë.”. Ku është Kuvendi i Kosovës? Mendoj se ky debat që në kemi sot, është një nga pjesët e nevojshme por në fazën tjetër domosdo.

Çështja e dytë, është çështja e krijimit, theksova - të partneritetit mes komunash dhe pilot-njësive që do të janë komuna dhe këtu mund të marr vetëm një shembull. Nëse nuk krijohet një strukturë e qëndrueshme mbi bazë ligjore, pra në karakterin e përgjithshëm sistemor duke filluar edhe me ligjin mbi organizimin territorial me kompetenca të qarta - droj se mund të kemi praktika që nganjëherë kanë qenë në fazë të caktuara të historisë pengesë kryesore e zhvillimeve, e komunikimeve midis entiteteve në rastin tonë edhe të imbylljes së tyre eventuale.

Unë e them një shembull, ta zëmë në Francën e dikurshme që sot ka krejt një model tjetër, më vështirë ka qenë të kalosh nga jugu i Francës në veriun e Francës sesa të shkosh nga pjesa e Evropës së skajshme deri në Kinë. Ne jemi që të krijojmë, të krijojmë komunikim, mos të

krijojmë forma të atilla të cilat në një mënyrë apo në mënyrë tjetër krijojnë bariera të këtyre komunikimeve.

Dhe, një element i tretë, që duhet t'i kihet kujdes i posaçëm, është çështja e instancës apo e veprimit të pushtetit të ndarë, pushtetit të gjyqësisë. Nëse ne kërkojmë që në një fazë të zhvillimit të mëtejshëm konfliktet eventuale që mund të ndodhin në mes komunash të zgjidhen në nivel sistemor, të zgjidhen ta zëmë në nivelin e Gjykatës Supreme të Kosovës apo panelit të posaçëm të saj i cili është i krijuar me Kornizën kushtetuese dhe në anën tjetër kemi restrikcion në ndërhyrje ndërkombëtare apo përfaqësuesit të UNMIK-ut, mendoj se nuk është në rregull. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. E ka fjalën Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Lulzim Zeneli.

#### DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit zoti kryesues. Zonja dhe zotërinj,  
Thonë, nuk mund të ecë shpejt ai që nuk e di se për ku është nisur. E rrëfimi kosovar për pushtetin vendor që në zanafillë sot e gjithë ditën është prezantuar i ngatërruar dhe i mbështijellur, herë si decentralizim, herë si reformë e pushteti vendor, dhe rrallëherë edhe si ndërtim i një pushteti të ri demokratik e funksional.

Apologjia që dëgjuam ndërkajq sot këtu, mua ma kutoj një diskurs po nga kjo foltore, po në këtë sallë që tashmë kam pas besuar se është harruar por që mua më ktheu në kohën e rinisë sime. Që në fillim do të doja të them fare qartë dhe shkoqur pse edhe unë ashtu si edhe shumica e deputetëve dhe qytetarëve do të ishte packuivoke për se cilën prej qasjeve të përmendura po të ishin të mirëfillta, mbasë me renditje të kundërt. Mirëpo do të isha i pasinqertë po të mos theksoja po aq shkoqur se unë ashtu si edhe shumica këtu nuk jam bindur se ajo që po na serviret është qoftë decentralizim, qoftë reformim dhe aq më pak ndërtim i një pushteti të ri demokratik të vetëqeverisjes vendore. Në secilën trajtë që shtrohet çështja, imponohen pyetje e dilema të shumta.

Po parashtroj disa prej tyre, duke kërkuar falje që nëse përsëris ndonjë dhe duke filluar me pyetjen e apo shtruar. Ç'është në të vërtetë kjo që po na serviret? Si e ka emrin, si ta quajmë? A është kjo që ofrohet prioritet i vërtetë i transicionit aktual në Kosovë? Pse nuk ishte përfshirë si e tillë në dokumentin e standardeve për Kosovën dhe kush e imponoi si prioritet dhe standard parësor me aq nguti. Pse poenët e meritat për këtë projekt merren përvete, kurse përgjegjësia eventuale i hidhet të tjerëve. Unë druaj se autorësia e vërtetë i takon dikujt krejt tjetër. Pse në procesin e deritashëm u anashkalua Kuvendi i Kosovës dhe pse në procesin e planifikuar të ligjvënes madje edhe për miratimin e ligjeve – vëni re ju lutem – injorohet Kuvendi. Thuhet "i miraton Qeveria". Deklaratat dhe idetë e plasuara të Kryetarit të Kuvendit besoj as, kanë përfaqësuar Kuvendin dhe as janë marrë të tilla. A duhet t'i paraprijnë ndryshimet ligjore e kushtetuese reformës së pushtetit apo reforma duhet t'i paraprijnë ligjeve e kushtetutës.

Riorganizimi eventual i pushtetit vendor rregullohet me ligj, siç theksohet në një pjesë të dokumentit, apo me urdhëresë administrative të Përfaqësuesit special siç theksobet në pjesën tjeter. Pse lexohet e citohet vetëm Kreu i tetë dhe vazhdimisht harrohet Kreu i pestë. A ka arritur pushteti qendror në Kosovë në atë shkallë që të imponojë nevojën e decentralizimit. Si mund të bëhet decentralizimi i një pushteti të pakompletuar dhe skajshmërisht të decentralizuar. Çka ofron projekti për decentralizim, në relacionin UNMIK - komunitat e Kosovës? Si mund të

decentralizohet për shembull Shtërpca dhe komunat si ajo, dhe çka do të thoshte kjo për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Çka ofron projekti për decentralizim në relacionin Beograd – komunat me shumicë serbe në Kosovë? Çka decentralizon, reformon e demokratizion projekti i Qeverisë në komunat që nuk janë përfshirë në projektin pilot? Cili është kriteri i përzgjedhjes së lokaliteteve për projektin pilot? Mbi ç'bazë janë përfshirë lokalitetet si Parteshi e Mamusha dhe jolokalitetet që u përmendën këtu, të mos i përsëris. A mund të pritet që zgjidhjet qështë edhe si pilot-projekte që ofrohen në Kosovë të zbatohen edhe jashtë Kosovës, për shembull në Siarinë e Hashanitëm, të Medvegjës e të Vranjës. A ishte formimi i komunës së Zveçanit një lloj i ngashëm pilot-projekti? A është analizuar efekti i tij, dhe cilat janë përfundimet?

Shndërrimi artificial i një lokaliteti minoritar, në një qendër administrative, e forcon apo e trezikon identitetin etnik të lokalitetit? Me fjalë tjera, modeli i tashëm i Gjilanit është zgjidhje, apo veriu i Kosovës. Ndarja e panaqyrshme administrative mbi motive e kritere ekskluzivisht etnike e ndihmon atrimin, integrimin dhe pajtimin ndëretnik apo sjell të kundërtën? A bëjnë pjesë në funksionet e transferueshme të pushtetit sipas praktikave moderne edhe policia, gjyqësia dhe çfarë do të thoshte kjo për të ardhmen e Kosovës. A është koncepti bazë i shoqërisë së ardhshme të Kosovës koncepti qytetar apo koncepsi i banorit, një pjesë e tërë i është kushtuar kësaj. Çka do të thotë koncepti banor? Si shpjegohet formulimi dhe definimi i papreseden i këtij koncepti në dokument dhe veçmas rekondimini pompoz i këtij koncepti përligjet e ardhshme. Si shpjegohet legjitimimi me projekt i krijimit të asociacioneve, vëni re, në shumës "të asociacioneve" dhe jo të një asociacioni të komunave dhe ku do të çonte kjo. Cila është kostoja e këtij projektit, nga do të financohen - e të tjera.

Ka edhe shumë pyetje, zonja dhe zotërinj që do të mund të shtroheshin por nuk lejon koha, aq më pak ka kohë përgjigjet eventuale. Qeveria megjithatë ka kohë. Përgjigjet adekuate në këto dhe në shumë pyetje tjera të ngashhme janë kusht i domosdoshëm për një transicion të suksesshëm të pushtetit vendor në Kosovë, proces të cilin - po përsëris - do ta mbështesim me forcë. Thonë mënyra më e mirë për të diskredituar e pamundësuar një ide të drejtë është ta çosh atë deri në absurd. Absurde është t'i hysh rregullimit të interierit e mobilimit të shtëpisë ende para se ta përfundosh, ende para se t'i hedhësh kulmin. Dokumenti i ofruar për fat të keq, ka shumë absurde të tila dhe ne na vë në pozitë absurde. Të themi po, i themi po gabimit dhe dështimit. Kurse të themi jo, mund të duket sikur i themi jo procesit të normalizimit të demokratizimit në Kosovë. Dikush do të dëshironë që ne t'i bënim të dy gabimet. Kosova nuk duhet ta bëjë as njërin as tjetrin nga këto gabime. Kosovës së re i duhet proces i mirëfillt i ndërtimit, reformimit dhe demokratizimit të të gjitha niveleve të pushtetit dhe jo kuazidecentralizim që në fillim mua më pat tingëlluar, dikush edhe mund ta ketë dëgjuar, si po e them serbisht "deçja decentralizacija - deçja centralizacija", kurse tash më tingëllon si "dreçentralizim". Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka Lulzim Zeneli, le të përgatitet Zylfije Hundozi.

#### DEPUTETI LULZIM ZENELI:

Inderuar kryesues i Seancës, ministra të Qeverisë së Kosovës, deputetë të respektuar, Më lejoni t'spreh opinionin tim rrëth reformimit të pushtetit lokal, gjegjësish programin e Qeverisë për reformë lokale, temë e cila është përfolur mjaft por jo edhe e debatuar deri më tanë.

Sot kemi pas rastin të dëgjojmë se në këtë aspekt edhe jemi të vonuar, por konsideroj se derisa edhe vendet me traditë shumë të lartë demokratike debatojnë bille-bile edhe bëjnë debate shumë të ashpra në këtë temë, e konsideroj se në këtë aspekt nuk jemi edhe aq të vonuar sa mendojmë.

Mendoj se ky proces nuk duhet tē shikohet nga prizmi i ngushtë dhe i mbyllur pér vetë faktin se nuk ekziston ndonjë sistem i reformimit tē pushtetit lokal tē cilin mund ta përqafonim leht. Reformimi i pushtetit lokal apo decentralizimi dhe hyrja në agjendë politike të Kosovës si kushtëzim politik apo nevojë e zhvillimeve tē trendëve demokratike sot nuk ka aq rëndësi tē madhe sa kanë rëndësi veprimet e matura dhe tē peshuara mirë pér t'u adresuar drejt ky proces nē përputhje tē plotë me interesat e qytetarëve dhe me interesat e vendit.

Decentralizimi apo reformimi, si po e quajnë, i pushtetit lokal, si proces e kemi përkrahur nē parim bazuar nē përparrësitë që i ka ky proces, dhe ajo siç kanë qenë shpërndaja e përgjegjësive, adresimi, shkurtimi i rrugës së komunikimit që shumë shpesh po përfolët dhe ngritura e cilësisë së shërbimeve. Mirëpo, nē këtë rast nuk duhet hezituar nē asnjë mënyrë tē theksohet se duhet kujdes dhe tē vihet nē konsideratë mundësia e krijimit tē strukturave tē mbyllura dhe tē izoluara, mosflaksionimi i kontrollit dhe largimi ndaj përgjegjësisë pér interesin më tē gjerë. Dhe krejt kjo është e sforuar kur kihet parasysh koha dhe rrëthanat nē tē cilat po zhvillohet ky proces, pozita aktuale e Kosovës dhe krejt kjo gamë e konfuzitetit që është krijuar nē opinionin tonë fatkeqësishët e krijuar nga qeveria e kaluar dhe e bartur edhe nga Qeveria e tanishme. Por, pavarësisht se është zhvilluar e tërë kjo ekspeditë nga shumë faktorë tē involvuar nē këtë projekt, është inkurajes fakti se Kosova po hyn nē këtë proces duke pas nē tavolinë një mori praktika tē dëshmuara rrëth reformimit tē qeverisjes lokale.

Duhet tē kihet parasysh nga tē gjithë aktorët pjesëmarrës çka është thënë edhe sot sepse një proces i tillë nuk është i lehtë. Është një proces që merr kohë, ka koston e vet, por din tē jetë edhe i dhimbshëm. Kjo është parë edhe nē fajnjësi, dhe një praktikë e tillë është dëshmuar edhe nē vendet perëndimore.

Të nderuar deputetë, ne kemi pranuar reformimin e pushtetit lokal, po e theksoj edhe një herë – si nevojë tē kohës që shtrojnë proceset vendore dhe trendët e zhvillimeve demokratike, por konsideroj se pér tē qenë nē harmoni me zhvillimet normale tē këtij procesi është i domosdoshëm marja e opinioneve gjithëpërfshirëse. Dhe, një gjë e tillë bëhet dhe është e mundur vetëm me një rol shumë më aktiv tē institucioneve vendore. Pa një kampanjë tē fuqishme dhe tē guximshme pér tē larguar tē gjitha dilemat që ekzistojnë sot nē opinion rrëth decentralizimit apo reformimit tē pushtetit lokal nuk shpresojmë se do tē ketë një proces rezultativ nē këtë aspekt. Qytetarët e Kosovës duhet tē largojnë njëherë e përgjithmonë frikën që kanë pér këtë proces, së pari. Reformimi i pushtetit lokal, krijimi i pilot-njësive komunale assesi nuk duhet tē krijojë idenë e krijimit tē territoreve nē baza etnike ashtu siç propagandohet. Qytetarëve tē Kosovës duhet t'i u mundësohet ta kuptojnë drejt këtë proces, pastaj cili është interesë i tyre dhe çka përfitojnë nga ky proces. Qeveria duhet tē jetë ajo e cila duhet tē bëjë tē qartë se cili është synimi, caku i synuar dhe nē çfarë forme do tē vazhdojë ky proces edhe pas njohjes së pavarësisë së Kosovës. Të mos harrojmë se - problemet mbi reformimin e pushtetit lokal vetëm mund tē shtohen edhe pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës, sepse vetëm atëherë mund tē dëshmojmë dhe tē argumentojmë nē mënyrë tē plotë interesin dhe perspektivën e qytetarëve nē tërë këtë proces. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Falemnderit zoti deputet. Fjalën e ka deputetja Zylfiye Hundozi, le tē përgatitjet deputetja Teuta Sahatqija.

#### DEPUTETJA ZYLFIE HUNDOZI:

Zotëri i kryesues, deputetë tē nderuar, zotni ministra tē pranishëm,

Në momentin kur institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes e kanë pranuar që t'i realizojnë standarde si parakusht për pavarësinë e Kosovës, njëherit e kanë pranuar që të bëjnë realizimin e decentralizimit i cili është pjesë e këtyre standardeve. Shpresoj se nga diskutimet që do të mbahen sot në këtë seancë do të dalin propozime të mençme, të cilat do t'na ndihmojnë që ky proces të zhvillohet ashtu që të arrijë qëllimin e vet e mos të dëmtojë shumicën e popullatës së Kosovës. Pasi që decentralizimi është një proces i vazhdueshëm, i cili do të zgjasë edhe më tutje, mendoj se kam të drejtë të propozoj formulimin e një dokumenti të ri, gjegjësisht ligji për këtë çështje i cili do të merr parasysh specifikat ekonomike, kulturore, historike dhe politike të Kosovës të kombinuara nga diskutimet më të dobishme nga debati i sotëm.

Dokumenti kornizë që na jepet, paraqet një kopjim të dokumenteve të ngjashme nga shtetet evropiane, i cili na është servuar si rezultat i punës së Grupit punues në Kosovë. Me shpresë se do të formulohet dokumenti, gjegjësisht ligji i ri, e me qëllim të dhënieve së kontributit në këtë drejtim, i jap këto propozime konkrete:

Gjatë përpilimit të ligjit, të ndërrohet definicioni për banorin e komunës. Tani në tekstin e dhënë nga Grupi punues, banor të komunës janë përpos banorëve të përhershëm edhe personat që kanë jetuar në territorin e komunës para janarit të vitit 1998. Ky definicioni duhet të ndryshohet sepse dihet që menjëherë, pas fillimit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë duke u nisur nga lufta në Sloveni, Kroaci dhe Bosnie – Kosova ishte vërvshuar me refugiatët nga këto vende, të cilët kanë jetuar në Kosovë gjatë vitit 1998.

Në pjesën e këtij dokumenti, ku shtjellohet siguria publike në komunë, faqe 16, teksti shqip, faqe 14 teksti serbisht, në pjesën ku merret parasysh siguria e komuniteteve, flitet për krijimin e këshillave të sigurisë publike, të cilat do të krijojen në nivelin lokal, ndërsa organ ekzekutues i tyre do të jenë agjencitë e ndryshme të sigurisë dhe SHPK. A duhet të lejojmë që pos SHPK-ës edhe krijimin e agjencive të ndryshme të sigurisë, të cilat do t'i ndihmojnë komunës për realizimin e sigurisë së komuniteteve. "A o t'i jasin llogari këto agjencione? Nëse lejojmë që pos SHPK-ës me sigurimin e popullit, merren strukturat e ndryshme, do të arrijmë efekt të kundërt me atë të cilin e kemi dëshiruar ta arrijmë primarisht duke filluar reformën e pushtetit lokal, e ai është integrimi i të gjitha strukturave ekzistuese në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Tanimë dihet se SHPK-ja është multietnike dhe ky është argumenti i mjaftueshëm përfunksionimin e tyre edhe në ato vende me minoritete.

Tani është aktuale realizimi i pilot-projekteve pasi që reforma e pushtetit lokal është proces i gjatë dhe kërkon shumë kohë e angazhim. Përzgjedha e tanishme e njësive pilote është në bazë të një përkufizimi përfundimtar ku ata do të vendoseshin mbi bazën e zonave gjeografike të dalluara qartë, grup fshatash me disa tipare gjeografike, ku qytetarët janë lidhur me nevojat dhe interesat e përbashkëta – traditë kulturore dhe gjuhë të përbashkët. Me përkufizimin e tanishëm trasohet rruga që këto njësi komunale të bëhen etnikisht të pastra.

Qëllimi i krijimit të pilot-projekteve është që të testohen objektiva e procesit të reformës së qeverisjes lokale, siç janë:

(Ndërrim fajli nga CD – ndërprerje e shkurtër)

.... pastra. Marrja e Graçanicës përfundimtar, e cila është etnikisht e pastër, është njëjtë si me marrë përfundimtar Prokuplen. Objektivat e parashtruara mund të arrihen vetëm nëse propozohen përfundimtarët e komunale të cilat nuk janë etnikisht të pastra. Përfunksionimin e komunave etnikisht të pastra tanimë e dimë, dhe vështirësitet të cilat janë të paraqitura janë të njoftura përfundimtarët e Kosovës. Prandaj, duhet të jepen propozime të reja përfundimtarët e komunave etnikisht të pastra.

formimin e pilot-njësive komunale e jo ato që janë dhënë tani dhe si kriter tē mos jetë etniciteti i pastër.

Shpresoj se Qeveria do t'i marrë parasysh rekandomet nga këto diskutime dhe do tē dalë me një dokument tē ri, zbatimi i tē cilët do tē jetë i dobishëm pér tërë popullin e Kosovës. Edhepse po ngutemi që standartet tē vlerësohen pozitivisht, është më mirë që ky proces prej fillimit tē vendoset në baza të shëndosha, duke marrë parasysh realitetin e tanishëm kosovar, që më vonë mos tē kemi ndjenjë tē fajit pér gjykime që do tē mund tē bëheshin nga gjeneratat e ardhshme. Faleminderit.

#### KRYESUESI NAJM MALOKU:

Ju faleminderit zonja deputete. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, le tē përgatitet Xhezair Murati.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATQUA:

Zonja dhe zotërinj,

Deri tani pér decentralizim u fol në shumë aspekte. Decentralizimi i pushtetit është proces i cili ka tē bëjë me tërë territorin e Kosovës, si dhe me çdo banor tē saj. Prandaj, si qështje shumë serioze e rëndësishë së tillë kërkon patjetër që tē debatohet në Kuvend dhe tē respektohen rekandomet e nxerra nga ky debat.

Nga shumë aspekte, tē cilat i prek tema e decentralizimit, unë do tē koncentrohem më shumë në aspektin e financimit tē komunave tē reja dhe arsyeshmërinë fiskale tē decentralizimit.

E dimë që në Evropë viteve tē fundit është tendenca e forcimit tē trendëve tē decentralizimit. Ky trend është i fokusuar në decentralizim, i cili është plotësish i arsyetur nga pikëpamja financiare. Arsyja pér reformën e pushtetit lokal – decentralizimin, duhet tē jetë një vendim që ka si shtyje qëllim shumë pragmatik – krijimin e kushteve më të mira dhe lehtësira banorëve tē vendit, e jo një taktkë apo lojë politike e cila nuk ka bazë reale financiare dhe praktike, dhe e cila pér afat tē shkurtër në dukje krijon avantazhe, por në fakt – në periudhën afatgjate - ajo do tē krijojë probleme tē reja, ndoshta edhe më tē mëdha se këto tani në fillim. Çdo qasje tjetër, përvëç asaj serioze, praktike, me benifite afatgjate pér banorët e vendit tē caktuar – është e destinuar në mossukses.

Komunat ekzistuese, nuk kanë burime tē shumta financiare. Burimet e financimit tē komunave janë transfertat qeveritare, taksat administrative nga dhënia e licencave dhe pagesave tjera që i cakton komuna, tē hyrat nga asetat e komunave, gjobat apo përqindjet e inkasimit tē gjobave dhe mbledhja e tatimeve në prona.

Duke pas parasysh se komunat e tanishme ekzistuese nuk kanë treguar ndonjë aftësi tē madhe në mbledhjen e këtyre tatimeve, barra kryesore e ekzistimit tē komunave tē sotme bie në buxhetin e Kosovës. Pra, buxheti i komunave, në pjesën më të madhe financohet nga transfertat qeveritare. Duke pas parasysh këtë, shtrohet frika se shumëfishimi i komunave tē reja do ta rëndoje shumë buxhetin e Kosovës, i cili edhe ashtu është më i vogël se ai i vitit tē kaluar. Ky buxhet, siç e dimë, e ka tē paraparë deficitin e planifikuar buxhetor, pra nuk do tē jetë i aftë tē mbulojë shpenzimet e veta edhe pa barrën e komunave tē reja.

Gjithashtu duhet tē kihet parasysh se në këtë buxhet nuk janë paraparë mjetet nga tē cilat do tē financohesin këto komuna tē reja. Pilot-komunat e parapara janë siç e dimë tē gjithë Hani i Elezit, Graçanica, Parteshi, Juniku dhe Mamusha. Përvëç Hamit tē Elezit, i cili mund tē

lavadrohet me ekonominë e qëndrueshme dhe afersinë e kufirit e cila siguron të ardhura të mjaftueshme për komunën që komuna të jetë e vetëqëndrueshme, komunat tjera të parapara për pilot-komuna nuk mund të lavadrohen me ndonjë ekonomi që është e aftë ta bartë barrën e ekzistimit si komunë. Bile nuk mund të lavadrohen as me përbushjen e obligimeve tatumore, e as me pagesën e shërbimeve publike të cilat i shfrytëzojnë.

Formimi i komunave të reja do të duhej të kenë një kusht shumë të rëndësishëm, që komuna e re të ketë aftësi për të grumbulluar të hyra.

Në shumë raste dëgjuam se për pilot-komuna do të sigurohen donacione për fillimin e decentralizimit, por kjo nuk mund të ndodhë çdo vit. E pastaj, me kalimin e kohës, këto komuna, këto pilot-komuna do të shndërrohen në komuna fantazme, siç e shprehi dikush në komuna të fukarallëkut, në barrë të bûxhetit edhe ashtu shumë të dobët të Kosovës.

Gjithashtu duhet të kemi shumë kujdes sa i përket donacioneve që ndonjëra prej komunave të reja të mos financohet përmes donacionit nga ndonjë shtet tjetër, me të cilën gjë do të mitet influenca në vendimet e komunës.

Ne nuk mund të hyjmë në procesin e decentralizimit duke u bazuar në Rregulloren 2000/45 mbi qeverisjen lokale, e cila nuk përkufizon qartë kompetencat në mes organeve qendrore dhe atyre lokale në sferën e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, gjë e cila lë hapësirë për arbitraritet dhe sistem jofunksional. Pra, spektri i përgjegjësive të komunave është shumë më i madh sesa kapaciteti i tyre fiskal.

Që të mos vijmë në situatë që një projekt kaq i madh e i rëndësishëm të dështojë, duhet para fillimit të këtij procesi të bëjmë krijimin e infrastrukturës ligjore e cila do të mbështetet në kushtetutë dhe e cila do të rregullojë në mënyrë të qartë të hyrat dhe shpenzimet publike, dhe të bëhet analiza detale e mundësive vetjake financiare të komunave. Decentralizimi do duhet të jetë vazhdim natyror i reformës së pushtetit lokal, të bazuar edhe në mbështetje në kushtetutë dhe legjislacion, i forcuar me analiza të thukta për arsyeshmërinë ekonomike, në ngritje të kapaciteteve profesionale i cili do t'i ofrojë qytetarit zgjidhje afatgjate të problemeve të tyre dhe lehtësirave në punë.

Me qëllim të koordinimit të Kuvendit me Qeverinë, propozojmë që të formohet një komision ad hoc i cili do të shqyrtojë procesin e decentralizimit në kuadër të kushtetutës dhe të japë rekomandime të nevojshme. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAJM MALOKU:

Faleminderit zonja deputete. Më lejoni t'ju njoftoj se debati po zhvillohet në prezencën e 96 deputetëve. Fjalën e ka Xhezair Murati, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

#### DEPUTETI DŽEZAIR MURATI:

Poštovan predsedavajući i kolege poslanici, ministra je sve manje...

Danas imamo za razmatranje veoma značajnu temu za sve gradjane Kosova a time i za manjinske zajednice, čiji sam predstavnik.

Sigurno je krajne vrijeme da od počinjanjem reforme lokalne uprave na Kosovu u prvi plan stavljamo konačno pravo gradjana tekako da im približimo institucije a ne obrnuto, a time pojednostavimo i poboljšamo kvalitet života gradjana a prava podignemo na nivou demokratski razvijenih zemalja što i krajnji cilj.

Proces reforme sigurno neće biti niti kratak niti lak, ali što se prije s time suočimo to je lakše po sve nas. U našem slučaju, primera radi, u Makedoniji, koja ima približno isti broj stanovnika kao i Kosovo sa ovom reformom se krenulo prije desetak godina i ona se u prvoj fazi pokazala neuspješnom pa su u drugom procesu, tek uspeli od 120 da smanje ovaj broj opština na oko 80 i mislim da iz tih iskušnji trebamo učiti a nedavno je jedna parlamentarna grupa naše Skupštine gospodarstva u Skoplju i zajedno sa grupom parlamentaraca Makedonije radila upravo na pitanjima koja su danas u našoj Skupštini aktuelna.

Kažem u procesu priprema za započet decentralizaciju od strane naših institucija, i od prethodne i od ove Vlade naša grupa odnosno predstavnici manjinskih zajednica su bili pozivani na dogovore a to je slučaj i danas sa ovom Vladom. Tako da naši prijedlozi su plan, kao što je već rečeno, plan dogovora u Grupi 6+. Međutim želim javno ovom prilikom da kažem da smo veoma često zaobilaženi posebno u poslednje vreme od strane medjunarodnih predstavnika i mislim da je to dalje nedopustivo ukoliko želimo da ovaj proces obuhvati sve zajednice i sve političke subjekte.

Svakako da u dosadašnjim predlozima ima i propusta. Konkretno, današnja Skupština se mnogo bavila pilotom projekata, i mislim da smo naveli upravo suštinske probleme oko toga da li će buduće opštinske jedinice ići po etničkim šavovima, da li ćemo se baviti prioritetom ekonomskog održivosti ili ćemo izraziti odredjenu skepsu kako su neki kolege rekli, zaista mislim da Vlada pred sobom ima vrlo ozbiljne i argumentovane predloge koje treba u daljem procesu da ih iskoristi.

Pogotovo mislim da kao enigma pokazala upravo ta ekomska održivost opština odnosno naredni izbori, koji će biti kroz godinu i nešto, da li će obuhvatiti nove opštinske jedinice ili ćemo ići po starom administrativnom rasporedu. Međutim, kriterijumi nadlegadanja realizacije primena danas imaju više varijanti. Mislim da je preovladavala onaj predlog za ad hoc komisiju koja bi povremeno nadgledala proces decentralizacije na Kosovu.

Mislim da je pred nama zaista doista dosta složen proces i da ćemo moći napred samo zajedničkim maksimalnim zalaganjem svih zajednica ali i političkim subjektima na svim nivoima kako bi smo ostvarili zajedničke ciljeve. Današnja rasprava je zaista visok stepen saglasnosti povodom toga postigla tako da proces decentralizacije moramo poručiti sa ovog mesta – ići će pod kišobranom kosovskih institucija, političke i izvršne vlasti i nikako ne treba mješati sa procesom kantonizacije kako neki prijeđeju. Mislim da proces decentralizacije ustvari je ono što mi želimo, dakle ostvarivanje standarda.

Ja bih ovde takodje rekao da na neka današnja izlaganja, kada je izražena sumnja u to – kako je došlo do predloga pilot-projekata. Naime, pred Vladu ovu sadašnju stigao je ponudjeni dakle dokument od pet opština pilot-projekata. I onda je tu, kao neki predlog išao za dvije opštine iz većinske zajednice, dve iz Srbije i jedna iz ostalih zajednica. Mislim trebamo biti realni – nismo mogli očekivati iz ostalih zajednica da idu dvije opštine. Samim tim, figurirao je predlog Mamuša i Vitomirica. Ako se malo pozabavimo argumentacijama mi trebamo biti realni ako govorimo o interesima građana i onda možemo reći da je Vitomirica mnogo bliže Peći i da je na neki način kao predgradje Peći. Da je Mamuša udaljena 20-tak kilometara od Prizrena a da je Rečane, recimo sa okolnim selima i po 20-tak kilometara takodje udaljeno od opštine Prizren. Samim tim, argumentacija je veoma jasna i ne treba ovde da se bavimo nekim zaslužnim pojedincima koji svoj patriotizam na taj način jevtino prodaju time što danas izražavaju skepsu i sumnju u to da će sutra podržati proces recimo nezavisnosti Kosova. Mislim da je to previše jevtino. Takvim građanima, ako su toliko zaslužni, možemo po jednu bistu da im poklonimo ali mi moramo ovim stvarima da se bavimo na vrlo ozbiljan i

odgovoran način kako to zaslužuje ovaj proces, kako je to i današnja sednica pokazala, tako da u tom pogledu mislim ja sam veliki optimista s obzirom na to da smo se danas pozabavili krucijalnim problemima.

Muslim da je naša Parlamentarna grupa samim dosadašnjim učešćem a i daljnje, biće u svakom slučaju spremna na konstruktivan prilaz i doprinos ovoj veoma složenoj temi kojom se danas bavimo. Hvala.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju falemnderit zoti deputet Fjalën e ka Ramadan Kelmendi, le tē përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

(Në mungesë tē diskutimit original, është marrë përkthimi nga përkthyesi simultan)

I nderuari kryesues, tē nderuar deputetë, ministra, e tjerë, Procesin e reformimit tē vetëqeverisjes lokale duhet shikuar dhe kuptuar ndërmjet pushtetit dhe demokratizimit tē pushtetit lokal, i cili ende nuk është realizuar. Duke shikuar nga këndi, çështje e parë e cila duhet shtruar është tē përgjigjemi në atë se Kosova dhe institucionet e saj ende nuk kanë pushtet e as institucionë, dhe ende nuk janë centralizuar. Në këtë vështrim, bëhet pyetje – çka mund tē demokratizohet dhe decentralizohet. Në rastin konkret, para nesh duhet përgjigjur në tri pyetje:

E para - çfarë është ky proces i konceptit tē pushtetit lokal dhe çka nënkuftohet bartje e punëve në shkallë më të ulët tē organizimit tē pushtetit.

E dyta – forma e decentralizimit a kuftohet bartje respektivisht organizim i punëve nga komunat në njësi organizative, dhe

E treta – forma e decentralizimit politik, a nënkupton bartje tē punëve duke vënë mekanizma kontrollues në nivel më të ulët tē pushtetit.

(Vazhdon transkriptimi nga diskutimi i incizuar original)

Duke mos pasur për qëllim t'iu përgjigjem tē gjitha pyetjeve dhe nuk mund ta bëj këtë, unë citoj vetëm një dispozitë tē nenit 10, pika 3 tē Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale, ku në mes tjerash është përcaktuar sa vijon: Pushtetet lokale kanë tē drejtë që në kushte tē përcaktuara me ligj, tē cilat mjerisht ne nuk i kemi përcaktuar me ligj, tē bashkëpunojnë me pushtetin lokal përkatës tē vendeve tjera. Shtrohet pyetja hapur: Si do tē reflektohet kjo në Kosovë kur, prap përsëris, nuk e kemi ligjin mbi decentralizimin. Dhe nga këto paraprakisht shtrohen pyetjet – me këtë projekt tē decentralizimit sa do tē arrihet shpërndarja e përgjegjësive në më shumë nivele tē organizimit administrativ tē pushtetit lokal.

E dyta, sa do tē arrihet afirmimi i shërbimit tē qytetarëve? Sa do tē shkurtohet rruga e komunikimit tē pushtetit qendoror, atij lokal dhe njësive. Si do tē arrihet evidentimi më i lehtë i parregullsive dhe dobësive në ushtrimin e pushtetit. Sa do tē arrihet individualizimi i përgjegjësive apo i autokracisë. Sa do tē jetë pjesëmarrja gjithëpërfshirëse qytetare në organizimin dhe funksionalizimin e këtij pushteti. Dobësitë e decentralizimit janë tē shumta. Rritja e pakujdesisë për interesat e përgjithshme evidente; theksimi i tepruar i interesave tē një

minoriteti apo tē një lokaliteti tē përcjella kundër konflikteve dhe interesave tē mjedisit më tē gjerë; vështirësitë në fushën e funksionimit tē kontrollit dhe rritja e shpenzimeve buxhetore.

Shtruar nga këndi tjetër, ne duhet tē krijojmë parakushtet paraprake që tē mos vjen deri te moskuptimi se lejohet ndarje territoriale.

Tre, tē mos identifikohet dhe as mos tē afrohet territorializmi etnik; tē mos pranohet komuna si njësi komunale mbi bazë etnike; tē mbrohet karakteri unik i Kosovës; tē ruhet integriteti territorial i komunës, tē parashihen vështirësitë nga këndi ekonomik, politik dhe bashkëpunues; tē shikohet shkalla e lartë e varfërisë, papunësisë, e mosinvestimeve në riaktivizimin dhe ndërtimin e kapaciteteve tē reja në mjediset e parashikuara.

Shikuar në tërësi, strategjia e reformës së pushtetit lokal gjegjësish tē decentralizimit është një proces i ndërlikuar, në radhë tē parrë politik, juridik – i cili kërkon stabilitet politik dhe që nuk e kemi, ekonomik – që mungon, dhe bazueshmëri juridike, bazueshmëri tē fortë ligjore dhe qëllim tē caktuar duke përfshire që Qeveria e Kosovës në procesin e decentralizimit tē çmojë dokumentet bazë mbi administratën lokale dhe në këtë drejtim tē shtrojë pyetjet për tē cilat duhet zgjidhë, ndonëse në procesin e decentralizimit tē pushtetit lokal ne patëm dy dokumente sa tē afta aq edhe tē pakuptueshme dhe tē shpjeguara në mënyrë tē kundërtë në medie. Decentralizimi nuk duhet kuptuar dhe nuk duhet tē krijojë kufij etnik. Nuk pranon ndërrimin e kufijve komunal dhe atë kadastral. Është kundër enklavizimit mbi baza etnike. Është proces eksperimental dhe pikërisht - pse proces eksperimental. Natyrisht, tē gjitha këto tē njohura dhe tē panjohura, kur do tē bëhet ky proces i decentralizimit, kjo do tē thotë se ne patjetër rrugë më tē mirë për këtë do tē kishim pas njohjes së pavarësisë së Kosovës ndërkombëtarisht, dhe do tē ishte çështja më e arsyeshme juridike, reforma e pushtetit lokal më e kuptueshme dhe më e realizueshme.

Por ajo që vlen tē theksohet, para fillimit tē këtij procesi ka qenë mëse e arsyeshme: Nën 1 - Të nxirret ligji mbi qeverinë lokale; Nën 2 - Ligji mbi financimin e pushtetit lokal; dhe 3 - Të përcaktohet me njësi fushëveprimi ligjor administrativ i komunës ekzistuese dhe i atyre njësive komunale. Bazën juridike për këtë që them, e mbështhes në këto fakte: Edhe pse pesë vite pas përfundimit të luftës në Kosovë në disa komuna, konkretisht në enklava serbe, mbi bazën etnike vepron pushteti lokal i një shteti tē huaj për ne, pushtet i cili as nuk e njeh administratën e bashkësisë ndërkombëtare dhe as pushtetin lokal e atë qendror fare, edhe pse financohen nga i njëjtë pushtet.

Pikërisht kjo na jep arsyë që tē fillon ky proces i decentralizimit, por jo tē konsiderohet si i vonuar apo si i shpejtuar. Duhet ecur me rrethana dhe proceset në vijim. Në tërësi, procesi i decentralizimit duhet tē mbështetet në karakterin e thellë demokratik dhe tē ndryshimeve shoqërore mbështetur në domosdoshmërinë e ndryshimeve kushtetuese dhe nxjerrjen e ligjit mbi organizimin territorial të Kosovës; ndryshimin funksional dhe struktural tē pushtetit lokal mbi bazën e afirmimit tē pushtetit tē qytetarëve në mënyrë tē barabartë për tē gjithë pa dallim.

Do t'i shkurtoj disa.... Më lejoni tē them vetëm edhe këtë fjali. Të gjithëve duhet tē na jetë model regjioni i Mitrovicës për decentralizimin që filloi para 18 vjetësh dhe sot arriti në tri komuna tipike mbi bazën etnike, për pasoja politike për tē cilat janë tē njohura. Dhe vetëm ky fakt jep tē kuptohet që duhet tē jemi shumë sycelur mbi bazën juridike dhe politike tē ....

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutimit)

## KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka deputetja Nekibë Kelmendi, le të përgatitet deputeti Enver Hoxhaj.

## DEPUTETJA NEKIBË KELMENDI:

Ju faleminderit zoti kryesues. Paraprakisht dua të kërkoj falje nga deputetët nëse e dhunoi durimin e tyre me përsëritjen e atyre që u thanë, por mëqenëse nuk isha këtu në radhët e para të diskutimit doemos përsëritjet nuk mund të shmanget.

Lidhur me dokumentin e Qeverisë për reformat e qeverisjes lokale kam disa vërejtje parimore, të cilat do t'i elaboroj në vijim.

Ky dokument, ndonëse pretendon se është i bazuar në Kartën evropiane të autonomisë lokale mendoj se as parimeve të kësaj Karte nuk i është përbajtur, anipse dokumenti i Këshillit të Evropës është i nënshkruar nga shtetet, kurse Kosova, sipas Kornizës kushtetuese është vetëm një territor apo një entitet. Asgjë më tepër. Nëse do t'ishte përbajtur parimeve të Kartës evropiane të autonomisë lokale, atëherë, sipas saj, nuk do të krijuhet komuna të reja por do të krijuhet bashkësi lokale, të veshura me përgjegjësi efektive, të cilat mundësojnë një drejtim njëkohësisht dhe efikas - më afér qytetarit.

Propozimet që na janë dhënë në këtë dokument, me pilot-projekte, përkatësisht me formimin e komunave eksperimentale, nuk paraqesin bashkësi lokale siç e ka në konsiderim vetë Karta, por janë thjeshtë komuna. Sepse, siç do të dalë nga përbajtja e këtij dokumenti, thuhet - citoj: "Në vitin 2005 puna e përqendruar do të mbështetet në zbatimin e menjëhershëm të pilot-projekteve ashtu siç janë përkufizuar këtu". Dhe, shtrohet pyetja parimore: si është i mundur decentralizimi të fillojë të zbatohet "ëherë nëpërmjet pilot-projekteve kur për këtë nuk ekziston bazë ligjore, siç është ligji shtetit lokal dhe ligjet tjera të cilat u përmendën këtu. Në favor të kësaj vërejtjeje parimore, shkon edhe konstatimi i Grupit punues për qeverisje lokale i datës 19 korrik 2004 ku në shtojcë janë identifikuar për t'u ndryshuar 18 rregulllore të UNMIK-ut dhe për t'u hartuar nga e para 12 ligje. Kjo flet më së miri se çështja e decentralizimit të pushtetit lokal është një proces të cilit duhet t'i paraprijë krijimi i bazës ligjore, përkatësisht hartimi i legjislacionit të ri. Secilës reformë i paraprinë hartimi i legjislacionit përkatës, andaj edhe reformës së pushtetit lokal në Kosovë duhet t'i paraprijë një legjislacion i tillë.

Unë mendoj se ky dokument më tepër është udhëhequr me parimin që e kemi tanë ne të njojur këtu për diskriminim pozitiv dhe me krijimin e pilot-projekteve është bërë një diskriminim pozitiv për themelimin e komunave të reja.

Është e papranueshme pastaj që të dublifikohen edhe mandatet e deputetëve, sepse në komunitat e reja thuhet se ato do t'i përbëjnë deputetët e kuvendeve ekzistuese, kurse më vonë do të zgjedhën edhe deputetët tjerë në këshillat e tyre, që njëkohësisht mbeten këta deputetë që futen në këshillin e këtyre njësive të reja komunale të mbeten edhe deputetë të kuvendeve të tyre të zgjedhura.

Nga ana tjetër, në faqen 4 të dokumentit thuhet se "në mungesë të një gjykate kompetente, UNMIK-u është përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve". Kjo e cenon parimin ndërkombëtarisht të pranuar mbi ndarjen e pushteteve dhe është në kundërshtim edhe me parimet e proklamuara në kreun e dytë të Kornizës kushtetuese të Kosovës.

Pastaj, në faqen 7 thuhet: "Grupi për vetëqeverisje lokale – kriteri i banorit". Nuk është, përmendimin tim, zgjidhje në mënyrë adekuante: "Banor janë personat që kanë jetuar në territorin e Kosovës para 1 janarit 1988". Lidhur me këtë, unë kam të dhëna të cilat i kam të siguruara nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar: "se në mbarim të gushtit 1995 në Kosovë ka pasur 50.000 refugjatë nga Kroacia dhe nga Bosnja, pas Konferencës së Dejtonit, që kanë ardh në Kosovë dhe tash atyre duhet t'u njihet edhe statusi i banorit të Kosovës. Pastaj duhet t'u njihet statusi i banorëve të Kosovës edhe personave për të cilët janë ndërtuar kolonitë apo shtëpitë për kolonizim në Baballoç, në Gllogjan dhe në Junik në vitet e 90-ta, 90-91 aty diku janë themeluar – ndërtuar këto shtëpi, e ku kanë ardh edhe refugjatë të përkatësisë serbe nga Shqipëria, sikur që kanë ardh edhe në vitin 1990 në Motelin "Nora" në Klinë". Prandaj, kriteri i njohjes së statusit të banorit është i papranueshëm.

Referendumi, si instrument që është paraparë për realizimin e demokracisë në nivelin lokal, në këtë dokument, nuk gjen mbëshitetje në Kornizën kushtetuese. Aty nuk është i paraparë referendumi, prandaj si mund të gjëzojë një njësi lokale, një njësi komunale më shumë të drejta se sa që ka institucionin qendror i Kosovës apo se që parashev akti më i lartë juridik i Kosovës.

Dhe në fund, meqenëse secili propozoj nga një komunë, le t'më lejohet edhe unë ta propozoj nëse bëhet decentralizimi, themelimin e komunës së Drelajve, e cila ka qenë komunë dhe ...

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zonja deputete, Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj, le të përgatitet deputeti Ramë Buja.

#### DEPUTETI ENVER HOXHAJ:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar zonja dhe zotërinj,  
Në politikë çdoherë vlen parimi se nuk është aq shumë e rëndësishme se kush e krijon një fakt politik ose kush e nis një proces politik, por kush në të vërtetë e shfrytëzon atë. Do të thotë kush në realitet përfiton nga një iniciativë ose një proces politik. Dhe unë mendoj se debati i sotëm pikërisht e vërteton një parim të tillë dhe mund të përbëlidhet në dilemën se çfarë do të ndodhë me këto pesë pilot-projekte pas definimit të statusit final të Kosovës, sa do të përfitojnë qytetarët e Kosovës të të gjitha përkatësive nga një projekt i tillë apo se sa do të mund të përfitojë politikisht Beogradit gjatë definimit të statusit final të Kosovës nga këto pilot-projekte.

Unë s'e kam ndërmend që të përsëris shumë vlerësimë të cilat u thanë deri më tash. E kam ndërmend vetëm të përmendi disa vërejtje kryesore. Zakonisht parakushti i parë për sukses në një reformë është qëndrueshmëria dhe funksionaliteti i reformës. Politikat afatshkurtra vazhdimisht e kanë démtuar Kosovën e pasluftës dhe duket që edhe në këtë legjislacion ne kemi vazhdim të një kontinuiteti të politikave afatshkurta.

Në sot debatojmë për programin e Qeverisë, i cili ka 9 faqe, i cili ka disa ide të shkaperderdhura dhe i cili përmend disa emra të disa pilot-projekteve. Mendoj që Kosova nuk e meriton që të debatojmë për një proces të tillë fundamental në vitin 2005 - përsëri në vitin 2006, përsëri në vitin 2007 dhe përsëri të mendojmë se në çfarë drejtimi ta nisim këtë proces në vitin 2008. Kosova ka nevojë për një reformë të pushtetit lokal, mirëpo koncepti duhet të jetë afatgjatë dhe të njëjtën kohë të jetë gjithëpërfshirës dhe të jetë i dizajnuar që paraprakisht,

Reformat e pushtetit lokal çdokënd kanë qenë reforma fundamentale meqë rregullojnë pushtetin dhe territoret komunale. Në të gjitha vendet e botës një proces i tillë është përcjell me arrije të një konsensusi politik dhe shoqëror. Meqë kjo reformë nisë në Kosovë para definimit të statusit final, kjo do të duhej të ishte premisa kryesore meqë siç duket procesi lëviz drejt krijimit të komunave sipas parimit etnik. Qasja e Qeverisë aktuale nuk ka qenë gjithëpërfshirëse, përkundrazi ka qenë përjashtuese dhe përkundrazi është përcjell pothuaj me një lloj unitarizmi politik.

Vërejtja e tretë ka të bëjë me aspektin ligjor, i cili u përmend deri më tash, mirëpo reformat më të suksesshme të pushtetit lokal kanë nisë pikërisht me kriimin e hapësirës në kushtetutat e vendeve të caktuara ose edhe me miratimin e kushtetutave të reja. Unë mendoj se nuk është gjeografia hapësirë e cila krijon premisë për pjesëmarrje të njëre zve në pushtet, por është hapësira në jetën publike përmes reformave kushtetuese ose edhe të miratimit të kushtetutave të reja, ajo e cila siguron garanci për integrimin e të gjithëve që jetojnë në Kosovë.

Kosova ka nevojë për një kushtetutë të re, dhe definitivisht – për mendimin tim – një proces i tillë do të duhej të dizajnohej në baza kushtetuese dhe ligjore. Për Qeverinë nuk është fare e qartë se sa shkallë do të duhej t'i ketë pushteti në Kosovë. Duhet t'i ketë dy, tri, katër, pesë dhe vërtetë sesa janë të financueshme.

Dhe, kur jam te aspekti finanziar, nuk kisha përsëritur kolegët e tjere, mirëpo përvoja perëndimore ka treguar se reforma e pushtit lokal dhe decentralizimi janë përcjell vazhdimisht me një konflikt permanent mes pushtetit lokal dhe pushtetit qendror rrëth tatimmbledhjes dhe shpërndarjes së saj. Meqë Kosova ka një buxhet të vogël, dhe nevojat për projekte të tillë në të ardhmen do të ishin shumë të mëdha, është mëse e rëndësishme që në një proces të tillë të hyhet me vizione të qarta dhe të mos krijohen parakushte për konflikte rrëth fuqive fiskale në një Kosovë të ardhmen.

Masandej, është shumë e paqartë çfarë do të ndodhë me politikat publike, a do të propozojë ato komuna, çfarë do të ndodhë me politikat sociale, do të vijë nga komuna, do të vijë nga pushteti qendror dhe meqë kompleksi është shumë kompleks do të duhej, për mendimin tim, edhe kjo pjesa e politikave publike dhe sociale të përfshihet.

Dhe, për fund – vërejtja e fundit: Reforma e pushtetit lokal. - Çdokënd ka rrjedh në dy parime kryesore ose sipas parimit etnik, ose si reformë e administratës. Dhe ne, duket që në shembullin e Kosovës kemi të bëjmë me të dy parimet. Nëse është fjala ashtu, atëherë sugjerimi im do të ishte pse nuk fillohet me qytetin e ndarë të Mitrovicës, që vërtetë të dy pjeset e qytetit përmes pilot-projekteve të ofrohen mes veti dhe të finalizohen me bashkimin e qytetit. Ose, nëse është fjala për reformë administrative – pse nuk merret qyteti i madh i Prishtinës, i cili – nuk mendoj se është aq metropol si u përshkrua deri më sot, mirëpo i cili ka vërtetë nevojë për qeverisje të mirë dhe i cili ka nevojë për riorganizim qoftë të pushtetit qoftë të territorit.

Unë kam mbet sot i fascinuar me debate të kolegëve të mi. Në politikë fjala është fakt dhe besoj se faktet do të përcillen edhe me veprime konkrete politike. Faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka Ramë Buja, le të përgatitet Lutfi Zharku.

## DEPUTETI RAMË BUJA:

Të nderuar deputetë, i nderuar zotë kryesues,  
Enveri tha se është i fascinuar, unë po e shoqëroj atë sepse më pëlqeu debati i gjithë kolegëve  
të mi dhe u pa se vërtetë paska qenë nevoja që shumë më herët të debatojmë për këtë çështje  
dhe s'e di kush e ka ndie për më shumë nevojë – pozita apo opozita. Dhe, ky fakt flet qartë.  
Konsideroj se jemi të vonuar me këtë debat, megjithatë më mirë vonë se kurri.

Dicëka më shqetëson tek debatet, për faktin që për çështjen për të cilën po debatojmë nuk është  
as decentralizim as reformim i pushtetit lokal, por është një ristrukturim territorial i komunave  
të Kosovës pa bazë ligjore dhe kushtetuese. Andaj, kjo gjë nuk do të duhet t'i ndodhë Kosovës  
në asnjë mënyrë.

Nuk them gjë të re, por reformohet dicëka që ka formë e ne të gjithë bashkë e dimë se cila është  
forma e pushtetit qendror në Kosovë, e pushtetit komunal në Kosovë dhe çka mund të bartet te  
njësitë tjera nënkunale.

Pa dashur t'i përsëris kolegët. E dimë bashkë se nuk u nis nga tendencia për të pasur më shumë  
pushtet kryetarët e komunave, por u nis nga një tendencë e mbrapsh që të joshet etnia e  
serbëve për të marrë pjesë në zgjedhjet e dyta lokale në Kosovë. Deklarimi i zotit Shtajner,  
Përfaqësues special i Sekretarit të përgjithshëm në Mitrovicën e veriut ishte atëherë – se do të  
bëjmë decentralizimin në këtë formë çfarë edhe sot bisedohet për të pér të joshur këtë etnik për  
të marrë pjesë në zgjedhje. Dhe kjo gjë po vazhdon të ndodhë mbrapsh dhe nuk do të kishim  
dëshiruar, besoj të gjithë bashkë, që Kosovës t'i ndodhë dicëka të mbapshtë në mënyrë që  
ecuria të shkojë mbrapsh.

Decentralizimi në Kosovë duhet të ndodhë, por kur dhe si? Kolegë të nderuar të Kryesisë se  
Parlamentit ishim bashkë në Francë dhe në një bisedë në Parlamentin Francez, në mes tjerash,  
njëri nga deputetët tha: "Decentralizimi është një luks që kushton shumë shtrenjtë". Për ne  
tanimë nuk është luks, është dicëka i imponuar që do të duhet të ndodhë sipas dikujt  
domosdoshmërisht. Ne nuk do të duhet t'i ishim për të që domosdø të ndodhë.

Pilot-projektet. Në këto pilot-projekte nuk ndodhi përllogaritja ose fizibiliteti financiar as  
territorial, as demografik. Mbi të cilën bazë do të ndodhë kjo, e dinë ata që kanë bërë projektin  
dhe insistojnë për ta implementuar.

Unë konsideroj se ndarja në komuna etnike është diskriminim, jo integrim i etnisë në shoqëri,  
çfarëdo etnie qoftë. Dhe, jam mbështetës i asaj se nëse do të duhet krijuar komuna njëetnike  
dhe fillojmë me këtë lojë e plojë atëherë do të duhet se gjithsesi edhe etnia e hashkalive, edhe  
ajo e goranëve, edhe ajo e boshnjakëve, edhe ajo... kënd e harrova, nuk e di – që të krijojnë  
komuna njëetnike sepse kështu do të krijohet një mozaik se di sesa i logjikshëm pastaj në  
Kosovë. Por, duke u ndarë, nuk integrohem. Është fare e qartë se diskriminohen ata të cilët  
janë më të vegjël sesa ajo që është shumicë në Kosovë.

Logjika racionale, politike dhe pragmatike e të ndodhurit të decentralizimit, në kuptimin e  
mirëfillt të fjalës dhe të veprimit, do të ishte atëherë kur Kosova ka formën e vet edhe  
territoriale edhe pushtetore dhe pastaj të dimë se cilat janë komunat tonë dhe çka mund të  
bartim sipas rekomandimeve të fqinjëve të Evropës apo rregullativës së Këshillit të Evropës  
për pushtetin lokal. Në të kundërtën, ne do t'i kthehem i dhe rikthehem sa e sa herë kësaj  
çështjeje dhe nuk do të ishte mirë, edhe pse jemi të ndërgjegjshëm besoj të gjithë, se  
decentralizimi nuk përfundon njëherë e mirë, me pikë. Atij duhet t'i kthehem përmë ta pa në  
mënyrën më të arsyeshme.

Partia Demokratike e Kosovës ka një projekt të vetin për reformën pushtetore të pushtetit lokal dhe qendror në Kosovë dhe dua të flas tash thjesht dhe qartë e shkurt për atë se si e mendon Partia Demokratike strukturimin, reformën dhe decentralizimin në Kosovë.

Partia Demokratike e Kosovës, në projektin e saj ka 8 prefektura, 47 komuna, 390 bashkësi territoriale. Me mendimin se pas një viti të veprimit racional të njësive nënkomunale, disa të caktuara që janë me emër, do të kishte mundësi që të kalojnë në njësi komunale, por jo menjëherë dhe me pilot-projekte të caktuara.

Andaj, pa ju lodhur më shumë, po ju them se jemi për atë që decentralizimi gjithsesi t'i ndodhë Kosovës por t'i ndodhë në kohën e duhur, në momentin e caktuar dhe atëherë kur ai mund të bëhet vërtetë ashtu që do të jetë profitabil për Kosovën. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet. Para se të vazhdojmë me debatin, është kërkesë e përkthyesve që të debatohet e diskutohet më ngadalë për shkak të përkthimit më efikas në tri gjuhë. Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

#### DEPUTETI LUTFI ZHARKU:

I nderuari kryesues, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,  
Unë shkurtimisht do të mundohem të shpreh mendimet e mia në lidhje me çështjen e reformës së qeverisjes lokale, e posaçërisht dallimeve gjegjësisht ngashmëruive të disa koncepteve në të dy dokumentet.

Që në fillim, po cek mendimin se në mes të këtyre dy dokumenteve nuk ka dallime esenciale, të cilat do të ndryshonin konceptin e tërësishëm të qeverisjes së reformës lokale. Dokumenti i parë që zyrtarisht quhet "Kornizë për reformimin e vëtëqeverisjes lokale në Kosovë" është bazë e dokumentit të ri, gjegjësisht reformës së qeverisjes lokale apo programit të punës përvitin 2005. Prandaj, është shumë normale që dokumenti i parë gjegjësisht korniza është më e gjërë, më e detajizuar dhe më e ngarkuar me koncepte rrëth organizimit të pushtetit lokal të reformuar, përderisa programi është shumë më pragmatik dhe më i qartë duke përcaktuar hapat dhe afatin e implementimit të reformave. Prandaj, në këtë aspekt, të dy dokumentet mund të shikohen si një tërësi, e jo të ndarë, e aq më pak si dokumente të ndryshme apo me koncepte bazë të kundërtë.

Së pari, të dy dokumentet si pikënisje theksojnë qëllimet e njëjtë të reformave në qeverisjen lokale dhe atë ofrimin e shërbimeve administrative, sa më efikase për qytetarë, përmes organizimit të një administratore më të vogël dhe më efikase si dhe zbritjen apo zhvendosjen e procesit të vendosjes përsfere të caktuara të jetës së përditshme sa më afér qytetarit.

Mirëpo, të dy dokumentet, edhe pse nuk u vihet theksi kryesor, potencojnë se qëllimi dhe arsyja e kësaj reforme është ajo që është përfolur dhe potencuar më së shumti, e kjo është integrimi i të gjitha komuniteteve në strukturat qeverisëse me çka synohet të arrihet qëllimi përfundimtar i zhëbërsës së strukturave paralele. Ky qëllim, më vonë në jetën e përditshme, gjithnjë e më tepër ka filluar të ndahet në dysh duke marrë parasysh fokusimin e faktorit ndërkombëtar apo atij vendor. Kështu, nën presionin e vazhdueshëm të faktorit ndërkombëtar, fokusimi në integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat qeverisëse, ka fituar një rëndësi primare dhe është neglizhuar duke u neglizhuar strukturat paralele, ndërsa aktivitetet do të duhej të renditeshin në drejtim të kundërt, domethënë zhëbëria e strukturave paralele të çojetë në integrimin e komuniteteve.

Megjithatë, programi ka një qasje më të avancuar dhe është më i përpiktë në mënyrën e zbatimit të reformave të qeverisjes lokale. Në këtë aspekt mund të vërehen së paku dy çështje të cilat janë avancuar në program. Kështu, përderisa në kornizë ekzistojnë opsione të themelimit të drejtpërdrejt të komunave të reja, ose themelimit të njësive të komunave, programi decidivisht përcakton se nuk krijohen komuna të reja, por vetëm njësi të komunave. Kjo po ashtu është më tutje e përcaktuar edhe me definimin e qartë se kufijtë komunal ekzistues nuk do t'i nënshtron shqyrtimit gjatë pilot fazës. Nga kjo rrjedh se apriori mohohet themelimi në mënyrë automatike i komunave të reja si dhe nuk prejudikohet se çdo pilot njësi e komunës do të zhvillohet në komunë të re por do të varet nga suksesi dhe qëndrueshmëria e tyre. Po ashtu programi paraqet edhe mundësinë që pilot-projektet të zgjerohen në fushëveprimin dhe numrin e tyre në një fazë më të avancuar.

Çështja e dyte është se programi paraqet bartje të kompetencave të njëjta në pilot njësi të komunave, përderisa korniza ka lënë hapur mundësinë që kompetencat përcaktohen sipas rastit në përputhje me rrëthana lokale. Me këtë, programi eliminon bartje selektive të kompetencave në pilot-njësi të komunave në bazë të preferencave të ndryshme e që në këtë rast mendohet në preferenca etnike.

Çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve eventuale, po ashtu është një çështje që do të duhej shqyrtuar edhe një herë. Kështu, përderisa korniza rekordon autorizimin e odës speciale të gjykatës supreme për çështje kushtetuese, për zgjidhjen e kontesteve, programi përcakton UNMIK-un si përgjegjës.

Po ashtu, të dy dokumentet cekin rëndësinë e përkrahjes së pilot-projekteve nga qytetarët në fjalë. Në lidhje me këtë, më duhet të theksoj se së paku një nga pesë pilot-projektet e propozuara kanë përkrahjen e parezervë nga qytetarët e saj, e ky është Hani i Elezit. Kjo është vërtetuar edhe me shkresën dërguar Ministrisë për administratë e qeverisjes lokale, të nënshkruar nga të gjitha partitë politike dhe shoqatat që veprojnë në Han të Elezit.

Në fund, sikurse edhe të tjerët, edhe unë po cek aspektin finanziar, gjegjësisht koston e kësaj reforme të cilën asnjëri dokument nuk e sqaron në masë të duhur e që është e një rëndësie të posaçme sic është për shembull marrëveshja me pilot-komunat lidhur me ndarjen e mjeteve financiare si dhe përcaktimi i mjeteve buxhetore për pilot-projektet.

Duke shpresuar se disa nga sugjerimet e cekura do të merren parasysh, me këtë e përfundoj. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAJM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. E ka fjalën deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet për fjalë deputeti Gazmend Muhamheri.

#### DEPUTETI FETAH BERISHA:

Inderuar zoti kryesues, të çmuar kolegë deputetë,

Kemi në dorë dy dokumente të dy qeverive për të cilat sot po debatojmë. Draftdokumentet shënojnë fillimin teorik për organizimin e reformës për vëtëqeverisjen lokale. Është bërë një përpjekje për të dhënë një kontribut për procesin e reformës së qeverisjes lokale. Procesi i reformës ka rëndësi të madhe për Kosovën sepse Kosova është qeverisjen dhe organizimin lokal. Për të gjithë ne, është e rëndësishme, si për shumicën ashtu edhe për pakicën. Kjo do të thotë se të krijosh institucione demokratike funksionale do të thotë të sigurosh qeverisje të

qëndrueshme lokale. Për përpilimin e draftdokumentit është thënë se është konsultuar edhe përvuja e vendeve rjonale dhe evropiane me traditë. E gjithsesi, procesi i reformës duhet të bazohej në parimet e Kartës evropiane të veteqeverisjes lokale, si dhe në kompetencat e përgjegjësitë të bazuara në këtë dokument.

Prandaj, ky dokument e ka rëndësinë e vet për Kosovën. Mirëpo, a është tani i rëndësishëm më shumë se gjërat më të rëndësishme për Kosovën? Nuk e di. Unë mendoj se jo. Megjithatë, unë do të veçoj vetëm dy-tri segmente të paqartësisë. Këtu ne do të përmendim Komizën kushtetuese që tani aktualisht është një kushtetutë e Kosovës por që është e përkohshme deri në finalizimin e statusit të Kosovës ku do ta ketë Kosova kushtetutën e vet. Për këtë, përmendi edhe zonja Nekibe Kelmendi, që unë nuk do të elaboroj më tutje, do të thotë këto dy dokumente nuk e kanë mbështetjen ligjore dhe kushtetuese.

Segmenti tjetër, të cilin do ta potencojoj, është se përpiluesit e draftdokumentit nuk e paskan të qartë ende se Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm është aprovuar qysm herët dhe tani këta thonë se ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore për të gjitha nivelet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm duhet të jenë nën mbikëqyrjen e komunave dhe se drejtoret e shkollave, arsimtarët dhe mësimdhënësit duhet t'i zgjedhë kuvendi komunal. Ju lutem, asnjëherë kuvendi komunal nuk i ka zgjedh drejtoret dhe arsimtarët në procesin mësimor. Si është fut kjo fjalë aty, unë nuk e di. Ndoshta dikush ka menduar në sistemin e përparmë që tanimë ai nuk ekziston – kur për zgjedhjen e drejtoreve ndikonte një ish LKJ që tanimë nuk ekziston.

Edhe pilot-projektet që nënkuftojnë pilot-projektet nënkomunale dhe komunale, nuk janë sqaruar mirë. Ato parashohin krijimin e njësive të reja por nuk parashohin zhëbëjen e strukturave paralele, ndërsa integrimi del shumë i zvetëuar këtu në këtë dokument. Dëgjoni ju lutem, po citoj: "Projektdokumenti do të nxis zhëbëjen e strukturave paralele". Do të thotë, ky do ta nxis për krijimin e tyre e jo në fund zhëbëjen e tyre. Ju lutem pse nuk është zënë në gojë Mitrovica këtu. Pra, strukturë alele gjithsesi duhet të zhëbëhen. Gjithashtu, nuk e kam të qartë, e besoj edhe të tjerët, ç'është ajo polici parçiale e vendore ose ato gjykata që duhet të jenë në funksione komunale të cilat do t'i zgjidhin problemet të cilat aty mund të ekzistojnë.

Pra, në këto dy draftdokumente ka shumë paqartësi të cilat duhet të qartësohen në të ardhmen prej grupit profesionist dhe grupei profesionist ta ketë parasysh se këto dy dokumente duhet të jenë vetëm një proces i ngadalshëm, jo i ngutshëm dhe afatgjatë. Prandaj, për ta përfunduar, jo imponim të ngutshëm që dëmiton procesin e decentralizimit i cili duhet të ecë sigurt, hap pas hapi – të analizohet zhvillimi në fazë më afatgjata, mos të kthehen mbrapa proceset të cilat janë filluar. Nuk mund të ndodhë decentralizimi komunal para pavarësimit të Kosovës, regjistrimit të popullsisë e gjëra të tjera të cilat Kosova i ka përpara.

Më në fund, jo imponim, jo enklavizim, jo struktura paralele por integrim real të minoritetit serb në realitetin e Kosovës. Ne e dimë se realitetin e Kosovës Beograd nuk e pranon, prandaj minoriteti serb edhe e dëgjon atë, por minoritetit serb duhet t'i qartësohet se këtu e ka të ardhmen e vet në realitetin e ri - në Kosovën e lirë demokratike. Ju faleminderit,

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. Tani fjalën e ka deputeti Gazmend Muhaxheri dhe pastaj do ta bëjmë një pauzë.

## DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI

I nderuar zoti nënkyetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra Shatri e Haziri që patët durimin të qëndroni dhe të dëgjoni diskutimi ne deputetëve.

Do të duhej që nga ky Kuvend të dalim me një zgjidhje të njësuar konsensuale e jo vetëm t'u afrohet hapësirë grupeve parlamentare për të diskutuar e në fund të punohet me arshinët e grupit punues.

Sipas dokumentit kornizë, del se qëllimet e përgjithshme strategjike të projektit kontribuojnë në sigurimin e qeverisjes së qëndrueshme dhe kushteve të jetës për të gjithë kosovarët, integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës dhe në konsolidimin e të gjitha institucioneve. Shtruarja e qëllimeve kësisoj meriton aplaudim. Megjithatë, ai që ka krijuar njohuri të përgjithshme për decentralizimin, mbetet me dilema. Dhe për t'u sqaruar qytetarëve kosovar se ç'do të thotë kjo, së pari duhet përgjigjur në pyetjet:

- Do të ketë ndarje politike në Kosovë, apo jo?
- Ka kapacitete për ndërtimin e një administrative funksionale dhe efikase, apo jo?

Para dy vitesh, ky Kuvend ka miratuar Ligjin për planifikimin hapësinor. Ky Ligj i detyronte komunat që brenda 18 muajsh të përgatisin planet e tyre urbane. Kanë kaluar 18 muaj dhe asnjë komunë, asnjë administratë komunale nuk e ka realizuar këtë obligim që ka pas me ligj. Kjo reformë ndodh për të kënaqur minoritetet mirëfilli dhe për t'u përmirësuar kushtet e jetës - sa për sy e faqe.

- Cilat janë kriteret për themelimin e njësive qeverisëse lokale, kush i ka caktuar ato?
- Cilët do të jenë kufijtë e këtyre njësive të reja administrative, kush do t'i caktojë dhe në bazë të të cilave kritere?

Vërejtje e parë serioze praktike për decentralizimin është se kjo formë e reformës së pushtetit është e padëshirueshme dhe e rrezikshme në vendet ku ekzistojnë lëvizje separatiste. Aty ku nuk ekziston një pushtet qendor që garanton një politikë koherente, flasim për një ndërmarrje aspak praktike.

Në dokumentet kornizë për decentralizimin, që na janë dorëzuar nga Qeveria Rexhepi, ashtu edhe nga Qeveria e sotme Kosumi, mungojnë emrat e ekspertëve të grupeve punuese që hartuan këto dokumente. Identifikimin e grupit punues vendor dhe ndërkombëtar - bekgraundin e tyre profesional dhe politik. Nuk kisha dëshiruar këtij populli që grapi apo grupet punuese që e krijuan kornizën për reforma të pushtetit lokal - Qeveria dhe Kuvendi të luajnë rolin e pilotit, në fund të pastrojnë duart kurse qytetarët e Kosovës ta paguajnë dëmin e shkaktuar nga ky lloj decentralizimi.

Të gjitha normat dhe përvojat ndërkombëtare afrojnë një bazë stabile për të ndërtuar shtylla themelore të parimeve për reformën e pushtetit lokal në Kosovë, e ato janë një rrjet koherent i ligjeve që tregillon përgjegjësitë, funksionet, resurset dhe marrëdhënet e niveleve të qeverisjes. Në procesin e decentralizimit, duhet të ekzistojë vullnet politik me konsensus të plotë parlamentar, e jo konsensus i koalicionit qeverisës i cili është jofunksional, pra në kushtet tona paskonfliktoze përfundon me imbarimin e mandatit të koalicionit. Të garantohet implementimi i decentralizimit nga ana e institucioneve të Kosovës, atëherë kur merrin garanciat për funksionimin e Kosovës si partner i barabartë me vendet tjera të rajonit: Pa asnjë lidhje politike dhe administrative me Serbinë; Për një reformë të mirëfilltë të pushteti lokal, është i nevojshëm definimi i rrjetit ligjor, koherent dhe atë: ridefinimi i kushtetutshmërisë, i

ligjt pér qeverisje lokale, i ligjt pér kufijtë e njësive administrative, si dhe ligjt tjetra të parapara në kornizë. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit zoti deputet. Tani do të bëjmë pauzë, e cila do të zgjatë deri në ora 16. Urdhëroni zoti deputet. E ka fjalën Fadil Kryeziu.

#### DEPUTETI FADIL KRYEZIU:

Dëshja në raport me parafolësin tim, kur thotë se asnjë komunë nuk ka përpiluar planet zhvillimore-urbanistike. Mendoj se sjell dy të vërteta pér dy komuna se Prishtina dhe Prizreni tashmë kanë të aprovuara planet zhvillimore urbanistike. Prandaj, duhet të shërbohem më shpesh me fakte. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju lutem zoti deputet, nuk ishte replikë dhe nuk ju ka përmend emrin. Deri në orën 16 pauzë. Deputetët që dëshirojnë të diskutojnë, mund t'i deponojnë fjalimet me shkrim, si pjesë përbërëse e transkriptim. Do të vazhdojmë punën në orën 16. Ju faleminderit.

(Vijon pauza)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën)

(Në vazhdim, Seancën plenare e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit)

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Unë besojë se kemi forum pune dhe vazhdon seanca fjalën e ka Emin Krasniqi, urdhëroni Emin, foltorja është e juaja. Dhe le të përgatitet Bislim Hoti.

#### EMIN KRASNIQI

Së pari përshëndes kryetarin e Kuvendit, ministrin i cili ka edhe më durim pér të përcjellë, z. Haziri, deputetët, përfaqësuesit e misionit ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe gjithë vëzhguesit e punimeve të këtyj Kuvendi.

Disa vërejtje e rekomandime përkitazi me formulimin e pikës së rendit të ditës, çështjes së kërkuar pér dend dite dhe Programit të Qeverisë së Kosovës pér reformim të pushtetit lokal.

Pér t'ju shmangur përshkrimet e enorme kritike do të përpinqem që mënyrë taksativë të paraqesë disa vërejtje - rekomandime përkitazi me, së pari formulimin e pikës së rendit të ditës dhe aspekte të caktuara rekomanduese ndaj Programit të Qeverisë së Kosovës pér reformim të pushtetit lokal si vijon:

1. Përfaqësuesi i grupit parlamentar PDK, ngaherë dihet, se në emr të grupit parlamentar ka artikular kërkësën që në njëren prej seancave të ardhme parlamentare kërkësë që është mbështetur edhe nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare të partive të tjera me përashtim grupit parlamentar të minoritetit serb të cilët nuk shfrytëzojnë hapësirën debatuese të këtyre seancave që të përfshihet në rend dite njëra prej çështjeve më problemore pér Kosovën me dimisjonale rasonale dhe më gjerë, pra çështja e decentralizimit. Pra në këtë rast nuk është turmirë kërkesa e artikular nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të shqyrtojmë dhe t'i qasemi decentralizimit si projekt i Qeverisë së Kosovës, si projekt miratim i

Këshillit të Evropës apo si proces për Kosovën dhe për rajonin e më gjér. Dihet se reformimi i pushtetit lokal nuk do të thotë decentralizim dhe decentralizim nuk është vetëm reformim i pushtetit lokal.

2. Natyrisht shumë prej nesh këtu e të tjerrë reprezentues të mendimit shkencor e politik e profesional sa i përket reformimit të pushtetit lokal kemi parasysh rrashqet dhe kriteret e përcaktuara e të parapërcaktuara të procesit demokratik e të qëndrimeve politike të faktorëve që janë, a mund të janë determinues. Kësaj çështje do t'i qasesha nëse më lejohet duke e pasur parasysh njëkohësisht interesat aktuale politike dhe interesat strategjike.

a) Interesat aktuale politike, edhe pse afatshkurra si pilot projekte, madje edhe standartet janë atu i fortë i avancimit pozitës dhe të pozicionit tonë politik për statusin e Kosovës. Duke qenë se në parim është mbështetur pilot projekt për decentralizim dhe formim të komunave të përmendura duhet së pari të përkufizohet tërë territori i lokaliteteve që përfshihen në ato komuna, autoriteti i financimit, autoriteti qendror, infrastruktura dhe kompetencat. Prى është interes yni politik që në koordinim me faktorët determinues të bëhet një sprovë gjenerale për të mos thanë eksperimentale siç është bërë në shumë aspekte gjere tanë.

2. Interesat strategjike nuk kërkojnë që pilot projekt për decentralizim të shoqërohet e të përciljet edhe me akte ligjore, sepse në stadin e përkufizimit të statutit politik të Kosovës do të duhet të nxirret ligji për ndarje territoriale e administrative.

Të nderuar kolegë e të pranishëm tjerë në kontekst të shqyrimit të programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal sugjeroj si vijon:

1. Duke pasur parasysh mundësitet e shfrytëzimit të teknologjisë informative si dhe dhunimit që i bëhet kësaj nga një vistër pushtetarësh, zbatimi i infrastrukturës ligjore nuk do të thotë as reduktim por as fabrikim i administratës.
2. Të rishikohen në mënyrë ekstreme kompetencat e "e kompetentëve në segment të caktuar të ministrive si ato të arsimit, shëndetësisë, të ambientit të planifikimit hapësinor të mirëqenies sociale, të energetikës të bujqësisë etj. Faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Faleminderit z. Emin, Bislim Hoti, le të përgatitet Sanije Alijaj

### **BISLIM HOTI**

Të nderuar koleg deputetë, të ju them të drejtën se sot më bëhet qefi që po diskutojmë lidhur me këtë çështje për arsy se më se 70% e popullatës së Kosovës sot do të njoftohen më detajisht se çfarë do të thotë decentralizimi ose reforma e vetëqeverisjes lokale. Çfarë do të sjellë ajo dhe çfarë perspektive do të kemi në të ardhmen.

Në emër të komunitetit të Egjiptas përkrahim decentralizimin dhe reformën e vetëqeverisjes lokale por jo mbi baza etnike. Në si komunitet asnjëherë nuk do t'i lejojmë vetes që ne emrë të komunitetit të kërkojmë të bëhem si komuna në emër të komunitetit që na takon, por gjithmonë këtë do ta shohim në kuadër të mazhorancës ku në një të ardhme shumë të afërt dëshirojmë dhe integrimin tonë plotësishët e shohim aty që ne disa pjesëtarë të komunitetit tonë në të ardhmen të janë edhe kryetar të komunës ku është e mazhoranca.

Ne e kemi një çështje të tillë, për shembull, tani i kemi dy zëvendëskryetarë në kuvendet komunale, kur nënkyetari i komunës së Istogut ndoshta ka meritë më të mëdha se vetë kryetari i kësaj komune dhe besojmë se në të ardhmen këtu do të integrohem, aty ku është edhe mazhoranca. Pra çka kërkoj në emër të komunitetit tim. Kërkoj që të krijohet me të vërtetë një komision parlamentar, sepse po të ishte krijuar me kohë një çështje e tillë komunat e parapara ose fshatra e propozuara nuk do të kishin mujt me ardhë në shprehje para fshatrave tjere që i kemi. Andaj ne kemi thanë edhe disa herë i kam kërkua me shkrim ministrit të Pushtetit Lokal z. Lutfi Hazirit për fshatin më të madh në regjionin e Hasit i cili me rrëthinë mbanë mbi 20 mijë banorë. Nuk do të hy në detaje se çka e pasqyron këtë fshat edhe pse kam marrë një përgjigje pozitive por për ne është e pakuptueshme.

Unë nuk do ta zgjasë shumë por do ta përkrahi diskutimin e gjithë kolegëve deputetë që janë këtu dhe mendoj që në të ardhmen në kuadër të tij komisioni parlamentar, së bashku me grupin punues që do të bëhet për këtë çështje, do t'i këqyrin gjërat në terren e jo nga vendi dhe të propozohen komunat që p.sh. ato fshatra të cilat janë propozuar. Unë nuk do të kisha quajtur reforma vetëqeverisës lokale por reforma vetëqeverisës rurale.

Andaj z. kryetar dhe të nderuar kolegë deputetë, duke pasur parasysh se në fillim të seancës Grupi parlamentar i PDK-së propozoi që paraprakisht kemi një bisedë këtu në Kuvendin e Kosovës për çështjen e dialogut Prishtinë – Beograd, atëherë po që se realizohet kjo çështje atëherë edhe unë e kam një kërkesë urgjente që të njëjtën ditë të vihet në rendin e ditës edhe çështja e kësimit sepse, në momentin e fundit tani ne jemi duke u ballafaquar me këtë problem që popullata me shumicë po kthehet edha nga diaspora. Ju faleminderit.

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Faleminderit. Unë besoj që të gjithë e dinë që deputetët kanë mundësi edhe ta deponojnë me shkrim dhe në mënyrë më përmajtësore.  
Sanje Alijaj le të bëhet gati Ylber Hysa.

#### SANIJE ALIJAJ

I nderuar z. kryetar, i nderuar z. ministër dhe ju kolegë deputetë. Edhe pse të ladhur më lejoni t'i them disa vlerësimë sa i përket projektit që sot është në debat për reformën e pushtetit lokal. Ndarja e tashme territoriale administrative e Kosovës në 31 komuna është e tejkaluar. Kjo strukturë sot nuk i përgjigjet Kosovës nga fakti se janë krijuar rrëthana të reja dhe se si institucionë dhe si shoqëri në përgjithësi synojmë ta reformojmë Kosovën në të gjitha segmentet në hap me kohën dhe në pajtim me standarde evropiane. Projekti që ne sot po e debatojmë nuk është ligj mbi decentralizimin siç po flitet me të madhe por një Projekt për krijimin e pilot-komunave që ne sot do t'i japim përgjigje të duhur institucionale të qëndrueshme në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Pilot-projektet sipas këtij plani janë njësi komunale që do të krijohen brenda komunave ekzistuese që janë pjesë dhe quhen pilot komuna. Sipas këtij plani dokumenti kornizë, njësia e re komunale hyn në lojë me të njëjtat kompetenca që i kanë komunat ekzistuese. Ndërkëq më vonë me dhënen e kompetencave të reja komunave ekzistuese po ato do t'i marrin edhe njësitë e reja brenda tyre. Ky projekt është i rëndësishëm dhe meriton vlerësim esencial sepse shënon fillimin e procesit politik të reformës së qeverisjes lokale në Kosovë parashtron elementet bazë të reformës që duhet zbatuar dhe zhvilluar më tej në të ardhmen. Nisma e reformës së pushtetit lokal si koncept dhe ofertë synon të ofrjë shërbime më të shpejtja qytetarit, shpërndan përgjegjësitë në shumë shkallë, strukturën rrugën e komunikimit të pushtetit me qytetarët, mundëson identifikimin më të lehtë dhe më të shpejtë të parregullsive si dhe mit

individualizimin e përgjegjësive. Prandaj duhet të angazhuar si institucionë për gjetjen e rrugëve më të mira për fillimin e procesit për reformën e pushtetit lokal.

Dezentralizimi në dukjen e parë bëhet me qëllim të integrimit të komuniteteve, mirëpo është një rrezik i madh po se se kalojnë shumë kompetenca dhe nuk përcillet urgjentisht më infrastrukturë të domosdoshme ligjore ekziston droja të mbyllt me dezintegrin. Prandaj këtij projekt dokumenti duhet dhënë drejtimin që të jetë shoqërisht i pranueshëm, politikisht i përshtatshëm, profesionalisht racional, organizativisht funksional dhe etnikisht i hapur.

Deputetë të nderuar, më lejoni të bëjë disa vërejtje konkrete. Reforma e pushtetit lokal synon në favor të demokratizimit, por me këtë projekt krijuim i një mekanizmi që synon parandalimin e mbivotimit të komuniteteve lokale që nuk janë shumicë për realizimin e të drejtave të tyre është jodemokratike. Ku mund të punohet në një verë të institucioneve për nxjerjen e dokumenteve që të krijojë kushte të njëjtë për të gjithë e ne po punojmë sinqerisht në këtë drejtim. Njëherit caktimi i kufijve administrativ pilot të njësive komunale nuk është i nevojshëm në fazën e parë të reformës sepse procesi ka karakter testues eksperimental, por kjo për bëhet pas regjistrimit të popullsisë dhe pronave dhe pas nxjerjes së ligjeve të domosdoshme për reformën e tërësishme të pushtetit lokal.

Këshilli i pilot njësive komunale do të përbëhet nga deputetët e kuvendeve komunale ekzistuese që në të njëjtën kohë mbesin edhe deputetë të pilot komunave. Mendoj se ky është dublikim i funksioneve që deri më tanë nuk është lejuar në institucionet e Kosovës. Në këtë projekt dokument gjyqësia dhe policia, edhe pse ka mbet për tu elaboruar nga UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të Kosovës, mendoj se është dashur të zbërthehen kompetencat që këto dy institucione do t'i ushtrojnë me rastin e fillimit të reformës së pushtetit lokal. Grupi hartues i këtij projekt programi në të ardhmen synohet të shndërrohet në bord i cili do të drejton dhe udhëzon pesë nëngrupet për reformën e pushtetit lokal.

Unë mendoj se nuk ka nevojë për krijuimin e mekanizmave të ri kur veç me votën e lirë janë dhe funksionojnë institucionet të dala nga vota e lirë e popullit. Duhet t'i kushtohet rëndësi se çka decentralizohet kur dihet publikisht që institucionet qendrore nuk janë plotësish të kushtëzuara sepse kjo paraqet rrezik që pushteti në Kosovë të reduktohet në Kornizë të qeverisjes lokale. Mbështes fillimin e procesit për reformën e pushtetit lokal sepse është një interes politik për Kosovë, edhe pse është proces i gjatë që përcillet me vështirësi financiare, politike, legislative e organizative por e vlen për ta filluar se mohon pushtetin paralel. Është projekt i institucioneve të Kosovës që i mënjanon projektet e tjera nga çarqet e ndryshme dhe se kam shpresë se mëson reformën rrënjosore që do të bëhet vetëm pas regjistrimit të popullsisë, pronës dhe pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Prandaj, në veten time e ndiej një dëshirë se si ta bëjmë si institucione këtë çështje sa më mirë dhe të pranueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Faleminderit. Ylber Hysa, le të përgatitet Rifat Krasniq.

### **YLBER HYSA**

Më duket atë që e kam pas përparsi në shkollë, tash e kam një pengesë duke pasur emrin me Y. Mbase do të duhet flas nga fundi dhe duke rrezikuar që të përsëriten, po megjithatë dëshiroj të ripohoj diçka që u thà këtu, më në fund kemi treguar se mund të kemi një debat kualitativ dhe të pjekur dhe kjo mund të duhet të ndodh sa herë që ai nuk pengohet, në këtë aspekt nëse mund të theksohet një gjë e përbashkët nga shumica e diskutantëve është fakti që apo thuaje se

askush deri më tash nga kolegët e nderuar nuk e ka kundërshtuar decentralizimin. Në fakt askush nuk ka thënë që decentralizimi nuk vjen. Problemi qëndron sa nga ne kemi thënë që pilot-projektet në fakt vlejnë, dhe besojë që këtu duhet ta mbështesim gjykimin tonë dhe debatin tonë që duhet të ndodhë sot. Në këtë aspekt askush nga ne këtu nuk është kundër më shumë të drejtave për qytetarë në nivelin komunal, apo askush nuk është kundër reformimit të pushtetit lokal, dhe askush nuk është për më shumë autonomi të komunave. Fjala është për cilat komuna, ato ekzistuese apo të reja me të cilat kriteriume, çfarë shkalle, çka bëhet me kompetencat e rezervuara ku ato përcillen me pushtetin lokal, pra këto janë ato që na ndajnë e jo çështja nëse jemi apo nuk jemi për reformimin e pushtetit lokal. Dhe kjo sidomos duke pasur parasysh që kjo është një çështje serioze dhe që në propozimin e afruar nga Qeveria ka shumë konsistencë të cilat tregojnë që në fund të nxirren konkludime për të cilat ose nuk jemi marrë vesh ose nuk i kemi paraparë. Në këtë aspekt sidomos nëse vlerësohet që qëllimi i pilot projekteve është që progresivisht të fusin në praktikë kalimin e propozuar të kompetencave shtesë nga niveli qendror në atë komunal dhe pastaj në pikën 3.3 fshihet kompetencat fillostarte të së cilës pilot komunë dhe pilotë njësi komunale do të përkufizohen veç e veç në pajtim me rrëthanat lokale dhe në pajtim me komunat në fjalë dhe pastaj pika tjetër ikonzistente në 2.1. Në fund ku thotë kemi një mungesë të gjykate kompetente. UNMIK-u është përgjegjës për zgjedhjen e mos marrëveshjeve apo kur bëhet fjalë për kompetencat ekzekutive dhe pastaj vërehet se nga këto kompetencia është edhe reagimi i menjëhershëm te zjarrifikësit. Reagimi i menjëhershëm është aq një koncept i mjegulluar sa që mund të nënkuftoj prej reagimit përfikjen e zjarrit e deri te ndonjë intervenim i policisë speciale apo ndonjë njësiti antiterror. Në këtë aspekt unë dua t'i besojë fjalës së kryeministrat të thënë sot që as policia as gjyqësia nuk do të jenë pjesë e këtij procesi. Mirëpo në anën tjetër më duhet të them që pikërisht kjo Qeveri është në dijeni të plotë të përgatitjes së draftit të ri për Ligjin për policin që mban datën 16. marsit 2005. Ku po thuajse pika 16 e tëra i kushiohet këtij aspekti dhe i cili në pikën 16.1 në mënyrë të qartë tregon që komuniteteve do t'i njihet e drejta për aktivitetet policore dhe sidomos në pikën 16.4 ku po citoj thuhet: "Kompetencat e tjera shtuese do të transferohen tek autoritetet komunale edhe në . . ." Pra në këtë aspekt duhet t'i kemi parasysh që kjo që po diskutojmë sot në një proces do të implikojë edhe mendime të shumta të tjera dhe me fjalë tjera ashtu siç e përmenda dëshiroj t'i besojë fjalës së kryeministrat. Më dua të them që me gjithë atë decentralizimi në këto rrëthana në Kosovë është një çështje serioze dhe ajo nuk mund të rregullohet në besë, po mund të rregullohet me ligj, dhe nëse mund të rezimoj nga e tëra që u tha deri më sot atëherë edhe së paku ekzistojmë dy mënyra: ose duhet të marrë parasysh atë që u tha sot nga një debat dhe ku po thuaj se e kishim më shumë pika që na bashkojnë se sa që na ndajnë dhe propozojmë që ta bëjmë këtë punë përmes një rregullore ose përmes një ligji të ri ose atëherë ju lutem të votojmë për propozim të Qeverisë këtu që së paku fundi kemi një vendim i cili do ta bëjë dikend përgjegjës për këtë proces. Ju propozojë që në fund të këtij debati ta shterim këtë mundësi dhe të definohemi çka do të bëjmë sot. Faleminderit.

### KRYETARI, NEXHAT DACI

Faleminderit, Rifat Krasniq, le të bëhet gati Sokol Bashota

### RIFAT KRASNIQ

Sayın Meclis Başkanı, Sayın Başbakan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Bu gündü Meclis toplantısının ilk noktasında Yerel yönetimin reformuyla ilgili Kosova Hükümeti tarafından hazırlanan programın görüşülməsi yer almaktadır. Sözkonusu programda 5 pilot belediye projesinin Kosova Meclisinin onayından geçmesi

beklenilmektedir. Sözkonusu pilot belediye projeleri Meclis tarafından onaylandıktan sonra, Mamuşa köyü de belediye statüsüne kavuşacaktır.

Kosovanın tek Türk köyü olarak bilinen Mamuşa, Kosovanın gelişmesi yönünde her zaman seferber olmuştur. Ister savaştan önce, ister de savaştan sonra, özellikle savaş esnasında 50.000 den çok mülteciye kapılarını açıp, yardım eli uzatmıştır.

Önceden de belirtmiş olduğum gibi, Mamuşa köyü Türk köyldür ve bu kimliğini koruması amacıyla Türklerin geleceği için oldukça faydalı olacağına inanmaktayım. Mamuşa halkını, sözkonusu pilot projenin Mamuşa yanı sıra, daha hangi köyleri kapsadığı ve araçların kimin tarafından karşılaşacağı ilgilendirmektedir.

Türkleri temsilen bir milletvekili olarak ben, bu pilot proje sayesinde altyapının gelişeceğine, bunun dışında sağlık, eğitim, kültür ve daha birçok alanlarda ilerleme kaydedeceğini, bununla birlikte gençlerin iş bulacağına umut etmekteyim.

Sözkonusu pilot projenin gerçekleşmesinin iyi tarafları olduğu gibi, zor tarafları da vardır, ama eğer çaba sarfetmiş olursak bütün zorlukları aşacağımıza inanmaktayım.

Konuşmamın sonunda, toplantıda hazır bulunan bütün milletvekillerine, Kosovanın geleceği için önemli olan bu projeyi onaylamaları çağrısında bulunuyorum. Faleminderit.

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Faleminderit, Sokol Bashota, le tē përgatitet Fehmi Mujota.

#### SOKOL BASHOTA

Z. kryetar, tē nderuar deputetē, Reformimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë është domosdoshmëri dhe nevojë eminente e shoqërisë kosovare, ashtu siç është e nevojshme reformimi i tërësishëm i sistemit juridiko-kushtetues në Kosovë. Duke u nisur nga ky fakt është me rëndësi vitale përcaktimi i prioriteteve, dinamikës edhe mbi tē gjitha i konceptit të reformës tē sistemit juridik në Kosovë dhe reformës së funksionimit të administratës publike. Reforma për kah hierarkia duhet nisur nga lart, duke u shtrirë në tē gjitha sferat e jetës shoqërore dhe institucionale në Kosovë, reformat e propozuara në vetëqeverisjen lokale duhet tē jenë pjesë e reformimit të sistemit të tërësishëm juridik dhe kushtetues në Kosovës dhe pjesë e këtij sistemit të reformuar. Kërkesa që me nguti xxxxxxxxx t'i hyhet procesit të reformimit të pushtetit lokal pa krijim tē infrastrukturës kushtetues dhe ligjore dhe reformë tē tërësishme të administratës publike në Kosovë e shkëputë këtë proces nga tërësia, e bënë projekt separat domosdo vlen tē kuptohet se është i motivuar më shumë në kritere politike, se sa në kriter tjetër tē qëndrueshme dhe reale.

Jemi shumë tē sigurt se një qasje e tillë nuk është e qëndrueshme dhe se do tē prodhojë pasojë edhe implikime tjera tē cilat në rrëthana kosovare morën dimensione jashtëzakonisht tē mëdha negative tē cilat do tē jenë shumë vështirë tē sanohen më vonë. Sipas prioriteteve tē renditjes paraprakisht duhet tē bërë transferimin e plotë tē përgjegjësive në harmoni me Komizën Kushtetuese në institucionet e nivelit qendror, tē flitet për decentralizim pa u konsoliduar pushteti qendror është humbje kohe dhe shëmangje e vëmendjes dhe përqendrimi nga qasjet prioritare e kanë tē bëjnë me konsolidimin dhe funksionalizimin e pushtetit qendror.

Dokumenti reforma e vetëqeverisjes lokale, programi i punës për vitin 2005 miratuar nga Qeveria e Kosovës për nga përbajtja qasja koncepti dhe karakteri është kryekëput dokument përfundimtari i ardhshme administrative të Kosovës. Si i tillë ky dokument nuk ka vizion tē qartë

për përkrahjen e reformës pa objektivat që duhet të arrihen me anë të këtij dokumenti. Pa të dhëna mbi implikimet financiare dhe buxhetore dhe shikuar në përgjithësi paraqet një projekt eksperimentar i motivuar kryesisht mbi baza politike. Duke krahasuar këtë dokument me dokumentin kornizë për reformimin e qeverisjes lokale në Kosovë të miratuar në korrik të viti 2004 nga Qeveria e mëparshme mund të konstatohet se ka shumangje esenciale nga ky dokument të cilat korisistojnë në:

1. Gjersa dokumenti Kornizë për reforma të vetëqeverisjes lokale ka për qëllim konsolidimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale duke përcaktuar mekanizma mbrojtës të autonomisë lokale dokumenti i ri përqendrohet në ndarjen e komunave ekzistuese në krijimin e komunave të reja,
2. Në dokumentin e kornizës për reformë të vetëqeverisjes lokale është rekondit kryesor nxjerra e ligjit të ri për vetëqeverisjen lokale që do të rregullonte edhe eliminonte problemet e shumta që janë prezantë në funksionimin e vetëqeverisjes lokale dhe do të krijonte kushte dhe bazë ligjore për formën e mëtejme, dokumenti i ri i qeverisë aktuale parashevë që në fund të vitit 2005 të aprovohet Ligji për vetëqeverisjen lokale. Logjikisht shtrohet pyetja cilat janë objektivat që synon të arrihet, cila është baza ligjore në bazë të së cilit do të funksionojnë njësitë e reja komunale dhe nën komunale,
3. Me dokumentin kornizë është paraparë që në pilot projekte të përfshihen komunat si tërësi e jo në mënyrë separatë pjesët e veçanta të komunës siç propozohet me dokumentin e ri,
4. Dokumentit të ri të propozuar nga Qeveria aktuale i mungojnë mekanizmat dhe instrumentet për shuarjen e strukturave paralele në Kosovë, dhe tërë koncepti dhe fryma e këtij dokumenti shkon në favor të ndarjes së mëtutjeshme në baza etnike dhe si i tillë mund të shërbet si fillim institucional i implementimit të strategjisë dhe planit të qeverisjes së Serbisë për ndarjen e Kosovës.
5. Gjersa dokumenti kornizë i aprovuar nga Qeveria e mëparshme parashevë mekanizma për përfshirjen institucionale të qytetarëve dhe shoqërisë civile në procesin vendim marrëse siguron transparencën e punës, ofrimin e shërbimeve më afér qytetarëve, dokumentit të ri të nxjerrë nga Qeveria aktuale i mungojnë këto mekanizma. Dokumenti i Qeverisë aktuale i quajtur reforma e vetëqeverisjes lokale është përpiluar dhe përgatitur jashtë syrit të opinionit publik dhe me pjesëmarrjen e rekrutuar të anëtarëve të grupit punues për vetëqeverisjen lokale. Për derisa sot Kosova ka nevojë për zgjidhje të qëndrueshme në shërbim të qytetarëve të saj, ajo më së paku ka nevojë të eksperimentohet se edhe ashtu është një eksperiment unikat ndërkombëtar.

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Fehmi Mujota, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

#### FEHMI MUJOTA

Faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, z. ministër të nderuar deputetë.

Më duket se më takon të ndërroj pak sa kahjen e diskutimeve për çështjet kaç madhore çfarë është reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi aq më tepër ndoshta një përparësi që vijë nga pushteti lokal dhe nga një përvojë katervjeçare dhe kam shokun e dikurshëm dhe mikun tim edhe z. Lutfi Hajrizin, këtu për të bërë sa komente dhe për të bërë sa vlerësimë shumë reale rrëth këtij procesi dhe për t'i dhënë kahjen mbarë kësaj çështje.

Po tē shikojmë të kaluarën tonë katervjeçare tē qeverisjes lokale në Kosovë, sigurisht që tē gjithë do tē vijmë te konstatimi se qeveria lokale në Kosovë punojë një kohë tē gjatë sipas një rregulloreje tē UNMIK-ut 2000/45 Rregullore e cila ishte kundërshtuar në kohën e vet edhe nga z. Ram Buja që është këtu prezent në kohën e strukturave tē përbashkëta administrative duke cilësuar si një rregullore tē parnjafueshme pér ushtrimin e kompetencave tē fushë veprimtarisë tē qeverisjes lokale. Mirépo ajo ka vazhduar tē aplikohet dhe aplikohet sot e kësaj dite në Kosovë në mungesë tē infrastrukturës ligjore tē themi një fjali, duke mos përmendur një nga një tē gjitha ato ligje që i duhet qeverisë lokale. Prandaj doemos çështja shtrohet t'u japid përgjigje në tri çështje kapitale pse decentralizimi? si decentralizimi? dhe kur decentralizimi? Në pyetjen pse decentralizimi besoj se tē gjithë e kemi tē qartë se as në demokraci tē pjakura nuk ka përfunduar decentralizimi dhe reformimi i pushteteve lokale dhe natyrisht që edhe Kosova duhet tē ndjek shembujt e tillë dhe rrugën e tillë, por shtrohet pyetja kur tē ndodh kjo. Kjo nuk mund tē ndodh një vënd i cili nuk ka status politik juridik tē përcaktuar, nuk ka kushtetutën e vet dhe nuk ka bazën e nevojshme ligjore pér këtë çështje. Nuk mund tē ndodhë pa respektuar kartën evropiane tē autonominë lokale dhe konventa tjera ndërkombëtare që garantojnë tē drejtat e njeriut dhe pakicave, dhe natyrisht nuk mund tē aplikohet dhe nuk mund tē zbatohet tërësisht në praktikë pér derisa në Kosovë nuk respektojnë veçoritë e vet vendit. Është shumë e qartë që një kohë tē gjatë projekti i tillë ka flutuar mbi hapësirën e Kosovës dhe këtu duhet ta themi shumë hapur që tē gjitha ato projekte tē më parme tē nisura në Beograd tē prezantuar përmes Shtajnerit në Strazbur, dhe tē kthyera anasjelltas në Prishtinë. Si meritë që duhet vlerësuar nga Qeveria e kaluar është që ky projekt në bashkë me pilotin e vet e ulin në pistën e Kosovës, por gjithsesi duhet tē kemi kujdes që Qeveria e tashme këtë projekt me pilotin e vet mos e lejë tē shkojë në pistë tē gabuar. Çështja është që duhet tē ndajmë qartë dhe mirë dy çështje: duhet tē ndajmë atë që nuk guxon tē ndodhë diçka që do tē gjenerojë krizë, diçka që do tē ndajë etnitë, diçka që do tē bëjë mbyllje tē tyre dhe diçka që do tē predikojë statusin përfundimtar tē Kosovës. Këtu jemi tē dyshimtë ose jemi gati tē sigurt tē gjithë këtu bazë diskutimeve që kemi se po tē respektojmë këtë vijë mbi baza etnike dhe politike duke mënjanuar tërësisht faktorët e tjerë aq tē nevojshëm pér përcaktuar parimet e decentralizimit dhe reformimit tē pushtetit lokal me siguri se kemi hyrë në një projekt shumë kontrovers, projekt kontrovers tē cilin kështu e titullojnë edhe vetë do tē thosha bashkëideatorët në Këshillin e Evropës, sepse tē gjithë e dinë se në këtë moment nuk është e mundur tē zbatohet një projekt i tillë aq, më tepër kur jemi në fazë shumë delikate tē definimit tē statusit tē Kosovës. Prandaj, pilot projekt kolog tē nderuar pér mendimin tim ofron ose krijon mundësinë më tē keq pér zgjidhjen e problemit institucionale pér qytetarin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik pér integrimin institucional dhe pér garantimin e zhvillimit tē demokracisë dhe vlerave tē demokracisë. Gjithsesi në këtë rast duhet tē kemi parasysh se praktika e vendeve tē tjera është një rast i mirë pér tē shërbyer me to po tē kemi parasysh se Kosova nuk është as Anglia, as Franca, as Norvegjia madje, madje as nuk është e ngjashme me vendet që kaluan tranzisionin e tyre, por që kanë anëtarësinë e tyre në Kombet e Bashkuar do tē thotë janë shtete. Dhe gjithsesi në këtë rast duhet tē respektuar specifikat tona tē Kosovës dhe tē mos ngutemi një gjë e cila mund tē shkaktojë telashe tē reja.

Parlamenti i Kosovës do tē duhet tē luaj rolin e vet legjislativ dhe do tē duhej tē marrë vendime përkatëse pér tē cilat bëne obligative Qeverinë dhe institucionet që dalin nga ky parlament. Prandaj do tē ishte praktikë e keq që parlamenti tē shkojë dhe tē hartojë ligje postvestom d.m.th. pas praktikave tē shkuara dhe t'i përshtat ato në bazë tē rrëthanave tē reja tē krijuara dhe jo tē paraprirë rrëthanave politikave që i duhen vendit. Një çështje tjeter që duhet ushtruar në këtë rast është që parlamenti duhet tē marr vendim tē tillë i cili do tē pamundëson t'ë bëren ose çvlerësimin e standardeve tē cilat po angazhohen tē gjitha institucionet e Kosovës, po angazhohet pozita edhe opozita, shoqëria civile, partitë parlamentare, jashtë parlamentare dhe tē gjithë qytetarët e Kosovës. Në qoftë se hyjmë në këtë projekt atëherë unë personalisht do tē mendojmë tē gjithë dhe ta kemi tē qartë se kemi rrëzikuar një proces tē tillë dhe nuk do tē

pajtohesha me konstatimin e një kolege që përmendi më herët një fakt se hartimi i legjislacionit në atë kohë dhe do ta dëshjojë procesin. Unë do të tha që ndryshe, në qoftë se do të hymë tanë në pilot projektet e tillë ku nuk dimë sakun e saktë dhe e dimë se çka do të gjenerojë në esencë, atëherë dyshojë dhe besoj se jam plotësisht i bindur se kjo do të rrëzikoje gjithë legjislaturën dhe fazën kushtetuese të Kosovës, dhe jo e para. Prandaj kolegë të nderuar do të kisha dëshiruar që të përbëllidhemi në një mendim të përbashkët që ky Kuvendi të marrë vendim tretë kësaj çështje kaq kapitale dhe atë do të mund ta bënte në dy mënyra:

È para për të treguar pjekurinë si institucion si parlament dhe si vend që nuk është kundër proceseve normale, kundër decentralizimit, reformimit të pushtetit lokal dhe nuk është për mbylljen e dyerve të cilat janë të hapura në gjithë Evropën dhe gjithë botën e zhvilluar. Por është kundër atyre parimeve dhe atyre irregullave dhe atyre projekteve të cilat në fakt e bëjnë dc legitime edhe Kosovën e bëjnë të papërbajtishëm parlamentin, e bëjnë të pa vlerë gjithë vendimet dhe diskutimet që marrin në këtë Kuvend. Prandaj kolegë të nderuar, mendoj se në fund të këtij debati kaq përmbytësor dhe kaq të afërt me diskutimin njëri me tjetrin duhet të marrim vendim meritór i cili do t'i hap rrugët procesit të mëtejshëm të proceseve normale që do të ndodhë në Kosovë. Ju faleminderit.

### **KRYETARI NEXHAT DACI**

Z. Mujota ju faleminderit. Bajrush Xhemajli, le të bëhet gati Fatmire Mullhaxha.

### **BAJRUSH XHEMAJLI**

Ju faleminderit z. kryetar, përshtendes kolegë deputetë, ministrin e pushtetit lokal z. Haziri dhe në fund kryeministrin një përshtendetje të veçantë për atë që u kthye sepse unë z. kryeministër isha i vetmi që protestova nga vendi që ju nuk ishit këtu në sallë derisa diskutojë.

Më duhet të them që në fillim se kur ditë më parë kam dëgjuar deklaratën e kryeministrit Kosumi lidhur me këtë seancë për decentralizim se pavarësisht se çka thuhet në seancë Qeveria do të vazhdojë të implementoj projektin e saj dhe këtë e plotësoj z. ministri i Pushtetit Lokal z. Haziri, në eksponenë e vet se veç ka filluar në disa segmente të implementohet ky projekt. Pata përshtypjen sikur ky debat po bënë po feston dhe mendoj që nuk ka dalur ashtu përfaktin se të gjithë pozitë e opozitë në pikat kryesore jemi që ky projekt të revidohet dhe shikuar në bazë diskutimeve që u banë këtu duhet ndërrerë ky proces së paku derisa të konsolidohet projekti. Pastaj, kur dëgjova eksponenë e kryeministrit dhe të ministrit të pushtetit lokal z. Haziri, dhe duke pasur parasysh edhe projektin për të cilën po diskutojmë mu shfaq përpëra një episodë e historisë sonë jo të largët dhe të palavdishëm ajo e vitit 1989 për kundër asaj që pas shqyrtimit publik të atëhershëm u pa dhe u pat thënë qartë se Kosova dëmtohet dhe përmes ndërrimeve kushtetuese aneksonej nga Serbia, dilnin disa shqiptar me alamet tituj të cilët mundoheshin më kot ta bindin popullin se këto ndërrime ishin të pakta dhe nuk qojnë në peshë. E ne pastaj e dimë se sa peshë ka pasur dhe çka u bë më vonë. Këta të kaluarës po i shoh se shfaqen edhe sot fatkeqësisht vetëm në një kohë dhe drithë tjetër, por gjithsesi të dëmshme për procesin që po kalon Kosova.

Lansimi me pompozitet i projektit të Qeverisë dhe sofizmat nga ana e të involvuarve në implementimin e këtij projekti se kinse është një projekt për të mirën e qytetarëve nuk do të duhej të qonte peshë para fakteve të shumta që nuk do t'i numëroj më sepse janë numëruar nga shumë parafolës të mijë, por të cilat fakte argumentojnë kategorikisht të kundërtën, se ky projekt nuk ka të bëjë me reformimin e pushtetit lokal, për të mirën e shumicës dhe besoj se as të pakicës, madje as pakicës serbe. Reformimi i pushtetit lokal në këtë rast decentralizimi do të duhej bërë për t'ju ofruar shërbime më të mira e më të shpejtë qytetarëve për ta bërë shtetin më

funksional. Dhe nē këtë sens unë si deputet jam që tē bëhet reformimi i pushtetit lokal, atçherë kur tē vijë koha, tē bëjmë projekte ashtu siç do tē duhej bërë, pra si nē gjithë botën e qytetëruar, por unë nuk jam pér një decentralizim siç e parashevë projekt i Qeverisë, sepse ky decentralizim është i motivuar politikisht dhe bëhet mbi baza etnike. Kush e ka motivuar dhe si veç e dimë por shihet qartë dhe mendoj se çdokush dhe u tha edhe nga shumica se është i motivuar politikisht dhe mbi baza etnike. Duke bërë pazarllëqe politike është një decentralizim regional mbi baza nationale me qëllime të hapura politike dhe secessioniste. Kështu askush nē botë nuk ka bërë me shtetin e vetë dhe aq më pak ne do tē duhej tē bënim nē këto rrëthana që po kalojmë. Eksperimente të tillë me Kosovën janë tē pa pranueshme. Nëse e bëjmë këtë nē fakt ne e ndihmojmë dhe e realizojmë konceptin serb pér ndarjen e një pjese sa më tē madhe të Kosovës, nē fakt nē emr tē decentralizimit kështu siç po bëhet, është duke u futur kontrabandë ndarja e Kosovës. Ndoshta dikush është i gatshëm që ta bëj edhe këtë qoftë pér t'ia bërë qejfin dikujt apo pér tu ndier më mirë nē karrigen pushtetore, por unë jam i gatshëm që tē pranoj vetëm atë reformim tē pushtetit lokal i cili bazohet nē ligj dhe ashtu siç kanë vepruar vendet më tē përpunuara, ashtu që ato modele që i përgjigjen vendit tonë pér t'i adoptuar sa më mirë. Unë nuk jam i gatshëm që t'ia bëj qejfin askujt nē këtë rast as Bashkësisë Ndërkombëtare nē dëm tē Kosovës. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Fatmire Muhaxha, kurse le tē përgatitet Nait Hasani

### **FATMIRE MULHAXHA**

Nga gjithë ajo që thanë parafolësit u kuptua qartë se decentralizimin si proces askush nga ne nuk e konteston. Mirëpo, mbetet kontestuese ajo se si duhet tē bëhet decentralizimi dhe koha. Për deri sa statusi final i Kosovës mbetet i pa definuar dhe shumica e kompetencave gjinden nē duar tē institucioneve ndërkombëtare nuk ekzistojnë nē fakt shumë përgjegjësi dhe pér t'u transferuar dhe decentralizuar. Projektit e tillë kërkojnë resurse tē mëdha. Buxheti i këtij viti nuk ka paraparë asgjë pér komunat e reja dhe këto komuna nuk kanë ekonomi lokale mjaft vitale pér tē funksionuar nē mënyrë tē pavarur. Me qenë se donacionet e parapara që tē sigurohen nuk dihet, pér sa kohë ato do tē jenë nē dispozicion, prandaj mbetet e paqartë se si do tē financoj dhe ofroj subvencione Qeveria pér administratën shtesë nē këto komuna nē kushtet ekzistuese tē varfërisë së madhe nē Kosovë.

Decentralizimi si proces është i domosdoshëm por duhet trajtuar së bashku me ndërtimin e sistemit tē përgjithshëm juridiko-kushtetues tē Kosovës nē rend tē parë dhe kjo çështje kërkon koncenzus tē gjerrë tē spektrit politik dhe shoqëror Kosovar, pér ndryshe kjo do tē garanton qëndrueshmërinë dhe kontinuitetin e procesit, do tē na ofronte siguri që nuk do tē identifikohet me ndarjen territoriale dhe nuk do tē ofroj territorializim etnik. Do tē sigurohem se me ndërtimin e garmiturave qeveritare nuk do tē vihet procesi nē pikëpyetje dhe nē anën tjetër paralelisht duhet tē sigurohet edhe reformimi i administratës publike dhe efikasiteti i shërbimeve publike, kështu që tē jetë organizativi funksional dhe i pranueshëm shoqërisht. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Nait Hasani, kurse le tē përgatitet Berat Luzha

## NAIT HASANI

Të nderuar koleg deputet, i nderuar kryetar, i nderuar kryeministër dhe ministër.

Mund të them që ky projekt që na është prezantuar neve për pilot-komunat, për decentralizimin, një formë e këtillë çfarë na është prezantuar është identik me projektin politik të Lidhjes Komuniste të Serbisë të prillit me platformën politike për zhvillimin e Kosovës të prillit 1981, por tash me një vello tjetër, tash i demokratizuar, prandaj projekti përmban tri emërtime: projekti final për decentralizimin në Kosovë, reforma e Qeverisë lokale dhe programi i punës për vitin 2005. Në bazë të kësaj ndarje nuk është bërë radhitja e përbajtjes në bazë të emërtimeve, në bazë të qahit dëshmohet se projekti është hartuar në mënyrë joprofesionale. Gjithashtu projekti është preambulë pa mbështetje ligjore, si dhe nuk duhet se a është hartuar nga ndonjë grup punues dhe në çfarë përbërje ka qen ky grup. Si hartues i projektit është paraqitur ministria e qeverisjes lokale edhe pse projekti është i përkthyer me një përkthim shumë të dobët dhe nuk është korriguar nga ministria, por në procedurë të shkurtër është procedu në Qeveri, kurse Qeveria e ka miratuar pa kurrfarë korrigimi nga grupi punues në kabinetin e kryeministrat.

Korniza strategjike në këtë pjesë hyrëse të projektit për t'i mëshehur ndryshimet esenciale përkrah dokumenti kornizë, i miratuar nga Qeveria e Kaluar e Kosovës dhe përkrah organeve relevante ndërkombe të dëshmohet se projekti është hartuar në mënyrë joprofesionale. Gjithashtu projekti është preambulë pa mbështetje ligjore, si dhe nuk duhet se a është hartuar nga ndonjë grup punues dhe në çfarë përbërje ka qen ky grup. Si hartues i projektit është paraqitur ministria e qeverisjes lokale edhe pse projekti është i përkthyer me një përkthim shumë të dobët dhe nuk është korriguar nga ministria, por në procedurë të shkurtër është procedu në Qeveri, kurse Qeveria e ka miratuar pa kurrfarë korrigimi nga grupi punues në kabinetin e kryeministrat.

Fushëveprimi i reformës. Në paragrafin e parë thuhet se idetë tjera kanë të bëjnë me policinë e vendosur në komuna janë në diskutim e sipër siç e tha edhe kolegu Ylber Hysaj për policinë, kurse sipas prononcimit : "faqësuesve të Qeverisë dhe të UNMIK-ut, kjo punë është e kryer në Kosovë, duhet të kemi komunale.

Problemi i sigurisë dhe i shërbimeve që duhet t'i kryej policia në komunë është rregulluar me dokumentin kornizë, parografi i fundit në faqen 16. Formimi i policisë komunale në Kosovë është jo vetëm i dëmshëm për të gjitha komunitetet por edhe i trezishëm sepse Kosova ende nuk e ka zgjidhur statusin e vetë, ende nuk ka arritur një shkallë të demokracisë së konsideruar, serbët ende nuk kanë vullnet të inkuadrohen në strukturat institucionale, se polici komunale nuk kanë hierarki me SHPK-në, se duhet të mbajnë uniformë dalluese etj, etj.

Unë propozoj që të zbatohet dokumenti kornizë, kapitulli i 11 paragrafi i fundit në faqen 16 që shërbimet e përcaktuara nga këshillat për sigurime publike në komunat t'i kryen SHPK-ja. Dokumenti kornizë shtojca e dytë, pilot 2004 është ndryshuar në tërësi dhe në realitet nuk kemi pilot-projekte në 5 komunat ekzistuese të radhitura në pikën 3 apo 2, por kemi komuna të reja të emërtuara. Pilot njësi komunale. Me të gjitha kompetencat që i kanë komunat ekzistuese siç thuhet në paragrafin e 4 faqe 3 të këtij dokumenti. Komunat ekzistuese janë zgjedhur 5 komuna si mbulesë për t'i detyruar ato që komunave të reja t'u ndahet pasuria, paragrafi 3.1 i fundit. Paragrafi 4 i dokumentit kornizë, Projekt pilot 2004 është ndryshuar në tërësi. Sipas paragrafit të parë ku thuhet: "Një numër i kufizuar i komunave duhet të hyjnë në pilot planet si tërësi. Këto komuna duhet të organizohen si njësi komunale", pra shtrohet pyetja a thua këto komuna do të organizohen vetëm me nga një njësi komunale, atëherë çfarë testimi duhet të bëhet në komunat ekzistuese ku sipas këtij projekti nuk i bartet asnjë kompetencë të paraparë në kapitullin 4 të dokumentit kornizë 2004. Gjithashtu në rreshtin e parafundit të paragrafit 4 të projektit pilot 2004 ku thuhet: "Se disa njësi nën komunale do të mund të bëhen komuna të reja ose të mbeten njësi nën komunale" nën nënkuption se komunat pilot do ta

themelohen vetëm një njësi komunale siç është rregulluar me këtë projekt, por nënkuption që komunat të organizuara në njësi komunale duke i përfshire të gjitha kualitetet brenda territorit të saj, disa fshatra ose lagje në njësi komunale. Në dokument është thënë se edhe kufijtë do të vendosen mbi bazën e zonave gjeografike të dalluar qartë, grup fshatrash me disa tipare gjeografike ku qytetarët janë të lidhur me nevoja dhe interesa të përbashkëta, tradita kulturore dhe gjuha dhe komunat e reja a do të pyeten p.sh fshatrat të cilat do të hyjnë aty apo jo, apo do të hyjnë me dhunë.

Në qoftë se njësitë komunale do të nisin me të njëjtat kompetenca si dhe komunat ekzistuese që i kanë sipas ligjit të aplikueshëm siç thuhet në faqen 3 të këtij projekti, kurse 5 komunat ekzistuese nuk marrin asnjë kompetencë shtesë të paraparë, në kapitullin 4 të dokumentit kornizë. Parashtrohet pyetja se a po bëhet testim mbi pushtetin lokal, përgjigja është se nuk po bëhet kurrfarë testim nga se nuk po bëhet organizimi i komunës me gjithë territorin e saj në njësi komunale, si model për organizimin e pushtetit lokal në Kosovë, se komunave ekzistuese nuk po ju barten kompetencat e reja, por në këto komuna do të barten kompetenca atëherë ku dhe kur do të organizohen komuna të reja.

Bartja e kompetencave shtesë. Sipas kësaj rregulle nuk ka kompetenca shtesë për komunat ekzistuese pa u bërë organizimi i njësive të reja vetëqeverisëse, nga se njësitë e reja qysh tanë janë të barabarta me komunat ekzistuese. Ky rregull paraqet një kushtëzim të pranohen këto komuna të reja të themeluara në bazë etnike ose nuk do të kemi kompetenca shtesë në komunat ekzistuese. Në rreshtin e parë faqe 5 thuhet: "Kompetencat fillostarte të secilës njësi të vetëqeverisjes lokale do të jenë veç e veç të definuara në pajtim me rrethanat lokale dhe në pajtim me autoritetet lokale në fjalë". Me këtë kuptohet se këto njësi komunale nuk mund të kenë kompetenca të njëjta, p.sh nuk mund të ketë kompetenca të njëjta Hani i Elezit me Parteshin. Sikur të ishte e organizuar komuna e Prishtinës ose ndonjë komunë tjeter me shumë njësi nën komunale më të vogla në gjithë territorin e saj, atëherë kuptohet se njësitë më të vogla nuk mund të kenë kompetenca të njëjta me ato më të mëdha që planifikohen komuna të reja, p.sh Prizreni, Prishtina etj.

Në dokumentin kornizë të 19 korrikut 2004 në kapitullin e dytë rekomandohet që të miratohen dy akte kryesore ligjore. Ligji i ri për vetëqeverisjen lokale që do të miratohet në bazë të kësaj kornizë dhe ligji për financat lokale. Në paragrafin 2 thuhet, një numër i rregullave dhe i ligjeve të tjera ekzistuese do të duhej të ndryshohen si dhe duhet të miratohen disa ligje, me këtë do të thotë se me miratimin e këtyre dy ligjeve të reja të sipërpërmendura nuk mund të fillohet me projektet pilot, kurse ligjet tjera sipas paragrafit 2 duhet të miratohen gjatë periudhës së pilot-projekteve.

Në projektin e ri nuk është paraparë asnjë ndryshim i rregullores së UNMIK-ut siç është paraparë në pjesën shtojcë të dokumentit kornizë 2004, edhe pse projektligj i për qeverisjen lokale është hartuar nga ekspertët vendor në ministrinë e shërbimeve publike në korrik 2004 dhe janë harmonizuar me kartën evropiane mbi qeverisjen lokale, me planin e këshillit të Evropës, dhe me ligjet e vendeve në rajon. Qeveria e re nuk ka dashur ta përcjell në procedurë për miratim, tanë e pranon një dokument të vetin që është në kundërshtim me aktet e paraqitura më lartë.

Në bazë të të gjitha këtyre vërejtjeve, përkatesisht rregullat e këtij projekti mund të konstatohet: "Projekti krijon mundësinë e krijimit të komunave në baza etnike, me krijimin e këtyre komunave pamundësitet lëvizja e lirë e minoritetave, krijon mundësitë e krijimit të policisë komunale në baza etnike, pamundëson reformimin e pushtetit lokal, krijon huti te qytetarët e Kosovës duke e humbur besimin në institucionet e Kosovës dhe të UNMIK-ut" prandaj nuk e miratoj këtë pilot projekt të dëmshëm që është për qytetarët e Kosovës, mendoj

se nese duhet te krahasohet keshetu, kemi mjaft fshatra qe kalojne numrin e banoreve mbi 5,000 siq esht Shala, Komoranin, Zhurin, Krushen e Madhe, Ratkovcin, Hoq, Orlanin etj. Dhe ketu ka me shume nevoje se sa te jet Parteshi dhe Graçanica. Ju faleminderit.

### KRYETARI, NEXHAT DACI

Berat Luzha, kurse le te perqartitet Selvije Halimi

#### BERAT LUZHA

Dua te konstatoj se ky Projekt nuk ka asgje te perbashket me projektin e vitit te kaluar te korrikut, as nga permbajtja, as nga emri dhe as nga volumi i tij. Ne kete projekt parashihen formimi i komunave pilote, kurse ne projektin e vitit te kaluar parashiheshin formimi i 9 komunave qe do te ishin pjesa te komunave e jo komuna. Ky projekt ka gjithsej 9 faqe, kurse ai i ka pasur 22 faqe. Ky projekt me shume se projekti i vitit te kaluar i pernget projektit apo planit per decentralizim te Kosoves te Qeverise Serbe.

Se dyti dua ta them se perpara nuk kemi njeh plan apo njeh program per reformimin e qeverisjes lokale apo nuk kemi njeh plan per decentralizimin reformimi ka njeh kuptim krejt tjetër, qe do te ishte njeh riorganizim apo njeh ndryshim brenda njeh subjekti, kurse decentralizimi ka kuptimin e shperqendrimit te pushtetit ne menyr qe disa funksione te kalojne ne nivele me te uleta.

Formimi i komunave politike ne rrafshin etnik ne realitet, ka filluar qe nga koha e Milosheviqit, nuk esht e sotme me qellim te shperberjes se teresis se Kosoves e qe realizohet me formimin e komunave politike mbi baza etnike qe nga viti 86, sipas ktej plani atcherish ishin formuar komunat e Shterpces, Zveçanit, Artanës Zubin Potokut e shume tjera.

Të gjithë ne e dim se sa te sukseshme ishin keto komuna politike se çfarë opstrukcione i kësaj bëre e po i bëjnë ato vendit, dhe se sa i kanë kushtuar dhe sa po i kushtojnë ato edhe sot. Gjendje te varfér te Kosovës.

Para se te formonte komunat e reja politike qeveria bashkë me UNMIK-un duhet ta shtrijnë autoritetin e vetë ne te gjitha komunat e Kosovës, plani i tashëm serbë per decentralizimin e Kosovës por jo te Serbisë parashev formimin e komunave serbe në Kosovë, pastaj te bashkësive te komunave apo te regjoneve dhe se fundit te një kosmeti serb, i cili do t'i kishte te gjitha institucionet e nevojshme te një shteti çfarë do t'i kishte edhe Kosova, duke filluar nga Skupshina, nga Qeveria nga Milicia nga gjyqet tjera edhe ne se meritorët e këtyre regjoneve nuk lidhen ne mes veti gjeografikisht, ato do te lidhesin politikisht me një qendër pushtetore ne Kosovë dhe ajo qendër do te lidhej vertikalish vetëm me Beogradin dhe jo me Prishtinën. Kete plan pjesërisht e realizuar sigurisht edhe te perpunuar regjimi serb i cili nuk dallon shume nga regjimi i Milosheviqit, po tentonte ta implementoj edhe ne Kosovë. Per fat te keq, kete herë përmes qeverise te Kosovës e cila duke menduar se kësijo do ti ysh serbët per te marrë pjesë ne institucionet e Kosovës, realisht do ti kontribuonte ndarjes se mëtejshme te vendit apo krijimit te hapësirave qe do te paraqiteshin si vakume institucionale per Kosovën, me kete plan do te bëhej një zgjidhje qe nuk do te ishte zgjidhje. Një zgjidhje qe ne asnjë menyr nuk do t'i përgjigje interesave te Kosovës. Kjo zgjidhje me shume do t'i ngjante zgjidhjes se modelit bosnjak, kur formalisht ekziston një shtet kurse realisht brenda tij ekzistojnë apo funksionojnë dy shtete. Kësot zgjidhje nuk do te duhet te bëhesin ne Kosovë dhe kete duhet ta thotë edhe qeveria.

Ky plan serb aq i perfolur, qe sa kohë vitin e kaluar ishte hudoj poshtë nga Qeveria e Kosovës por edhe nga UNMIK-u, sipas dokumentit te qeverise ne vend te njesive komunale fillimi

do të formoheshin pesë komuna të reja me mundësinë e zgjerimit të numrit të tyre në të ardhmen edhe në komunat e tjera politike. Për mos e zgjatur qeverisë e cila me kokëfortësi ua njeh si të drejtë. Këtij projekti të huaj i bëjmë këto pyetje: edhe sa komuna politike do të formohen në Kosovë pasi procesi i decentralizimit do të vazhdojë edhe më tutje, a mundet që nesër çdo fshat serb të bëhet komunë në vete. Sa do të jetë e suksesshme p.sh. komuna e Parteshit, dhe nëse nuk është a do ta zhbëj Qeveria atë pas 18 muajve, të pilotimit të sajë. A mund të krahasohet Hani i Elezit me Parteshin? Apo a mund të krahasohet Parteshi me Prishtinën e cila do të ketë të njëtin status pas 18 muajve. A parashihet kjo ndarje me kornizën kushtetuese?-që është një statut i miratuar nga partitë në pozitë. Si do të caktohen kufijtë e komunave?- nëse një fshat i etnititet tjetër refuzon me referendum të përfshirë në kuadër të komunës së etniteti tjetër, a do ta detyrojë qeveria të hyjë dhunshëm në të. Nëse serbët edhe përkundër formimit të komunave të reja nuk integrohen në institucionet legale të Kosovës çka do të ndërmerr Qeveria?- a mundet qeveria ta parandaloj formimin e bashkësive të komunave apo regjioneve dhe pastaj të organizimeve tjera vijuese dhe .....

### **KRYETARI, NEXHAT DACI,**

Selvie Halimi le të përgatitet Genc Gorani

**SELVIE HALIMI**, i nderuar kryetar, i nderuar kryeministër dhe ministra të pushtetit lokal, të nderuar deputetë.

Për 4 muaj radhazi diskutohet në media dhe në publik për një dokument i cili nuk u paraqit para deputetëve në Kuvendin e Kosovës me arsyetimin se qeveria po përgatitet. Në prezantimin e një fjalimi nga kryeministri dhe nga ministri i pushtetit lokal, unë nuk vërejta asnjë farë përgatitje konkrete asnjë fakt real, por vërejtja një fjalim të bukur që asgjë s'ka të bëjë me realitetin. Para nesh është ofruar një dokument me tre emra, faktikisht në Kosovë kemi 3 pushtete paralele, cili pushtet, cilit emrë të këtij dokumenti i përket dhe çka po decentralizojmë, si mund të flasim për decentralizimin pa baza ligjore, ku askund në botë nuk bëhet një gjë e tillë. Si mund të flasim për decentralizimin pa e ditë faktikisht se sa është numri i qytetarëve në Kosovë, dhe pa e ditë strukturën e tyre, çfarë moshe e cila është përbërja gjinore, cili është niveli i edukimit të tyre, cila është gjendja shëndetësore e tyre, cili është, apo cila është gjendja ekonomike e çdo qytetari në Kosovë. Disa komente i kam konkretisht me kornizën strategjike që thuhet se do të implementojë dokumentin kornizë. Të nderuar deputetë, dhe veçanërisht ju qeveritarë, lirohuni nga dokumentet korniza sepse një kornizë e aprovuar 4 vite më parë ja se ku po na sjellë, lirohuni nga eksperimentet nga të cilat jemi duke vuajtur si qytetarë të Kosovës pavarësisht se cilit etnitet i përkasin. Ky program i punës është një program që me qëllim ka anashkaluar dhe është ngutur të kalojë në implementim pa infrastrukturë ligjore duke u thirrur me eksperimente.

Grupi i kontaktit me një takim të cilën ju e paraqitini në kornizën strategjike të mbajtur, më 16 dhjetor 2004, ndërsa tjetra theks të veçantë i kushton legjislacionit dhe kërkon kalim të shpejtë të legjislacionit duke e ditur se është në ligj i gatshëm që të procedohet në parlament dhe kjo nuk është bërë për pesë muaj radhazi.

Në faqen 2, paragrafi i fundit thuhet në momentin- komenti im ka të bëjë me atë që të mos marrë kohë me lexuar citatet nga dokumenti. Në momentin e krijimit të komunave të reja do të fillojë bartja e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal. Këtu kemi të bëjmë me bartjen e kompetencave të cilat ende janë të rezervuara për UNMIK-un, kemi të bëjmë me bartje të kompetencave direkt nga qeveria e Beogradit dhe kemi të bëjmë me bartje të kompetencave nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse. Do të thotë atyre komunave të reja do t'i u

lejohet që të vendosin vetë për financimin e tyre, për dhënen e nënshitetësisë, për të drejtën e pronës, gjëra të cilat këto u përdhunuan.

Në faqen 3, komenti im ka të bëjë me kufijtë territorial të komunave nuk është ofruar një qartësi se a është e aftë kjo qeveri që të mbrojë kufijtë e komunave ekzistuese, me çka do të garantojmë mbrojtjen e atyre kufijve, cilët janë ato mekanizma, paragrafi 7 i faqes 3. Komenti, këtu kemi të bëjmë me një thelb të artë të problemit, se gjithë ky debat sot sillet, thuhet se me decentralizim apo reformim të pushtetit lokal do të bëjmë zhbëren e strukturave paralele. Zhbërrja e disa strukturave për 6 vite radhazi, nuk u gjet kurrfarë mekanizmi që të zhbëhen, kjo nuk është e vërtetë do të thotë mekanizma ka pasur, mirëpo nuk është punuar deri në fund që të zhbëhen ata.

Po të shikohet vëmendshëm se cilat komuna janë shpallur për pilot projekt le të konstatohet se në pilot projektet e ardhshme do të jenë komunat me gjendje të njëjtë, por ato ku ekzistojnë strukturat paralele dhe kështu do të vërehet një vijë apo korridor unazor të thyer, por pa u shkëputur askund brenda për brenda territorit të Kosovës, me mundësit e dukshme daljeje në Serbi dhe Mal të Zi. Ky veprim- Qeveri e nderuar, nuk qon askund tjetër vetëm se në një pasiguri të qytetarëve të Kosovës. Ky koment i imi, bëhet edhe më i fortë me pasuesin 8 po të faqes 3, faqja 4 paragrafi 2, si mund të lejoni që të quajmë një eksperiment këto pilot projekte me kompetenca të një komunë ekzistuese. Ju kisha lutar që të hiqni maskën si qeveritar para qytetarëve të Kosovës, të mos veproni me tanë këtë diplomaci që është vështirë për të kuptuar, sepse kjo do të sjellë dëm vetëm qytetarëve të Kosovës. Një gjë duhet ta mbajmë në mend të gjithë, edhe ne si kuvendar edhe qeveria, asnjeri prej nesh nuk e ka këtë mandat nga votuesit e Kosovës.

Paragrafi 3 fjalia e dytë si do të matni përparimin e komunave në zbatimin e pilot-projekteve, cilat janë ato kriterë të nderuar qeveritar? - këtë e lidhi edhe me deklarimet e ministrit të pushtetit lokal që për herë të fundit e dëgjojë, se prioritet do të kenë komunat të cilat do t'ju vënë përparësi prioriteteve të përcaktuara nga qeveria, dhe ato komuna do të kenë prioritet në buxhet gjatë rishikimit të buxhetit, kurse të tjera çfarë do të ndodhë me to, kjo i ngjashto planeve zhvillimore para vitit 89, kur në Jugosllavinë e atëherëshme bëheshin planet e tilla, dhe jo rastësish Kosova nga gjithë ato pjesë, mbeti më e pazhvilluar dhe jo rastësish, rajoni i Drenicës dhe Llapit në tërë Kosovën mbeti i pazhvilluar, andaj ju kisha lutar që në këto raste jemi më konkret, sepse po përsërisim diçka nga e kaluara.

Paragrafi 7. kur flitet për buxhetin se këto komuna do të financohen nga Buxheti i Kosovës, dhe nga buxhetet që do të ofrohen nga bashkësia ndërkombëtare. Në rend të parë do të vijnë në shprehje, komunat ku kemi strukturat paralele, nga se aty janë të përkëdhelurit e bashkësise ndërkombëtare, dhe heshtja jonë, andaj në mënyrë indirekte po ndikoni që ky eksperiment i quajtur nga ju të jetë i suksesshëm. Aty ku ekzistojnë strukturat paralele, dhe aty do të formohen komunat etnikisht të pastra në dëm të Kosovës, dhe vetë atyre që do të janë ato komuna dhe në mënyrë indirekte po ndikoni që disa komuna të tjera që janë futur në këto pilot projekte të mbèsin të varfra, natyrisht të varfra do të jasin komunat me shumicë shqiptare, se kjo është praktika që e përcjellë Kosovën.

Paragrafi i fundit i faqes 4, fletë se UNMIK-u, do të jetë do të zgjidhë mosmarrëveshjet në radhë të mosmarrëveshjeve që do të lindin. Kush i garanton njëanshmërinë e UNMIK-ut, që vazhdon prej momentit të vendosjes së tij në Kosovë, a është e aftë Qeveria të garantojë paanshmëri të UNMIK-ut? Jo, atëherë ky program i punës është i papranueshëm sepse po të numërohen elementet dhe ti grupojmë ato në dy grupe, sa më shumë do të sjellë të mira apo dëme në interes të qytetarëve të Kosovës fuqimisht do të dominojë grupi se ky program sjellë dëme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Pavaresisht etnicitetevë të cilëve u përkasin edhe do të jetë shumë vështirë që të zhbëhet më vonë. Ju faleminderit.

## KRYETARI, NEXHAT DACI,

Ju faleminderit shumë, Genc Gorani, le të përgatitet Xhevati Bislimi

Genc Gorani, zonja dhe zotërinj deputetë, vetëm pasi Kosova të konsiderohet si shtet atëherë Kosovës do t'i duhet një reformë i pushtetit lokal, dhe të organizimit territorial me qëllim të arritjes së një demokracie më të afërt me qytetarin, nxitjen e zhvillimit ekonomik rajonal, shprehjen e të gjitha dimensioneve kulturore, pra edhe etnike, mirëpo sot paraqita një mori çështjesh shumë specifike për kontestin politik të Kosovës, kam fjalën kryesishët për pilot-projektin.

Pilot projektet janë eksperimentale, por në fakt pas konstituimit të njësive të reja komunale të ligjeve, të rregulloreve, dhe të institucioneve përcjellëse, ekziston mundësia e mbritjes së strukturave të krijuara dhe të pavarësimit të tyre, sepse procesi i kthimit mbrapa nuk është i definuar madje as si mundësi.

Pilot projektet kanë për pasojë krijimin e njësive të reja territoriale dhe të administratave gjegjëse, mirëpo nuk ekziston asnjë studim paraprak i arsyeshmërisë ekonomike, sociale, ekologjike e tjera për krijimin e tyre. Ky proces ka karakter eksperimental improvizues, implementimi i tij do të jetë stihikë.

Decentralizimi në këtë fazë fillostarte, dhe definitivisht eksperimentale, është një decentralizim, që të vëtmin kriter e ka atë të etnicitetit, në fakt këtë e kemi të gjithë të qartë. Jemi në mes të një procesi politik të nxitur nga rrethi ndërkombëtar të shpresuar në mënyrë diskrete nga rrëthet në Beograd dhe të pa kontrolluar nga koalicioni qeverisës.

Implementimi i pilot projekteve do të krijojë izolimin ndëretnik, institucionalizuar të njësive të reja administrative, do të ketë përkufizim etnik ndërsa qytetari do të vihet në rendin sekondar, ky decentralizim i përshtapet do të shkaktojë një çrrëgullim të funksionimit shtetëror të njëjtë që na dëshirojmë me aq zell të tregojmë të suksesshëm, jemi duke punuar kundër vvetvesës në një anë ndoshta do të plotësojmë një prej standardeve, po nga ana tjetër do ti tregojmë gjasat përmbylli me standardeve tjera, kontestin aktual politik të Kosovës. Decentralizimi i tillë krijon njësi territoriale të reja të plotë fuqizuar si konsekuençë, direkt. Do të ndodhë mbylla e kufijve etnike si pasurive minerale si dhe të hidro resurseve të shtrira prej veriperëndimi deri në verilindje të territorit tonë.

Me krijimin e njësive territoriale me kompetenca dhe pronësi defakti mbi resurset natyrore dhe esenciale për ekzistencën funksionale të Kosovës. I tërë territori ynë do të hyjë në një paqëndrueshmëri akoma më të madhe, pasi të jetë i realizuar pilot projekti hipatitikisht. Jam duke folur, ne do të zgjohemi në një Kosovë të varur nga vullneti i njësive komunale që do të jenë menaxhuesit e resurseve strategjike të të gjithë banorëve të Kosovës, me realizimin e pilot-projekteve ne vetë urdhërojmë mundësi dhe mjete konkrete të forta shantazhi qarqeve që sot deklarohen haptazi kundër pavarësisë së Kosovës.

Pysë po ashtu si është e mundur që po krijohet një skemë e re nën ombrellën e decentralizimit e cila skemë nuk ka bazë të mjaftueshme dhe financiare dhe të resurseve humane.

Apo ndoshta ky është qëllimi vërtetë i agjendave të pa publikuara që pastaj të arsyetohet një njësi porsakruar administrative në mungesë të financimit do të kërkojmë ndihmë diku tjetër, është lehët të qëollohet se ku do të kërkohet ndihma dhe kush do të vijë në ndihmë të njësive etnike, edhe një dezikuilibrium në Kosovë. Krijimi i dezikuilibriumve në Kosovë të shpërndarë po thuaj në tërë territorin është krijimi i një Kosove jo stabile, krijimi i një stabilitetit të ri

rajonal, cila do tē jenë zhvillimet e pastajme, a jemi duke përgatitur ne vetë edhe një konflikt të rënë në zhvillimet e paparashikueshme, që moti është dashur tē jemi ne vetë autor të idesë pér reformimin e pushteti lokal në kuadër të shtetit të Kosovës tē kemi kuaj në duar pér ndërmarrjet e reformave të pashmangshme me synime të qarta dhe përgatitje të duhur ne ish këtë rast e kemi humbur me fajin tonë, po kjo nuk mund tē më obligojë tanit që në emr të një patriotizmi momental-ta pranoj realizimin e pilot-projektit të cilat nuk janë vetë projekti qëllime pjesë e agjendave të pa qarta deri në fund. Nuk mund nuk mund ta kalojë mungesën totale të garacioneve pér konformitet pér synimet e parashtuara dhe vetëm në ato, si do që tē jetë tē gjitha përgjegjësitë pér treth zbatimit tē një programit të pilot-projekteve si dhe tē cilit do segment tē reformës tē tillë tē propozuar tē pushtetit lokal i takon koalicionit qeverisës. Përgjegjësia i takon edhe këtij Kuvendi nëse ky Kuvend nuk e kërkon shqyrtimin e këtij pilot-projekti në kuptim tē miratimit të tillë. Ju faleminderit pér vërmendje

**KRYETARI, NEXHAT DACI**, ju/ faleminderit shumë, Xhevati Bislimi le tē përgatitet Safetre Haderxhonaj

**XHEVAT BISLIMI**, zoti kryetar, zotërinj deputetë.

Zhvillimet e muajve tē fundit në Kosovë dhe rrëth sajë e kanë kapërcyer çështjen e decentralizimit apo tē reformimit të pushtetit vendor siç po quhet sot nga pozita. Qytetarët që po na ndjekin para televizoreve tē tyre do tē habiten me këtë komoditet tē Kuvendit dhe tē deputetëve të Kosovës, vërtetë luks që do t'i kushtojë Kosovës siç e tha një parafolës një kolegë i yni. Fqinjët tanë veçmas Serbia pastaj Bashkimi Evropian Grupi i Kontaktit dhe qeveria amerikane po merren intenzivisht me çështjen e statusit tē Kosovës, ndërsa Qeveria edhe Kuvendi i vetë Kosovës me kokëfortësi po vazhdojnë tē mbyllim sytë para kësaj çështjeje dhe po merren me reformimin e pushtetit vendor përshëndetje pér kryeministrin, prandaj unë jam kundër dhe kërkojë cë kjo çështje tē mbylljet në arkivat e qeverisë me te do tē merremi vetëm pas krijimit tē tē Kosovës. Projekti i qeverisë pér reformimin e pushtetit vendor që sot e kemi përparrë tē më së buti është një përkthim i dobët një studim joserioz, me sa duket qeveria nuk ka pasur kohë ta përkthejë dhe ta përpunojë më mirë sepse ishte e preokupuar në përgatitjet pér bisedime me Serbinë dhe pér pritjen e kryeministrit serbë në Kosovë, dihet botërisht se projekt i përgatitjet pér decentralizimin e Kosovës është iniciativë dhe vazhdimësi e projekteve që kanë ardhur vazhdimisht nga Serbia.

Ky projekt nuk ka asgjë tē përbashkët me reformimin apo decentralizimin e pushtetit vendor rrënjet e këtij projekti janë politike dhe etnike qëllimi i fundit i këtij projekti është ndarja e Kosovës mbi bazat etnike dhe paragjykimi i statutit tē Kosovës ose siç po thuhet më shumë se autonomi ma pak se pavarësi, prandaj unë jam kundër.

Kosova dhe populli i saj kanë pritur dhe kanë besuar se Qeveria dhe Kuvendi do tē ofrojnë dhe realizojnë projekte pér unifikimin e Kosovës dhe tē qytetarëve tē saj, projekte pér zhvillimin ekonomik dhe social tē vendit tonë.

Pakica serbe në Kosovë nuk mund t'i realizojë tē drejtat e sajë në struktura dhe komuna paralele por duke hyrë në institucionet e Kosovës ajo nuk mund t'i realizojë tē drejtat e sajë as duke këruar ndarje territoriale dhe administrative tē Kosovës por duke u integruar dhe bashkëjetuar me fqinjët e vetë në komuna dhe institucione tē përbashkëta, kjo është porosi edhe e qeverisë dhe kongresit Amerikan.

Ky projekt do t'i kushtonte buxhetit tē varfëri tē Kosovës miliona euro në kohën e një krize tē tmerrshme ekonomike dhe sociale që po kalon vendi ynë, kategorië tē tëra tē shoqërisë sonë, pensionist arsimtar profesor tē universitetit tē Prishtinës punonjës tē institutit albanologjik mjek

dhe infermier tē spitaleve publike punojnē pēr njē pagē mujore qē nuk i ploteson as pēr sē afērmi nevojat e njē jete normale. Veteran dhe invalid tē luftes çlirimtare tē UÇK-sē familjet e dëshmorëve minatorē e punētorē tē dikurshëm dhe njē armate tē tērē tē pa punē dhe tē pa strehë ndodhen nē njē gjendje skajshmërisht tē vështirë ndërsa njē dorë e njerëzve dhe e familjeve nē Kosovë mezi po sigurojnē njē kafshatë buke, mijëra tē rinj e burë po kërkijnë rrugë e kanale pēr tē shkuar atje kur rrezikohetjeta, nē Avganistan e nē Irak, pēr tē siguruar bukën e gojës, ndërsa pozita pēr qefin e Serbisë dhe tē disa çarqeve tē caktuara ndërkombëtare insiston tē harxhoj miliona euro pēr krijimin e komunave tē reja, këto fakte nuk i bëjnë nderë asnjë qeverie dhe as këtij Kuvendi.

Të gjithë sa jemi këtu këruam votën e qytetarit tonë pēr ta bashkuar Kosovën jo pēr ta copëzuar atë, pēr ta bërë shtetin e Kosovës kompromisi më i madh qē po e bëjnë shqiptarët e jo pēr tu tallur nē Kosovë dhe pavareshinë e sajë, pēr ta zgjedhur një qeveri qē prodhon paqe e siguri, mirëkuptim e zhvillim ekonomik e mirëqenie sociale dhe jo një Qeveri qē prodhon tensione politike qē thellon krizën ekonomike sociale abuzimet dhe korruptionet, reformimi i pushtetit vendor apo decentralizimi nuk është paraparë as nē standardet e famshme pēr Kosovën, nē interesin e Kosovës dhe tē rajonit janë projektet dhe angazhimi i UNMIK-ut dhe i Qeverisë pēr një Kosovë tē sigurt pēr tē gjithë qytetarët dhe pēr një Kosovë ku do tē sundonte rendi dhe ligji, krijimi i zonave speciale nē Kosovë dhe komunat qē ofron qeveria janë tē pa pranueshme mendoj pēr çdo qytetarë tē Kosovës.

Zotërinj deputetë, klasa politike dhe institucionale e Kosovës, duhet tē ketë konsensus tē plotë nē çështjen e ndryshimit tē raporteve me UNMIK-un i cili do tē duhej t'i bënte gati valixhet, vendin e tij do ta zinte shteti i Kosovës dhe institucionet e tij shtetërore, përvëç tjerash Qeveria e Kosumit nuk ka mandat pēr realizimin e këtij projekti dhe as pēr angazhim me bisedime me Serbinë.

Ndërrhyjet e Serbisë nē çështjen e organizimit territorial dhe administrativ tē Kosovës duhet tē marrin fund, Serbia nuk mund tē injoroj dhe as tē harrojë kaq shpejtë terrorin gjenocidin spastrimin etnik dhe holokaustin qē ka bërë nē Kosovë, këtë tē vërtetë tē dhimbshme mund ta harrojmë ndonjë politikan i Kosovës por nuk mund ta harrojë kur populli i sajë përfshirja e Serbisë nē çështjen e statusit tē Kosovës dhe pjesëmarrija nē bisedime pēr këtë çështje është e pa pranueshme pēr popullin e Kosovës dhe duhet tē jetë e papranueshme edhe pēr institucionet e Kosovës.

Kosumi dhe kushdo tjetër nē bisedimet e tillë do tē përfaqësonin vetveter se jo Kosovën, madje as lagjet e tyre, është koha e fundit qē klasa politike e Serbisë t'i kthehet problemëve tē shumta tē vendeve tē saj dhe ta lër tē qetë Kosovën dhe rajonin, këto janë vetëm disa arsyet e shumta pse unë dhe besoj fuqishëm qē i tërë populli i Kosovës është kundër këtij projekti dhe politikës së asaj qē po e quajmë pozitë, edhe diçka nē fund, më sa dëgjoja unë dhe kuptova tē gjitha grupet parlamentare dhe secili deputet veç e veç ishin kundër këtij projekti prandaj pyes z. Kryeministër dhe ministrin pranë tij tē cilët kanë dalur nga vota e këtij Kuvendit; politikën e kujt e bëjnë?

**KRYETARI, NEXHAT DACI**, ju faleminderit Safete Haderxonaj le tē përgatitet Nazim Jashari

### **SAFETE HADERXONAJ**

Të nderuar tē pranishëm, nē një ligjëratë ditë më parë z. Ministër i pushtetit lokal tha se unë kam hyrë nē koncenzus bon sa i përket reformës së pushtetit lokal, unë sot e kuptova qē vërtetë paska hyrë nē koncenzus bon nga se tē gjithë ministrat e janë vetëm por mos u mërzit z.

Ministër i pushtetit lokal se në fund po të bashkoja z. Kryeministër e ndoshta të ndihmon të dalësh nga koncenzusi BOM.

Cështjet më të diskutuara kohëve të fundit pa dyshim i shtojnë çështjet e decentralizimit të pushtetit lokal, bartja e proceseve vendimmarre sa më afër qytetarëve sigurimi i shërbimeve publike më të mira administrata publike më efikase është pritur nga të gjithë qytetarët e Kosovës, edhe pse të gjithë kemi qenë të bindur siç u tha edhe këtu në këtë debat publik shumë të mirë sot për çështjen e decentralizimit se është një proces edhe i ndërlidhur edhe i gjatë edhe shumë dinamik.

Kur e analizon programin e Qeverisë për pilot projektet është e pa mundur të mos i bësh pyetje, deri kur bartësit e institucioneve tona do të përulen me servilizëm e të bëjnë apo më mirë të themi të pranojnë me përvlje programet që pengojnë lëvizjen e proceseve në të mirë të Kosovës? Unë nuk pajtohem me projektet e tillë qofshin ato nën presion, nga mosdija, për qëllime politike të caktuara, apo të projektuara diku tjeter.

Qeveria duhet t'i bëj pyetje vetyves, a do t'i falë qytetari i Kosovës ata që nuk dinë çka bëjnë apo që bëjnë atë që nuk duhet bërë.

Qeveri e nderuar, unë vi nga Deçani dhe kam obligim moral por edhe qytetarë tu bëj një pyetje, Çka po ndodhë me Deçanin? Si do të zgjidhni z. kryeministër problemin e familjarëve të dëshmorëve dhe rasteve sociale në Baballoq dhe në Junik. Çarë po ndodhë me pjesën turistike të Deçanit me perspektivën e ardhmërisë së kësaj komune? - juve jua bëj këtë pyetje sepse faktikisht po i zyrtarizoni enklavat serbe në vend që të punoni në heqjen e tyre.

Programi që ju na keni ofruar është një retorik e thatë dhe praktikisht është e parealizueshëm. Të nderuar deputetë, unë do të ndalem vetëm një çështje, këtë program e bënë të parealizueshëm kostojë e pilot projekteve. Nga Kryeministri por as nga ministri i pushtetit lokal asgjë nuk u tha se sa është kostojë e këtij pilot projektit të cilin e kërkuau pothuajse "gjithë deputetët në këtë seancë parlamentare.

Në programin e Qeverisë krejt çka thuhet për këtë çështje është në faqen 4 paragrafi 7 po citojë:

Mjetet buxhetore do të epen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (buxheti shtesë do të miratohet të cilave do tu shtohet financimi shtesë nga bashkësia ndërkombëtare ndoshta kontributi i donatorëve nuk do të mungojë në zhvillimin ekonomik lokal ashtu siç nuk ka munguar as në të kaluarën. Për komunat tona, për të paguar pagat marrin grant por komunat tona për tu paguar pagat marrin grantin nga qeveria qendrore në saje të menaxhimit të keq të buxhetit kurse buxheti i Kosovës nuk ka ndarë asnjë cent për komunat e reja.

Në shtojcën dy pilot projektet të kornizës për reformimin e vëtëqeverisjes lokale në Kosovë të cilës është dashur t'i referohet qeveria në hartimin e programit në faqen e dytë në fund të paragrafit të dytë thuhet: Vetëm ato zona duhet të zgjidhen si njësi pilot të cilat në saje të potencialit të tyre ekonomik dhe aftësisë për të krijuar të ardhurat duken të asta për të bërrë shërbime banorëve të tyre, atëherë lind pyetja: Sipas cilave kriterë i zgjodhi qeveria pesë komunat për pilot projekt të reformimit të pushtetit lokal a do të ketë potencial ekonomik dhe aftësi për të krijuar të ardhurat për tu bërrë shërbime banorëve të tyre të këtyre komuna, sa është paralogarit e kostos të komunave si do të sigurohen mjetet kur Kosova ka filluar vitin me deficit të planifikuar buxhetor? Qeveria këto i quan projekte provuese besa edhe eksperimentale në të shumtën e rasteve, por të gjitha këto projekte Qeveri e nderuar kërkojnë para.

Ato thjeshtë do të ngarkojnë buxhetin qendror jo vetëm se nuk grumbullojnë të hyrat e tyre siç u tha këtu dhe u shpjeguan edhe komunat përkatëse por sepse e tillë është edhe politika e shfrytëzimit të buxhetit kur nuk ka përgjegjësi dhe transparencë buxhetore ku ka paaftësi në menaxhimin e taksave dhe tatimeve komunale ku më tepër ka lojë politike se sa qeverisje të mirëfilltë. Si pasojë e kësaj të hyrat tatimore nga qeveria lokale në vitin e kaluar ishin vetëm 4% nga të hyrat e tërësishme buxhetore.

Pushtetet lokale kanë qenë të varura nga qeveria qendrore ku pjesa më e madhe e buxhetit të përgjithshëm të komunave ishte planifikuar të vijë nga grantet e Qeverisë qendrore. Nuk ka rezultate më të mira as në tremujorin e parë të këtij viti, të hyrat e realizuara janë shumë më të ulëta se ato të planifikuara, të hyrat vatanake komunale në këtë tremujor janë vetëm 3.7% që krahasuar në tremujorin e parë të vitit të kaluar janë 1% më të ulëta sipas raportit finansiar të Ministrisë dhe Financave 69% të buxhetit të komunave ka shkuar në paga dhe mëditi kurse vetëm 9% për shpenzime kapitale 22% për mallra dhe shërbime, shifrat flasin vetë e komentet janë të tepërtë, kur kësaj ia shton edhe vërejtjet e vazhdueshme të fondit monetar ndërkombëtar për reduktimin e të punësuarve në administratë. Komunat e reja e shtojnë numrin e të punësuarve në administratë si dhe rrëth qëndrueshmërisë buxhetore dhe mundësise se bankrotimit të buxhetit për shkak të deficitit në rritje atëherë më duhet të them se projekti i reformës së pushtetit lokal sipas programit të ofruar të qeverisë në këtë menaxhim jo të mirë të buxhetit është i rrezikshëm dhe do ti kushtojë shumë Kosovës.

Deputetë të nderuar sipas kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale janë të rekomanueshme komunat e vogla por finanziarish të qëndrueshme, ai ka bërë llogaritë qeveria se këto pesë pilot komuna a do të janë në gjendje ti jepin më shumë qytetarëve të jetojnë në to dhe ti plotësojnë nevojat financiare nga ky program që na është ofruar se shihet se çdo gjë është filluar ashtu siç nuk është dashur të fillohet, për të bërë një formë të suksesshme qeveria është dashur të bëjë më shumë në krijimin e legjislacionit të domosdoshëm sipas rekomanimit të parë të kornizës për reformimin e pushtetit lokal siç u kërkua nga gjithë deputetët, në rregullimin e aspekteve të procesit buxhetor në reduktimi e shpenzimeve të punojë më shumë në fushën e tatimeve dhe ngarkesave tjera fiskale lokale në mënyrë që ato të janë të përballueshme për bizneset dhe tatim paguesit tjerë dhe të ndikohet në ngritjen e kulturës fiskale dhe në reduktimin e vazionit fiskal.

Zhvillimi i fushatës për vetëdijsimin e obliguesve tatimor dhe të sigurojë mekanizma më efikas administrativ për rritjen e inkasimit, të tatimit në pronë, pa u bërë asnjë hap në këtë drejtim, nuk mund të mendohet për ndonjë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, lokal e assesi për reformë të suksesshme, të pushtetit lokal apo kjo ndoshta bëhet me qëllim që reforma të vonohet edhe fuqizimi i qytetarëve ashtu që strukturat politike në pushtet të përfitojnë nga statuskoja, që t'i mbajnë pozitat e previliguara të tyre dhe ti ruajnë pushtetin mbi fondet publike të cilat i keqpërdorin për çdo ditë.

Ju faleminderit për durimin.

**KRYETARI, NEXHAT DACI**, Nazim Jashari le të përgatitet Hajredin Hyseni dhe i fundit Jonuz Kastrati,

**NAZIM JASHARI,**

I nderuar z. Kryetar, të nderuar përfaqësues të qeverisë të ndërruar kolegë deputetë,

Ishte sot një ditë e mbarë që në fillim kur na u dha shansi që të debatojmë për një proces i cili realisht mund të ketë implikime të mëdha në të ardhmen e Kosovës.

Gjeneza e këtij procesi, më duhet të them se, e tha shumë mirë z. Hamiti, buron nga dëshira e zyrtarëve komunalë për të pasur kompetenca më të mëdha dhe kështu në këtë vazhdë gjinden edhe disa projekte prej të cilave dy i kemi në Kuvend dhe po i analizojmë, projektin e Qeverisë së kaluar dhe projektin e kësaj Qeverie, po ashtu edhe një projekt i cili u laku edhe në çështjen ndërkombëtare ishte projekt i kryetarit të Kuvendit z. Daci me 80 komuna të cilin nuk e patën fatin ta kemi në dorë dhe që duke marrë parasysh potencialin që na ka lënë z. Daci do të ishte shumë i mirë për ta pasur dhe për ta realizuar, sepse me siguri do të gjenim zgjidhje ndoshta më të mira se ky projekt që e ka hartuar ky grup punues. Grupi punues për qeverisje lokale është krijuar në kontestin e kërkesës së bërë në deklaratën presidenciale të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 30 prill 2004 për: qeverisje lokale më efektive nëpërmjet devoluimit tek autoritetet lokale të përgjegjësive qendrore jo të rezervuara.

I interesuar saktësishët me këtë citat kërkova kuptimin e fjalës devoluim dhe e gjeta se në fjalorin e anglishtes që është gjuhë zyrtare në Kombet e Bashkuara dhe në Kosovë, siç e dimë ne gjithë thuhet se devoluim do të thotë dhënie kalim apo lëshim i kompetencave që në këtë rast nënkuption lëshim të kompetencave autoriteteve lokale tash a ekzistueseve apo atyre tjerave të pjesëtuara do të mbetët të shihet. Kush ishte ai kumbarë i cili me devoluim nënkupto pjesëtimin e organeve lokale ose të autoriteve lokale mbetet enigmë si do qoftë në bazë të dokumentit kornizë të miratuar më 19.07.2004 nga qeverina Rexhepi ishte paraparë rishikimi i 11 rregulloreve të UNMIK-ut, 8 ligjeve të miratuar në Kuvendin e Kosovës, kurse nga e para ishte parë të hartoheshin edhe 12 ligje tjera. Kjo ishte mendoj platforma e cila do të duhej ti paraprinte këtij procesi si sigurisht edhe me rishikime ditëve tjera të nevojshme por gjithsesi me rishikime dhe me hartimin e ligjeve të nevojshme, parimet e decentralizimit sipas grupeve parlamentare romë duhet ti përsëris edhe një herë, janë: vullneti politik i cili me këtë projekt nuk merren në konsideratë, korniza buxhetore e njësive nën komunale e cila nuk është e saktësuar fare, dhe potencialet administrativ i paspecifikuar sipas këtij projekti.

Edhe pse Qeveria ka dëshirë të arsyetohet apo t'ju justifikohet me respektimin e kartës evropiane për qeverisje lokale të jeni të sigurt zonja dhe zotërinj që kjo mungesë kushtetutshëmërie dhe ligjshmërie që e karakterizon këtë "reformë" nuk do t'i bëjë këtë as fare nderi Këshillit të Evropës pikërisht për shkak të moszbajimit të këtyre dy parimeve bazë të kartës evropiane në qeverisje lokale, nuk do të ndalem për të analizuar përrmbajtjen e këtij projekt propozimi apo kësaj platforme të cilin shpresoj që ky Kuvend në fund do ta votojë ose do të emëtojë një komision i cili do të merret me saktësinë e komandimeve të nevojshme për Qeverinë por do të ndalem pak sa me mënyrën e evokimit të projektit nga ana e dy përfaqësuesve të qeverisë.

Kryeministri në fjalën e tij tha se decentralizimi është proces administrativ dhe kushtetues, pajtohem plotësishët që është administrativ por nuk pajtohem kurssesi se është kushtetues, po ashtu i tha edhe dy fjalë të cilat logjikisht përfashtojnë njëra tjetër decentralizimi është ofertë serioze te bashkësitë e vogla etnike të Kosovës ky është citat, por edhe se nuk do të ketë komuna artificiale një etnike, nuk di tash cila është paqësore a është oferta serioze për bashkësitë e vogla etnike serioze po që se nuk epet mundësia për të krijuar komuna etnike, një citat tjetër ose një thënie tjetër e kryeministrat ishte se decentralizimi e synon hapin e enklavave dhe integrimin e tyre në jetën politike dhe ekonomike të Kosovës. Mendoj se me çfarëdo oferte të njëanshme e cila mund tu bëhet përfaqësuesve politik të komunitetit i cili është një një farë mënyre i izoluar ose edhe vetë izoluar varësisht nga percepcioni në enklava është i destinuar për mospranim nga ta për deni sa edhe ata nuk do të janë pjesë e ndërtimit të asaj oferte dhe mos mendoni zonja dhe zotërinj se ata do të vendosin në ndonjë presion ndërkombëtar për ta pranuar atë ofertë dhe për ta përmbyllur atë përgjegjës sepse do të ishte në kundërshtim me kartën evropiane.

Sa i përket ministrit fjalia e parë që e shqiptojë ministri i Pushtetit lokal z. Haziri, të cilin e respektojë shumë, tha se ky projekt e ka gjenezën në punën e qeverisë së kaluar dhe tek unë automatikisht shtroj një pyetje, pse vazhdimisht z. Haziri e shtron këtë çështje ose insiston në vazhdimësinë e projektit të qeverisë Rexhepi. A është kjo përpjekje për ta ndërtuar alibinë për fajin, apo është përpjekje për ta ndarë meritën, duke e njobur nivelin edhe kulturën politike të politikave tonë tu përfshirë edhe veten këtu. E di se ne shumë vështirë i ndajmë meritat, shumë ma shumë përpinqemi ta ndajmë fajin, prandaj ja një arsy shumë e fortë për ta refuzuar këtë projekt zonja dhe zotërinë. Gjithë ishim dëshmitarë se mbrëmë para Kuvendit u ndogjë në mënyrë kështu simbolike decentralizimi apo ky projekt i decentralizimit të ofruar, ajo ishte djegëje simbolike, por se të jeni të sigurt zonja dhe zotërinjtë se po që se insistohet në këtë projekt do ta kemi edhe një djegëse praktike ose reale të këtij procesi e cila flakë sigurisht se do të rrezikojë edhe të ardhmen edhe perspektivën edhe stabilitetin e regjionit. Ju faleminderit.

**KRYETARI, NEXHAT DACI,** Xhavit urdhëro,

### **XHAVIT HALITI**

Zoti kryetar faleminderit, unë po ju kërkoj falje por grupi parlamentar i PDK të Kosovës është i shqetësuar për shkak të ndërpërjes së transmetimit direkt të televizionit të Kosovës, prandaj ne tërhiqemi nga diskutimet dhe sipas informatave që kemi në vend të transmetimit që duhet t'i bëjë televizioni seancave po e transmeton z. Kryeministër me intervistat e tij prandaj në shejë proteste, jo për drejtuesin e seancës, por për shkak të sjelljes së pa përgjegjshme të televizionit të Kosovës dhe të zëvendës kryeministrit ne e ndërpremë debatin dhe nuk do të diskutojmë, nuk do të marrim pjesë në diskutime përfundit sa të sigurohet transmetimi në televizion.

Kryetari, Nexhat Daci, ju faleminderit, ne edhe ashtu jemi në fund të debatit, është vetëm që i dhashë fjalën Hajredin Hysenit dhe Jonuz Kastratit që janë paraqitur, por është e drejtë e juaja, Kuvendi nuk ka gisht në atë as që është çështje e saj, unë mendoj që ne duhet ta vazhdojmë, ju lus që ta vazhdojmë por është çështje e juaj politike, ne kemi një qëndrim përafërsisht se mundemi ta rrumbullaksojmë debatin dhe të shohim konkluzione çka po marrim, por unë as nuk mund t'ju lus as të bëjë presion është drejtë e juaja politike, si grup parlamentar.

Prandaj unë pres përgjigjen a do tua jep mikrofonin këtyre dyve që kanë ngelë a do të hjen dorë, urdhëroni Z. Hajredin Hyseni dhe le të përgatitet Jonuz Kastrati.

**HAJREDIN HYSENI,** z. Kryetar unë nuk hlek dorë nga fjalimi im por për shkaqe që i paraqiti kryesuesi momentalisht zëvendësi i grupit parlamentar z. Xhavit Haliti unë i bashkëngjitet kësaj,

**KRYETARI, NEXHAT DACI** z. Jonuz Kastrati është në sallë nuk është, pse je në listë në PDK-së, urdhëroni ju lutem, mikrofonin Jonuz Kastratit, deputeti se është i fundit

**JONUZ KASTRATI,** Unë jam nga Malisheva, e di që PDK-ja që edhe ma herët ka pasur dëshirë edhe nderin të më ketë në radhën e tyre, I nderuar kryetar i Kuvendit dhe z. I kryetarit, i nderuar kryeministër dhe ministra të nderuar kolegë deputetë dhe të pranishëm të tjere.

Është mirë që më në fund kjo çështje kaq e rëndësishme sillet përfundat në Kuvend aq më tepër që kjo vje si rezultat i punës së dy qeverive. Punë e mirë gjithsesi është bërë me përcaktimin dhe afatizimin që është bërë sipas viteve gjegjësisht viteve 2005, 2006 dhe 2007, të mundësoset apo të jetë i gatshëm deri në vitin e fillimit të vitit 2008.

Ndër pikat që shihen si të pranuara në fillimin e këtij procesi mund të janë detajizimi i të gjitha detyrave dhe të drejtave i të gjitha komunave, ndryshimi i sistemit zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme lokale, kalimi i kompetencave sa i përket shpërndarjes së kuvendit komunal nga PSSP-ja në qeverinë e Kosovës reflektimi me përbërjen e komiteteve nga partitë politike dhe koalicionet në bazë të ulëseve në Kuvendin komunal, përvèç kësaj, paraqiten edhe pikat që ndoshta duhet korriguar në të ardhmen siç janë marrja e vendimeve me shumicën e të pranishmëve aq më tepër nëse kemi të bëjmë me më pak se gjysmën e anëtarëve të zgjedhur në legjislacion.

Çështja e mandatit të krye shefit ku nuk përputhet me mandatin e Kuvendit edhe shkurtimi i afatit prej 6 në 3 muaj në mundësinë e marrjes së mandatit të deputetit gjithsesi konsiderohet si pozitive, vetë fakti që nga data prill 2004 në deklaratën presidenciale të këshillit të sigurimit është kërkuar qeverisja lokale më efektive apo nga data 16 dhjetor 2004 ku grupi i kontaktit ritheksoj rendësin e procesit të decentralizimit si një nga prioritetet më kontekst të zbatimit të standardeve dhe vetë fakti se kjo punë është e dy qeverive tregon se ky Kuvend nuk e ka shumë vështirë të gjejë rrugën e fillimit të këtij procesi i cili natyrisht se do të zgjatë dhe duhet të kërkojë rrugët që qojnë deri te realizimi i të drejtave të qytetarëve të Kosovës si dhe në demokratizimin e shoqërisë kosovare në përgjithësi, në fund ka shumë çka të thuhet për këtë proces por duhet të hapet rruga dhe të ndihmohet procesi. Ju faleminderit

**KRYETARI, NEXHAT DACI**, e lus Qeverinë Ministrin e pushtetit lokal ose kryeministrin që të merr fjalën,

Në fillim ministri Lutfi Haziri dhe në fund Kryeministri

**LUTFI HAZIRI**, ju faleminderit i nderuari kryetar, kryesi e punës, të nderuar deputetë.

Vërtetë isha i nderuar debatin e sotëm për reformimin e pushtetit lokal dëgjoj shqetësimet vërejtjet sugjerimet rekomandimet edhe pse jo rekomandimet e deputetëve lidhur me këtë proces në tërësi, jam i nderuar sepse zotërimi ynë është që gjitha këto të shqyrtohen në qeverinë e Kosovës në mënyrë që procesi të eci i tillë.

Unë do t'ju them në fillim se çka nënkupton koncenzusi BOM, z. Krasniqi se është ministër bartës i këtij procesi në emër të institucioneve të Kosovës, me pëlqimin e liderëve politik përmendi dy momente shumë të rëndësishme që ka të bëjë me procesin. Koncenzusi politik në rezidencën private të përfaqësuesit special dhe Brukselin si vend ku është paraqitur dokumenti për herë të parë në këtë shtëpi pa u kontaktua liderët politik dhe si iniciativë apo obligim politik i institucioneve të Kosovës me të cilin edhe ish kryeministri z. Rexhepi ka qenë udhëheqës i delegacionit dhe ka udhëhequr i këtij angazhimit të madh për të cilin e çmoj, a kërkjmë alibi a meritë unë dua të sigurojë të sigurojmë kontinuitet, kjo qeveri në dhjetor ka vendosur që parimi i kontinuitetit në procesin e reformimit të jetë parimi kryesor dhe në emër të ruajtjes së koncenzusit të arritur në verën e vitit të kaluar.

Për të mos lejuar prishjen e koncenzusit dhe për të vazhduar procesin si i tillë për hir të zhvillimeve të konstatimeve që janë bë brenda Kosovës qeveria në fund të dhjetorit të vitit të kaluar ka vendosur që parimi i kontinuitetit jo alibi tjetër as fajesi as patronët mbi procesin as ndarje e fajit apo meritës të ndodhë me këtë proces, ne mund të bisedojmë me fakte se sot shumica e deputetëve përmenden dy projekte, nuk ekzistojnë dy projekte ekziston një dokument kornizë i pranuar i vetmi legitim dhe i cili në parimin e kontinuitetit është punë dhe një program pune i cili ka dal nga pika 2 e vëndimit të Qeverisë korrik të vitit 2004 i cili është decidiv në pikën e parë në vendim i shpërndarë thuhet adaptohet dokumenti kornizë për

reformat e qeverisë lokale dhe pikë d, kërkohet nga grupi punues që ta sqaron deri në "pilot komunave" dhe përputhje me këtë vendim deri sa qeveria nuk e lëshon vendimin e shtë i obligueshëm edhe për këtë nivel unë kam vazhdua e kam zërthye e kam sqarua çka e shtë pilot njësi e komunës cilat janë barrierat? cilat janë problemet? sfidat dhe cilat janë përsitimet e qytetarit, dhe nëse e shikoni dokumentin kornizë në faqen 7 të nderaur deputetë, ajo që u tha këtu se ky dallon nga ky dokument dhe shumë komente në formë pyetësorë mendoj që deputetët kanë drejtë ta paraqesin qëndrimin e vet çdo formë që mendojnë thuhet shumë qartë.

Grupi punues rekomandon që së pari të fitohet përvjohë praktike në ristrukturimin e komunave nëpërmjet pilot projekteve, duhet të ekzistojë një numër i kufizuar i pilot projekteve disa prej të cilave do të korrespondonë në themelimin e komunave të reja me përgjegjësi të plota të komunave me themelimin e një lloji të ri nën komunale me përgjegjësi të kufizuar siç e shtë propozuar nga këshilli i Evropës. Ky artikull në këtë dokument bazik i adaptuar nga Qeveria që e shtë miratua në korrik të vitit të kaluar, unë jam përgjegjës si ministër i emëruar në dhjetor me zbatu atë që e shtë vendosur dhe atë me zhvendos në koncenzus.

Loja se nuk ka pasur komuna të reja duhet të ketë nivele më të ulëta komunale del në atë që vërtetë unë e kam pa praktikë në vitin e kaluar. Grupi punues ka qenë i ekspertëve ka qenë në nivel të këshilltarëve politik ministri e shtë përfaqësua. fatkeqësish në asnjë seancë ministri i atëhershëm nuk ka marrë pjesë, vetëm në sesionin e hapjes dhe më vonë në nivel të tre këshilltarëve politik krejt ky proces në emër të qeverisë së Kosovës ka shkuar. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka qenë e përfaqësuese me një ekspert në financa lokale dhe unë prej scancës së pestë në emër të asociacionit komunave kamë marrë pjesë në propozimin përgjegjësitë komunale irregulative dhe ekzekutive.

Sesioni i pestë e shtë fundi i dokumentit, po si i tillë nuk as nuk kamë dashur me i ikë përgjegjësive as nuk dua tash me abuzu tash me të drejtë si deputet, duhet me pas të qartë, pse ky proces e shtë ber i hapur në dhjetor, për shkak të ndjeshimërisë që e ka, shumë drejtë u tha nga profesor Hamiti. E shtë kërkesë e lidershipit lokal, e shtë e vërtetë edhe sot edhe pas 10 viteve lidershipi lokal ka me lufut me autoritetin qendror për të martë autoritet më të madh dhe në çdo vend lufton, ata dëshirojnë me pas autoritet në nivelin ku janë të zgjedhur drejtë drejtë, por nuk ka pasur motive të këqija në bazë kërcësive përkundër zhvillimeve që kanë ndodhur në këtë kontest.

Pse duhet të fillojmë në këtë fazë? Infrastruktura ligjore në Kosovë mungon, nuk ka organizim strukturim ligjor dhe nuk ka të drejtë askush të formon komuna të reja përvjohë përfaqësuesit special dhe Kuvendit të Kosovës dhe mu për këtë qellim e shtë eliminuar ideja e pranimit të komunave të reja. Zonja dhe zotërinj deputet besoj se të gjithë e dini se përfaqësuesi special mbas luftës në Kosovë ka themeluari dy komuna të reja, nuk duhet të herzitojmë dhe të mos e pranojmë publikisht, Komuna e Zveçanit e shtë themeluari mbas luftës në Kosovë dhe komuna e Malishevës e shtë certifikua mbas luftës në Kosovë me status të Komunës, dhe kompromisi ka qen i tillë, kjo praktikë Malisheva dhe Zveçani. Ndërsa 28 komuna tjera kanë qenë trashëgues, ndërsa komunat si institucionë lokale janë themeluari pas luftës dhe nuk kanë obligime dhe nuk janë në kontinuitet të ish pushtetit lokal të kaluar, sepse në ish sistemin federal komunat edhe Kosova ka qenë niveli i pestë respektivisht i gjashtë administrativ që e shtë pushtet i decentralizuar në kulturën e sistemit çfarë ka qen, por i kontrolluar në raport me Kosovën dhe i okupuar. Zhvillimet e pasluftës kanë bërë që pushteti lokal në Kosovë ta ketë vetëm një nivel administrativ dhe sot jemi në atë nivel. Pilot njësitë komunale janë institucionë të reja të themeluara brenda komunës aktuale dhe nuk e shtë lejuar ndërrimi i kufijve komunal. Dokumenti kornizë parashtë ndërrimin e kufijve komunal, angazhim i Ministrisë ka qen që kufijtë komunal mund të ndërrohen vetëm me ligjin përiorganizim territorial i cili parashihet të adaptohet në fund të vitit 2006, dhe deri atijherë askush nuk ka autoritet që ta ndryshon

organizimin e brendshëm komunal sepse riorganizimin territorial është çështje e ndjeshme, është problematike dhe është çështje që sjell në raport me shumicën dhe në raport me pakicën probleme, tensione sepse nëse studiohet rasti i Malishevës si komunë prej vitit 1985, abrogimi apo marrja e statusit të komunës, rikthimi pas luftës deri në riorganizim tregon qartë se sa probleme janë sjellur në këtë kontest dhe nëse dëshirojmë ta përmendi, komuna e Fushë - Kosovës, komuna e Zveçanit janë komunat pa territor komunal edhe sot e asaj dite.

Prej vitit 1985 Fushë Kosova si komunë nuk ka territor komunal, ajo është thënë një autoritet një autoritet në kuadër të kufijve natyral të parimit katastral ndërsa zona industriale mes Prishtinës dhe komunës së re të atëhershme të Fushë Kosovës ka qenë e pa definuar dhe njëra prej problemeve më të mëdha që sot e ka edhe qeveria në kuptimin në organizimin e brendshëm. Andaj, duke mos dashur që të abuzojë me këtë se kufijtë duhet apo nuk duhet përkushtimi i qeverisë është që infrastruktura ligjore 12 ligje të reja plus 15 ligje që duhet të sillen si paket i ligjeve në vitin e ardhshëm. Ndryshimi i tregullorëve të UNMIK-ut që ...pushtetin lokal dhe në fund përgatitja teknike pas marrjes së rezultateve të regjistrimit civil bëjnë që Kosova në vitin 2008 me ditë saktë se çfarë pushteti lokal do me pas sa nivele mundet me organizua, dhe cila është niveli i kategorizimit në Kosovë, sot Prishtina dhe Novo Brda kanë statut të njëjtë ligjorë të ardhurat përcaktohen në bazë të formulës që jep ligji për financa publike, por e drejta para ligjit është barabartë ne nuk mendojmë që duhet të jetë si e tillë. Prishtina mendojmë duhet të organizohet me ligj të veçantë i ndamë sikur çdo vend tjetër ku epet e drejta e qytetit respektivisht kryeqytetit e cila ka organizim brendshëm në kuadër të qendrave urbane dhe rurale në bazë të zhvillimeve që pritet me ndodhë më herët.

Disa deputetë përmendën qëndrueshmërinë financiare të komunave, asnjë komunë e Kosovës nuk ka qëndrueshmëri financiare më vjen keq as Prishtina sot nuk ka qëndrueshmëri financiare, 175 milionë është fonda i qeverisë që shkon në 30 komuna të Kosovës dhe e vetmja taksa e lejuese me ligj mbi finansat publike që kanë të drejtë komunat të grumbullojnë është taksa e pronës, asnjë taksa tjetër në Kosovë nuk guxon të grumbullohet dhe asnjë autoritet për autoritetit qendror. Reforma në menaxhimin e buxhetit në Kosovë është e patejkalueshme, komunat edhe ato që mund të bëhen mbas 5 viteve nuk kanë të drejtë grumbullojnë të marrin pare për interesat e veta pa u bë reforma në finansat publike. Po ashtu njësitë e reja komunale do të kenë detyra që të shtrojnë të njëjtë dhe nuk do të dallohen nga komunat aktuale përvëç një çështje. Asnjë etnitët nuk ka drejtë me grumbullua buxhet pa certifikua pa pas drejtës nga autoritetet qendrore për të grumbulluar buxhet. Rruga deri në certifikim buxhetor dhe Certifikim të pronës është së paku njëvjeçare. Duhet të kalon në procedurë, duhet përmbyshë obligime ligjore, duhet baza e auditimit të brendshëm duhet të certifikohet dhe atëherë me leju me grumbullu takson e pronës apo të hyrat tjera komunale që janë parapa. Nuk duhet që të grimohemi që rrugët komunale janë ato që u përmendën në shumë segmente, mund të bllokohen, mund t'ju lihen emra të dikujt. Unë besoj që shumica prej jush e njihni funksionimin e pushtetit lokal, rruga e sotshme për komunën është mirëmbajtje, ajo është rrugë publike për të cilin autoritetin kryesor e kanë institucionet e Kosovës, sikur që resurset natyrore nuk janë të drejta komunale, por resurset natyrore janë të drejtat e institucioneve qendrore. Fatkeqësisht në këtë rast janë të drejta të rezervuara, asnjë e drejt komunale nuk është e përcaktuar në përpunje me resurset natyrore, qofshin ato nëntokësore apo mbitokësore, përqindja e mijeteve që i takon komunave 6 vite pas ndërtimit të institucioneve tona ende nuk është ndarë. As nuk marrin mjete nga thengilli si rësurs natyror, komunat që ma së shumti kanë nevojë, as nuk marrin mjete komuna e Deçanit nga resurset e pyjeve. Ato kanë mbetur ashtu për arsyet e sistemit dhe mënyrës së përcaktimit të saj.

Cili është statusi i komunës dhe ka të drejtë me përmend, askush nuk ka të drejtë dhe deri sa nuk tregullohet me ligj edhe Graçanica edhe shumë vende që janë popullarizuar në Kosovë do të kalojnë në procedurën e monitorimit. Nuk duhet të dyshoni në institucionet që kanë me ba

monitorimin dhe unë nuk dëshiroj t'i iki përgjegjësisë se nuk jam i zgjedhur me ju dhanë grande vendbanimeve për motive politike apo motive të caktuara.

Të drejtën me qen komunë e ka vetëm ky organ i lartë përmes ligjit dhe unë jam i obliguar me përgatit infrastrukturën ligjore këtu dhe mandej ju mund ta caktioni se kush janë komunat e Kosovës, sa janë ato, kush mund të bëhet dhe kush e humb të drejtën me qen komunë në Kosovë, sepse ne kemi edhe raste që nuk ka qëndrueshmëri edhe komuna aktuale me qenë të qëndrueshme. Ne themi se çfarë qëndrueshmërie mund të ketë komuna e Artanës në raport me Hanin Elezit apo në raport me Junik, çfarë të hyrash ekonomike dhe çfarë garacionesh ekonomike dhe financiare ka, sikurse nuk ka komuna e Drenasit, Vitisë dhe shumë komuna. Nëse i trajtojmë njësoj dhe njëjtë ne mendojmë që duhet të angazhohemi që paralelisht infrastruktura ligjore, testimi i programit se si do të duket ai dhe ideja, testimi i programit bëhet për shkak se proceset kanë dështuar në shumë vende për shkak të mos ballafaqimit apo të mos pritjeve që janë shkaktuar. Maqedonia ka dështuar dhe lufta e ka sjellur procesin e decentralizimit, raport të kundërt në Shlloveni procesi në 4 vitet e parë ka dështuar dhe është riorganizuar pushteti lokal mu për shkak të problemeve që janë paraparë.

Ne nuk dëshirojmë me hy në një proces kur nuk e dimë dhe nuk jemi të sigurt, unë e dijë që nuk jemi të sigurt, ne nuk e dimë se si do të duket pushteti lokal në Kosovë dhe për të qen i sigurt duhet të bëjmë infrastrukturë ligjore, duhet ta testojmë programin dhe në të ardhmen ta rregullojmë. Sa ju përket çështjeve që kanë të bëjnë me rekomandimet që dolën sot që Këshilli i Evropës si propozim i dhënë para disa viteve nga udhëheqësi i Grupit parlamentar PDK-së, versioni i tretë të jetë projekt që duhet të shqyrtohet, unë do ta rishqyrtoj. Po ajo që dua ta them këtu ka të bëjë me një çështje. Rekomandimin e ambasadorit Civileti me mision 9 mujor në Kosovë e ka hudoj Dhoma e Pushtetit Lokal në Strasburg dhe Këshilli i Ministrave si i paqëndrueshëm, për shkak se ai rekomandim është punuar në formulën etnike dhe ai rekomandim ka qen nuk ka ofruar zgjidhje në Kosovë. Tri nivele e parashev organizimin e pushtetit lokal, duke i përfshirë edhe fshatrat e vogla, organizimi vullnetar. Nuk është i qëndrueshëm dhe si i tillë ai mund të rishikohet por nëse vetë autoriteti që e ka punuar këtë dokument e ka pa që nuk është pranuar parimi që ne mendojmë ta vendosim, por tregohet qartë se çelësi kryesor i vetëqeverisjes lokale është shkelur dhe si i tillë nuk është i qëndrueshëm. Ndërsa projektet tjera që u përmendën dhe nga z. Ramë Buja që ka pasur vizionin e vetë që pas luftës dhe nga kryetari i nderuar Daci dhe projekte të tjera që të gjitha parashohin rrityen e numrit të komunave. Të gjitha parashohin prosekturna, bashki në nivele nën lokale dhe divizione administratiave të reja për të cilën është nivel tjetër që duhet të bisedohet. Natyrisht që nuk mund t'i përgjigjen krejt asaj që është thënë dho që është adresuar për t'u sqaruar. Unë jam i vetëdijshëm që ndjeshmëria politike ekziston deri në fund, jam i vetëdijshëm që edhe ne edhe Parlamenti është në presion që ky proces duhet të vazhdoj, që nuk ka filluar sot, ka filluar në prill të vitit të kaluar dhe do të vazhdon deri në vitin 2008. Në fazën përgatitore duke dashur me ndërtua infrastrukturë, më vjen mirë që askush nuk e konteston procesin si të tillë po e konteston mënyrën e testimit të procesit që duhet të rishikohet dhe motivet që u dhanë këtu nuk qëndrojnë në atë se cili është kriteri i zgjedhjes, pse është pranuar ai vendbanim, pse nuk janë 7 vendbanime, janë çështje që mund të diskutohet dhe mund të vendoset.

Kostoja financiare e përgatitjes të fazës testuese të Qeverisë së Kosovës planifikohet në bazë të numrave të parë 7 milion euro. Trendet e ardhshme kjo kosto financiare është barrë e Qeverisë vetë me përgatit procesin si të tillë. Sa do të kusilton reformimi i plotë prej vitit 2008 e tutje, sa kohë do të zgjatë, sa mjete do t'i merr buxhetit të Kosovës unë nuk jam në gjendje ta them, sepse Ministria e Financave dhe autoritetet e tjera janë të thirrura me i bë paralogaritë, por nijë është e sigurt që do të jetë shumë i shtrenjtë dbe do të jetë shumë i gjatë. Ne po planifikojmë me hy me një proces i cili do të jetë i gjatë sikur në çdo vend tjetër. Ajo që është më e rëndësishme është që tash e tutje po vendoset një kulturë e vetëqeverisjes lokale në Kosovë,

nuk ka pasur traditë të mirëfilltë të qeverisjes lokale dhe si i tillë nuk është e lehtë të zbatohet në të ardhmen. Faleminderit për durimin tuaj.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Unë dua t'ju përkujtoj, në rend të ditës është shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal, jemi në fazën përfundimtare.

### **SABRI HAMITI**

E shfrytëzoj rastin që e kamë të drejtën të replikoj sepse më është përmendur emri dy herë nga ministri, më është përmendur edhe disa herë dhe mund t'ju them që pa e përmendur emrin jam cituar qoftë si miratim ose mosmiratim nga shumë diskutues, por është bërë rutinë që njerëzit të përmenden, tu merren idetë dhe të mos përmendet, por ajo është punë tjetër. Është e vërtetë dhe pajtohem me ministrin Haziri që të dy tekstet të cilat i kemi përparrë, i dyti është saktësishët dhe vetë e kamë thanë derivim i tekstit të parë dhe derivim në pikën e shtojcës 2. Unë vërejta në diskutime që për shkak të ngjyrimeve dhe të interesave propagandistike politike teksti i parë dhe i dytë, janë lexuar në mënyrë selektive, që është shumë keq dhe unë tash do t'ju lexoj për ta dëshmuar atë që është në mënyrë selektive dy pasuset shpejt.

Pajisja e këtyre komuniteteve me njësitet vetëqeverisjes lokale me të cilat ata mund të ushtronin ndikim më të madh do të kontribuonte në ndërtimin e besimit, do të demonstronte dëshirën e komunitetit shumicë për tu marrë me shqetësimet legitime të këtyre komuniteteve pakicë që është argument parekselanc politik. Që ky sistem i pilot projekteve është jolegitim, joligjor, e thotë formula, ato do të duhet të zbatohen shpejt pa pritur përfundimin e procesit të plotë legislativ dhe kompletimit të reformës të qeverisë lokale. Për më tepër projektet pilot mund të mbështesin procesin e hartimit të një ligji të ri tjetër dhe e treta, pos tipareve gjografike përcaktimin e këtyre

### **Mungon incizimi.**

### **HASHIM THAQI**

Faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputet, flas në emër të PDK-së dhe në emër të grupit parlamentar pasi që shefi i grupit parlamentar mungon, kështu që besoj se keni konsideratë nëse vazhdoj më tepër se dy apo tre minuta.

Duhet kuptuar se reformimi i pushtetit është proces politik dhe jo teknik. Për një proces politik kërkohet koncenzus, e koncenzusi për tu arritur vend më të mirë se në Parlament për këtë çështje nuk ka. U konkludua nga të gjithë mund të them se ky pilot projekt është jo ligjor, jokushtetues, jolegitim dhe si i tillë është kontestuar fuqishëm sot nga të gjithë diskutantët gadi në Parlamentin e Kosovës. Unë nuk dua të flas dhe deri sa Partia e Demokratike e Kosovës është komplet kundër këtij pilotprojekti. Lidhja Demokratike e Kosovës mbi 90% nga diskutimet del se janë kundër pilot-projektit. Gjithashu edhe grupi parlamentar i Orës u deklarua deri më tash në parim kundër këtij pilot projekt nga ajo që dëgjova unë, po ashtu pash edhe një zgjidhje qëndrimesh të grupit parlamentar të AAK-së dhe natyrisht qëndrime korakte konstruktive të grupit 6+1.

Jemi duke diskutuar qe sa orë, dhe asnjë fjalë e mirë për pilot-projektin e Qeverisë nuk u dëgjua në Parlamentin e Kosovës. Përkundrazi më duket se është bërë garë se kush të hedh balt më tepër mbi këtë projekt. Duhet dalluar se të gjithë jemi për procesin e reformimit të pushtetit lokal, dhe për procesin e decentralizimit, por procesi dhe ky projekt duhet dalluar, duhet dalluar se të gjithë jemi për decentralizim, të gjithë jemi për reformimin e pushtetit lokal, por

askush sot në Parlamentin e Kosovës nuk u pajtua me këtë pilot-projekt që u prezantua sot e që është diskutuar edhe më herët nëpër rrëthet e ndryshme. Pra, është një dokument politik, nuk ka bazë kushtetuese, është projekt ndarës e jo integrues, është projekt krejt në baza etnike e jo në bazë të vlerave qytetare, paraqet prezrik për krijimin e realitetit për ndarjen e brendshme territoriale të Kosovës, është projekt kundër kornizës kushtetuese gjithashtu dhe nëse duhet të ndodh, duhet të ndodh ndryshimi i kornizës kushtetuese, le të vendoset njëherë statusi e pastaj decentralizimi.

Edhe sa i përket mënyrës për të shkuar më tutje janë 4 mënyra që mendoj se duhet të marrim qëndrim unik si Parlament dhe ju ftoj të gjithë, të gjithë deputetët e vullnetit të mirë të të gjitha partive politike, që të vlerësojmë në interes të vendit e jo në interesat e ngushta e partiave. Nuk dua që ky diskutim të shërbej për të zhvilluar beteja politike, por për të sjellë një qëndrim unifikues në nivel të Kosovës. Prandaj pasi që deri më sot nuk është arritur koncezues politik për këtë projekt, as në nivel liderësh politik as në nivel të parlamentit, pasi që po thuhet se është vonë për nxjerrjen e ligjit për reformimin e pushtetit lokal. Pas që po deklarohet nga Qeveria se është i pamundur organizimi i një referendumi që do të ishte normale, demokratike krejt e pranueshme edhe për botën e civilizuar dhe për miqtë tanë ndërkombëtar, kërkohet që sot Parlamenti i Kosovës ose të deklarohet që të arrijë koncenzus në të ardhmen e afërt me spektrin më të fuqishëm politik e natyrisht edhe etnik, ose pilot-projekti të hidhet në votim nga Parlamenti i Kosovës. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

z. Kryeministër fjalën përmbyllëse.

### **BAJRAM KOSUMI**

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputet.

Së pari ju falënderoj për diskutimet thelbësore që i keni bërë dhe mund të them se jam shumë i kënaqur se sot jam bindur edhe njëherë se në Kosovë nuk kanë ndërruar vetëm qeveritë, por ka ndryshuar edhe mënyra e qeverisjes dhe kemi bërë një hap shumë të madh para. Kjo seancë e sodit e ka dëshmuar fuqimisht këtë.

Çështja e dytë shumica e diskutimeve që janë bërë këtu mund të inkorporohen në pilot-projektin për komunat, edhe unë mendoj se ato duhet të bëhen qoftë në formë të rekomandimeve, qoftë nga ato që i tha ministri Haziri, që përmendi disa prej tyre mund të bëhen dhe të inkorporohen. E treta, ky është fillimi i koncenzusit në këtë çështje. Ky debat i sodit dhe inkorporimi i vërejtjeve për të cilat po flas është fillim i arrijes së koncenzusit në çështjen e decentralizimit dhe të reformës së pushtetit lokal. Unë mendoj se do të kemi mjaft kohë që të arrijmë këtë koncenzus, deri sa të vijë koha për decentralizim dhe për reformë të pushtetit lokal, prandaj po ju lus mos mendoni se e kemi shkurt, e kemi sot këtu dhe kryhet me sot. Do të kemi edhe disa muaj ma shumë se 12 muaj që ne të arrijmë pik për pik koncenzusin në të gjitha çështjet themelore që kanë të bëjnë me reformën e pushtetit lokal, dhe me decentralizimin si segment i reformës së pushtetit lokal.

Unë dëshiroj të bëj një klasifikim të diskutimeve që ta lehtësoj fjalën time tash që të definoj se me çka do të merrem më shumë, në njëren anë po i vej diskutimet dhe idetë që u bën sot këtu në lidhje me reformën e pushtetit lokal dhe decentralizimin dhe ju them fillimi se pajtohem me të gjitha ato diskutime që janë bërë për reformën e pushtetit lokal, dhe për decentralizimin, pajtohem edhe me vërejtjet që janë bërë dhe me mbrojtjen që ju ka bërë.

Sot e them këtë sepse reforma e pushtetit lokal dhe decentralizimi si e thash edhe në fjalën time hyrëse do të bëhet pasi të zgjidhet statusi final i Kosovës, do të bëhet pasi të bëhen ligjet për reformën e pushtetit lokal, do të bëhet pasi të bëhen studime të shumta, ashtu si pati edhe shumë diskutime këtu përmënyrën se si do të bëhet reforma, përmënyrën se si do të bëhet decentralizimi. Nuk është kjo një punë e lehtë, edhe shtetet që janë stabile kanë përvojë e që janë shtete bëjnë studime, analiza, bëjnë pilot projekte deri sa të vijnë te implementimi i ligjit për decentralizim. Unë kamë përmendur disa shembuj, ka shumë shembuj i të gjitha vendeve në tranzicion që dëshmojnë përmënyrën se si do të bëhet reforma, përmënyrën se si do të bëhet decentralizimi. Këto janë pjesa më e madhe e diskutimeve me të cilët pajtohem dhe tash nuk do të flas më përmënyrën. Unë do të flas dhe kjo ka qenë tema e bisedës sot përmënyrën e pilot projektin përmënyrën komunale. Pilot projekt i d.m.th është një provë, nuk e ka msheshtur askush që nuk është eksperiment, ne kemi thanë fillimi shtetit që është eksperiment përmënyrën nuk ka legalitet, nuk është ligji. Nëse ju mendoni se provat duhet të mbështeten në ligje atëherë e bëjmë por të gjitha rregullat e legjislacionit tregojnë se nuk ndodh ashtu. Ligji është ligj dhe provat janë prova, eksperimentet janë eksperimente. Që të bëhet një eksperiment nuk duhet një ligj, pilot komunitar janë eksperimente. Unë e them shumë hapur se në këtë projekt përvëç tendencës që të shohim se si funksionon decentralizimi në Kosovë ka edhe politikë, askush nuk e ka fshehur këtë. Njëra prej dy argumenteve të mija fund e krye ishte politikë dhe e bëjmë me vetëdije e bëjmë me vetëdije këtë sepse duam të dalim nga tradita 6 vjeçare e politikës tonë në Kosovë, me i pa problemet dhe mos me i zgjidh problemet. Ne po hyjmë në fazën finale të zgjedhjes së statusit final të Kosovës dhe nuk mund të rrezikojmë t'i mbyllim sytë përmënyrën që i kemi para, po të vazhdojmë kështu e rrezikojmë vjetveter. Me i mbyllim sytë para problemeve e kemi pasur rastin me pa në 2004 me pa se çka do të thotë dhe çdo politikë dhe çdo qeveri. Çdo Kuvend që i mbyllim sytë para problemeve e ka gabim. Problemi i serbëve të Kosovës ekziston dhe është lehtë me thanë se Beograd i nxit, por është problem që po t'i nxit Beograd, nëse janë qytetar të Kosovës pse nuk je i zoti t'i me i nxit ata, pse po lej.

Beogradin me t'i nxit, ne kemi bërë një hap shumë të madh në këtë drejtim. Në këtë K... janë dy deputet serb dhe përmënyrën e parë pas luftës, dy deputet serb kanë votuar përmënyrën e Kosovës, në Qeverinë time është një serb, dhe Beograd trumbeton çdo ditë dhe i thirret serbët që t'i bojkotojnë institucionet, por gjithnjë e më shumë ka politikanë të mençur serb, dhe politikanë patriot serb që nuk duan ta bëjnë këtë por vijnë punojnë në institucionet tona bashkërisht dhe kështu zgjidhen problemet. Nëse doni me vazhdua lojën e blokimit ajo është pa rrugëdalje, e dëmshme përmënyrën. Ne duhet t'i gjemë zgjidhjet, t'ju ofrojmë zgjidhjet dhe t'ju garantojmë zgjidhjet përmënyrën e serbëve të Kosovës.

Unë e them këtë sepse dëgjova shumë diskutime që duhet t'i lëmë këto, mos të ngutemi, këto i bëjmë pasi që t'i bëjmë ligjet, këto i bëjmë pasi të bëhet shteti, kurse unë po ju them se disa gjëra dhe disa reforma edhe shumë reforma tjera duhet bërë përmënyrën e shtetit. Kishte thënë që decentralizimi bëhet përmënyrën e shtetit, ne nuk e kemi shtetin, ne do ta bëjmë shtetin, përmënyrën e shtetit ne duhet të tregojmë aftësinë përmënyrën e shtetit. Nuk e bëjmë këtë përmënyrën e shtetit, nuk e bëjmë përmënyrën e Bashkimin Evropian, kjo është ofertë përmënyrën e shtetit. Disa prej problemeve tona, e bëjmë në përpjekje me politikën integruese evropiane, por e bëjmë përmënyrën e shtetit, e bëjmë përmënyrën e shtetit. Unë nuk dëshiroj të ndalem në disa prej detajeve, ministri Haziri foli përmënyrën e shtetit, ne duhet t'i gjemë zgjidhjet, t'ju ofrojmë zgjidhjet dhe t'ju garantojmë zgjidhjet përmënyrën e serbëve të Kosovës.

Nuk do të ketë polici lokale, nuk do të ketë gjyqësi të komunave, nuk do të ketë komuna që t'ju jepim shtetësinë, askush në Kosovë nuk e ka të drejtë e shtetësisë sot dhe kjo është fatkeqësia, duhet ta krijojmë ne atë, por nuk e kemi ende. Pasaportat janë të Serbisë sot, nëse e bëjnë komunën e bëjnë edhe pasaportën tënde, nëse nuk e bëjnë komunën hiq vazhdon e Serbisë. Nuk dëshirojmë ta paragjykojmë sot suksesin apo moshuksesin e një komune, po bëhen 5 prova nuk

dihet saktë se a do të jenë të gjitha të suksesshme, në punojmë që të jenë të gjitha të suksesshme, por nëse nuk janë të gjitha të suksesshme ato që nuk janë të suksesshme dështojnë. Çështja e fundit që desha të them, me çfarë programesh do të punojnë komunat, nuk është mirë me thënë që po bëjmë enklava dhe po ndihmojmë institucionet paralele sepse kjo po tregon se nuk po i shohim ato, ato janë zotëri, ato ekzistojnë. Detyra ime është që të mos i lë ato, detyra ime është që të mos i lë institucionet e Serbisë në territorin e Kosovës, detyra ime është që të mos lë institucionet paralele që serbët e Graçanicës të integrohen në strukturat e Kosovës, që kryetari i njësisë komunale të Graçanicës të vijë këtu ose në Qeveri të raportoj për punën që e bën. Ky është qëllimi im dhe ky është qëllimi i Projektit dhe kush garanton duhet të garantojmë ne, nëse pret që dikush tjetër me të garantu të garanton ndryshe, por ne duhet të garantojmë për punën tonë, ne duhet të garantojmë për veprimet tona, ne duhet të garantojmë përritjen e qëllimeve tona dhe në fund unë mendoj se ka ardhur koha që nuk duhet bërë gjérat ngadalë, duhet të bëhen fëmijët, duhet të ecim më shpejt përparrë. Sipas të gjitha gjasave janë hiq më pak se 12 muaj përparrë dhe duhet të largohemi nga puna jonë e ngadalë gjatë këtyre viteve të fundit, duhet t'i bëjmë veprimet më shpejtë, duhet të nxisim punët tona më shpejtë dhe kjo krijon një konfuzitet se jemi mësuar që 6 vite me shku si thotë UNMIK-u, dhe tash kur t'i marrim vetë punët në dorë dhe t'i propozojmë veprimet vet na duket pak e vështirë. Por unë po ju garantoj që është më mirë kështu, ma mirë është që të veprojmë vetë, ma mirë është që projektet tona t'i qesim në tavolinë vetë, sepse nëse nuk i qesim projektet tona dhe nëse nuk i realizojmë projektet tona tjerët kanë me tentu me i qit në tavolinë projektet e tyre dhe besoni që nganjëherë po dalin edhe të suksesshëm. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Ju faleminderit. Më lejoni që të mundohemi përmes shefave të grupeve parlamentar ta konkludojmë një debat të suksesshëm gjatë tërë ditës. Unë mendoj se një pjesëmarrje gjatë tërë kohës i jashtëzakonshëm. Tani janë 92 deputet në sallë, çdo qeveri, çdo organ vendimmarrës që do të duhej të hynte në proces vendimmarrjeje do t'i shfrytëzonte bollshëm këto diskutime dhe këtë debat. Unë e kam një mendim të grupeve parlamentare, megjithatë do të doja që profesor Gashi një fjalë apo dy, Gjylnaze, Mahir, Thaqi e tha dho në emër të Orës kush të dëshirojë.

### **ALUSH GASHI**

Inderuar z. Kryetar i Kuvendit.

Në fillim të seancës së sotme ke miratuar rendin e ditës dhe kemi hyr në obligim që ta shqyrtojmë këtë projekt. Grupi jonë parlamentar përmes një numri të konsiderueshëm të diskutuesve i ka dhënë pikëpamjet e veta për të cilat mendojmë se Qeveria do të përfitojë. Ne nuk e shohim të arsyeshme që të kemi ndonjë rekomandim tjetër, besojmë se edhe një numër i deputetëve që ka pasur mirëkuptim që t'i dorëzoj diskutimet në formë të shkruara do t'i ndihmoj Qeverisë në një gjetje të një rruge sa më të mirë. Ne jemi marrë me proces, ne e kemi mbështetur procesin, por ne kemi qenë edhe shumë korrekt që nen pas nenit t'i shtrojmë pikëpamjet tona. Ju faleminderit.

### **GJYLNAZE SYLA**

z. Kryetar, i nderuar z. Kryeministër, i nderuar ministër Haziri.

Unë ju falënderoj në emër të grupit parlamentar për informatat shtesë që na i dhatë, por gjithashtu mendoj dhe shprehem në emër të grupit parlamentar se ka qen një debat i frytshëm dhe presim nga Qeveria që ky debat të merr rekomandimet e nevojshme për kryerjen e punës së vetë. Gjithashtu apelojmë te ju që të shtoni dinamikën e punës.

### MAHIR JAGXHILLAR

Edhe ne si grup 6+1 jemi tē mendimit se ka qen një debat i dobishem. Mendimi i grupit është që Qeveria nga ky debat mundet me i nxjerrë konkluzionet ose rekandiminet nga ky debat.

### VETON SURROI

Ne po ashtu dhe kemi thënë tē gjithë se e mbështesim procesin e reformës së pushtetit lokal. E falënderoj personalisht z. Haziri për shpjegimet plotësuese që i dha dhe me ato shpjegime ri përsëris qëndrimin tonë që jemi përfomimin e një grupei mbështetës në Kuvendin e Kosovës i cili reformën e pushtetit lokal e shef brenda reformës së përgjithshme kushtetuese. Sy dyti, kryeministri e bëri një presidencë jashtëzakonisht tē tresskshmë kur ceku se e ka tē drejtë që tē eksperimentoj me rregullimin territorial dhe me jetën kushtetuese juridike në Kosovë. Unë mendoj se ky parlament duhet t'i tregoj edhe z. Kosumi dhe çdo zyrtari tjetër tē Kosovës që nuk e kanë tē drejtë tē eksperimentojnë, nuk e kanë tē drejtë tē thyejnë ligjin dhe nuk e kanë tē drejtë tē veprojnë nëse nuk krijojnë legjitimitet politik. Çështja e tretë është se meqenëse kemi kësot presidencë i bashkangjitemi propozimit tē Partisë Demokratike që çështja e pilot-projekteve tē vihet në votë si çështje e thyerjes apo mos thyerjes së legalitetit në Kosovë.

### KRYETARI, NEXHAT DACI

Unë mendoj që tri grupet në koalicon ishin tē çarta, dy grupe po ashtu ishin tē çarta, prandaj mendoj që Qeveria duhet t'i merr tē gjitha idetë që janë shprehur sot nga pozita dhe opozita. Pozita nuk mendon se duhet nxjerrë vendim tjetër në bazë tē debatit tē sotëm sepse ishte vetëm shqyrtimi i programit tē Qeverisë për reformën e qeverisjes lokale.

### HASHIM THACI

Nuk është problemi këtu te autoriteti apo joautoriteti, çështja është tek parimi që jemi duk e diskutuar dhe tek çështja mjaft e rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e saj. Faleminderit për respektin është reciprok, por Partia Demokratike e Kosovës mendon se mbi 90% të diskutuesve tē tē gjitha partive politike ishin kundër pilot-projektit tē Qeverisë. Prandaj ne propozojmë që Qeveria ta térheq dokumentin, t'i merr rekandiminet e nevojshme dhe t'i kthej për diskutim dhe pëlqim përséri në Parlamentin e Kosovës. Çdo projekt i cili nuk e merr pëlgimin e Parlamentit tē Kosovës për qytetarët e Kosovës natyrisht edhe për tē gjithë opinionin demokratik do tē jetë jolegjitim, do tē jetë ilegal, prandaj ne kërkojmë edhe njëherë qysh sot tē qitet në votim ose Qeveria ta térheq dokumentin ose me marrjen e rekandimeve ta kthej përséri për diskutim në Parlament. Pra kërkojmë që propozimi i PDK-së Kosovës tē qitet në votim. Kjo është e drejtë demokratike dhe z. Kryetar kërkojmë që ta respektoni, kush është për, kush është kundër ose z. Kryeministër le tē zotohet se duke respektuar edhe rekandiminet shumë tē rëndësishme dhe shumë tē frytshme tē parlamentarëve tē Kosovës t'i merr këto rekandime dhe momentalisht ta térheq këtë dokument dhe tē sjell për diskutim përséri në një seancë tē afërt.

### KRYETARI, NEXHAT DACI

Unë e vlerësoj që është e drejtë e Grupit parlamentar dhe opozitës.

### ALUSH GASHI

Inderuari z. Kryetar. Ne dëgjuam debatin, dëgjuam edhe kryeministrin dhe ministrin dhe mendoj se porosia është e qartë. Qeverisë i nevojitet kohë që ta përpunoj këtë dokument në bazë të këtij debati, prandaj nuk e kuptoj fletën për deklarim përmes votës, sepse ne në rend dite kemi shqyrtimin, jo miratimin apo refuzimin. Ju faleminderit.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Unë dy herë e theksova që në rend të ditës është shqyrtimi, në emër të grupit parlamentar të PDK-së edhe opozita dhe pjesa tjeter kërkon unë jam i obliguar me e rrespektu rregulloren dhe jo me votu për aprovimin e pilot-projekteve se nuk e kemi edhe shqyrtimin, prandaj, urdhëro Fatmir

### **FATMIR SEJDIU**

Më duket se ideja është e përputhshme edhe ajo që u diskutua së fundi, apo që ishte një rezume e qëndrimeve për një zotim të mëtejshëm në përpunimin e dokumenteve. Gjithë debati ishte një debat në mbështetje të procesit, i gjithë debati ishte i përcjellur me vërejtje konkret të cilat u pranuan edhe nga ana e ministrit dhe nga ana e kryeministrit dhe pikërisht këtë që e shtroj z. Gashi më herët është se Qeveria ka nevojë që të përpunoj këto argumente, ta rishikoj këtë tekst të debatuar kësi soj dhe në një mënyrë të ecë në versionin e mëtejshëm, natyrisht duke pasur parasysh një pëlqim të mëvonshëm të Kuvendit. Çka është ajo që nuk mund të jetë në rregull tash nëse merret i parcializuar dokumenti i ofruar pa pjesën e vërejtjeve të cilat nuk janë pjesë e inkorporuar nuk mund të hidhet në votim dhe nuk është në rregull.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Unë mendoj se lodiha e ka bërë të veten, Propozimi është i çartë, tre grupet parlamentare propozojnë që janë në pozitë që Qeveria me vëmendje t'i analizoj dhe t'i inkorporojë debatin e sotëm që ishte i bollshëm dhe konstruktiv dhe një grup parlamentar decidivisht kërkon votim, prandaj ju lutem unë duhet të përqendrohem edhe në procedurë.

### **HASHIM THACI**

Z. kryetar, të nderuar deputet, isha shumë i qartë ne jemi në favor të procesit, por shumica e deputetëve në Parlamentin e Kosovës ishin apo kishin vërejtje shumë të trepta ndaj Projektit, për këtë arsy ne kërkojmë që të gjendet një zgjidhje konsensuale mund të them që Qeveria të tregoj vullnet të mirë, të tërheq publikisht këtë projekt dhe t'i merr rekomandimet që u dëgjuan këtu. Në qoftë nevoja të diskutohen edhe në të ardhmen dhe në të ardhmen shumë të afërt të hapet përsëri diskutimi për projektin që do ta sjell Qeveria dhe ta merr pëlqimin e Parlamentit. Dy grupe parlamentare janë në favor që të votohet për projektin apo kundër projektit, prandaj ose të votohet ose le të gjendet një zgjidhje e mesme që Qeveria publikisht ta tërheq këtë dokument.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Është dallimi esencial. Dallimi është i skajshëm, pozita nuk kërkon që të aprovohet sot dhe t'i jepet tjetër e gjelbërt. Z. Thaqi, pozita nuk kërkon që sot të aprovohet projektit për reformën e qeverisjes lokale, prandaj ne themi se kemi patur vetëm shqyrtim dhe debat, ju kërkon që të votohet dhe të hidhet ose të aprovohet.

### **HASHIM THAÇI**

Ju lutem, ose tē hiqet publikisht nga Qeveria, tē merren rekomandimet qē u dēgjuan këtu, tē plotësohet, tē sillet përsëri pér diskutim dhe tē merr pëlqimin e Parlamenti të Kosovës dhe asgjë tē keqe nuk ka këtu. Nëse kjo nuk kalon qē ishte një propozim i mesit apo i kompromisit i koncenzusit ose ky dokument qē tē jetë legjitim duhet ta marrë pëlqimin e Parlamentit, me qē shumicën e koalicionit e ka nē parlament le tē hidhet nē votim.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Unë jam shumë i çartë, pozita nuk është e mendimit qē ky dokument sot duhet ta merr notën kaluese si i tillë komplet, nuk është pér tē vendosur qē tē hudhet, prandaj ju keni dallim shumë tē madh substancial.

### **NEKIBE KELMENDI**

Unë e kuftova z. Thaçi, pak është kundërthënës, propozimi i parë i tij është qē tē tërhiqet dokumenti, propozimi i tretë është tē përpunohet dokumenti dhe tē sillet nē Parlament qē do tē thotë se edhe këta dakordohen qē dokumenti tē përpunohet dhe pastaj tē sillet nē Parlament dhe tē diskutohet përsëri qē do tē thotë se nē tē njëjtat gjatësi valësh jemi tē gjithë, qē tē përpunohet dokumenti dhe tē nxirret nē debat përsëri, nē bazë tē vërejtjeve qē janë dhënë.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Pr. Gashi, Gjylnaze Syla dhe Mahir Jakxhillar ishin decidivisht tē çartë, i rekombinohet Qeverisë qē ta analizojë debatin mirë t'i merr nē punën e mëtejshme tē gjitha vërejtjet, sugjerimet qē u bën nga ky debat dhe kjo është krejtësisht tjetër qē prapë tē vijë dokumenti nē Parlament, nē Parlament duhet tē vijë sipas qëndrimeve tē grupeve parlamentare, kur Qeveria donë me hy nē proces dhe e tha ministri qē ishte shumë i çartë qē brenda tri vjetësh, dhe fillim nuk mund tē ketë para statusit qē ishte recidiv, prandaj ju lutem grupet parlamentare janë tē çarta, ju keni tē drejtë me insistu nē qëndrimet e juaja.

### **VETON SURROI**

Edhe unë pajtohem se duhet tē ndërtojmë koncenzus dhe do t'i bashkëngjitesha plotësisht z. Gashi, z. Jagxhillar dhe znj. Syla dhe z. Thaçi, d.m.th nuk ka kurrfarë dyshimi qē ja besojmë Qeverisë z. Haziri personalisht qē t'i marrë rekombinimet tona t'i shqyrtoj dhe t'i kthej mbrapa. Ajo qē është diskutabile e vëtmja gjë diskutabile është zotimi i kryeministrit se donë tē shkoj tē implementoj programe pa respektim tē ligjit, pa respektim tē ligjit ne nuk mund t'i japi vizë. Çështja është pilot-projektit me apo pa ligj dhe kaq, si parlamentar nuk mund tē shkelim zotimin qē kemi dhënë si anëtar tē Kuvendit tē Kosovës se do t'i respektojmë ligjet e Kosovës.

### **KRYETARI, NEXHAT DACI**

Ne kemi harruar qē Qeverinë e ka zgjedhur ky Parlament dhe ashtu si e ka zgjedhur mund edhe ta abrogon ose ta ndërroj, prandaj edhe pas krejt vërejtjeve dhe sugjerimeve nē Programin e Qeverisë, pas krejt sugjerimeve tani. Në qoftë se një qeveri nuk ka sens me inkorporu e merr automatikisht përgjegjësinë e saj qē tē shtronhet përgjegjësia jo vetëm nē interpellancë por edhe nē ndërrime, prandaj unë kamë pasur takime intensive nē këtë kohë me grupe parlamentare me tē gjitha forcat e mundshme. Unë po ju them me përgjegjësi tē plotë qē asnjë Qeveri nuk do tē mund t'i ikte një debati tē këtillë dhe tē mos merrte dhe inkorporonte çështjet, prandaj ju lutem nē rend dite është pranuar shqyrtimi dhe ky Kuvend duhet t'i nxjerrë tē gjitha ligjet nesër. Prandaj jemi nē një fazë jo vetëm tē vëzhgimit por edhe tē nevojave tona shumë imediate pér

përkrahje vendore dhe ndërkombëtare dhe këtë nuk mund ta kontestoj askush. Unë i kuptova propozimet e juaja shumë çart dhe Qeveria është këtu.

#### HASHIM THACI

Z. Surroi e tha shumë çartë, duam një procès të ligjshëm apo jo të ligjshëm, personal apo institucional, prandaj ne jemi për projekt të ligjshëm me ligj dhe institucional, por në të njëjtën kohë pasi që tash për tash është e pamundur nxjerja e një ligji për reformimin e pushtetit lokal. Është e pamundur organizimi i një referendumi për reformimin e pushtetit lokal apo për decentralizimin me që nuk është arritur koncezusi politik në spektrin politik shqiptar dhe joshqiptar. Së paku atëherë Qeveria e Kosovës, këtu është ministri, ministri i pushtetit lokal të tregojnë vullnetin e mirë dhe kulturën politike të bashkëpunimit dhe jo të refuzimit, ky projekt dhe reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi nuk është çështje vetëm e Qeverisë, ne kemi përvjetorë të shteteve përreth ku nuk ka mund Qeveria vetëm me ecë. Ju mund të nxirri vendime të njëanshme por do të janë shumë të dëmshme për vendin, prandaj edhe besoj se nuk do t'i nxirri, por do të ishte me interes që z. Kosumi të zotohet që rekomandimet të cilat apo të nxirren nga diskutimet që u dëgjuan këtu, të merren seriozisht të studiohen të hidhen në letër të inkorporohen në Projekt dhe pastaj ky plotësim me këto rekomandime të sillet përsëri në Parlamentin e Kosovës ku do të diskutohet dhe do të finalizohej dhe do të merrte pëlgimin e Parlamentit.

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Ju lutem dhe jam i obliguar t'i qes propozimet e pozitës dhe të z. Thaqi, urdhëro edhe njëherë Alush.

#### ALUSH GASHI

Inderuari kryetar, mendoj se jo vetëm grupi jonë por asnjë deputet në Kuvendin e Kosovës nuk është për shkeljen e ligjit, prandaj çështja e shkeljes së ligjit a ka mbështetje apo nuk ka mbështetje nuk është çështje e diskutimit. Ne konsiderojmë se askush nuk duhet të jetë mbi ligjin dhe nuk përkrahim shkelje të ligjit. Më lejonë të ri përsërisë ne kemi ardhur sot këtu për me shqyrta një projekt që ka dalur nga Qeveria. Ne kemi shqyrtaat atë projekt dhe mendojnë se Qeveria ka mjaft hapësirë që të merr mësimë nga debati i sotëm. Fatmirësisht Qeveria mund t'i drejtohet këtij Kuvendi aq sa të jetë e nevojshme, por edhe ky Kuvend mund ta fton Qeverinë për këtë çështje edhe për shumë çështje tjera sa herë të jetë e nevojshme, sepse ja mundëson mënyra e punës në këtë Kuvend. Andaj z. Kryetar konsiderojmë se ne sot e, kemi shter këtë pikë të rendit të ditës, nuk ka nevojë të na ftoni në votë dhe të jetë një ndarje artificiale lidhur me këtë çështje.

#### KRYETARI, NEXHAT DACI

Unë po e konsideroj si çështje të myllur, opozita është përqendruar në propozimin e vetë e kërkova mendimin e pozitës.

(Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, bashkëngjiten diskutime të deputetëve të dorëzuara në formën me shkrim – (disa të përshkruara nga originali, disa të kopiuara me anë të skenerit kompjuterik)

**DEPUTETI SADUDIN BERISHA: (Diskutim i dorëzuar në formë të shkruar)**

I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër i ministra të Qeverisë, të nderuar koleg deputetë,

Tema për të cilën debatohet në këtë seancë plenare të Kuvendit është debatuar dhe sot diskutohet në qarqe e nivele të ndryshme, qoftë si një nevojë për ofrimin e pushtetit dhe shërbimeve të saja më afér qytetarit, qoftë si një nevojë e përmbytjes së standardeve apo si çështje e një procesi të domosdoshëm si nevojë për reformimin apo të riorganizimit të qeverisjes lokale, i cili proces edhe sot ndodh në vazhdimësi edhe në vendin me një demokraci në të avancuar dhe me një zhvillim më të lartë ekonomike.

Duke pasur parasysh proceset nëpër të cilat po kalon Kosova sot, progresin e arritur por edhe vështësit me të cilat përballet sot me një zhvillim të ultë ekonomik, papunësi ekstreme etj. Dhe procesit para final të definimit dhe rjobjes së shtetësisë së Kosovës si etnitet i ri i barabartë ndërkombëtar, qytetarët për interesin e të cilëve mendohet t'i hyhet këtij procesi të reformimit të qeverisjes lokale me të drejtë parashtrojmë pyetjet e shumta me përgjigjeje se çfarë është ky program, a ka mbështetje përkatësish bazë juridiko – kushtetuese, që ofron ky program dhe cili është interes i vetë qytetarëve me këtë rast, cilat janë përfitimet a siguron efikasitet dhe shërbime më të mira, a siguron zhvillim ekonomiko-social të komunave apo të njësive komunale, a siguron dhe a krijon efikasitet në proceset nëpër të cilat sot kalon Kosova dhe me të hyrat buxhetore aq sa janë sot në Kosovë, cila është kostoj finaciare e një programi të tillë dhe a është i përballueshëm për tu realizuar suksesshëm këtë program reformash për qeverisje lokale etj. Këto brengë dhe pyetje të shumta, kërkijnë përgjigjeje të drejta nga ne, para se gjithash si përfqësues të tyre në Kuvendin e Kosovës.

Nga e gjithë anë kam nxjerr një vlerësim me disa konstatime rrëth nevojës për reforma të pushtetit – qeverisjes lokale, programit të ofruar nga qeveria e mëparshme, e ish kryeministrit Bajram Rexhepit të muajt korrik 2004, dhe i mbështetur si proces edhe nga Qeveria e tanishme i z. Kosumi me dizajnimet e bëra shtesë të programit për qeverisje lokale të miratuar që në korrik të vitit 2004.

Të nderuar kolegë deputetë nevoja për reforma të qeverisjes lokale duhet të shikohen si një proces që merr kohë, angazhimet e shumta të kapaciteteve njerëzore materiale, studim të hollësishëm të kushteve dhe rrëthanave në të cilat do të ndodhin reformat dhe i gjithë kjo nxjerr konstatimin se ky proces nuk është i lehët, kërkon vlerësimin dhe çmimin që duhet paguar për një proces të tillë reformash, duke ditur faktin se edhe në vendet me një demokraci më të avancuar qeverisëse dhe zhvillim të lartë ekonomik kanë vështësi të këto procese të avancimit dhe funksionimit më të mirë të pushtetit lokal, andaj këto procese edhe sot vazhdojnë në këto vende. Kjo lënë hapësirë për të kuptuar se ky proces kërkon kohë dhe mund edhe më shumë te ne në Kosovë, jo se nuk dëshirojmë që ky proces të ndodhë sa më shpejtë.

Sa i përket programit për reformat e qeverisjes lokale këtë që e kemi ne para Kuvendit, nuk mjafton vetëm dëshira e mirë për reforma, por, kërkohet edhe baza mbi të cilën mendohet ti qasemi këtij procesi, që mendoj që ky projekt pasqyron pikërisht këtu çalon së pari:

- ky projekt program, sipas meje nuk ka bazueshmërin juridiko-kushtetuese mbi të cilën mendohet të realizohet, sepse as korniza kushtetuese në fuqi një mundësi të reformat e kësaj natyre nuk e mundëson, çka nënkuption domosdoshmërinë qoftë të ndryshimit të kushtetutës aktuale e pse jo edhe të nxjerrjes së Kushtetutës së re të Kosovës, në të

kundërtën ky program dhe çdo program tjetër mbi këto baza do t'i ngjajë një grupi pa kohë.

Për realizimin e një programi të tillë reformash të qeverisjes lokale nuk mjafio vetëm ndryshimi apo edhe një Kushtetutë e re e Kosovës nëse nuk do të nxirreshin edhe një sërë ligjesh sistemore që kanë të bëjnë me qeverisjen e pushtetit lokal; si ligjet mbi ndarjen dhe organizimin territorial të komunave, ligjet mbi qeverisjet lokale etj. Këtë e bënë edhe më të domosdoshme sepse edhe sot pas zgjedhjeve të dyta komunale, - komunat e Kosovës organizohen dhe funksionojnë përmes një Rregulloreje për qeverisje lokale 2000/45 të UNMIK-ut, akt që është tejkaluar dhe është pengesë për qeverisje të mirë dhe efikase të pushtetit lokal, sepse kapacitetet qeverisëse të komunave janë shumë më të mëdha se që aktualisht u ofrohet me aktet në fuqi.

Legjislacioni që duhet të miratohet në Kuvend, si organ më i lartë ligjvënës i vendit mbi këto baza duhet të siguroj efikasitet dhe qeverisje të mirë, e mbi të gjitha barazi për të gjithë qytetarët para ligjit, që ky legjislacion të parmundësojë ç'do reformim të qeverisjes lokale që mund të ketë për synim reformat mbi bazat e ndarjes etnike, religioze apo gjuhësore, të komunave apo të njësive komunale.

Programi për reforma ka shumë të meta, paqartësi e defekte të natyrave të ndryshme, kështu që këto do të eliminohen vetëm atëherë kur qeveria përmes Kuvendit do të siguron kushtetutshmérinë dhe bazën ligjore sistemore për qeverisjen lokale.

Unë e shoh si nevojë dhe proces që duhet të ndodhë në Kosovë si në regjion reformimin e qeverisjes lokale për interesat qytetare që ka kjo qeverisje në menyrë që t'i ofrohet sa më afër qytetarit për të plotësuar nevojat e tij sa më mirë. Vetëm mbi këto baza mund të kemi qeverisje të mirë dhe qeverisje të vendosur ekskluzivisht për përbushjen e interesave qytetare. Ju faleminderit.

#### DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA: (Diskutim i dorëzuar në formë të shkruar)

I nderuar kryetar Daci, te nderuar kolege deputete,

Shume shtete demokratike ne bote, jo vetem vendet e raj onit, janë percaktuar për qelsin e modelit administrativ që paraqet decentralizimin e pushtetit dhe bartejn e tij ne nivel lokal, dhe natyrisht per kete vendos vet shteti perkates me mekanizmat e vet, me qellim te permiresimit te jetes se qytetareve që eshte edhe synim i Kosoves.

Personalisht, une e perkrah procesin e reformimit te pushtetit local, respektivisht decentralizimin. Por, mendoj se permbytja e këtij tekstit te cilin e kemi marre nga Qeveria per reformimin e pushtetit lokal duhet të jete rezultat i strategjisë nationale te Kosovës të cilën duhet ta percaktoje ky Kuvendi, si institucion i dale nga vota e lire e qytetareve të Kosovës, e i cili pastaj do të autorizoje Qeverine dhe institucionet e tjera relevante të punojne ne realizimin e këtij procesi. Procesi i decentralizimit është kuptimin e vet te fjalës e as me dokumentet perkatese nderkombetare nuk nenkupton krijimin e komunave te reja, sepse kjo u takon proceseve te tjera zhvillimorete shoqerise.

Ne vendet demokratike qellimi i decentralizimit të pushtetit eshte që të shfrytëzojen mundesite maksimale per të pershtate veprimtarite komunale me kushtet lokale ekzistuese dhe specifikat e tyre. Ne kete menyre veprimtarite komunale do të mundesojne shfrytëzimin e resurseve ekzistuese ne menyre sa me efektive dhe ne kete menyre do të ju permiresojne kushtet e jetes se qytetareve të vet. Per nje funksionim me të mire ne kushte të shtetëve normale, zakonisht ministria e financave duhet ta kete perjegjesine per ligjin komunal, ne menyre që te krijohet rapporti i drejt vertikal funkcional i sistemit shoqeror shteteror. Qellimi veprimtarise se

ministrise se financave do t'd ishte qe t'd ruhet dhe te zhvillohet veteqeverisja komunale duke respektuar qellimet nationale t'd vendit, t'd cilat i vendosin Kuvendi dhe Qeveria e Kosoves. Me duhet ta them se ne vendet demokratike ku procesin e decentralizimit e konsiderojne si proces shume t'd rendesishem t'd demokracise, nuk behet ndonje precizim i ndajes se detyrave ne mes shtetit dhe komunave ne kushtetuten e vendit. Kurse per ndarjen e detyrave ne mes t'd shtetit dhe komunave vendet me pervoje ne demokraci thone publikisht dhe ne dokumente t'd shkruara, se ndarja e detyrave ne mes t'd shtetit dhe komunave eshte qeshtje parimore dhe praktike. Decentralizimi si proces mundeson qe ndarja e detyrave ne mes t'd pushtetit qendror dhe atij lokal te ndryshoje me kohen ashtu si zhvillohet edhe shoqeria, pra ne hap me zhvillimin shoqeror. Ne ne Kosove jemi te detyruar qe ne te njejten kohe te punojme ne dy drejtime. Ne drejtim te konsolidimit te pushtetit qendror me te gjitha kompetencat dhe perjegjesit dhe reformimit te pushtetit local qe nuk ndodh ne vendet te cilat insistojne ne kete forme te decentralizimit ne Kosove.

Kuvendi dhe Qeveria e Kosoves duhet te kene kompetencia te plota dhe perjegjesi, per te vendose vet per qellimet nationale, ashtui si veprojne vendet tjera, ne menyre qe te krijohen mundesite normale per me i caktu edhe veprimtarie e komunave me ligje dhe norma juridike. Vetem funksionimi i tille qendror mund te percaktoj e kushtet per veprimtarine e komunave si dhe ndarjen e detyrave ne mes te pushtetit qendror dhe komunes.

Deshiroj te them se pushteti lokal ne Kosove edhe ne kushtet ekzistuese funksionon dhe ne perjithesi eshte ne funksion t'd mire te qytetareve te Kosoves. Kete e them nga fakti se ne Kosove punojne nje numer i madh organizatash joqeveritare te shtrira ne gjith teritorin e Kosoves. Keto organizata kane mundesuar organizimin e qytetareve ne grupe dhe ushtrojne e aplikojne demokraci lokale ne gjithe Kosoven, pa dallim perkatesie etnike. Nga kjo rrjedh se qytetaret e Kosoves tanime e kane pranuar nje lloj decentralizimi ne Kosove sepse jane te organizuar neper shoqata e organizime te tjera jo qeveritare ne vendet ku jetojne d'je veprojne qe ne fakt, keto shoqata paraqesin demokracine joformale dhe vullnetin e te gjit "stareve te organizuar ne kete menyre ne te gjitha komunat, pa dallim perkatesie etnik. Demokracia lokale eshte gjithashu nje proces i gjate, por i cili tanime ka filluar dhe t'd njejtin duhet shpij perpara ne te mire te te gjith qytetareve te Kosoves. Ju faleminderit

#### DEPUTETI SHABAN HALIMI: (Diskutim i dorëzuar në formë te shkruar)

I nderuari zoti Kryetar, zoti Kryeminister, ministra, te nderuar koleg deputet, Dokumentin te cilin e kemi ne shqyrtim i emruar si Dokument Korniz i Reformimit te veteqeverisjes lokale ne Kosove, eshte i nje rendesije te veqant, per vet faktin qe ka per qellim ofrimin e sherbimeve me afer qyteteareve me qka dhe kontribuohet ne sigurimin e nje qeverisje me te qendrueshme dhe kushte me te favoroshme per qyteterin Kosovare, nese pas ketij qellimi nuk qendron ndonje qeshtje tendencioze. Dokumenti korniz i punuar nga Grupi punues ne perberjen e te cilil kane qene te perfshira institucionet relevante, asocacionet, ekspertet nderkombetar dhe pushtetet lokale me baze te gjer, na bene qe te kuptojme se jane shfrytezuar te gjitha mundesit qe ky document te jete sa me i kompletuar dhe permbajtesor per te percaktuar Rregullat e Reformimit te Veteqeverisjes locale. Ne baze te ketij Dokumenti Korniz kemi dhe Programin e punes per vitin 2005 per fillimin e implementimit te Veteqeverisjes locale. Qe te dy keto Dokumente bejne teresin e detyrave, obligimeve dhe aktiviteteve qe duhet te ndermerren per fillimin e puneve rrethe Reformimit te Veteqeverisjes locale.

Te nderuar koleg deputet, rrjedhen e iniciativave per Reformimin - Decentralizimin ne fjale e kemi te njojur, gjithashu diskutimet dhe debatet e zhvilluara pro dhe kunder, por tanjemi ne fazen kur duhet te debatojme per dokumentet ne fjale dhe te japim mendimet tona.

Ter kete iniciativ e kam kuptuar si proqes ne vazhden e shume proqeseve te cilat po zhvillohen ne Kosove e qe nuk mund ta kuptoj ndryshe pos si plotesim te kritereve apo standardeve qe duhet ti plotesojme per te qene pjese e Bashkimit European dhe Aleances Veri Atlantike dhe si qytetare te barabart per te shfrytezuar vlera dhe per te dhene vlera me interes per qytetaret e ketyre bashkesive e ndoshta dhe me gjere. Prandaj si proces te tille e mbeshtes dhe do te jap kontributin tim individual si qytetare, ne grupin parlamentar dhe ne komisionin ne te cilin gjendem.

Pavarishte nga vuullneti i shprehur; dhe kam rezerva per te cilat mendoj se mund te pengojne gjate implementimit te procesit te Reformimit te Veteqeverisjes locale. Ne kete drejtim kam patur parasysh debatet qe mund te zhvillohen nga ana e deputeteve per qeshtje te caktuara nga profesioni dhe pervoja qe kane, dhe jame perqendruar ne qeshtje per te cilat kam bindjen se mund te jap kontributin tim.

Rezervat e mia i mbeshtes ne dy qeshtje per te cilat mendoj se jane esenciale per sukseset e deshiruara te Reformes se Veteqeverisjes locale dhe ate:

Nen nje - mbeshtetja financiar e projektit dhe

Nen dy - qvesha e Komunave e neser dhe Njesive nenkomunale nga prona.

Sa i perket te pares, ne Dokumentin Korniz ne faqen 12 pika 9 dhe ne Programin e punes ne faqen e 4 eshte theksuar se Mjetet e nevojshme bugjetore do te jepen nga BKK dhe mjetet shtes nga Bashkesija nderkombetare, nj eherit dhe pregaditj a e ligj it gj i theperfshires mbi financat locale, brenda mundesive paralelisht me ligjin per Vetqeverisjen lokale, mendoj se kjo eshte e qendrueshme, sepse si njeri ashtu edhe tjetri ligje plotesojne njeri tjetrin dhe materien e bejne me konkrete. Mirepo, ne dokumentet e mesiper permendura nuk ka asgje me teper - lidhur me numrin e Komunave qe plotesojn kushtet per te qene komuna-, ne vete, numrin e Njesive Nen-komunale, infrastrukturen e nevojshme apo te domosdoshme dhe mjetet e nevojshme financiare qe prej fillimit t implementimit te Reformimit ne pes Pilot Komuna dhe pese njesi Nenkomunale e deri ne perfundimin e projektit me o 1.01.2008.

Ndoshta me nxjerrjen e dokumenteve tjera keto qeshtje do te sqarohen por per momentin krij ohet pershtypj a se do te j et nj e mbingarkes per BKK kur injekti eshte i planifikuar gjeri ne vitin 2008 sipas Koprizes zhvillimore dhe nuk ka planifikim te dukshem te rritjes se te Hyrave Buxhetore aq me teper kur kerkasat per meje financiare jane ne shtim e siper me formimin e Ministrive te reja dhe institucioneve tjera te nevojshme ... Llogarija eshte e thjesht do te kemi me shume komuna e njesi komunale, me shume punetor me shum automjete zyrtare, adoptim te objekteve nese ka apo ndertim te objekteve te reja etj. Me qka dhe do te kemi dhpenzime me te mdha... sa komuna .... sa njesi Nen komunale....

Ndersa sa i perket te dytes, lidhur me objektet dhe pronen komunale eshte theksuarue faqen 9 pika 7 te DK mjft qarte se komunat duhet te luajne nje rro a iv nese beh- et prmatizimi i prones shoqerore apo publike dhe objekteve. Kjo Materije tanim me eshte e rregulluar me akte ligjore te cilat jane ne funksion, por ka ende hapsir qe te intervenohet ne kete drejtim dhe Komunave tu lihet ne dispozicion Hapsir e lire tokesore e pse jo edhe ndonje objekt ne pronesi te tyre. Me privatizimin e prones shoqerore dhe asaj publike shume Komuna mbeten pa asnjë meter kator te hapsirave toksore per planifikime afatgjate te zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturen tjeter te domosdoshme ku dhe mungesa e mjetave financiare per te bere eksproprijime dhe kompenzim te pronave, len komunat pa nje vision te qarte per planifikim strategjik te zhvillimit ekonomik dhe humbje te donacioneve per ndertim te objekteve kapitale per nevoja te Komunave dhe qytetareve te saj, shkolla, punkte shendetesore, qerdhe fermijsh, shteti kulture, qendra sportive, qendra rinore etj. Gjithashtu disa komuna nuk jane ne gjendje tu dalin ne ndihm shume iniciativave te bizneseve private per investime te reja dhe

per zgjerim te kapacitetve te tyre me qe nuk jane ne gjendje tu ofrojne hapsira ne pronen shoqerore apo publike etj .....

#### DEPUTETI YMER HALIMI: (diskutim i dorëzuar në formë të shkruar)

I nderuari kryetar Daci Kryeministri Kosumi Te nderuar ministra dhe deputete

Sa duket e kemi nj e teme mij aste te ndj eshme, shkak se ka te bej e me qytetarin dhe ka peshen politike me konatacione te ndryshme.

Pytja e pare qe e shtroj eshte: a) a eshte i nevojshem decentralizimi ne kete kohe kur:

- veprojne tre pushtete ne nje toke qe kerkon te jete shtet;
- a kemi pushet te centralizuar, te decentralizuar. Thjeshte a keme pushet?
- a do kete sukses reformimi i plishtetit me kete gjendje kaq te rende ekonomike dhe
- me kete jostabilitet te brendeshem politik ku lufta e te gjitheve per pushtete, ne -d
- nivel, eshte bere teper e tmerrsite. Ku, mjerisht pushteti u be privilegje i -do lloji, por jo edhe perjegjesi sepse ligjet nuk funksionojne!? Dhe pyetja e dyte:
- Decentralizimi eshte oferte politike qe atje ku dedikohet ka gjase qe te mos aprovohet (shqiptaret dhe serbet e Kosoves)?

Prandaj ky Kuvend s'pari le ta rrespsktoi ligjin e pastaj Id te veproi. Deputet te nderuar, Po te vepronim politikisht me mire, po te kishim rrethana me te favorshme ne Kosove, reformimi i pushtetit lokal do te permbshej ne menyre evolutive, sipas kerkeses se arsyeshme te qytetareve dhe rrethanave vendore. Tashti kerkohet te permbsuhet me nderhyreje, ta quaj cezarike, pa rrethanor perkates. Rezultati eshte stohastik dhe keshtu nuk vepron politika e mirefillt as demokracia mirefillt. Mbi kete qendron shqetesimi i njerzeve ne Kosove i ngritur nga jo pak dilema. Prandaj, sot ka vend per debat shterues e jo debat sa per sy e faqe. Besoj se kjo eshte e mireseardhur per Qeverine. Perpjekja e kujtdoqofte per anashkalim te debatit rezulton demshem per proceset demokratike ne Kosove.

Procesin e reformimit te pushtetit lokal e filloi Qeveria e kryeministrit Rexhepi dhe po e vazhdon qeveria aktuale e kryeministrit Kosumi, por jo me koncept te njejtë. E perbashkta e ketyre dy koncepteve eshte parcializimi territorial i Kosoves me dy parim: etnik e gjeografik, ne shtrirje horizontale, kurs reformimin i pushtetit dhe nivelet reformimit te vertikales se pushtetit, juridikisht eshte tersiht i pa determinuar dhe kjo eshte qensorja e nej decentralizimi. Ky empirizem pa pas Kushtetute eshte teper i panatyrshem.

Sa i perket decentralizimit ne baze etnike (serbe), ky ishte projekt i dikurshem edhe 1 shteti serb (mund t'i keni edhe dokumentet perkatese) prandaj kjo perputhshmeri na shqetson me jo pak arsy? Meqenese njohim prirejen etnocentriste te serbeve, veqmas ndaj shqiptareve, veshtire se nje decentralizimi i kesaj baze do te jete i arsyeshem. Me decentarlizim serbet nuk joshen me hyre ne institucionet e Kosoves se pasluftes, sepse synimi i tyre eshte mosskheputja e Kosoves nga Serbia, ose ndarja e Kosoves e jo demokratizimi i saj. Prandaj mbi kete baze dhe ne mbeshtetje td qarqeve te caktuara td bashkesise nderkombetare dhc sipas paaftesise se politikes vendore me plot sukses lidershipi i tyre po shantazhon.

Sa i perket "levizjes se lire" (po me duket e pakuptimt ta them) td serbeve te Kosoves me se paku eshte varur nga shqiptaret vendor. Ajo diligohet nga qendra jasht Kosove, por edhe nga perjegjesia kolektive e kombit td tyre dhe vete atyre per dhune e kime te bera ose heshtazi te aprovuara mbi shqiptare. Bile kjo i bend agresive, per ta shmange nderdijen e tyre nga kjo e keqe dhe me largaur vemendjen e qendrave td vendosjes, e qe ata td trajtohen si viktima. Ndersa shqiptaret vendor veqmas ata qe kane dhene me se shumti per Kosoven (antare te familjeve td tyre) apelojne per sigurin e levizjes se te gjitheve pa dallim, sepse ata dhe te dashurit e tyre luftuan ashtu si edhe td gjithe luftaret e lirise per universalen, per lirine e te

gjitheve. Prandaj me të drejtë mund të them se pilot-komunat nuk janë siguri e bashkësive etnike por zbatueshmeria e ligjeve univerzale dhe raspektimi i ndersjeti. Kjo është e mundur atehere kur heqet friga e të gjitheve ndaj të gjitheve. Kjo vertet mund të arrihet me pavarsimin e Kosovës. Kete duhet ta dijne të gjithe.

#### DEPUTETI GANI KOÇI: (Diskutim i dorëzuar në formë të shkruar)

(Komente lidhur me Projektin e Qeverisë per decentralizim)

Ne këtë dokument te Qeverise te titulluar "Reforma e Qeverisë Lokale- si Program i punës per vitin 2 005", përgjegjësi që është e kthyer, që nuk është shtet diskutuar asnjehere ne këtë Kuvend, ne aspektin teorik dhe praktik sikur janë ngaterruar nacionet. Ne dokumentin e afrouar, qeveria nuk e kupton akoma se që do të thotë decentralizim dhe që kuptohet me organizimin e pushtetit lokal ose vendor. Nuk j'ane keto sinonime të një era tjë etres. Qeverisja vendore është kategori kushtetuese, siq është kategori kushtetuese edhe ndarja administrativë territoriale. Ndërsa decentralizimi ne kuptimin e vete teorik nenkupton bartje të funksioneve të pushtetit qendror ne organet e njësive lokale veteqeverisese. Me dokumentin per decentralizim, a kemi bartje të pushteti nga niveli qendror ne atë lokal, apo po ndodhë territorializimi, ne emer të decentralizimit.

Ne Kosovë procesi i decentralizimit nuk po behet me qellim per t'ju afrouar sa me shume sherbime qytetareve, per vi bere atë faktor të vendosjes per interesat e tyre, per ta shkurtuar rrugen e tyre të komunikimit me pushtetin qendror, por është perpjekje per dezintegrimin e territorit te Kosovës mbi baza etnike.

As Dokumenti Kornize dhe as ky i qeverisë se sotme nuk është bere mbi bazën e studimeve teorike, nuk është mbi bazën e analizave të realitetit të tashem dhe të ardhmes se Kosovës, nuk është bere mbi bazën e praktikave të deritashme, ne menyre që si projekt te ishte shoqerisht dhe politikisht i pranueshëm dhe i pershatshëm, profesionalisht i arsyeshëm, organizativisht funksional dhe financiarisht i perballueshëm..

Ky projekt nuk i hap etnititetet por i mbyllë ato. Vet fakti i krijimit te njësive te reja komunale mbi baza etnike (Kete nuk është as dokumenti Kornize dhe as Rekomandimet e Keshillit te Evropes), si kriteri te vetem me të cilin është shërbuer qeveria, tregon jo per hapjen dhe integrimin e etniteteve por per mbylljen e tyre ose legalizimin e enklavave. Ky synim i qeverisë nuk ka të bez me decentralizimin, por ka të bez me ndarje të re administrative-territoriale. Ne fund te fundit si mund te kuptohet bartja e kompetencave dhe perjegjesive në nivele lokale kur ato ende nuk janë bartur në nivelin e institucioneve qendrore te Kosovës. Si mund te kemi decentralizim kur akoma nuk kemi pushtet dhe centralizim në nivel qendror. Ose kjo është perpjekje per të veshur me pushtet komunat etnike para se ai pushtet nga UNIVIK-u te kaloje ne institucionet qendrore te Kosovës.

Nëse pilot projekti per decentralizim është një eksperiment si e ka quajtur kryeministri ne një deklarim te tij publik, atehere pse eksperimentohet fillimi i shtetit me komuna te reja etnike. Pse nuk është filluar nga psh. Dardania si njera nga pjeset me të medha te qytetit te Prishtines, por ka kaluar ne Graçanicë. Pse eksperimenti nuk është bere ne vet qytetin e Prizrenit por ne Mamushe.

Kjo tregon se nuk është perfill kriteri i numrit te banoreve si një nga kriteret per ndarje te reja administrative-territoriale dhe per decentralizim, nuk është perfillur kriteri i arsyeshmerise dhe qendrueshmerise ekonomike per njësitet e reja, nuk është perfillur kriteri gjeografik dhe al demografik, por per baze është marre vetem kriteri etnik. Kush do t'i bartë perjegjesitë dhe pasojat e deshtimit te eksperimenteve te tilla.

Nese ne pilotprojektin e Qeverise thuhet se kufijt komunal ekzistues nuk do te jene objekt shqyrtimi gjate pilot fazes, atehere cila do te jetë hapësira territoriale e pilot komunes se Graqanices, Hanit te Elezit apo Parteshit. Prej dhe deri ku, ne kuptimin territorial do ta shtrijne pushtetin e vet keto pilot komuna. Cilat do te jene kompetencat e Prishtines, Gjilanit ose Ka-anikut si komuna baze mbi pilot njesite komunale te reja.

Nese ne dokument thuhet se njesite komunale do Vi kene te njejtat kompetencia si edhe komunat ekzistuese dhe se do te ushtrojne pushtet rregullativ dhe administrativ pavaresisht nga pilot komuna, a nenkupton kjo decentralizimin apo diqka tjeter? Nese me pushtet administrativ perveg tjerash kuptojme, edhe policine, a do te thote kjo se pilot njesite komunale do te kene policine e vet pavaresisht nga pilot komunat dhe ne anen tjeter ky segment i sigurise a do te kaloj drejtperdrejt ne kompetence te pushtetit lokal para se kjo te behet ne nivel qendror. ¶

Kjo tregon se bartje, ose perfolja per bartje te kompetencave nga LJNMIK-u tek vendoret eshte vetem provizore dhe se kjo bartje nepermjet te procesit te decentralizimit drejtperdrejt po tentohet te kaloj ne nivele lokale dhe se pushteti qendror ende pa u veshur po zhveshet nga kompetencat dhe perjegjesite. Konsideroj se reforma e Qeverisjes Lokale dhe decentralizimit do te duhej te bazohej ne rekomanimet e keshillit te Evropes, ne Karten Evropiane per Qeverisjen Vendore, ne njohurit teorike dhe praktikat e deritashme dhe se me pilot projekte te orientohej ne formimin e njesive nenkomunale dhe jo njesi komunal si- eshte dhene ne pilot projektin e qeverise,

1. Perparesi do te duhej te kishin njesite nenkomunale multietnike e jo ato monoetnike, por qe nuk do te duhej te perjashtoheshin ne teresi,
2. Do te duhet te behej kalm i pushtetit ne vijen vertikale dhe jo si- pretendohet tanj,
3. Do te duhej se pari te perqatiteshin ligjet per organizimin ose riorganizimin e "administrativo-territorial respektivisht Ligji per ndarjen administrativo territoriale te n... es, pastaj Ligji per veteqeverisjen lokale, Ligji per organizimin e qyteteve te n... ma dhe sidomos per organizimin e qytetit te Prishtines dhe ligjet tjera te nevojshme per kete proces,

Po te veprohej keshitu atehere vertete do te arriheshin objektivat e deshiruar si: 1. Ngritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe jetës së qytetarëve në nivelet lokale; 2. Shkurtimi i rrugës së komunikimit të qytetarit me pushtetin; 3. Shpërndarjen e përgjegjësive në shumë shkallë, dhe individualizimi i këtyre përgjegjësive; 4. Ngritjen e rolit të vendimmarjes së qytetarëve; 5. Efikasitetin e administratës dhe shërbimeve; 6. Zhvillim të njëjtë në nivel lokal; 7. Integrat i etniteteve në shoqëri dhe institucionë; 8. Demokratizim i institucioneve dhe pjesëmarrja e drejtperdrejtë e qytetarëve në këto institucionë shoqëruive në

Menyra se si e Qeveria e ka kuptuar dhe e ka projektuar decentralizimin si proces qon drejt dezintegrimit te Kosoves ne kuptimin territorial, legalizimit te pushtetit parallel, "leopardizimi" ne kuptimin etnik i hartes se Kosoves dhe realizimit te planit te Beogradit per Kosoven. Qeshtja e decentralizimit ne menyren qe eshte shtruar, eshte nje presion dhe mision politik, dhe si i tillë ne këte faze, te statusit ende te pazgjedhur te Kosoves nuk besoj qe do ta favorizonte zgjidhjen e dejte te ketij statusi, mbi bazen e vullnetit te shumicës se qytetareve te saj. Zgjidhja e drejt e statusit te Kosoves do te favorizonte dhe do te percaktonte qarte edhe decentralizimin si proces dhe si nevoje.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA: (Diskutim i dorëzuar në formën me shkrim)Pjesë e shkëputur për diskutim

Si rekomandim për Qeverinë: Decentralizimi nuk duhet kuptuar si e kundërtë e centralizimit, por një veprim që plotëson mangësitë e vetëqeverisjes lokale, që plotëson: afirmimin e një pjesëmarrje më të gjerë të qytetarëve në qeverisje; siguron një mirëkuptim për hallet dhe nevojat e qytetarëve; frenon proceset autoritare të pushtetit qendror; jep mundësi, favorizon strukturën dhe politikën tjera; afirmimin e një pjesëmarrjeje më të gjerë të qytetarëve në qeverisje; siguron një mirëkuptim për hallet dhe nevojat e qytetarëve; frenon proceset autoritare të pushtetit qendror; jep mundësi, favorizon strukturën dhe politikën tjera; siguron shërbime më të efektshme; krijon ndjenjën e bashkëjetesës dhe bashkëveprimit; krijon lidhshmëri të shoqërisë civile dhe pushtetit.

Ka shqetësimë të arsyeshme se kjo nisëm është e domosdoshme për minoritetin serb. Qasja kryesishët e tillë, jo e drejtë, favorizon pushtetet ekzistuese paralele duke i legalizuar dhe arsyeton keqëverisjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI: (Diskutim i dorëzuar në formën me shkrim)

Si duhet kuptuar decentralizimin? Procesin e decentralizimit a duhet kuptuar si një nevoje e përmirësimi te shërbimeve administrative dhe te tjera për qytetarin, si një transferim i kompetencave dhe te përgjegjësive tek pushtetet komunale me qellim te trajtimit sa me te mire te nevojave te qytetarëve apo edhe njérën edhe tjetrën?

Për mendimin tim decentralizimi nënkupton edhe njérën edhe komponentin tjetër, por me prioritet te bartjes se kompetencave tek autoritetet lokale duke ngritë rolin e pergjegjesise se tyre për përbushjen sa me te mire te funksionit te tyre ne te mire te qytetarëve.

Decentralizimi duhet te jete i atille qe ne fokus te zhvillimit te tij te ketë qytetarin dhe interesin e tij, dhe jo qasjet e tjera te cilat do te ndikonin ne zvogëlimin e rëndësisë se vete procesit.

Decentralizimi nuk është i lehte për t'u implementuar duke pas parasysh edhe përvojën tone ndoshta jo te mjaftueshme ne ketë faze, pastaj interesat e ndryshme sigurisht edhe politike, por edhe mungesa e legjisacionit baze për këtë proces (mungesa e ligjit për organizimin territorial-administrativ te komunave) dhe ne veçanti unë do te thoja shtrëngimet buxhetore përkatësish fondet e nevojshme për implementimin e tij. Ne duhet te sigurojmë faktorët se paku ata me kryesoret (fondet, ligjet, shkallen e rezikut, mundësítë, përparsësitë, pastaj faktorët ekonomik, politik etj.) nëse dëshirojmë qe ky proces te jete i suksesshëm. Nuk e konsideroj te arsyeshëm dhe te pëlqyeshëm faktin nëse faktori politik ose edhe ai etnik do te ndikonin këtë proces. Siç e thamë edhe me herët ne fokus te procesit duhet te jete qytetari.

Krijimi i njësive komunale (ndoshta për këtë faze me mire do te ishte te themi njësi te komunave) dhe me vone krijimi i komunave te reja ne rrjedhën e kësaj reforme për ato njësi komunale te cilat do te konsideroheshin si me te suksesshme (siç thuhet ne dokumentin baze) do te këtë implikime te konsiderueshme buxhetore dhe për këtë duhet te jemi te përgatitur. Kjo kërkon një analizë gjitheperftshirese shkencore profesionale, andaj

edhe konsideroj se decentralizimi është proces ne vazhdimësi i cili duhet te mbështetet por me kujdes.

Sipas parashikimeve te hyrat buxhetore vitin e ardhshëm do te jene me te vogla ne krahasim me te hyrat buxhetore te vitit ne e vijim dhe këtë parashikim buxhetor duhet marre me mjafte seriozitet.

Bashkësia ndërkombëtare duhet edhe me tej te ndihmoj ne mënyrë qe qëndrueshmëria buxhetore e vendit te jete me e madhc, dhe sidomos pjesëmarrja ne sigurimin e buxhetit per implementimin me sukses te procesit te decentralizimit. Ne këtë drejtum duhet te sigurohet se decentralizimi duhet te krijoj mundësi për veteqendrueshmeri te njësive apo komunave te reja dhe jo qe ato te bëhen barre e autoriteteve qendrore për një kohe te gjate.

Prandaj edhe zhvillimi ekonomik më i shpejte i Kosovës duhet te jete prioriteti ynë me i rendesishem me q'rast pastaj edhe do te krijoheshin kushte shume me te favorshme për mbështetje te proceseve te caktuara ne Kosove.

Përfundimisht, Decentralizimin duhet kuptuar si nje proces implementimi te plete i cili kërkon mbështetje afatgjate dhe efektet e te cilit duhet te ndikojnë ne përmirësimin e mirëqenies njerëzore ne përgjithësi.

#### **DEPUTETI MILAZIM HALITI: (Diskutim i dorëzuar në formën me shkrim)**

##### Reforma e pushtetit lokal

I nderuari z. Kryetar , i nderuar z. Kryeministre , Ministra , të nderuar Deputet .

Grupi punues per qeverisje lokale, ka hartuar kornizen per Reformen e Vetec Lokale ne Kosove dhe dokument kornize eshte adaptuar nga Qeveria dhe eshte mirep. Nga strukturat relevante lokale dhe nderkombetare. E konsideroi të rendesishem dhe të domosdoshem procesin e decentralizimit perkatesisht reformes se Pushtetit Lokal , drejt zbatimit të standardeve .

Me procesin dhe nevojen e reformes të pushtetit lokal, mundesohet qe geshtjet publike do te jene sa me afer qytetareve dhe nga niveli me ulet i Qeverisjes ne kryerjen e sherbimeve publike per qytetar , si parim i vendosur ne Karten Europjane të Veteqeverisjes Lokale .

Procesi i Reformes se Pushtetit Lokal nuk eshte i lehte i cili kushton dhe nevojiten mjete te konsiderueshme të cilat duhen të sigurohen nga buxheti i Kosoves , edhe pervoja e vendeve te tjera ne zhvillim tregon se ky proces eshte i veshtire qe të zbatohet menjehere si reforme e plete .

Prandaj eshte parapare pilot projekti i 5 njësive komunale. Eshte me rendesi zevendesimi i grupit punues qe do të behet me formimin e Bordit drejtues per Reformat e Qeverisjes Lokale , i cili do te mbikeqyre funksionimin dhe koordinimin e puneve duke dhene udhezime gjate procesit te zbatimit të reformes.

Krahas vleresimit se eshte i domosdoshem fillimi i reformes se pushtetit lokal , qe mund të nenkuptohet si nje nga standardet per zbatim , eshte shqetësues fakti i anashkalimit të institucioneve kur thuhet se themelimi i pilot njësive komunale do te behet me një e Urdherese administrative të PSSP para miratimit te Ligjit per Qeverine Lokale .

Pastaj perberja e Keshillit do te jete nga deputetet e kuveneve komunale ekzistuese sig thuhet , qe ne te njejten kohe ata mbësin edhe deputet te zgjedhur te kuveneve dhe ne kete rast kemi një dyfishim te funksioneve qe mendoj se nuk do te ishte ne rregull .

Pastaj eshte çështja e legjislacionit ku duhet rishikuar edhe 19 Rregullore te LINMIK-ut qe nga 21 Totori 1999 e këndej, si dhe një numër i Udhëzimeve Administrative . Duhet hartuar 12 Ligje të reja qe do te jene ne funksion të Reformës se Pushtetit Lokal .

Mbështetjen e fillimit te Procesit te Reformës se Pushtetit Lokal ne parim duhet kuptuar si një proces që do të zgjas dhe i cili nuk është i përkryer as ne shtetet me demokratike Ju faleminderit

**DEPUTETJA REMZIJE NIMANI: (Diskutim i dorëzuar në formën me shkrim)**

Zotëri Kryetar i Kuvendit, e nderuara qeveri zonja dhe zotërinj deputet.  
Sot po diskutojmë për një çështje shumë të ndjeshme dhe të rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Dokumentin për decentralizim, që e kemi para veti, duhet t'i qasemi në mënyrë parimore duke e kuptuar drejtë.

Me këtë dokument nuk paraqitet ndarja në vija etnike e as në enklavizim, por një çasje më e drejtë dhe më e afërt e të gjithë qytetarëve me pushtetin.

Decentralizimin e kuptojmë të tërësishëm pa privilegje dhe pa diskriminim të askujt, por vetëqeverisje lokale të avancuar ku populli i Kosovës është faktor. Përkushtimi i tij është drejtë realizimit të përbushjes së standardeve si pjesë e procesit.

Territori i Kosovës më afér 11 mijë km<sup>2</sup>, në përbërje të vetë përfshinë 30 komuna (5 apo 16,7% nga të cilat: Artana, Shtërpca, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi janë me shumicë të komunitetit serb).

Në Kosovë janë mbajtur 4 palë zgjedhje, dy për nivele komunale dhe dy të nivelit qendror.

Në këto zgjedhje pa marrë parasysh pjesëmarrjen e komuniteteve, vendet janë plus të rezervuara në të gjitha nivelet e kuvendeve, po ashtu edhe në postet ministrore në tri vende të rezervuara.

Secila nga 30 komunat ka statutin e vet dhe shtrirjen gjeografike. Përkundër kësaj e kundër edhe të vet votës së lirë e demokratike, e cila çdo kund respektohet dhe është e shenjtë, veprimet megjithatë janë toleruese dhe përkëdhelëse.

Në komunën e Mitrovicës serbët gjashtë vjet pas luftë dhe krijimit të realitetit të ri në Kosovë nuk janë pjesëmarrës në jetën institucionale edhe pse financohen nga buxheti i Kosovës, kanë të instaluar pushtetin paralel nga regjimi i Beogradit dhe janë peng të politikës destruktive të Beogradit që është i dëmshëm për vetë serbët e Kosovës.

Kërkohet që standartet duhet plotësuar të gjithë e jo vetëm shqiptarët. Shqiptarët, jo serbët dhe një pjesë e vogël e serbëve këtë e kanë kuptuar drejtë.

Në mesin e përbushjeve të standardeve janë: - Pacenueshmëria e kufijve të Kosovës, mbishkrimet, emëritimet, kthimi në pronat private, lëvizja e lirë etj.

Sot në institucionet komunale ku janë me shumicë serbe keqpërdoren institucionet ngase këto nuk respektohen, nuk respektohet as administrimi i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Mbishkrimet dhe emëritimet janë vetëm në gjuhën serbe, kurse lëvizja e lirë në pjesën veriore të Kosovës për shqiptarët, jo serbët dhe ndërkombëtarët është e vështirësuar.

Në rrugën Mitrovicë Prishtinë çdo ditë shoh automjete me targa të qyteteve të Serbisë dhe me regjistrim paralel si: K, PR etj. Që lëvizin pa kurrfarë përcjellje dhe të lirë. Por kjo nuk ndodh me tabelat legjitime: KS në veri të Kosovës.

Absurdi i këtyre ditëve është fakti që autobusët që bartin punëtorët dhe qytetarët n gjukatën e Mitrovicës dhe në "Kodrën e Minatorëve" janë me regjistre të huaja.

Kjo pazakonshmëri artificiale e kriuar është pa arsyeshme dhe e pa nevojshme për Mitrovicën dhe pjesën veriore të Kosovës. Ju faleminderit

**DEPUTETI FADIL GECI: (Diskutim i dorëzuar me shkrin - i përshkruar nga originali):**

Inderuar kryesues i Seancës, të nderuar kolegë deputetë,  
Është mirë që më në fund deputetët do të mund të debatojnë lidhur me çështjen e reformës së pushtetit lokal dhe se nuk do të jenë të limituar në informim varësisht nga tekot e Qeverisë Rexhepi ose të z. Krasniqi.

Sa i përket debatit lidhur me procesin e decentralizimit, unë jam plotësisht i bindur se është një domosdoshmëri dhe se një debat i tillë konstruktiv në këtë Kuvend do të kontribuojë në gjetjen e alternativës më të mirë të riorganizimit të pushtetit lokal, në mënyrë që i njëjti të jetë në funksion të plotë të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Para vites kemi Projektin e Qeverisë mbi reformën e pushtetit lokal, i cili projekt ka fare pak për mos me thënë shumë - shumë pak dallime me projektin e Qeverisë Rexhepi, iniciativën për decentralizim, përkatesisht për qeverisjen lokale të nisur dhe propozuar nga Qeveria Rexhepi. Tani kjo është e qartë. Në dokumentin e datës 23.07. 2004 të nënshkruar nga Jakup Krasniqi, ish ministër i MSHP dhe zoti Peter Ivanov, drejtëor i Zyrës për çështje politike, e që i është dërguar Bajram Rexhepit, Kryeministër i atëhershëm i Kosovës thuhet: "I nderuari zoti Kryeministër, në emër të Grupit punues për qeverisje lokale (GPQL), kemi kënaqësinë t'u dorëzojmë për miratim nga Qeveria dokumentin kornizë për reformën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë të përfunduar në takimin e tij të datës 19 korrik 2004 siç është parashikuar në termat e reformës... Si bashkëkryetar dëshirojmë të shprehim mirënjojen tonë të thelli për anëtarë të GPQL-ës... etj.

Pra, Grupi punues për vetëqeverisje lokale i Qeverisë Rexhepi qysh më 19.07.2004 del me kornizën për reformën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë (Vula me nr. 1389, data 27.07.2004, me të gjitha dispozitat përkatëse: hyrje, rekomandime, vlerësimi, kompetenca e përgjegjësi, detyra e marrëveshje, status ligjor të banorëve e njësi të vetëqeverisjes lokale, forcim të demokracisë dhe organeve lokale, mbrojtje të komuniteteve e financime, bashkëpunime ndërkombëtare etj.

Sipas dokumentit nr. 1/107 ish Qeveria Rexhepi në mbështetje të neneve 9, 3 dhe 16 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, Qeveria Rexhepi në mbledhjen e mbajtur më 23.07.2004 mori vendimin për aprovimin në parim të Projektit kornizë të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, të cilin dokument e ka nënshkruar ish Kryeministri Rexhepi.

Nga dokumenti i lartëkur shihet se Qeveria Rexhepi me lehtësi i ka pranuar rekomandimet nga jashtë për dobësimin e influencës funksionale të organeve qendrore në favor të institucioneve të pushtetit lokal. Në fakt, kjo veprimtari, do të tha jo ilegale, është bërë dhe

koordinuar mu nga ish Ministri Krasniqi, i cili sot po e bën zhurmën më të madhe. Është mirë që përkohështetje falje publike para Parlamentit dhe qytetarëve të Kosovës dhe të mos bëjë ndërmimin e tezave, duke kritikuar Qeverinë aktuale, të mështeshë dobësitë e tij dhe të Qeverisë anëtar i të cilës ka qenë.

Kuvendi ka qenë dhe është i përkushtuar që interesat e Kosovës duhet mbrojtur dhe proceset duhet të çohen përpara me një dinamikë edhe më të theksuar duke qenë unik si pozita ashtu edhe opozita, por me një unitet parimor dhe të shëndetshëm e jo me ndërskambca dhe me pengesa tendencioze përtak penguari punën e Kuvendit dhe Qeverisë.

Çka është shumë interesant, siç theksova edhe më lartë, se me punën e Grupit punues përvetëzues i lokale të Qeverisë Rexhepi nuk kanë qenë të informuar deputetët e përbërjes se kaluar të Kuvendit.

Prandaj, me të drejtë shtrohet pyetja se ku mund të bazohet gjithë kjo zhurmë e tyre apo fushatë tejet destruktive e opozitës. Në qoftë se vlerësojnë se projekt i nuk është i mirë, duhet ta thonë, por nëse nga kjo duan të kenë përfitime politike e tjera, tanimë maskat kanë ra. Nuk mund t'i shitet këtij Kuvendi e as popullit të Kosovës mjegull. Kërkoi që vetë PDK-ja të bëjë identifikimin e dallimeve nga projekti i Qeverisë Rexhepi me projektin e kësaj Qeverie sepse dallime qenësore nuk ka. Sa i përket finesave dhe lojëratëve të fjalëve nuk janë argumente që mund PDK-ja të bëjë përfitime politike sepse çështja e Kosovës është e rëndësishëm më të madhe sesa dëshirë e opozitës përtak penguari punën e tensioneve në jetën politike e që opozita si duket e ka metodë të punës dhe mbijetesës.

Në fund, propozoj që Kuvendi në parim të mbështesë procesin e reformimit të pushtetit lokal në Kosovë dhe të ngarkojë Qeverinë dhe institucionet e tjera relevante kompetent që të punojnë në këtë drejtim.

(Me kaq Seanca plenare e datës 19.05.2005 përfundoi punën)

\*\*\*\*\*

(Seanca plenare e datës 19.05.2005 vazhdoi punën me datë 20.05.2005 në ora 10.00)

(Seancën plenare e kryesoi, Kryetari i Kuvendit, Akademik Nexhat Daci)

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje në vazhdimin e punës së Seancës së përgjithshme të plenare. Pas një ditë pune, tanë në rend ditë është pika e tretë:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit përsigurinë e përgjithshme të produkteve.
- Fjalën e ka kërkuar anëtar i Kryesisë, Ramë Buja. Urdhëroni, Ramë.

#### DEPUTETI RAMË BUJA:

Mirëmëngjesi të gjithëve. Urim përditë të mbarë të sotme dhe të suksesshme, siç ishte dita e djeshme, zoti Kryetar dhe ju të nderuar deputetë.

Konsiderojmë që pika e dytë e rendit të ditës, nuk është përmbyllur dje, megjithë përgëzimet përditë debat që ishte shumë i frytshëm dhe shumë i suksesshëm dhe dëshirojmë që kësot debate të përsëriten edhe më tutje, por ne të Partisë Demokratike mendojmë se kemi akoma për

të thënë dhe nëse nuk kemi eventualisht, atëherë është shumë logjike, besoj kjo çështje të hidhet në votë e të dihet kush është për pilot-projektin e kush jo.

Është shumë normale, sepse shpjegimi i djeshëm se ishte shqyrtim i këtij materiali, ne i shqyrtojmë të gjitha projektligjet dhe pastaj i votojmë, është gjithçka normale dhe gjithçka në rregull. Dhe besoj që edhe votimi që do të ndodhë do të jetë shumë i logjikshëm dhe do t'i japë vizë ose jo pilot-projektit dhe natyrisht do ta legitimojë atë për të vepruar ose të kundërtën e saj. Besoj se kjo gjë, zoti Kryetar, do të duhej të ndodhë krejt zakonshëm, sepse mbi 90% e deputetëve kanë qenë kundër pilot-projektit andaj ta verifikojmë këtë edhe me votën që do t'ja jap ky Parlament kësaj çështjeje. Dhe unë kisha kërkuar që edhe sot, kur kjo gjë të përmbyllët, të jetë këtu edhe zoti Kryeministër, megjithë respektin për Ministrin e pushtetit lokal që është në Seancën e sotme. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Janë paraqitur anëtarët e Kryesisë Gazmend Muhamxheri, pastaj Naim Maloku. Urdhëroni Gazmend. Karta e Gazmendit është identifikuar si Ylber Hysa!...

#### DEPUTETI YLBER HYSA:

Ju faleminderit. Edhe ne e përkrahim këtë iniciativë dhe mendojmë se debati i djeshëm ka qenë i një rëndësie shumë të madhe dhe ka qenë edhe një moment mbi të cilin mund të ndërtojmë konsensusin aq shumë të përfolur edhe nga Qeveria edhe nga opozita. Besoj se ky është një moment i mirë mbi të cilin mund të ndërtojmë pozicione të tillë edhe për çështje të tjera strategjike, siç janë bisedimet për statusin final. Andaj, konsideroj se është e drejtë që ta zgjidhim këtë dilemë. Çështja është këtu. A duhet të ketë pilot-projekti aprosim parlamentar apo jo. Ne mund ta bëjmë këtë sot, ashtu siç është apo siç u propozua dje: që të përfillen të gjithë rekomandime që ishin bérë këtu dhe pastaj të sillen prapë, në mënyrë që të votohen. Pra, a është e thjeshtë: ne jemi që ky pilot-projekt të ketë ose të mos ketë aprosimin parlamentar. Konsiderojmë se ky është një moment i cili mund t'i nevojitet edhe Qeverisë edhe opozitës. Pra, nëse jo – atëherë ne nuk marrim përgjegjësi për një platformë të tillë e cila është paraqitur tek ne.

Apelojmë që të kuptohet si një vullnet i mirë ky propozim dhe që sot ose të vendosim ta hedhim në votim këtë pilot-projekt, i cili është paraqitur para nesh, ose ndoshta ta bëjmë një pauzë e të merren vesh shefat e grupeve parlamentare që të zotohen që një gjë e tillë të ndodhë më pastaj. Por, për ne është shumë e qartë që një pilot-projekt i tillë nuk mund të kalojë pa aprosim parlamentar. Nëse, jo atëherë Qeveria e mban përgjegjësinë e plotë për të.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Naim Maloku.

#### DEPUTETI NAIM MALOKU:

Inderuari zoti Kryetar, të ndenuar kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj, Debatë i djeshëm për çështjen e reformimit të pushtetit lokal në Kosovë dëshmoi qartë se ky Parlament për çështjet madhore me interes të përgjithshëm për Kosovën nuk ka ndarje pozitë-opozitë. Dhe kjo është një e mirë që është dëshmuar edhe para nesh dhe kemi dëshmuar njëri me tjetrin – grupet parlamentare, secili deputet por këtë e kemi dëshmuar edhe para qytetarëve të Kosovës. Patë sugjerime dhe vërejtje në këtë projektin, i cili ishte një projekt i filluar në

Qeverinë e parakaluar, pra në vitin e kaluar, i vazhduar me Qeverinë Haradinaj. Pra, projekt për një proces i cili duhet të fillojë, por që do të zgjasë një kohë të gjatë.

Unë jam i mendimit se nuk duhet të qitet në votim pilot-projekti përfaktin se nuk dëshirojmë të kemi ndarje pro dhe kontra. Është mendim, është mendim – ju lutem, ju lutem të nderuar deputetët unë ju kam dëgjuar me vëmendje, dje e keni pas më së shumti fjalën ju, mundemi me shikuar edhe Transkriptin. Ju kam dëgjuar me vëmendje dhe nuk kam ndërhyrë në fjalën tuaj. Ju lus të tregoni një konsideratë pavarësisht se si e ndieni veten, a kuptoni dhe ta përfundoj mendimin tim.

Qeveria e Kosovës ka mundësi, u tha edhe dje, me i marrë të gjitha vërejtjet në konsideratë që janë dhënë. Më shumë kanë pas vërejtje dhe sugjerime nga pozita se sa edhe nga opozita, pra kemi qenë... Për këtë mundemi më shikuar edhe Transkriptin se çfarë vërejtje, çfarë sugjerime ka pas. Pra, Transkripti do të jetë dhe ne do ta përcjellim në vazhdimesi punën e Qeverisë. Ky është mendim imi. Pra, jam kundër votimit. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACL:

Ju faleminderit. Unë do t'ju lutja ta kemi një pauzë 15 minutash. Lus shefat, sikur atë që propozoi ORA që grupet parlamentare të takohen dhe së bashku - te unë të shohim çfarë të bëjmë më tej.

(Vijoi pauza)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën)

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë besoj se pas një vonesë të dukshme, nëse mundem të rezymoj dhe nëse e kam të qartë, përafërsisht, marrëveshja është e këtillë: Qeveria duhet të obligohet që debatin e zhvilluar dje ta analizojë dhe t'i inkorporojë çështjet fundamentale esenciale të rëndësishme që janë theksuar në debat dhe në kohë të caktuar sa ta caktojmë – dy javë, tri javë, një javë a një muaj – ta kthejë atë material në procedurë parlamentare ose t'i raportojë Kuvendit për atë çka ka inkorporuar. Në qoftë se nuk e kam krejtësisht të qartë, unë do të doja që zoti Ylber Hysa, por në qoftë se nuk e kam thënë ashtu siç duhet. Urdhëroni...

#### DEPUTETI YLBER HYSA:

Faleminderit. Besoj se në bisedën që patëm, mbrrijtëm një lloj konsensusi sipas të cilët duhet ta ruajmë fryshtë e debatit që kemi pas dje dhe në këtë mënyrë propozimi i kompromisit është që rekomandimet nga debati i djeshëm të përpunohen nga Qeveria dhe në një afat të respektueshëm, u propozua njëdyjavësh, që të sillen në procedurë parlamentare. Propozimi tjetër ishte, edhe nga Qeveria, që të krijohet një komision ad hoc, me të gjitha grupet parlamentare, i cili do të përcjellë punën në Ministri që ka të bëjë me reformimin e pushtetit lokal dhe që një komision i tillë mund të fuqizohet nga ky Parlament në njëren nga seancat e ardhshme. Konsideroj se ky ishte kompromisi i arritur dhe më duket se të gjithë u pajtuam përkëtë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se... Po, zoti Thaçi, kompromisi është arritur. Çfarë debati doni prapë?

**DEPUTETI HASHIM THACI:**

Faleminderit zoti Kryetar, tă nderuar deputetë, Eshtë diskutuar pér pilot-projektin edhe në kuadër të grupeve parlamentare të partive politike. Eshtë arritur konsensus i plotë se ky pilot-projekt është i dëmshëm dhe i papranueshëm pér Parlamentin e Kosovës nga diskutimet e shumicës së kuvendarëve të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu eshtë arritur që të jetë propozim edhe i Partisë Demokratike të Kosovës që rekomandimet e kuvendarëve të Kosovës Qeveria t'i merr në konsiderim dhe në një afat të caktuar kohor, që do të duhej caktuar sot nga Parlamenti i Kosovës të kthehet pér diskutim këtu dhe të votohet.

Partia Demokratike e Kosovës, e rithekson edhe një herë, kërkon që ose të votohet sot pilot-projekti ose të caktohet një datë tjetër që të kthehet në Parlament dhe të votohet pilot-projekti. Domethënë, mundësish brenda javës jë bëhet kjo.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Faleminderit. Unë nuk e di, prandaj edhe luta zotëriun Hysa të thotë diçka pér këtë. Në qoftë se zotëri Hysa thotë se eshtë arritur kompromis dhe eshtë kompromis i pranueshëm sikur që tha, unë pasq prej reagimeve të pozitës dhë të deputetëve tjerë. Kjo eshtë tash e njëjtë vazhdimësi, prandaj urdhëroni pér sqarim profesor Gashi.

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

Faleminderit zoti Kryetar. Ne dje kemi pas në rend dite shqyrtimin e një dokumenti lidhur me decentralizim të ofruar nga Qeveria. Grupi Parlamentar i LDK fillim e mbarim ka qenë shumë konstruktiv në këtë çështje, me vërejtje parimore, por edhe me kontribut nen pas nenit.

Ne konsiderojmë këtë shqyrtim dhe debat të perfunduar. Ne presim nga... e Kosovës që nga debati i djeshëm të ketë marrë mësimë, të cilat do t'i shqyrtojë në Qeveri dhe do të bëjë përpjekje t'ua gjejë vendin në projektin e tyre.

Qeveria, sipas procedurave të Kuvendit të Kosovës ka të drejtë t'i drejtohet këtij forumi saherë të jetë e nevojshme.

Ne si Grup Parlamentar, kemi forcën politike që ta ftojmë Qeverinë në debat saherë të shohim të arsyeshëm, por edhe i mbështesim grupet tjera parlamentare lidhur me këtë çështje pér debat.

Ne menduam se arritëm një pëlqim lidhur me këtë çështje: që Qeveria, përmes Ministrit të pranishëm, apo Kryeministrin - të zotohet pér marrje me një seriozitet të plotë të debatit të djeshëm dhe pas inkorporimit të tij në tekst që Kuvendi i Kosovës ta merr në shqyrtim në kohën kur Qeveria është e gatshme ta shtrojë para nesh. Por, nëse pér çfarëdo arsyec tjetër dëshirohen të provohen forca demokratike, ne jemi të gatshëm - sipas procedurave të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Faleminderit shumë. Zoti Bajram Rexhepi, je në monitor, a e ke kërkuar fjalën? Më fal, s'e paske kërkuar. Veton Surroi, a e kërkoni fjalën? Urdhëroni.

DEPUTETI VETON SURROI:

Zonja dhe zotërinj,

Më duket se debati i djeshëm, po edhe përpjekja e sotme e të gjitha grupeve parlamentare, ka qenë jo për të krijuar ndasi por për të krijuar konsensus.

Nëse do të mund të tertiqeshin dy pikat themelore të konsensusit gjatë debatit të djeshëm siç i shënoi unë, është që Kuvendi i Kosovës në tërsi dhe të gjitha grupet parlamentare veç e veç e përkrahin procesi ne decentralizimit si të tillë dhe nevojën që Kosova të kalojë nëpër një proces të decentralizimit. Emërtues i përbashkët, po ashtu si pikë e dytë, është që ky Kuvend i Kosovës kërkon një procedurë ligjore dhe legjitime në këtë proces të decentralizimit. Pra, në këto dy pika, unë nuk kam pa ndohnjë dallim. Ka qenë emërtues i përbashkët i të gjitha grupeve parlamentare që procesi i decentralizimit të kalojë nëpër një procedurë legjitime dhe legale.

Për të mund të arrihen këto dy qëllime, zoti Hysa dhe Grupi ynë Parlamentar, në bisedën e zhvilluar me Kryetarin e Kuvendit kanë propozuar apo kanë identifikuar si formulë të mundshme të kompromisit këto dy çështje: E para, siç do të kishte nevojë, pra Ministria e pushtetit lokal, e cila ka zhvilluar një punë intensive, që të ketë një komision ad hoc të formuar nga ky Kuvend i cili do t'i ndihmonte në punën e mëtutjeshme dhe do të ishte një lloj mbikëqyrësi parlamentar për punën e legalitetit dhe legjitimitetit të këtij procesi.

Dhe, çështja e dytë, është që rekomandimet, të cilat kanë qenë ekstensive në Kuvend t'i merrë Qeveria dhc të na raportojë brenda një afati – ishte i arsyeshëm.

Pra, janë katër pika, t'i rikthejë prapë:

- Pika e parë, Kuvendi i Kosovës përkrah plotësish procesin e decentralizimit;
- Dy, Kuvendi i Kosovës, përkrah plotësish nevojën që ky proces të jetë legal dhe legjitim;
- Çështja e tretë, Kuvendi i Kosovës formon komisionin mbështetës për procesin e decentralizimit; dhe
- Çështja e katërt Qeveria na e kthen prapa një dokument, i cili përmban me veti rezymenë.

Unë do të lusja që, nëse këto katër pika janë të pranueshme, të mos i hyjmë votimit, sepse edhe debati nuk ka qenë përcarës, debati ka qenë unifikues në këtë Kuvend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor Kuçi, jeni të paraqitur në monitor, a e keni kërkuar fjalën? Urdhëroni profesor, shkurt.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:

Mirë, në qoftë se 'don, unë ua jap fjalën, por... pa u bë nervoz! Faleminderit zoti Kryetar, tënderuar... Unë kisha pas dëshirë edhe profesori Sabri me më dëgjuat. Mirë, faleminderit. Mendoj se këtu është çështje të trajtojmë çka është puna e debatit ose jo dhe mendoj se debati pa marrë përasysht mendimet që mund të jenë pro dhe kontra, mendimi që ky Kuvend është organi kryesor vendimmarrës në Kosovë duhet të respektohet edhe në kuptimin legjislativ, por edhe në kuptimin tjetër politik. Dhe debati nuk do të ketë kuptim në qoftë se në fund të debatit nuk do të ketë një vendim për të. Nuk dua të prejudikoj vendimin – pozitiv ose negativ, por gjithsesi duhet të jetë një vendim.

Cështja e dytë, që mendoj është shumë me rëndësi, se ky projekt është një ndër projektet kryesore që mund dhe duhet Qeveria e Kosovës t'ia ofrojë Kuvendit të Kosovës dhe ky projekt shpeshherë në vende demokratike matet edhe me forcën e Qeverisë, kuptimi i asaj se Qeveria për projekte të tillë mund të mbetet ose të mos mbetet më. Dhe në qoftë se nuk kalon një projekt i tillë, atëherë duhet të konsiderohet që projekt i nuk është i zbatueshëm. Do të është plotësisht e kuptueshme që Qeverisë t'i jepet një afat dyjavor që t'i inkorporojë vërejtjet që janë dhënë nga Kuvendi, ta sjellë prapë projektin këtu dhe ai projekt të merr votën e këtij Kuvendi. Do të thotë nuk mjafton vetëm të mos merr votën kundër, por gjithsesi projektin duhet ta merr votën pro. Në kuptimin e kësaj, do të thotë debati në qoftë se merrët vetëm sa për shprehje të mendimit të lirë, ose sa për shprehje në momente të caktuara të emocioneve, mendoj se nuk ka nevojë që të mbahet fare. Pra, ka kuptimin vetëm në qoftë se është organ vendimarrës dhe merr vendimin. Edhe për Qeverinë edhe për të tjérët, derisa të jetë një vendim i tillë duhet të konsiderohet se nuk merren veprime të tillë në drejtim të reformimit të pushtetit lokal. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Sabri Hamiti le ta merrë fjalën.

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

I nderuari Kryetari i Kuvendit, kolegë të nderuar,  
Kuvendi është vend i demokracisë, por unë mendoj që nuk është vend i lojnavë pa kufij. Dhe një diskutim serioz, me seriozitetin më të madh të mundshëm që kapte kapacitete të njohurive dhe të përgjegjësive të deputetëve të Kosovës i provuar dje, nuk është mirë që të përdhoset me lojni politike të pakufishme. Lojnitë po dalin në dritë edhe sot, që aq më keq, pas një tubimi kur ne dëgjuam katër variantë të marrëveshjes tuaj, secili e ka variantin e vet.

Kjo tregon që është lojë pa kufij dhe unë ju lutem... Unë për veti po flas, personalisht mendoj dhe krejt Grupi im Parlamentar nuk e pranon një lojë të pakufi të tillë.

Prandaj, krejt çka është thënë dhe çka është bë, çon kah një përfundim: që Qeveria, kryetari Qeverisë dhe Ministri i resorit të caktuar të pushtetit lokal le t'i marrin ato rekomandime që janë shumë esenciale, që janë rekomandime – nëse ata dinë t'i kuptojnë – për dobinë e punës së tyre, nëse s'dinë – atëherë s'iu vyejnë as plani i parë as këto rekomandime; t'i marrin dhe t'i inkorporojnë në programin dhe t'ia kthejnë në kuti Kuvendit.

Sa për votime! T'i lëmë ato lojna, se ne kemi fuqinë me thënë s'do të votojmë hiq dhe votojmë sipas procedurave për mos ta votuar Kuvendi këtëfarë dokumenti. Fundi i fundit, ne shkojmë në lojna pa kufij dhe nuk kemi nevojë të humbim kohë. Unë kërkoj deklarim të ministrit para nesh që do t'i bëjë këto gjëra dhe të ecim tutje. Faleminderit shumë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministri e ka ofruar vetë atë, do të thotë nuk është si obligim. Por, Ministër - ma mirë urdhëroni vetë arsyetoni. Jo – jo, tjerë nuk mund të paraqiten. Ministri është i fundit dhe pastaj do të vendosim lidhur me këtë.

MINISTRI LUTFI HAZIRI:

Zoti Kryetar, tē nderuar deputetë, Faleminderit pér mundësinë që pas sqarimeve të pasdites mëvonshme të djeshme, pas debatit do të konfirmoj edhe një herë: Për mua ka qenë shumë e dobishme çdo rekomandim, çdo sugjerim, çdo vërejtje qoftë ato vërejtjet teknike që janë dhënë në dokument. Dhe, tē gjitha rekomandimet do t'i shqyrtoj, do t'i përgatis dhe do t'i procedoj në Qeveri pér të eliminuar dobësitë që mund të evidentohen pér të fuqizuar dokumentin dhe pér të siguruar procesin që në tē ardhmen ka me ec drejt dhe në interes të qytetarëve të Kosovës. Këtë obligim, në emër të Qeverisë, do ta kaloj prapë në procedim – në bazë të procedurave dhe tregullave në Parliament, duke mos mohuar asnjëherë rolin e organit më të lartë vendimmarrës i cili gjithmonë do të jetë vendi më i çmueshëm dhe vendi më i detyrueshëm pér mua, e këtë po e them edhe në emër të Qeverisë së Kosovës. Faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju faleminderit. Ka përfunduar kjo. Unë mendoj se të gjitha çështjet janë të qartësuara. Në qoftë se PDK, megjithatë, insiston në procedurë, unë duhet ta respektoj. Por, ta sqarojmë edhe këtë. Në procedurë a ta votojmë materialin e Qeverisë apo jo, pastaj faza e dyte është – në qoftë se fiton. Urdhëroni Fatmir...

DEPUTETI FATMIR SEJDIU:

Jo, zoti Kryetar, s'kam diçka tjetër. Ne u morëm vesh dhe mendoj se qëndrimi është shumë i qartë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Prandaj, ftoj Grupin... Jo jo si individ. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK, kush dëshiron fjalën. Urdhëroni Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THACI:

Faleminderit zoti Kryetar. Mendoj se çështja është shumë e thjeshti. Nuk është mirë deputetë të caktuar me komplikua procesin. Duhet të definohet qartë: a e ka përkrahjen e Parliamentit të Kosovës pilot-projekti i Qeverisë apo jo, e para. E dyta është: të përcaktohet një periudhë kohore nëse nuk kalon versioni i parë i deklarimit të sotëm i Parlamenti pér një periudhë të caktuar që Parlamenti t'i japë kohë Qeverisë, pastaj ky projekt me plotësimë dhe rekomandime të sillet pér diskutim dhe pér votim në Parlamentin e Kosovës. Prandaj në mes këtyre dy propozimeve, mendoj se është mirë të gjedhet njëri prej tyre, që është me interes dhe mendojmë se do të ishte mirë kjo e dyta – do të thotë një periudhë kohore prej 7 ose 10 ditësh Qeveria t'i marrë, është edhe këtu Ministri, t'i marrë rekomandimet, të sjellët përsëri ai dokument këtu pér diskutim dhe të votohet. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Tani ju ftoj të gjithëve të përqendroheni në këtë. Është kërkesë e një Grupi Parlamentar dhe ne duhet ta respektojmë si procedurë.

E shtroj në votim:

- Kush është pér propozimin e PDK-ës që të shqyrtohet mundësia a të votohet materiali i paraqitur dje pér referim. Ju lutem të numërohen votat.

Edhe një herë, procedura është dy pjesëshe dhe ju lus, të gjithë ata që janë kompetent për këtë ta përcjellin me vëmendje.

Hapi i parë, të hyhet në procedurë të vendimmarjes për propozimin e PDK a të votohet materiali i debatuar dhe shqyrtuar dje.

Prandaj pyes:

- Kush është për propozimin e PDK-ës, ju lutem.
- Asnjë s'është përf! Prandaj, s'ka kuptim votimi.

Informata e dytë, ju lutem. Atëherë, mbetet në fuqi konsensusi që e ka shpjeguar Ylber Hysa. Mirë de, por unë e luta, për në një pjesë të asaj martëveshjeje unë nuk kam qenë dhe nuk dua të jam interpretues i asaj pjese. Unë e shpjegova, por megjithatë, përfir të Transkriptit – përfir të dokumenteve - ishte dokumentacion valid dhe e pashtë aprovim në përgjithësi. Prandaj, vazhdojmë ...

(Reagim prej vendi – pa kyçje të mikrofonit)

Po e vëra në votim, u refuzua. Ju nuk votuat.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektiligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Konstatime hyrëse. Miratimi në parim i këtij Projektiligji është bërë më 24 mars 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime, me amendamentet si vijon:

Shpresoj se materialet i keni marrë me të gjithë dhe me kohë.

Për çka e kérkon fjalën Xhezair. Përligjin a? Jo, e kemi krye, të lutem. Jo, sepse e kemi krye. Pas kësaj pike, të lutem.

Amendmenti 1, Komisioni funksional.

Kush është përf? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendmenti.

Përf t'mos e theksuar gjithnjë, të them se të gjitha amendamentet janë të Komisionit funksional.

Amendmenti 2.

Kush është përf? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendmenti.

Amendmenti 3.

Kush është përf? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendmenti.

Amendmenti 4.

Kush është përf? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5.

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6.

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka..

Kalon amendamenti.

Tani ju ftoj ta votojmë ligjin në tërësi. 97 deputetë janë prezent në sallë.

Kush është për? Ju faleminderit shumë.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e radhës, pika 4 e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për ekonomi, tregti dhe industri lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për Odë Ekonomike.

Vërejtjet hyrëse:Ligi për Odën Ekonomike është miratuar në Seancën plenare të mbajtur më 28 prill 2004.

I njëjti i është dërguar për shpallje PSSP me 10 maj 2004.

PSSP, përmes Zyrës ligjore, i është drejtuar Kuvendit me disa vërejtje duke kërkuar sqarime plotësuese për disa dispozita të këtij Ligji.

Shkresa iu është shpërndarë të gjithë deputetëve, si dhe Komisionit për tregti dhe industri. Komisioni për ekonomi, tregti dhe industri, pas shqyrtimit radhazi në disa mbledhje vendozi që Kuvendit t'i paraqesë raportin e datës 13 prill 2005 me rekomandimet për amendamentimin e këtij Ligji.

Arsyetimin, nëse e sheh të nevojshme, le ta paraqesë zëvendëskryetari Bajrushi Xhemajli. Po më shkruan kështu... Domethënë, s'ke nevojë. Faleminderit shumë.

Amendamenti 1.

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3.

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Dhe i fundit, Amendamenti 4 .  
 Kush është për? Ju faleminderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 Abstenime? Nuk ka.  
 Ju lutem, tani ju ftoj t'i votojmë rekomandimet në tërësi.  
 Kush është për? Ju faleminderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 Abstenime? Nuk ka. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës...  
 Aha, Xhezairi po e kërkon fjalën. Kerkoj falje, urdhëroni.

#### DEPUTETI DŽEZAIR MURATI:

Gospodine Predsedniče, gospodo ministri, kolege poslanici, gospodo predstavnici medjunarodne zajednice,

Dok smo se juće celodnevno bavili jednom veoma važnom tačkom, dakle o decentralizaciji lokalne vlasti na Kosovu, na Prištinski aerodrom stigao je avion sa više od stotinu porodica povratnika iz Nemačke, pretežno predstavnika manjina, koji su stihiski grupno vraćeni i mnogo od njih su ostali da spavaju na Prištinskom aerodromu – na Slatini. Neki su otisli kućama, neki nemaju kuće. Mnogi su se javili predstavnicima manjinskih zajednica, tu ima najviše porodica iz grupe Roma, Haškalija i Egipćana a ima i predstavnika drugih zajednica i većinske Bošnjačke i tako dalje, pa onda apelujem na našu Skupštinu, na Vladu i na predstavnike medjunarodnih misija kao i na UNMIK i OSCE, da se ovako stihiski povratnici ne ponavljaju jer nisu stvoreni ekonomski uslovi za vraćanje ljudi u tako velikom broju. Imao složena ekonomska i socijalna situacija time se dalje produbljava s toča mislim da bi smo trebali da preduzmemo korake da se prvo stvore održljivi uslovi a potom da dodje do takvih povrataka. Verujte, neki su išli prijatno kućama, neki od ... predstavnici ... jina ovde su bili na neodumicu gde te ljudi da smeste. Ovo je jedan dodatni problem i ja molim, zaključujem ovo da uputimo jedan apel misiji medjunarodne zajednice da ovakve stvari se više ne ponavljaju, ne bar na ovakav način kako je to juće uradjeno. Evo, hvala. Ja mislim da će neko imati sluha da ovako teško stanje dalje ne produbljujemo. Hvala vam i izvinite.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se keni shtruar një çështje shumë të ndjeshme dhe jam i bindur se ka mbështetjen e plotë të Seancës plenare. Prandaj, le të formulohet nga Kryesia apo komisioneri përkatës që është për mbrojtjen e tyre dhe ta procedojmë në procedurë të mëtejshme. Do të thotë, plotësisht të gjithë e mbështesim, dhe s'kemi nevojë të votojmë sepseasnje nuk do të jetë kundër një çështjeje të tillë. Faleminderit Xhezair.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës dhe pastaj e bëjmë një kafepauzë.

(Ndërprerje e shkurtër)

Pikën e pestë duhet ta kapércejmë përkohësisht. Referuesi i Qeverisë nuk është në sallë. Prandaj kalojmë në pikën e gjashtë:  
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit përmbeturinat.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me 20 prill 2005 dhe janë përbushur kushtet përmirësimi dhe miratimi të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional, përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet zëvendësministri, zoti Merxhan Avdyli që në emër të Qeverisë, ta prezantojë ligjin. Foltorja është e juaja, zëvendësministër.

### ZËVENDËSMINISTRI MERXHAN AVDYLI:

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke i kushtuar rëndësi të posaçme infrastrukturës ligjore, si një prej prioriteteve që ka në veprimin e saj ka angazhuar ekspertët e saj edhe në hartimin e një ligji shumë të rëndësishëm e të domosdoshëm për ta pasur projektin e të cilit e keni sot përparrë për ta miratuar. Është ky Projektligji për mbeturinat.

Mbeturinat sot janë njëri prej problemeve të Kosovës, trajtimi i të cilit së paku deri më sot nuk është treguar i mjaftueshëm. Kosova sot, pikërisht për shkak të mungesës ose zbratzësisë ligjore për këtë lëmi po përballet me një situatë të rëndë dhe vështirë të tejkalueshme të mjedisit, përkatësisht të ndotjes së tij. Gati e gjithë Kosova, bashkë me peizazhet e bukurë të natyrës së saj po shëmtohet nga mbretëria e mbeturinave. Qytetarët e Kosovës janë producues të mëdhenj të mbeturinave. Ato sot arrijnë shifrën deri në 2 milion kilogram në ditë. Ndërkaoq, po qe se kësaj sasie kërcënuese ia shtojmë edhe sasinë prej 2 milion kilogram hi dhe zgjyrë që mbeturinohet nga KEK-u gjatë një dite, si dhe miliona kilogram mbeturina të tjera komerciale, ndërtimore, spitalore dhe industriale – sipas analizave të bëra nga ekspertët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - në Kosovë prodhohen rreth 1.6 milion ton mbeturina në vit.

Pasi mbeturinat janë të llojeve të ndryshme dhe shumë prej tyre janë kërcënuese të përhershme të shëndetit të njeriut dhe të mjedisit, shtrohet domosdoshmëria për ndërmarrjen e masave të menjëherëshme nga institucionet e Kosovës për përmirësimin e gjendjes në përgjithësi dhe përvogëlimin e mbeturinave dhe rrezikut nga to në veçanti.

Vetë fakti se mbeturinat e Kosovës janë nën kompetenca të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe për arsyet profituese ato menaxhohen nga kjo Agjenci, e cila nëpërmjet ndërmarrjeve publike të trashëguara nga e kaluara, bazuar në një ligj shumë të mangët komunist të vitit 1984 dhe për këtë nuk është në gjendje të krijojë strukturë të mirëfilltë të menaxhimit të mbeturinave – është parë i domosdoshëm hartimi i Projektligjit të mbeturinave.

Arsye kryesore për të pasur Kosova një ligj të tillë të miratuar dhe funksional janë:

- Veprimi jopërkatës me mbeturina dhe administrimi i keq i tyre, që ka paraqitur dhe ende vazhdon të paraqësë problem të madh ekologjik në Kosovë;
- Vendasja e një administrimi integral të mbeturinave, duke filluar nga krijimi i mbeturinave, mbledhja dhe klasifikimi i tyre, transporti, magazinimi, trajtimi e deri te deponimi përfundimtar;

Përmes këtyj ligji do të futen në funksion parimet bashkëkohore për: klasifikimin e mbeturinave; planifikimin e administrimit të mbeturinave; përcaktimin e kompetencave për administrimin e mbeturinave; organizimin e përgjithshëm të administrimit të mbeturinave; administrimin e mbeturinave të veçanta; licencimin e kompanive për administrimin e mbeturinave; qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave; financimin; monitorimin dhe mbikëqyrjen inspektuese të administrimit të mbeturinave.

Të nderuar deputetë,

Projektligi për mbeturinat, marrë në përgjithësi, paraqet ligjërisht mbrojtjen e shëndetit të njeriut nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit nga ndotja dhe nga rreziqet që shfaqen nga mbeturinat.

Projektligi ka për qëllim administrimin e mbeturinave duke krijuar kushtet për parandalimin dhe minimizimin e mbeturinave në burim të tyre, reduktimin e veticë të rrezikshme të mbeturinave, si dhe zhvillimin e teknologjive të pastra dhe shfrytëzimin efikas të resurseve natyrore.

Ky Projektligj do të mundësojë përpunimin e mbeturinave me anë të riciklimit përkatesisht ripërdorimit të tyre si lëndë dytësore energetike dhe gjithashu do të mundësojë edhe rehabilitimin e vendeve të ndotura dhe sanimin e deponimeve të mbeturinave.

Me këtë Projektligj gjithashu do të definohen dhe përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për administrimin e mbeturinave, do të krijohet baza ligjore për nxjerrjen e udhëzimeve administrative – të cilat në mënyrë të veçantë do të përshkruajnë kushtet për administrimin e mbeturinave speciale, licencimin e ndërmarrjeve për administrimin e tyre, karakterizimin e mbeturinave, e të tjera.

Zgjidhja e problemeve në fushën e administrimit të mbeturinave nuk mund të jetë e plotë dhe e suksesshme nëse veprohet në mënyrë parçiale dhe jashtë sistemit për mbrojtjen e mjedisit, andaj për këtë arsy Bashkimi Evropian insiston në unifikimin e kriterieve për kërkesa të domosdoshme për ruajtjen dhe ngritjen e cilësisë së mjedisit në rajon, kështu që edhe ne jemi duke u kyçur në këto procese unifikuuese.

Në këtë dritë, Projektligi për mbeturinat, është hartuar duke u bazuar edhe në parimet dhe synimet e rregulloreve bazike të Bashkimit Evropian në fushën e administrimit të mbeturinave, kështu që përafimet dhe harmonizimi i legjislativit me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e administrimit të mbeturinave është një proces i cili do të nisë me miratimin e këtij Projektligji për të vazhduar e plotësuar me aktet nënligjore që rjedhin nga ky Projektligj.

Deputetë të nderuar,

Duke çmuar shumë kohën tuaj dhe duke pas në konsideratë mundësinë e përqendrimit të vëmendjes tuaj në këtë dëgjim, pa hyrë në paraqitjen konceptuale të këtij Projektligji, duhet theksuar edhe tri segmente për të plotësuar këtë ekspozë.

Së pari:

- Hartimi i këtij Projektligji është bërë kryesishët për të krijuar kushtet dhe mundësitë për shfrytëzimin racional të lëndëve të para të energjisë dhe përdorimin e lëndëve alternative energetike nga mbeturinat;
- zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat e deponuara për gjeneratat e ardhshme;
- sigurimin e resurseve të qëndrueshme financiare dhe mekanizmave nxitës për investime si dhe për zhvillimin e aktiviteteve sipas parimit – ndotësi paguan, apo shfrytëzuesi paguan;
- vendosjen e standardeve teknike për trajimin e mbeturinave;
- zvogëlimin, shfrytëzimin e serishëm, riciklimin dhe rigjenerimin e mbeturinave;
- zvogëlimin apo reduktimin e veticë të rrezikshme të mbeturinave duke përdorur teknikat më të mira dhe zëvendësimin e materieve të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- krijimin dhe implementimin e sistemit efikas për informim me të cilin do të mbulohen të gjitha pikat, sasitë e mbeturinave, pajisjet për trajtim dhe deponitë e mbeturinave, si dhe aktivitetet tjera për administrimin e mbeturinave;

- angazhimin maksimal të dijes së ekspertëve dhe potencialin ekonomik vendor për vendosjen e një sistemi funksional për administrimin e mbeturinave në Kosovë;
- ngritjen e vjetëdijes së qytetarëve në të gjitha nivelet e shoqërisë lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Së dyti:

Projektligji për mbeturinat është bazuar kryesisht në parimet themelore për administrimin e mbeturinave, siç janë,

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Afërsia dhe vetëtrajtimi;
- Vigjilanca dhe parandalimi;
- Ndotësi paguan;
- Administrim i sistematizuar i mbeturinave sipas prioriteteve;
- Përgjegjësia e prodhuesit;
- Sigurimi financiar;
- Qasja e publikut në informata; dhe
- Mbrojtja e të drejtave në gjykatë.

Dhe, së terti:

Bashkë me Projektligjin për mbeturina, është shtojca, e cila duhet të miratohet bashkë me këtë Projektligj.

Shtojca që i është bashkëngjitur këtij Projektligji përbën pjesën integrale të tij, me të cilat ky Projektligj do të jetë i kompletuar nga aspekti praktik dhe funksional.

Vlen të theksohet se shtojca përkufizohet në çështje të standardeve shkencore teknike, administrative dhe si e tillë është marrë nga direktivat e Bashkësisë Evropiane, ku janë përfshirë:

- Katalogu i mbeturinave, i cili është i harmonizuar me Katalogun evropian të mbeturinave;
- Lista e mbeturinave, sipas vendimit të Komisionit evropian, nr. 1999/816 EC, në të cilën mbeturinat janë specifikuar sipas rrezikshmërisë së tyre.

Gjithashtu, në shtojcën e këtij Projektligji janë përfshirë edhe: dokumenti përcjellës gjatë bartjes së mbeturinave, i cili paraqet një formular në të cilin do të shënohen të dhënat e mbeturinave gjatë transportit, si dhe formulari i raportimit për mbeturina, që është një listë unike e propozuar, e cila do të shërbejë për raportimet periodike lidhur me gjendjen e mbeturinave në vendin e caktuar.

Projektligji është para jush, vota është e juaja, ndërsa miratimi i tij është në dobi të shëndetit të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zëvendësministër, ju faleminderit, Dëgjuam fjalën hyrëse.

Hapim debatin. E ka fjalën Besa Gaxherri, në emër të LDK. Urdhëroni Besa.

#### DEPUTETJA BESA GAXHERRI:

Faleminderit zoti Kryetar. Inderuar zoti Kryetar i Kosovës, të nderuar ministra të pranishëm dhe kolegë deputetë shumë të respektuar. Kryetar i thash, po nëse e kam përzier, edhe ai më përziu mua, s'ka problem.

Në bazë të prezantimit gjithëpërfshirejtës nga Qeveria, që u bë për këtë Projektligj, unë vetëm po shkoj edhe këtë. Duke pas parasysh nevojën për kompletim të infrastrukturës ligjore në Kosovë ky ligj ka ardhë në kohën e duhur dhe i përgatitur shumë mirë. Pse them në kohën e duhur? Sepse, Kosova përfjetoi një luftë të tmerrshme, me shkatërrime të paparashikuueshme, me pasojë të tmerrshme si në njerëz, infrastrukturë, objekte dhe në ekonomi në përgjithësi. Pasojë e kësaj luftë janë edhe mbeturinat e llojeve të shumta, edhe të atyre të kategorisë së rrezikshme. Por nuk ka pas mundësi të aplikohet ligji i tillë për menaxhimin e mbeturinave kur Kosova po kalonte në fazën shumë të rëndë emergjente, që ishte e shndërruar në kantier pune, me një ekonomi tërësisht të shkatërruar, me një buxhet të konsoliduar nga donacionet dhe grandet e huaja. Ndërsa, tanë kur Kosova çdoditë për konsolidohet me hapa të sigurtë drejt integrimit në Evropë vend shumë me rëndësi zë ambienti i pastër dhe ruajtja e tij.

Ne dimë se Kosova ka shumë probleme me mbeturina dhe kjo çështje duhet të rregullohet në radhë të parë me ligj, por edhe më vëtedijesimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë në përgjithësi, si dhe natyrish se duhet të kemi një buxhet më stabil, prà më të fortë apo më të mirë të Kosovës për aplikimin e këtij ligji.

Dhe sa i përket këtij ligji, ne - Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar dhe jemi të kënaqur në përgjithësi me përbajtjen e tij.

Me këtë rast, dua të jap edhe mendimin tim personal. Ky ligj është një ndër ligjet më të mira që kanë arritur në Kuvendin e Kosovës. I hartuar në mënyrë tejet profesionale, që iu përgjigjet edhe kushteve vendore, por edhe standardeve evropiane. I kompletuar, me shtojcën që janë definuar grupet e mbeturinave, të kategorizuara për mrekulli në 20 grupe. Ligji është gjithpërëfshirejtës përfshirës për fushën e caktuar.

Një gjysmë vërejtje, që mund ta bëj, është tek Dispozitat ndëshkuese. Kisha dashtë shumë pak dalem, mos t'ju marr kohë dhe atë lidhur me nenin 47 dhe nenin 50. Domethënë, nenin 47 lexoj vëtëm hyrjen: "47.1 Me gjobë prej 500 deri 100.000 euro dënohet çdo person juridik për që se bën ndonjë nga shkeljet si vijon:", e keni a), b) c) deri në o).

Mendoj se kufiri i poshtëm është tepër në disproporcion me kufirin e lartë, sepse nuk është definuar mirë dhe lë hapësirë që të manipulohet nga mëkanizmat që i ekzekutojnë këto dispozita – që shkelja e rëndë, kushtimi po e them në thojza "mund të dënohet me 500 euro ndërsa ajo më e lehtë - deri në 100.000 euro".

Edhe në nenin 50 për çka kam vërejtje gati të njëjtë, por një moment deri sa ta gjej, ju lutem. Domethënë edhe këtu thotë kështu "Me gjobë në shumë prej 100 deri në 400 euro do të dënohen për kundërvajtje personat përgjegjës në organin e administratës respektivisht organizata e cila bën autorizime publike nëse..." e keni a), b), c) dhe e keni ligjin para vetes.

Domethënë, edhe për këto shuma këtu, nuk pajtohem sepse në bazë të përshtaktimit a), b), c) shkeljet janë të rënda përfshirës shumë. Por, mendoj se këtë çështje do të mund ta rregullojmë në Komisionin e buxhetit dhe çdo gjë do të jetë mirë.

Krejt në fund, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon nga Qeveria përkatesisht nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor që t'i shfrytëzojë mëkanizmat e vet të mundshëm përfshirës shumë e mbeturinave, të këtij ligji sa më shpejt që është e mundur, sepse nevoja e ambientit respektivisht ndotja e ambientit, e ujit, e ajrit në Kosovë tashmë është e padurueshme. Dhe, 18 muaj, sa është shkruar në ligj përgatitje e dispozitave e tjera përfshirës filluar të aplikohet ky ligj, mendoj se është shumë dhe vonë, domethënë bëj një apel që këto procedura mund të ndryshohen në Kuvend te ato pikë.

Dhe, në fund, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e mbështet këtë ligj që të kalojë nëpër procedura të Kuvendit. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Besa, ju falemnderit. Berat Luzha në emër të PDK, le të përgatitet Mazllom Kumnova nga AAK. Urdhëroni Berat.

#### DEPUTETI BERAT LUZHA:

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet Projektljin që të futet në procedurë parlamentare. Mendoj se ligji është i vonuar. Kosova ka pas nevojë që shumë më herët ta ketë një ligj, i cili do ta rregullonte flushëveprimtarinë e caktuar për shkak se Kosova vuani nga papastërtia, do të thotë nga një ambient i ndotur dhe shpreson se ligji do të ndikojë që ambienti të pastrohet dukshëm.

Viteve të fundit kemi pas një qasje mjaft të mirë në ndërtimin e deponive, mirëpo çka është më e keqja – ato deponi – shumica e rasteve, nuk janë mirëmbajtur sa duhet dhe ka nevojë Kosova të ketë edhe shumë deponi të tjera në mënyrë që të jetë shumë më e pastër. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën Mazllom Kumnova, le të përgatitet Gazmend Muhaxheri.

#### DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Zoti Kryetar, Grupi i AAK, në këtë Kuvend e ka pas në dorë edhe këtë Projektligj dhe ka konstatuar se hartuesi mirë ka bërë që ka favorizuar në prioritetet e tij dhe së pari, duke u nisur nga fakti se sot zbatohen ende ligjet e kapërcyera dhe e dyta se problemi i mbeturinave në Kosovë nuk duhet nënçmuar sepse, jo vetëm që e kërcnon shëndetin tonë, por me një administrim të mirë ka mundësi shumëzimi i tyre si lëndë e parë, sidomos për energjetikë.

Le të ndalem tash në disa shqyrtime më konkrete. Te kreu për Administrimin e mbeturinave, nuk ka qartësi të statusit të ndërmarrjeve publike – sot ende nën administrimin e AKM dhe ndërmarrjeve private. A do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit, çështja e pronës ekzistuese e të tjera, gjithnjë e kam fjalën te ndërmarrje publike.

Po kështu, Projektligi duhet përmirësuar çështjen e administrit, mbikëqyrjes, rregulatorit, operimit me deponitë rajonale sikur janë: sigurimi i infrastrukturës, stacioneve të transferit të mbeturinave e të tjera.

Kur e hapim këtë çështje, dihet se në Kosovë investimet më të qëlluara kanë qenë në deponitë rajonale, të cilat janë në standarde më të avancuara në rajon. Në anën tjetër, mbeturina kemi në çdo hap, në çdo kënd, në çdo vendbanim – në disa raste rrezikojnë edhe mjedisin dhe shëndetin. Mirëpo, vënia në funksion të plotë të tyre, ka mbet peng e një keqadministrimi të AKM..

Projektligi që kemi në dorë, ka qasje në këtë çështje, por lypset një përpunim më i qartë nëpër nene të Kreut të pestë, kur flitet për administrimin e mbeturinave.

Te kreu në këtë Projektligj – Dispozitat ndëshkimore, neni 47 dhe 49 si duhet është bërë një gabim kur flitet për gjoba, është dhënë në të tri gjuhët tri varianta të ndryshme.

Ky Projektligj, që është e vërteta, ka një lëkundje në normën gjuhësore, ose pasiguri gjuhësore të hartuesit të Projektligjit, që me siguri i duhet një dorë e mirë.

Projektligji dhe shtojca e tij, kanë mbështetje në dokumentet ndërkombëtare dhe hartuesi ka qenë i kujdeshëm në zbatimin e standardeve dhe direktivave që aktualisht sot janë të domosdoshme.

Si përfundim, mund të themi se këtij Projektligji duhet t'i hapim rrugë për në komisione, të cilat mund ta bëjnë edhe përmirësimin e propozuar nga Grupi i AAK. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Gazmend Muhxheri, le të bëhet gati Ragip Zekollit.

#### DEPUTETI GAZMEND MUHXHERI:

Grupi Parlamentar i ORA-s përkrah në parim këtë Projektligj, mirëpo ka disa vërejtje. Vërejtja e parë është në nenin 18 ku përmendet "laboratori i autorizuar". Bëjmë pyetje domethënë a ekziston ky laborator apo duhet të ndërtohet. Nëse duhet të ndërtohet, shpenzimet buxhetore nuk janë të parapara në ligj.

Kemi vërejtje edhe në nenin 34 pikë 3. Duke marrë parasysh se jemi vendi më i varfér në rajon, kjo pikë domethënë lejon importimin e mbeturinave jo të rrezikshme nëse interpretohet siç mund të interpretohet – mund të shndërrohemi në vend ku vendet e rajonit mund t'i vendosin mbeturinat e tyre.

Kemi një vërejtje serioze për afatin e gjatë të akteve nënligjore, me të cilat Ministria obligohet t'i nxjerrë për 18 muaj. Domethënë, jemi të mendimit se ky afat duhet shkurtohet dhe të jetë 6 ose 9 muaj. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe i fundit Ragip Zekollit. Urdhëroni Ragip.

#### DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI:

Faleminderit zoti Kryetar. Unë nuk dua t'i qasem aq shumë ligjt po të mos ishte shtojca e fundit dhe vërtetë nëse deputetët kanë pas rastin ta shohin vetëm atë fletën e fundit, që unë kujtoj se vërtetë, edhe për deputetët edhe për Qeverinë edhe për sponsoruesin është fyese.

Në këtë fletë, ku thotë se duhet shtuar një tabelë, atëherë – le që nuk është shqip tabelës e mjauftueshme e kështu me radhë, mirëpo përkundër që Qeveria ka paguar një fondacion që mund të korrigohen gabimet gjuhësore, ma besoni që në këtë fletë janë të panumërtë dhe që s'po dua t'i them.

Nëse do të vijnë përsëri kështu ligjet e tillë, e që kemi pas bisedë edhe më herët në Parlament, atëherë mendoj se vërtetë nuk është e arsyeshme dhe do të ishte mirë që për herë të fundit të troket në ndërgjegjen e sponsoruesve dhe të Qeverisë, po ndoshta edhe tonën që në duar të deputetëve mos të vijnë në këtë formë. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ragip, ju faleminderit. Plotësisht e arsyeshme. Pak me vonesë u lajmëruat, por urdhëroni, E ka fjalën Fehmi Mujota. Urdhëroni Fehmi.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA:

Faleminderit. Unë kam vetëm një propozim. Meqë ligji është i një rëndësie shumë të veçantë, dhe të gjitha grupet parlamentare u pajtuan që të shkoj, kisha propozuar të mos votojmë fare.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

(Ndërprerje e shkurtër)...

Prandaj, ju lutem, ishte propozim që e kuptuam të gjithë, do të thotë duhet të kthehet atje ku duhet për me ardh si duhet, sepse kemi kërkuar edhe në mandatin e kaluar, edhe në këtë mandat. Shpresojmë se lëshime të tillë nuk do të përsëriten. Megjithatë unë ju ftoj të përcaktohermi, sepse është vullnet i secilit.

Kush është që në parim ta mbështesim Projektligjin e shqyrtuar? Faleminderit shumë.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Më lejoni t'ju them se komisionet që duhet ta shqyrtojnë janë: Komisioni përmjedis dhe planifikim hapësinor - si Komision funksional dhe referues; Komisioni përgjyqtës, legjislacion; Komisioni përbuxhet dhe Komisioni përkomunitete.

Vazhdojmë punën. Kalojmë në pikën vijuese:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit përlirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë.

Meqenëse, prap nuk kemi referues nga Qeveria, këtë pikë e lëmë përmë vonë. Vazhdojmë me pikën tjeter:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit përborxhet.

Konstatimet hyrëse: Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 26 prill 2005 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen Komisionit funksional. Ftoj Ministrin përekonomi dhe financa, zotin Hak Shatri, që në emër të Qeverisë para deputetëve ta arsyetojë ligjin. Ministri foltorja është e juaja. Urdhëroni...

MINISTRI HAKI SHATRI:

Faleminderit. Inderuar Kryetar, të inderuar deputetë,

Procesi buxhetor në periudhën e paskonfliktit në Kosovë është karakterizuar me përpjekjet përsigurimin e të hyrave të nevojshme fiskale përfinancimin e nevojave me prioritet të lartë dhe përpjekjeve përenditimin e kapaciteteve humane të nevojshme përealizimin dhe menaxhimin institucional me fondet publike.

Nxjerra e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjit mbi administratën tatimore, Ligjit përmarrëveshjet financiare ndërkombëtare dhe disa ligjeve tjera

që mbulojnë sferën e politikave fiskale kanë qenë bazë e krijimit dhe konsolidimit të sistemit buxhetor të Kosovës.

Kjo bazë ligjore dhe përvoja pesëvjeçare, kanë ngritur çështjen e nevojës së reformimit të mëtejmë të sistemit buxhetor. Për këtë qëllim, Ministria e Ekonomisë dhe Financave po bën përpjekje që duke filuar nga ky vit në përgatitjen e projektibuxhetit për vitin 2006 të sigurojë që rrjedhimet buxhetore të reflektojnë sa më mirë prioritetet qeveritare, të cilat do të vëhen brenda një kornize afatmesme buxhetore.

Meqenëse kapacitetet e ekonomisë së Kosovës janë të nivelit që nuk mundësojnë të hyra fiskale të mjaftueshme për realizimin e projekteve të shumta me prioritet, Qeveria mendon se për këtë qëllim duhet shfrytëzuar të gjitha mundësitë për sigurimin e burimeve plotësuese financiare, duke përfshirë këtu edhe burimet nga donacionet dhe huamarjet.

Për ta realizuar këtë, nevojitet krijim i bazës ligjore, të cilën deri më tani nuk është përfshirë në ndonjë ligj apo dispozitë tjeter normative.

Ligji për marrëveshjet financiare ndërkombëtare, i miratuar në Kuvend dhe i shpallur nga Përfaqësuesi special, përcakton procedurat dhe përgjegjësitet për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare financiare, duke përfshirë edhe marrëveshjet për kredi dhe garantim.

Mirëpo, për rregullimin normativ të hyrjes borxh, është i nevojshëm aprovimi i këtij ligji, me të cilin, në mënyrë të plotë dhe të konkretizuar do të rregullohet ngarkimi me borxhe brenda dhe jashtë vendit, konform standardeve të institucioneve financiare ndërkombëtare. Pra, do të definohen format dhe procedurat e ngarkimit me borxh, niveli i ngarkimit, format dhe procedurat e dhënes së garacioneve nga Qeveria e Kosovës, menaxhimi me borxin publik, si dhe projektet prioritare që do të financohen nga mjetet e huazuara.

Nxjerra e këtij ligji është edhe një nga kërkesat e parashtruara në standardet e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën.

Të nderuar deputetë, Projektligi përbëhet nga 7 pjesë – me 36 nene.

Pjesa e parë, rregullon fushëveprimin dhe përkufizimet, përkatesisht lëndën dhe qëllimin e ligjit.

Pjesa e dytë, përfshin dispozitat lidhur me ngarkimin e sektorit publik, format e hyrjes në borxh dhe niveli i ngarkimit.

Pjesa e tretë, përfshin dispozitat mbi administrimin me borxin publik, me qëllim të menaxhimit efikas të tij.

Pjesa e katërt, përfshin dispozitat lidhur me lëshimin e garacioneve nga ana e Qeverisë së Kosovës, procedurën për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e garacioneve qeveritare dhe përfundimin e garacionit.

Pjesa e pestë, dispozitat për letrat me vlerë, me të cilat rregullohen emetimi, llojet e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria, vlera, kushtet, mënyra e shitjes dhe afatet e maturimit të letrave me vlerë.

Pjesa e gjashtë, dispozitat që i referohen procedurave në raste të onlending-ut – formë e huas ku Qeveria merr mjete nga huadhënësi dhe ua jep shfrytëzuesve të fundit.

Dhe, pjesa e shtatë e fundit – përfshin dispozitat kalimtare.

Ju propozoj që të votoni për aprovimin në parim të këtij Projektligji, i cili padashim se gjatë shqyrtimit në komisione përmes amendamentimit mund të kompletohet dhe begatohet. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju faleminderit. Hapim debatin. E ka fjalën Naser Osmani, në emër të LDK-sës. Urdhëroni Naser. Le të bëhet gati Mazllo Kumnova.

#### DEPUTETI NASER OSMANI:

I nderuar Kryetar, të nderuar kolegë dhe ministra. Projektligji për borxhe është përgatitur qysh në mandatin e kaluar të Qeverisë nga disa këshilltarë, të cilët kanë qenë të angazhuar dhe të cilët nuk kanë marrë parasysh ligjet ekzistuese që e rregullojnë këtë çështje.

Ligji për borxhe është një çështje e cila veças rregullohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Huamarja është një aktivitet fundekrye buxhetor. Çdo aspekt i huamarjes duhet të integrohet në procesin e zhvillimit të buxhetit. Kosova e ka një ligj të shkëlqyeshmë, gjithpërfshirës për procesin buxhetor dhe menaxhimin e financave publike. Çdo ndryshim në politikat tona të huamarjes, duhet të reflektohet në këtë ligj, përkatësisht në kapitullin e nëntë mbi kufizimet në huamarje, garacionet, kreditë dhe kapitalizimin.

Ligji për menaxhimin e financave publike është një instrument i përshtatshëm që na jep bazë të mjaftueshme ligjore për t'u marrë me kësot aktivitete në të ardhmen. Nëse dëshirojmë politikat tona lidhur me borxhet, atëherë më e udhës do të ishte që të ndryshojmë dhe plotësojmë politikat të cilat nuk janë mbuluar në mënyrë adekuante me ligjin aktual. Prandaj, konsideroj se nuk kemi nevojë të bëjmë ligje që krijojnë kolizion dhe propozoj në emër të Grupit të LDK ky ligj të tertiqet.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mazllo, po të kërkoj falje, por grapi i dytë me vonësë u paraqit. Në emër të PDK, Safete Hadërgjonaj, t'i japim pëparësi pra edhe në emër të gjinisë. Urdhëroni...

#### DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ:

Faleminderit zoti Kryetar. Ju përrhëndes të gjithë ju të pranishëm.

Projektligji për borxhet rregullon një problematikë të ndërlikuar në lëmin e financave dhe pajtohem me idenë se është një ligj i nevojshëm për të arritur një kornizë legislative gjithpërfshirëse për ekonominë.

Çështja e huamarjes, siç u tha edhe nga parafolësi, është rregulluar me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Mirëpo, ky Ligj ka qenë i ndikuar nga statusi i Kosovës

dhe nga Korniza kushtetuese. Ligji nuk përdor termin borxh qeveritar, por ka rregulluar të njëjtën huamarrje si rregullim që i bëhet borxhit qeveritar. Pra, në këtë ligj është rregulluar procesi i huamarrjes që ka koston e saj në buxhetin e Qeverisë dhe menaxhimi keq i kësaj huamarrjeje i bie në barrë buxheteve të viteve të ardhshme.

Sipas këtij ligji, shuma totale e borxhit publik, duhet të mos kalojë vlerën 60% të brutoproduktit vendor dhe që deficiti buxhetor të mos kalojë 3% të bruto-produktit vendor. Në njëfarë mënyre, problematika e borxhit është e rregulluar me Ligjin për menaxhimin e financave publike, por rrëthanat që kanë ekzistuar në Kosovë kanë kushtëzuar shumë kufizime në këtë drejtim për shkak të çështjes së bartjes së kompetencave.

Kur flasim për huazimet dhe për procedurën e hyrjes borxh, Kosova duhet të përcaktohet për huazime publike për nevoja të investimeve publike, por jo për nevoja të konsumit buxhetor, apo thjeshtë për të mbuluar deficitin/buxhetor, sepse kjo do të ndikonte shumë dëmshëm në qëndrueshmërinë buxhetore.

Në këto rrëthana, kur statusi i Kosovës është i padefinuar, Fondi monetar ndërkombëtar vazhdimeshi ka rekomanduar ndjekjen e një politike të kujdeshme të huazimit dhe të garantimit të borxhit – që ato mos të janë barrë e rëndë për Kosovën në periudhën afatmesme dhe afatgjate.

Mirëpo, nëse i anashkalojmë të gjitha këto çështje dhe analizojmë Projektligjin për borxhet, shohim se ky Projektligj ka të meta karakteresh të ndryshme, e unë do t'i paraqes vetëm disa: çështja e gjuhës; çështja e terminologjisë jopërbajtësore; çështja e formulimeve dhe nocioneve; çështja e zbatueshmërisë së Projektligjit; çështja e menaxhimit me borxin publik.

Është e vërtetë se Kosovës dhe institucioneve të pavarura vetëqeverisësë të Kosovës iu duhet qëndrim i ligeve sa më shpejt si parakusht për funksionimin normal të kornizës ligjore, por, si qëndrim, është bërë shprehi që ligjet të kopjohen e të njëjtit - nuk i përshtaten rrëthanave në Kosovë. Kanë një gjuhë të pakuptueshme, kanë renditje jo të mirë, disa dispozita nuk janë harmonizuar me dispozita të ligeve të miratuara më parë. E njëjtë gjë, po ndodhë edhe me këtë Projektligj që na është ofruar në shqyrtim.

Në analizën e këtij Projektligji, dalin shumë çështje që aspak nuk lidhen me realitetin në Kosovë dhe është vështirë i aplikueshëm me këta parametra ekzistues politik dhe ekonomik që janë në Kosovë.

Vërejtjet tona kanë të bëjnë duke filluar nga nen 2, kur është fjalë te definicionet dhe atë gjatë dhënies së sqarimeve për termat, për shembull "sektor publik", "borxhi publik", "qeveria", "programi vjetor i ngarkimit", "onlendingu" e tjera që kanë shumë paqartësi.

Vërejtje të ngjashme kemi edhe në nenin 3, nenin 5, nenin 7 paragrafi 3, nenin 11 paragrafi 1, nenin 13 paragrafi 1, nenin 31, nenin 32 dhe në disa nene të tjera.

Me këtë ligj, i është dhënë kompetencë e pakufizuar ministrit të financave saqë anashkalon edhe rolin e kryeministrit dhe Ministria e Financave i tejkalon kompetencat e Qeverisë.

Në Projektligj është dashur qartë të konkretizohet: kush është autoriteti që ka të drejtë në martjen e huave nga institucionet ndërkombëtare, shtetet e ndryshme, personat fizik e juridik.

Projektligji reflekton në mosnjohjen e lëndës, në aspektin e formulimit të nocioneve dhe të

terminologjisë së kuptimeve dhe përshkimeve, është i përcjellur me joprofesionalizëm dhe konfuzitet.

Sikur Ministri, në prezantimin e këtij ligji, të na paraqiste se cila është strategjia e implementimit të këtij ligji, atëherë do t'na lehtësonte shumë që të japid një votë formale për të bërë një punë më të madhe në amendamentimin e këtij ligji në komisione. Për ndryshe, me këtë ligj, vetëm sa do të hyjmë në inflacion ligjor, sepse është i pazbatueshëm.

Më mirë është që, për shkak të mangësive të shumta, Projektligji - me qëllim të përpunimit më të mirë dhe për të pasur mundësi konsultimi sa më të gjerë të ekspertëve profesional - ligji të rikthehet në përpunim.

Po ashtu, pata edhe një sugjerim... Në përgjithësi, vetë Projektligji tregon se është shumë e nevojshme që në Kuvend të angazhohet një grup i ekspertëve, qofshin ekspertë vendor por njëkohësisht edhe konsultat me ekspertët ndërkombëtar, që do të bashkëpunonte me Zyrën ligjore të Kryeministrit në mënyrë që të bëhet harmonizimi i projektligjeve me ligjet e aprovuara më parë dhe të mos vijnë në Kuvend ligje të cilat janë në konfuzion me ligjet e miratuara, me gabime gjuhësore e përmrbajtësore. Kështu, ekspertët do ta punonin edhe në harmonizimin e këtyre ligjeve me direktivat e Bashkësisë Evropiane. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Mazllom Kumnova – AAK, Ic të bëhet gati Nazim Jashari – ORA.

#### DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Edhe Grupi ynë ka marrë në shqyrtim këtë Projektligj dhe me këtë rast ka konstatuar se hartuesi ka pas kujdes në rrugimin e formës së procedurave, nivelin, qeverisjen e borxheve në publik, dhëni e garancive, si dhe raportin për borxhet publike. Mirëpo, që në fillim kemi qenë në dilemë athua është e domosdoshme që kjo përmrbajtje të ngritet në një ligj, siç është ky Projektligj, apo të jetë pjesë përbërëse ose të zë vend aty ku duhet në ligjin përfundim – me ligjin përkates. Mirëpo, nga Qeveria nuk kemi marrë një deklarim të tillë, prandaj na mbetet në - si Kuvend - të vendosim gjatë këtij procedimi.

Ndërsa, kur i kthehemi çështjeve më konkrete atëherë edhe vërejtjet tona janë se duhet të rishqyrtohet neni 3 pika 6 – çështja e detyrimeve. A ngarkohet Qeveria apo Ministria, dhe nëse është e dyta – cila është ajo.

Neni 5 ka paqartësi - kur me këtë ligj detyrohet edhe banka qendrore...

Neni 24 ka paqartësi, ndoshta nga mangësia e formimit gjuhësor...

Neni 30 ka paqartësi gjuhësore - deri te një mospërfillje totale të gjuhës shqipe.

Përkundër këtyre vërejtjeve, Grupi i AAK i hap rrugë, në njëfarë mënyre, këtij Projektligji qoftë si ligj me vete, apo si pjesë përbërëse e ndonjë ligji tjetër. Kaq, Kryetar. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Dhe - i fundit - Nazim Jashari. Urdhëroni.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Inderuar zoti Kryetar, të nderuar kolegë deputetë,  
Desha të shpreh kënaqësinë time për përgjegjshmërinë që ky Kuvend po manifeston si gjatë seancës të pjesës së djeshme ashtu edhe gjatë seancës së sotme.

Ky Projektligj që kemi përparrë, është një Projektligj të cilin Ministria si duket e ka pru pak me një nguti dhe pa një harmonizim paraprak - posaçërisht me koalicionin qeveritar dhe ne e përkrahim propozimin - edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës - që ky Projektligj t'i kthehet Ministrit për ta rishikuar dhe për të punuar në të akoma dhe pastaj për ta sjell para Kuvendit në një formë pak më të pranueshme, dhe që t'mund Kuvendi ta procedojë më tutje në komision. Pra, mbetet që Qeveria të shfaq një dozë pak më të madhe serioziteti dhe t'mos ndodhë që kështu të hasë në një mur refuzues në Kuvend. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se çështja është e qartë. Po, urdhëroni Ministër. Ministri Hak Shatri dëshiron fjalën.

MINISTRI HAKI SHATRI:

Faleminderit zoti Kryetar. Edhe ne kemi qenë para dilemës se kjo materie a mund të rregullohet me ligj të veçantë apo mund të rregullohet në kuadër të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Meqenëse në Programin legjislativ të Qeverisë për këtë vit, ky ligj ka qenë i paraparë si ligji i veçantë, ne i jemi qasur dhe e kemi proceduar si ligj të veçantë.

Në qoftë se nuk ka pengesa formale, i kisha propozuar Kuvendit që një të mos tërhiqet nga procedimi, por të vazhdojë në diskutim në komisione në vazhdim dhe pastaj të vazhdojë puna në një formë që mund të transformohet në projektligj për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. T'i ndërrrohet emri dhe kjo materie të bëhet pjesëpërbërëse e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Për Qeverinë është me rëndësi që kjo sferë të rregullohet sa më shpejt dhe të rregullohet me ligj. Sepse, siç jeni në dijeni, deri tash janë lidhë dy marrëveshje me bankat ndërkombëtare dhe ne do të humbnim shumë kohë derisa të përgatisim një projektligj në vit, ose derisa të hyjmë në procedurë të re. Këtë propozim e kam vetëm me qëllim të përfitimit në kohë. Kurgjo tjetër nuk mëshihet prapa kësaj.

Kurse, zoti Mazlom – sa i përket çështjes së bankës qendore. Unë me kënaqësi do të shfrytëzoj këtë rast t'ju informoj se institucionet e Qeverisë së Kosovës, në bashkëpunim me UNMIK-un në procesin e transformimit të kompetencave nga UNMIK-u te institucionet vendore dje në procesin e ndryshimit të Rregullores për BPK-ën – kanë arritur pëlqim dhe kanë vendos që BPK-ja e deritashme – tash e tutje të jetë: Bankë Qendore e Kosovës. Ju faleminderit.

(Duartrokutje)

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ministër, ju faleminderit për këtë informatë të rëndësishme. Procedurash nuk është e mundshme kërkesa. Parlamenti jep mundësi që t'i drejtoheni Kryesisë, Kryesia autorizon komisionin përkatës dhe në bashkëpunim me Qeverinë – me procedurë të përshtypetur, në qoftë se ju e vlerësoni, për këtë pastaj është i gatshëm Parlamenti, por tani nuk mund të hyjmë në procedurë të mëtejshme për këtë. Ju faleminderit.

Tash propozoj dhe ju fitoj – pasi Sabri u kthye – ne të tjerët tash të shkojmë në një kafepauzë prej 30 minutash.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Unë do t'ju lutja t'i zëmë vendet dhe të vazhdojmë punën. Sot me gjimnastikë të numrave do të merrem. 69 deputetë janë të pranishëm në sallë, prandaj mund të marrim vendime të plotfuqishme.

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës, kurse për pikën 5, 7 dhe 9 do t'i presim referuesit. Propozoj kështu për t'mos humbur kohë.

- Shqyrtimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve të Kuvendit.

Me kërkesë të Grupit Parlamentar të LDK, konform Rregullës 38.6 - Kryesia i propozon Kuvendit që të miratojë këtë:

**V E N D I M**

1. Deputeti Sadudin Berisha, emërohet anëtar i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kuqstetuese në vend të deputetit Fatmir Sejdiu;
2. Deputetja Remzije Nirmani, emërohet anëtare e Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport në vend të deputetit Sabri Hamiti; dhe
3. Deputeti Ilmi Ahmeti, emërohet anëtar i Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim në BE në vend të deputetit Naim Jerliu.

Mendoj se, si çdoherë, duhet të kemi votim formal dhe të përcaktohem. Kush është për këtë vendim? Ju faleminderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nu ka.

Prandaj konstatoj se edhe pikë e dhjetë e rendit të ditës ka përfunduar.

(Ndërpunjje e shkurtër)

Do të kthehem pas - në pikën e pestë të rendit të ditës, Kryeministri si referues, në emër të Qeverisë, është këtu.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurat kontestimore.

Konstatime hyrëse: Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me kohë – më 18 prill 2005 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional, përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Bajram Kosumi që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Foltorja është e juaja, Kryeministri. Urdhëroni...

#### KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:

Inderuar Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,  
Kam kënaqësi që në Seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës të prezantoj për shqyrtim dhe miratim njërin ndër projektet legislative më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës – Projektligjin për procedurën kontestimore.

Ky Projektligji, i cili është i paraqitur nga Zyra e Kryeministrat në bashkëpunim me Grupin e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, ofron një ndihmësë të rëndësishme në kompletimin e infrastrukturës ligjore në çështjet juridiko-civile.

Që në fillim, dëshiroj t'ju vë në kujtesë rëndësinë e veçantë që ka ky Projektligji, por edhe Projektligji për procedurën jashtëkontestimore dhe Projektligji për procedurën përmbaruese – të cilët do t'i parashtron këtij Kuvendi për shqyrtim dhe miratim në njëren nga seancat e ardhshme të tij.

Projektligjet në fjalë paraqesin pjesë të rëndësishme të legjislacionit, me të cilat mbulohet pothuaj në tërësi fusha e marrëdhënieve civile-juridike dhe me të cilat ligje rregullohen në detaje procedurat para gjykatave civile që nga fillimi e deri në përmbarimi i tyre.

Projektligji për procedurën kontestimore përbën gjithsej 33 kriteri dhe ka 530 nene, duke filluar nga Dispozitat themelore deri në Dispozitat kalimtare dhe të fundit. Tërë përbajtja e Projektligjit paraqet një version të detajizuar të procedurave, të cilat janë zbatuar deri më tash nga gjykatat tonë në çështjet kontestimore.

Në këtë Projektligji janë dhënë ndryshime dhe zgjidhje të reja, të cilat janë shprehje e nevojave për një ligj modern, i cili rregullon në mënyrë më të përshtatshme procedurat në gjykatat civile.

Me këtë Projektligji janë ofruar zgjidhje përsa i përket shumë vështirësive, me të cilat praktika gjyqësore është përbollur gjatë zbatimit të ligjit të vjetër për procedurën kontestimore.

Gjithashtu, me këtë Projektligji thjeshtësohen format e ushtrimit të parashtresave të ndryshme para gjykatave por gjithnjë duke tentuar që kjo të mos shkojë në dëm të kualitetit juridik të Projektligjit.

Me këtë Projektligji janë shkurtuar afatet të cilat kanë ekzistuar në ligjin e vjetër, dhe në disa raste nuk parashihen gjyqtarët porotë, për shembull, para Gjykatës Supreme dhe kjo në funksion të efikasitetit dhe zbatueshmërisë më efikase të ligjit dhe të zvogëlimit të shpenzimeve procedurale.

Projektligji në fjalë, ka kaluar në të gjitha fazat e parapara me ligj për hartimin e tij, dhe në punimin e tij ekspertët kanë treguar vullnet, angazhim dhe përkushtim maksimal si dhe

kompetencë e profesionalitetit. Kjo nënkuption se ky Projektligj ka kaluar me sukses të gjitha aspektet e standardizimit dhe harmonizimit me Njësinë për standardizim dhe harmonizim të Zyrës për Integrime Evropiane. Për këtë, vlerësimet e tyre i kanë dhënë edhe ekspertët e huaj të cilët kanë bashkëpunuar gjatë vlerësimit të këtij Projektligji.

Të gjitha vlerësimet e ekspertëve për këtë Projektligj, kanë qenë pozitive, e po ashtu edhe pesha, rëndësia dhe prioriteti për legjislacionin që mbulon këtë fushë, i cili rezulton nga plani implementues Standardet për Kosovën supozon interesimin tonë që të kërkojmë aprovimin në parim të këtij Projektligji dhe kalimin e tij në procedurat vijuese të parashikuara me legjislacionin në fuqi. Ju fitoj që ta përkrahni. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACL:

Kryeministër, ju faleminderit. Hapim debatin. E ka fjalën Ramadan Kelmendi, në emër të LDK, le të bëhet gati Nerkhivane Dauti...në emër të PDK. Ashtu a, qenka paraqitur Nekibe Kelmendi në emër të LDK dhe kërkoj falje për këtë ndryshim. Urdhëroni Nekibe,

#### DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

I nderuari Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, të nderuar deputetë,  
Grupi Parlamentar i LDK, ka mirëpritur hartimin e Projektligjit për procedurën kontestimore, me të cilin tanimë po afrohet plotësimi i mozaikut të ligjeve sistemore të Kosovës.

Me rregullat procedurale të parapara me këtë Projektligj sigurohet mbrojtja gjyqësore dhe realizimi i të drejtave të cenuara, të trezikuara ose të kontestuara subjektive civile. Për dallim nga ligji i mëparshëm, ky Projektligj me qëllim të shkarkimit të gjykatave, ka paraparë arbitrazhin si mënyrë të zgjidhjes së kontesteve në çështjet tregtare. Në këtë mënyrë, është arritur efikasitet më i madh i gjykatave që ndikon në shkurtimin e kohëzgjatjes së zgjidhjes së kontestit. Risi tjetër është se me këtë ligj, përvës llojeve të mëparshme të aktgjykimeve, është paraparë edhe një lloj i ri i vendimit gjyqësor, e ky është aktgjykimi për shkak të mosdëgjueshmërisë, me të cilin kontesti midis palëve merr fund sikur edhe me aktgjykimet tjera.

Projektligji ka adoptuar të gjitha parimet themelore të procedurës kontestimore, siç janë: parimi i dispozicionit, i shqyrtimit, i dëgjimit të palëve, i koncentrimit, i ekonomisë procesuale, parimi verbal, parimi i drejtpërdrejtshmërisë, i publicitetit, i ndihmës së palës laike e tjera.

Teknika e hartimit të këtij Projektligji është e mirë, por kjo nuk nënkupton se është edhe e përsosur, për çka në vijim shkurtimisht do të bëhen vetëm disa vërejtje.

Vlen të ceket se ky ligj është i standardizuar, sikur që tha edhe zoti Kryeministër, dhe për standardizimin e tij janë shfrytëzuar këto dokumente ndërkombëtare:

- Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të plotësuara me Protokollin I që rregullon të drejtën për mbrojtjen e pronësisë; Gjykata e pavarur dhe paanshmëria e gjykatave;
- Deklarata universale mbi jurisprudencën e pavarur, apo gjyqësorin e pavarur;
- Rregullat e përgjithshme mbi pavarësinë e gjyqësisë;
- Rregullat procedurale të Gjykates së Parë të Bashkimit Evropian;
- Rregullat procedurale të Gjykates së Drejtësisë e Bashkimit Evropian;
- Konventat ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike;

- Karta mbi tē drejtat themelore tē Bashkimit Evropian, tē Këshillit tē Evropës, Komitetit tē Ministrave;
- Rekomandimi numër R-84 mbi parimet e procedurës civile; për parimin e realizimit tē drejtësisë, e shumë dokumente tē tjera ndërkombëtarisht tē pranuara.

Sic thash, ka disa vërejtje. Vërejtja më e madhe, sa i përket teknikës së hartimit tē ligjit, konsiston në atë se radhitja e fazave procedurale është bërë në mënyrë tē papërshtatshme dhe tē pazakonshme, sepse procedura e shkallës së parë është vendosur pas procedurës së shkallës së dytë e që do tē duhej tē jetë e kundërtë.

Sa i përket vërejtjeve në nene konkrete, Grupi Parlamentar i LDK tash për tash është përqendruar vetëm në disa sosh. Kështu, meqë me nenin 6 është rregulluar çështja e përdorimit tē gjuhës në procedurën kontestimore, fndoshta në vazhdim tē këtij nenit do tē duhej tē barteshin nenet 96, 97 dhe 98 meqë edhe këto nene e rregullojnë po tē njëjtën çështje, pra çështjen gjuhësore në procedurën gjyqësore.

Neni 116 duhet tē thjeshtësohet dhe tē lirohet nga pjesa që lidhet me mjetet e jashtëzakonshme juridike meqë ekziston pjesa e veçantë me tē cilën është rregulluar se kundër cila vendimeve dhe brenda cila afateve mund tē përdoren mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Çështja e përdorimit tē mjeteve teknike apo e stenogramit, duhet tē rregullohet në mënyrë më tē përshtatshme dhe më tē plotësuar e jo ashtu sic është rregulluar me nenin 138.

Meqë me nenin 146 është lënë mundësi e marres së aktgjykimit tē pjesshëm, pjesa lidhur me aktgjykimin plotësues duhet tē vendoset pas nenit 146.

Me nenin 152 duhet tē përcaktohet afati për shpalljen e aktgjykimit dhe afati përpilimin me shkrim dhe dorëzimin e vendimit palëve në procedurë. Nuk mjafton vetëm që për vonesa të opalljes dhe tē dorëzimit tē aktgjykimit palëve në procedurë tē njoftohet kryetari i gjykatës por duhet tē parashihen masa tē tjera në mënyrë që drejtësia tē mos vonohet. Sepse, nëse drejtësia vonohet, është barazi me padrejtësi.

Pa arsyё tё justifikueshme, nё Projektligj nuk ёshtë përfshirë edhe një mjet i jashtëzakonshëm juridik, sic është kérkesa përmbrojtjen e ligjshmërisë.

Ka vend edhe për intervenime tē tjera, por këto do tē bëhen në fazën e shqyrtimit tē mëtutjeshëm nëpërmjet amendamenteve që do tē bëhen.

Përndryshe, Grupi Parlamentar i LDK e mbështet në parim Projektligjin për procedurën kontestimore, kurse mangësitë e sipërpërmendura dhe mangësitë e tjera eventuale, do tē eliminohen me anë tē amendamentimeve. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemndérit Nekibe. E ka fjalën Nerxhivane Dauti, le tē bëhet gati Bislim Hoti.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Të nderuar deputetë,

Projektligji për procedurën kontestimore hyn në grupin e ligjeve më të rëndësishme sistemore që - së bashku me katër ligjet tjera të miratuara në këtë Kuvend sic janë Ligji për të drejtat

sendore, ai i Familjes, i Trashëgimit dhe i Detyrimeve – përbëjnë tërësinë e kodit civil të Kosovës.

Nevoja përfshirë këtë ligj është e pakontestuese, sepse si i tillë do të eliminonte të gjitha pengesat procedurale me të cilat janë ballafaquar gjykatat dhe palët gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore në praktikën tonë gjyqësore.

Megjithatë, edhe pse është i një rëndësie të veçantë ky ligj, ligji i propozuar ka mangësi, të cilat do t'i prezantoj në vijim:

Së pari.- Ligji nuk përputhet me Udhëzimin administrativ numër 8/2004 të Qeverisë së Kosovës lidhur me procedurat e hartimit dhe të dorëzimit të projektligjeve Qeverisë dhe Kuvendit.

Së dyti.- Ligji nuk është i standardizuar juridikisht dhe nuk është i formatizuar fare.

Së terti.- Versionet në tri gjuhë: shqip-anglisht-serbisht nuk janë harmonizuar fare.

Së katërti.- 90% e neneve të inkorporuara në këtë ligj, që përmban gjithsej 530 – fare nuk janë ndarë në paragrafë dhe pika përkatëse.

Së pesti.- Ekzistojnë edhe gabime dhe mungesa tjera në ligj, të cilat u caktuaj edhe nga parafolesja ime, që po të miratohej në shqyrtim të parë - do të dëmtonin cilësinë e ligjit në tërësi.

Duke marrë parasysh vërejtjet e theksuara në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në cilësinë e anëtarës së Komisionit për legjislacion, propozoj që Projektligji përfshirë procedurën kontestimore t'i kthehet Qeverisë me qëllim që ligji të përpunohet dhe të kompletohet në tërësi. Ju faleminderit përvëmendjen.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit shumë. E ka fjalën Bislim Hoti, le të përgatitet Teuta Sahatqija.

#### DEPUTETI BISLIM HOTI:

- Inderuar zoti Kryetar, të nderuar kolegë deputetë,
- Grupi Parlamentar i AAK-IRDK ka shqyrtuar Projektligjin përfshirë procedurën kontestimore dhe në këtë rast ka konstatuar se do ta përkrahë në parim përfshirë t'i dhënë vizë në procesin e mëtutjeshëm.

Gjatë shqyrtimit, ne si Grup Parlamentar do t'i japim mendimet tona, duke pas parasysh edhe të gjitha ato vërejtjet që diskutohen nga ana e deputetëve tjerë dhë në mënyrë perfektionuese ta bëjmë një ligj të fortë i cili do të ishte mjaft i rëndësishëm përfshirë Kosovën. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit Bislim. E ka fjalën Teuta, le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Duke pas parasysh se ky ligj ka rëndësinë e veçantë, rëndësinë e madhe përfshirë legjislacionin tonë dhe duke pas parasysh vërejtjet të cilat i dëgjuam prej profesionistëve dhe parafoseve të mia, mendojmë që ky ligj do të duhet të kthehet në ripunim, në mënyrë që kur të vjen në aprovim ne

Parlament tē jetē i plotësuar dhe tē mos i ketē këto defekte. Prandaj ne nuk e përkrahim, por mendojmë se duhet tē kthehet. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën Ramadan Kelmendi, le tē bëhet gati Milazim Haliti.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

I nderuari Kryetar, tē nderuar deputetë, i nderuari Kryeministër, Një ndër ligjet me rëndësi të madhe, e që begaton infrastrukturën ligjore në Kosovë, padyshim është propozimligji pér procedurën kontestimore. Pas analizës që i kam bërë këtij propozimligji, vlerësoj se ky propozimligj ka bazueshmëri juridik pér t'u proceduar e aprovuar dhe se me përbajtjen që ofron nuk prek me asnjë dispozitë kompetencat e rezervuara, por ka shumë lëshime tē cilat në përbajtje nuk janë tē mirëfillta.

Personalisht mendoj se disa dispozita tē propozimligjit janë aq tē gjata sa kalojnë në shpjegime teorike dhe se humbin vlerën e dispozitës ligjore. Po ashtu, kur disa anëtarë tē Komisionit pér hartimin e këtij propozimligji kanë deklaruar se nuk kanë marrë pjesë por vetëm ua kanë vënë emrat, veprim i tillë nuk është i mirë dhe as korrekt.

Megjithëkëtë, kur Kosova po kalon në ekonominë e tregut tē lirë, është mëse e arsyeshme tē vihet jashtë zbatimi i ligjit i procedurës kontestimore i vitit 1977, i cili është diskriminues nga se ka përcaktim formale-juridike tē tejkaluara, tē cilat janë në kundërshtim edhe me fushën e standardeve të Bashkësisë Evropiane. Propozimligji i procedurës kontestimore i Kosovës duhet tē jetë në harmoni me kohën e proceseve demokratike nëpér tē cilat po kalon Kosova, duke mënjanuar pengesat që janë shkaktuar më parë.

Mendoj se vërejtja përbajtësore, kryesore dhe qëllimt. ;ë mund t'i bëhet këtij propozimligji është fakti se baza mbi tē cilën ngritet ky propozimligji merret ligji i vjetër, i procedurës kontestimore i ish-Jugosllavisë dhe se struktura juridike e tij, e cila si e tillë është e tejkaluar dhe diskriminuese, në vend tē merret ndonjë model i ligjeve tē ndonjë shteti tē Bashkësisë Evropiane më i avancuar.

Propozimligji në përcaktimin e rrëgullave tē reja juridike, në kontestet juridiko-civile pak vend i lë lirisë së mbrojtjes së interesit tē palës në proceset kontestimore, gjegjësisht propozimligji i mungon lënia e mundësisë pér formimin e gjykatave tē specializuara dhe veçoj, pér shembull – çështjet e marrëdhënies së punës, kontesteve ekonomike, atyre trashëgimore dhe arbitrazhës.

Megjithkëto vërejtje pozitive, ky propozimligj afiron zgjidhjet më adekuatë në marrëdhëniet juridiko-civile tē personave juridik dhe fizik, duke i vënë ato brenda rrëgullave ligjore. Vlerësoj se gjykata duhet tē shqyrtojë kërkesëpadinë në çështjet juridike tē paraqitura vetëm me shkrim dhe jo kërkesëpaditë gojore dhe publike siç janë përfshirë në nenin 4, ngase në raste tē tillë do tē lë pasoja tē papranueshme në procedurat kontestimore.

Në rrethanat e krijuara në Kosovë, pala e interesuar në proceset kontestimore nuk ka mundësi t'i sigurojë tē gjitha provat, faktet dhe dëshmitë pér ta mbështetur kërkesëpadinë. Andaj, në raste tē tillë duhet përcaktuar se gjykata tē merr në mënyrë zyrtare kërkesat nga organi kompetent dhe t'i sigurojë ato, siç janë: rëza marrëdhënia pronësore-juridike, banesore e tjera – konflikte tē cilat janë shumë tē ndjeshme dhe prezantë në Kosovë.

Propozimligji lë zbrastësirë juridike në rastet kur lënda bartet nga një gjykatë në tjetrën, për shkak të jokompetencave lëndore dhe territoriale, të rikthimit në kompetencë e tjera. Përcaktimi se gjykatat tona nuk kanë kompetencia në shqyrtimin e kontesteve të shtetasve të huaj, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, e tjera dhe se në raste të tillë vlefshme nregullat e së drejtës ndërkombëtare – është e diskutueshme në teori dhe në praktikë juridike dhe i paqëndrueshëm. Sepse kjo nregullat nuk vlen në asnjë shtet tjetër të botës, nga se kompetencat territoriale vijnë në aplikim në secilin shtet veç e veç dhe ne nuk mund të bëjmë përjashtime, si për shembull kontestet mëresore – neni 40, e tjera. Paditësi, në kërkesën pronësore-juridike ka vështirësi të përcaktuara. Vlera e kontestit, natyrishët do të jetë subjektive dhe do të ishte mirë që propozimligji të përcaktojë komisionin ekspert e profesional për raste të tillë.

Propozimligji duhet të jetë i saktë, nga se kërkon që parashtesa e ankesa duhet të dorëzohet në numër të mjaftuar, kjo do të thotë në numër të pakufij si dhe të mund të dorëzohen prej orës shtatë deri në orën ...

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju lutem, le ta përfundojë. Kyçjani prap mikrofonin deputetit.

**DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:**

Dhe, krejt në fund, vlerësoj se marrja e aktgjykimit vetëm në bazë të pohimit apo të pranimit, është i padrejtë nga se me paramendime dhe parapërgatitje bëhen shpeshherë pranime të veprave dhe se shqyrtimi konkret do të vërtetojë drejtësinë, kurse ankesa e afatshme patjetër duhet të pengojë ekzekutimin e vendimit.

Megjithkëto sugjerime, mendoj se këtij propozimligji duhet t'i bëhen arsyeshëm ndryshime dhe plotësimet e procedurën e mëtutjeshme. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Dhe, Milazim Haliti. Urdhëroni Milazim.

**DEPUTETI MILAZIM HALITI:**

Faleminderit. Inderuari zoti Kryetar, inderuari zoti Kryeministër, të inderuar deputetë, Projektligi për procedurën kontestimore, është i rëndësishëm sepse cakton nregullat procedurale për zgjidhjen e kontesteve nga gjykata për marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizik dhe juridik dhe bën një shkëputje nga ligji i vjetër që nuk i përshtatet nevojave të kohës dhe i takon një sistemi të kaluar.

Rrethanat e reja në Kosovë kërkojnë që të kemi ligjin e harmonizuar me standartet ndërkombëtare që, siç thuhet në Projektligj, janë marrë parasysh konventat, rekomandimet dhe standardet që kanë të bëjnë me lëndën e procedurës civile. Projektligi ka strukturën e duhur dhe është mjaft voluminoz, që përbëhet prej 3 pjesëve kryesore dhe ka 530 nene. Këtë Projektligj e përkrah në parim me ndonjë vërejtje, sugjerim dhe propozim që do t'i bëhet këtij Projektligji e që mund t'i përmend tanë në vijim.

Në nenin 99 paragrafi 4, të sqarohet më mirë – kur dhe si konsiderohet parashtesa: “është e verifikuar nga firma e kualifikuar elektronike”.

Para nenit 149, përkatësisht në tekstin nën pikën q) fjalët: “padëgjueshmërisë, mosbindjes” mendoj se duhet të zëvendësohen me fjalë të tjera, si: “mosparaqijes së përgjigjes në padi - nga se pasojë e mosparaqijes së përgjigjes në padi është aprovimi i kërkesëpadisë”.

Në faqen 39, titulli “Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit” të ndryshohet dhe të bëhet “Vendosja, hartimi me shkrim, shpallja dhe dërgimi i aktgjykimit”.

Në të gjitha nenet, fjalët “dhënia e aktgjykimit” të zëvendësohen me fjalën “shpallja e aktgjykimit”.

Në nenin 177, paragrafi 1, fala “tregimin” të zëvendësohet me “numrin dhe datën”.

Në nenin 194, paragrafi 1, të fshihet pika: “1) ta hedhë poshtë ankesën, si e vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;” nga se kjo është paraparë në dispozitën e nenit 195.

Në nenin 511, paragrafi 4 është i paqartë nga se në të pas presjes thuhet: “por nuk mund të evitojnë zbatimin e dispozitave të alinesë 7 të këtij neni”, kurse ky nen ka 5 aline, që do të thotë nuk ekziston fare alineja 7.

Projektligji për procedurën kontestimore ka nevojë të lekturohet dhe të korrigohet në aspektin gjuhësor si dhe shurmë dispozita mund të riformulohen më qartë, të cilën punë do ta bëjë Komisioni funksional në mënyrë që të lehtësohet interpretimi i tyre. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Tani duhet të përcaktohem. 90 deputetë janë në sallë.

Kush është për aprovimin në parim të këtij Projektligji, të lexuar? Ju falemnderit. Është shurmica absolute.

Kush është kundër? Le të numërohen votat – kundër.

Ju lutem, më sugjerohet që të shkojmë prej fillimit.

Kush është përf? Meqë është kërkesë, le të numërohen.

A ka votë abstenimi? Një abstenim.

58 vota janë përf; 26 kundër dhe 1 abstenim.

Konstatoj se ligji mund të shkojë në shqyrtim të mëtejshëm – në procedurë të mëtejshme.

Po ashtu, tash kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës të cilën e kapërcyem më parë.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë.

Konstatimet hyrëse: Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 22 prill 2005 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftoj Kryeministrin që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Projektligin. Foltorja është e juaja Kryeministri.

### KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:

Falemnderit Kryetar i Kuvendit, Të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, Qeveria e Kosovës po hyn në një fazë shumë të rëndësishme të përbushjes së strategjisë legjislative të vitit 2005, sidomos të pjesës prioritare të saj. I këtij karakteri është edhe Projektligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë, të cilin sot po e prezantoj para jush.

Bartëse e aktiviteteve për përgatitjen e këtij Projektligji ka qenë Zyra e Kryeministrat, ndërsa kontribut të çmuar kanë ofruar edhe përfaqësuesit e disa ministritave, përfaqësues të UNMIK-ut, të Këshillit të Evropës, OSBE, GTZ, AER e tjera.

Projektligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë paraqet bazën ligjore në të cilën do të mbështetet veprimtaria e bashkësive fetare, të drejtat dhe detyrat e bashkësive fetare, si dhe zhvillueshmëria e kapaciteteve menaxhuese të tyre.

Kompletimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë, mjaft të ndjeshme të jetës, është imperativ për institucionet dhe shoqërinë tonë. Kjo për faktin se një pjesë e konsiderueshme e të drejtave dhe detyrimeve të bashkësive fetare nuk janë të rregulluara fare me dispozita ligjore, duke lënë kështu zbrastësi juridike, kurse një pjesë tjeter e atyre të drejtave është e rregulluar me dispozita ligjore, të cilat nuk janë në harmoni me kërkasat më të reja të Kosovës, me standarde ndërkombëtare dhe me direktivat e Bashkësisë Evropiane.

Mbështetur në atë që theksuan më lartë, konsiderojmë se Qeveria e Kosovës ka arritur të nxjerrë para jush një Projektligji, i cili me kompetencë do të vendosë bazën ligjore të rregullimit dhe mbrojtjes së lirive themelore të bashkësive fetare.

Në këtë drejtim, Projektligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë rregullon çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes së besimit dhe të ndërgjegjes të secilit njeri, duke përfshirë mirëkuptimin, tolerancën dhe respektimin e ndërsjellë të lirisë së besimit dhe të ndërgjegjes, siguron të drejtën e secilit njeri që të shprehë besimin dhe bindjen e vet dhe të manifestojë atë përmes publikimeve, ceremonive fetare, organizimeve të vizitave me besimtarët e tjera.

Projektligji përbëhet prej 4 kapitujve dhe 41 neneve, i cili ka strukturën si në vijim:

Me Dispozitat e përgjithshme – Kreu i parë, përcaktohet rregullimi i lirisë së besimit dhe statusi juridik i bashkësive fetare.

Me Dispozitat e posaçme – Kreu i dytë dhe tretë, rregullohet kryerja e ceremonive fetare, mundësia e themelimit të shkollave e fakulteteve të secilit nivel, paprekshmëria e hapësitave të bashkësive fetare, evidentimi i bashkësive fetare e tjera.

Me Dispozitat përfundimtare – Kreu i katërt, rregullohet hyrja në fuqi e këtij ligji.

Të nderuar deputetë, më lejoni t'ju them se ky Projektligji është vlerësuar lartë nga ekspertë vendor dhe ndërkombëtar, sidomos nga ekspertë të Këshillit të Evropës.

Prandaj, ne në Qeveri konsiderojmë se aprovimi i Projektligjit për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë, përbën një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të funksionalizimit të sistemit legjislativ në Kosovë. Për këtë arsy, ju fitoj ta aprovon

Projektligjin në fjalë në mënyrë që e tërë kjo veprimtari të vendoset në suaza të kornizës adekuate ligjore. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit Kryeministër. Ë hapim debatin. Fjalën e ka Sabri Hamiti në emër të LDK, le të bëhet gati Berat Luzha në emër të PDK. Urdhëroni Sabri.

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

Zotni, Kryetar i Kuvendit Daci, zotni Kryeministër, kolegë deputetë,  
Ligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare ka një rëndësi kapitale, sepse – nën a) kodifikon njérën nga liritë thëmelore të njeriut; nën b) saktëson statusin e bashkësive fetare në shoqërinë demokratike, dhe nën c) artikulon të dhënën e ndarjes së administratës, pra shtetit e pushtetit nga feja.

Prandaj, ligji do një gjuhë të saktë e të qartë, sidomos në përcaktimin e nocioneve themelore. Ligji ka një materie, një substancë mirë të strukturouar por ka një variant shkrimi në shqip me një sintaksë thuaja të prishur.

Unë do t'i jap saktësish disa vërejtje që mendoj se duhet t'i ketë parasysh ai që e përpunon ligjin më tutje – Komisioni.

Nën një.- Ngatërrrohet nociioni i besimit me nacionin e fesë. Nuk është e njëjtë gjë.

Ngatërrrohet nociioni i ndërgjegjes me nacionin e përcaktimit fetar. Janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Në këtë vështrim, duhet të saktësohen nenet: 2, 3, 4, 6, 9, 13, 18, 21 dhe 26.

Nën dy.- Neni 7, pika 3 – që e keni në faqen e tetë të tekstit, duhet të formulohet: "Feja është e ndarë nga shteti, bashkësia fetare është e ndarë nga autoritetet publike". Kjo është fundamentele të shkruhet kështu.

Nën tre.- Neni 14, pika 2 dhe 3 – që është në faqen 11 të ligjit, duhet të saktësohet që "bashkësitë fetare të regjistruara duhet ta përbajnë emrin e Kosovës gjatë regjistrimit".

Nën katër.- Neni 16, duhet ta ketë alinenë 3, ku do të thuhej: "Ceremonitë fetare nuk mund të bëhen në institucionet publike, në shkolla etj.". Kjo është po ashtu me rëndësi të veçantë.

Nën pesë.- Neni 24 është i papërcaktuar dhe i diskutueshëm, ndoshta të hiqet i téri. Në të thuhet se "PSSP-ja vendos për të drejtën e besimit e të praktikimit të fesë në TMK dhe në SHPK". Ky është nen shumë i paqartë dhe i papërcaktuar.

Nën gjashtë.- Neni 25, duhet të hiqen pikat 2 dhe 3 – që është në faqen 17. Mendoj se Qeveria nuk duhet të financojë bashkësitë fetare. Ka të bëjë me financimin e bashkësive fetare nga ana e Qeverisë.

Nën shtatë.- Në nenin 30, pika 3 – që është në faqen 20, të saktësohet mënyra e regjistrimit të degëve të qendrave fetare nga jashtë Kosovës në degët në Kosovë.

Mendojmë që ligji mund të kalohet në lexim të parë, me kushtin e redaktimit gjuhësor të tekstit të shqip.

Edhe një herë po theksoj: Kjo është paradoks. Teksti anglisht dhe serbisht është i saktë. Teksti shqip është i pasaktë. Le të mendojë sponsoruesi pse ka ndodh kjo. Ndërsa, meqë sponsoruesi është Qeveria dhe këtu është kryetari i Qeverisë.... Unë e njoh Bajram Kosumin, se e kam të zanatit. As fjalimin që e mbajti për këtë ligj është e pamundur që e ka shkruar ai, sepse formulën e tipit "zhvillueshmëria e kapaciteteve menaxhuese" që e tha ai këtu - është e pamundur ta thotë ai. Atëherë, tekstet e ligjeve dhe të fjalimeve, ju lutem shumë - të shkruhen saktë dhe shqip. Faleminderit shumë. Fola në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

#### **KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DASI:**

Falemnderit profesor. Shpeshherë dhe shumëkush i lexon fletat që nuk janë të vetat. Prandaj, nënkuftohet kjo, dhe unë nuk po dua ta mbroj Kryeministrin as gjuhën e tij, por janë shërbimet dhe vërejtjet janë serioze, por s'kemi nevojë me emra....

(Ndërhyrje e deputetit S.H. – pa kycie të mikrofonit)

Mirë, falemnderit. Dakord. E ka fjalën Berat Luzha, le të bëhet gati Gjylnaze Syla. Urdhëroni Berat.

#### **DEPUTETI BERAT LUZHA:**

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar zoti Kryeministër, Projektligji për lirinë fetare dhe për pozitën juridike të bashkësive fetare, ka një rëndësi të madhe përmes tregullimin e njërsë nga sferat më të rëndësishme të shoqërisë.

Ajo çka bie në sy në këtë ligj është se askund në tekstin e Projektligjit nuk përmenden objektet fetare, si xhamitë, kishat apo tempujt tjerë fetar. Vetëm në një vend përdoret gabimi i fjalës "prift" në vend të fjalës "klerik".

Në ligj kufizohet e drejta e bashkësive fetare për sigurimin e bazës materiale, domethënë të drejtëni e krijimit, të fitimit dhe të shpenzimit pasi ato apriori klasifikohen si organizata joprofitabile. Gjithashtu, bashkësive fetare duhet lënë të drejtëni e organizimit dhe të udhëheqjes së vizitave vendeve të shenja – pelegrinazhit për besimtarët e vet.

Në ligj duhet shikuar mundësinë edhe për lirimin apo lehtësitet e tatimit dhe lehtësitet në dogancë, për shkak të specifikave që i ka bashkësia fetare.

Ky Projektligji, si edhe Projektligji i kaluar paraprak përmes mibeturinat, janë vonuar aq shumë në procedurë derisa kanë ardhë në Kuvend. Përndryshe, për një muaj, që nga mbledhja e kaluar, nga Qeveria kanë ardhur vetëm katër projektligje, gjysma e tyre janë të bartura nga viti i kaluar. Si do t'i hartojë Qeveria njëqind ligje, të premtuara dhe si do ta kompletojë infrastrukturën ligjore si njëren nga standardet më të rëndësishme për Kosovën me këtë dinamikë të bërges së ligjeve.

Grupi Parlamentar i PDK pajtohet që ky ligj të miratohet në shqyrtimin e parë.

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Berat faleminderit. E ka fjalën deputetja Gjylnaze, pastaj le të përgatitet Genc Gorani – ORA.

### DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

Faleminderit. I nderuari zoti Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, deputetë të nderuar, Projektligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësisë fetare në Kosovë është një ligj i mirë dhe i rëndësishëm ngase mbron dhe promovon religionet dhe besimin në Kosovë, por gjithashtu mbron edhe kulturën kosovare.

Në Kosovë ekzistojnë religjione të cilat praktikohen me shekuj. Këto religjione dhe monumentet e tyre janë pjesë e kulturës dhe historisë së bujshme të Kosovës. Religjioni në Kosovë, përkundër luftërave të shumta në histori, ka pasur vendin e veçantë dhe të respektuar. Këtë e dëshmon edhe ekzistimi i monumenteve të shumta religioze në Kosovë.

Populli i Kosovës ka pas gjithmonë qëndrim tolerant ndaj religjioneve të shumta. Këtë e dëshmon edhe fakti se populli i Kosovës është i përfaqësuar në tri religjione. Edhe sot komunitetet religioze gëzojnë një status të veçantë në shoqëri. Bashkësítë fetare kanë qenë dhe kanë mbetur jashtë intervenimeve politike dhe jashtë intervenimeve të institucioneve shtetërore. Komunitetet fetare gëzojnë privilegje dhe liri të shumta në shoqëri. Populli i respëkton këto bashkësi dhe pronën e tyre.

Megjithatë, duhet të jemi të vëmendshëm meqë në kohët e fundit në Kosovë janë lajmëruar disa sekte të ndryshme, qoftë të feve të pranuara në Kosovë, por qoftë edhe të pavarura nga çdo fe. Në popullsi ekziston një skepticizëm i madh ndaj këtyre sektave, ngase as populli e as organet shtetërore nuk janë të informuara lidhur me veprimtarinë e tyre. Disa nga ato kalojnë spektrin religioz dhe tentojnë të ndërhyjnë në çështje pol... gjë që bie ndesh me parimet shpirtërore dhe humaniste të fesë.

Religionet e pranuara në Kosovë, e kanë fituar besimin e qytetarëve përmes veprimtarisë së tyre me shekuj. Mirëbesimin e qytetarit, të organeve shtetërore dhe shoqërisë në tërësi ndaj komuniteteve të pranuara fetare në Kosovë nuk mund të gëzojnë me ligj edhe komunitetet dhe sektet tjera. Këtë mirëbesim dhe privilegjet tjera, të merituara për komunitetet fetare të pranuara, duhet t'i ruajmë dhe mos t'i vëmë në rrezik duke lejuar që çdokush dhe çfarëdo veprimtarie të thirren në këtë emër.

Në shumicën e vendeve evropiane, këto organizata nuk gëzojnë të drejtat e njëjtë me religionet e pranuara.

Në nenin 3 të këtij Projektligji, nuk përcaktohet qartë se ku qëndron ndryshimi në mes të fesë dhe të besimit. Këtu flitet për të drejtën e mendimit, vetëdijes, besimit dhe fesë duke mos bërë dallimin e qartë të këtyre nocioneve.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, konsideron se interpretimi i gjërë i së drejtës së fesë dhe besimit nuk çon drejt promovimit të tolerancës fetare dhe promovimit të fesë në përgjithësi. Për këtë arsy, kërkojmë që në kuadër të këtij neni, ose diku tjetër në ligj, të definohet qartë se çfarë është feja, besimi, vetëdija ose mendimi. Të gjitha këto të drejta nuk mund të kenë rangun e njëjtë të privilegjit dhe mbrojtjes në shoqëri.

Me këtë kusht, Grupi Parlamentar i Aleancës, miraton në parim Projektligjin.

Vërejtja tjetër parimore ka të bëjë lidhur me mungesën e deklaratës financiare në këtë Projektligj. Përkundër shkresës së Ministrisë së Financave, të bashkëngjitur me memorandumin shpjegues, përkundër faktit se me Projektligj parashihet të kryhet një zyre e regjistrimit dhe një komision i përbërë nga përfaqësuesit e bashkësive fetare si dhe përkundër pretendimit të Projektligjit të ndajnë mjete buxhetore bashkësive fetare, ky Projektligj nuk e përmban deklaratën financiare lidhur me implementimin e tij. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Genc Gorani, le të bëhet gati Xhezair Murati besoj për 6... Më fal Xhezair. Urdhëroni Genc.

#### DEPUTETI GENC GORANI:

Faleminderit zoti Kryetar, zoti Kryeministër, zonja dhe zotërinj deputetë, Grupi Parlamentar ORA përkrah në parim këtë Projektligj. Në parim po ashtu përkrahim shumicën e rekomandimeve të grupeve tjera parlamentare, për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme, thelbësore dhe rekomandojmë fuqimisht që Komisioni funksional përkatës t'i marrë këto parasysh.

Edhe një herë, ndonëse shumëherë është përsëritur, konstatojmë se ka lëshime shumë të rënda, thelbësore gjatë përkthimit të dokumenteve të këtij Projektligji. Mos për asgjë tjetër, vetëm për një ilustrim:

Në nenin 26 c), e keni tekstuasht: "Seminare ose krijuime" në kllapa (themelime) "që në mënyrë të efektshme janë të destinuar për trajnimin e ministrave të regionit ose të edukimit fetar". Marr lejen ta ripërkthej, meqenëse kemi aty versionin anglisht dhe serbokroatish. Duhet të jetë "seminare ose themelatë që në mënyrë efektive janë të destinuara për trajnimin e predikuesve të religionit", e jo të "ministrave të regionit". Pra, mendoj se Komisioni funksional përkatës do të ketë shumë punë për këtë dhe do ta lë këtë edhe si një ilustrim... Mjerisht, nuk jam i sigurt se kjo nuk do të përsëritet, sepse nuk po shoh çka konkretisht Kuvendi ose ne deputetët jemi duke ndërmarrë që këto projektligje të mos na vijnë më ne këtë nivel të përkthimit. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Xhezair Murati, le të bëhet gati Ferid Agani – nga Partia e Drejtësisë. Urdhëroni Xhezair.

#### DEPUTETI DŽEZAIR MURATI:

Poštovani predsedniče, kolege poslanici,

Mislim da je ovaj zakon stigao u vreme nakon više decenijskog statusa vjerskih prava i zajednica kada su bile na marginama društva i mislim da je on došao u pravo vreme i da i mi, kao i ostale demokratske zemlje, stavimo vjerska osećanja u okvire u kojima ih prihvataju i demokratske razvijene zemlje. Mislim da je komentar zakona u memorandumu suštinski sadržajno i jezički veoma konfuzan za razliku verzije teksta zakona na srpskom a koja je mnogo jasnija ali je dosta uopštena. Dakle, dijametralno se razlikuju sadržinski i jezički memorandum zakona i sam tekst Nacrtu zakona.

Dalje, u opštим odredbama ovog zakona ima dosta uopštenih odredaba, pogotovu kada su recimo u pitanju registrovanje novih vjerskih zajednica, nedostajanja kriterijuma koji odreduju

ili mogu tri čovjeka kao nevladinu organizaciju da osnuju recimo novu vjersku zajednicu ili neku sektu, o čemu su neki od kolega govorili i tako dalje. Mislim da tu treba pojasniti te kriterijume.

Dalje, u nedostatke ubrajam i izbegavanje pominjanja postojećih ili preovladujućih vjerskih zajednica na Kosovu. Nigde se ne pominju imenom koje su te zajednice. Recimo, nigde toga nema u tekstu, kao da bježimo od novih marginalnih zajednica i onih tradicionalnih koje su opšte prihvaćene. Nema jasnih odredaba izmedju onoga što je pravo, vjera, svijest i recimo ono što se može kao podsvjest, što se ubacuje.

Takodje ima nejasnoća kada je u pitanju finansiranje konkretno. Nacrt zakona se ne finansira, a sugerise se finansiranje iz konsolidovanog budžeta recimo vjerskih zajednica i tako dalje. Sve u svemu, to su primedbe što ne znači da mi u načelu ne prihvatom ovaj zakon. Mi ga prihvatom u načelu, ali mu treba prići dosta oprezno i dopuniti ga, jer je Radna grupa i potom proširena Radna grupa, potom i članovi – čitav tim ga radio, a došlo do ovih propusta. Dakle u načelu Parlamentarna grupa 6+ podržava ovaj zakon ali uz primedbe koje se moraju dopuniti i ubaciti. Hvala.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Ferid Agani, le tē bëhet gati profesor Mark Krasniqi.

#### DEPUTETI FERID AGANI:

Inderuar Kryetar i Kuvendit, inderuari Kryeministér, tē nderuar deputetë, Para nesh kemi projektin e dokumentit ligor, tē cilin Partia e Drejtësisë e konsideron si tejet tē rëndësishëm pér stabilitetin dhe zhvillimet e gjithmbarshme shoqërore në Kosovë.

Duke përvëndetur iniciativën pér tē rregulluar me ligj këtë lëmi, si dhe punën e bërë në këtë drejtim, do t'i parashtroj disa mangësi dhe propozime pér tejkalimin e tyre në fazat e ardhshme.

Çështja e parë ka tē bëjë me zbatimin e lirisë fetare tē mësimbesimit në shkollat publike. Mësimbesimi në shkollat publike është praktikë e verifikuar në shumë shtete, që mbështetet nga shumë konventa ndërkombëtare, që kanë tē bëjnë me çështjen e tē drejtave tē njeriut. Që nga gushti i vitit 1995 me udhëzimet e Kryetarit Clinton, mësimbesimi fetar është i lejuar në shkollat publike tē Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndërsa, e njëjta vlerë qëmoti është pasuri e sistemeve arsimore tē Shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe shumë shteteve tē tjera në rajon dhe në botë. Praktikën e mësimbesimit në shkollat publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ilustrojnë mjaft mirë edhe këto fjalë tē Kryetarit Clinton tē thëna më 30 maj tē vitit 1998, citoj: "Shkollat bëjnë më tepër sesa ushtrimin e mendjes së fëmijëve. Ato po ashtu ndihmojnë përkujdesin pér shpirtërat e tyre duke i përforcuar vlerat tē cilat i mësojnë në shtëpitë dhe komunitetet e tyre.". Unë besoj se njëra prej mënyrave më tē mira pér tē ndihmuar shkollat tona që ta bëjnë këtë është nëpërmjet përkrahjes së tē drejtës së nxënësve që në mënyrë tē vullnetshme tē praktikojnë besimet e tyre fetare, përfshirë edhe lutjen në shkolla.

Përfat tē keq, institucionet e Kosovës nuk ishin tē gatshme që ta përvetësojnë këtë vlerë civilizuese dhe empirike. Iniciativa e argumentuar ligjore e Partisë së Drejtësisë pér zbatimin e lëndës së mësimbesimit në shkollat filllore e tē mesme të Kosovës, e paraqitur më 15 prill 2003 dhe e përkrahur nga 18 deputetët e mandatit tē kaluar tē Kuvendit as nuk u pranua, as nuk u refuzua, as nuk u debatua. U manifestua ambivalencë e skajshme institucionale ndaj një çështjeje me rëndësi tē padiskutueshme pér stabilitetin psiko-social tē rinisë së Kosovës që jeton në situatën e transisionit ekstensiv tē shoqërisë sonë.

Projektligji, të cilin po e shqyrtojmë, përsëritë pasigurinë e ngjashme në nenin 3 pikë e) duke afuar formulim të përgjithësuar për mundësinë e zbatimit të lirisë fetare të mësimbesimit në vendet e përshtatshme për këto qëllime, duke mos specifikuar se këto vende mund të janë edhe shkollat publike.

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se është koha e fundit që edhe shoqëria jonë dhe rinia e saj shkollore të gjëzojnë vlerat e lirisë së mësimbesimit fetar krahas moshatarëve të tyre në shoqëritë më të përparuara. Mendoj se ka ardh koha kur paragjykimet agresive duhet t'ia lëshojnë vendin arsyes dhe faktave pozitive që dalin nga përvoja e shumë shteteve. Jam i bindur se kjo nuk do të jetë e vështirë në Kosovë, ku pluralizmi fetar dhe toleranca ndërfetare paraqesin vlera të verifikuar. Çështja e dytë, është mungesa e plotë e bashkësive ekzistuese fetare në tekstin e Projektligjit. Bashkësitë fetare ekzistuese, në veçanti Bashkësia Islame e Kosovës dhe Ipeshkvia e Kosovës, kanë bartur barrën e zhvillimeve më të rënda psiko-sociale nëpër të cilat ka kaluar shoqëria kosovar veçanërisht në dekadat e fundit. Kjo me siguri vlen edhe për kishën ortodokse në Kosovë kur është fjala për popullatën serbe të Kosovës.

Në emër të anëtarëve të Partisë së Drejtësisë shpreh pakënaqësinë e thellë me injorimin e këtij të bashkësive ekzistuese fetare në tekstin ligjor. Konsideroj se, duke pas parasysh kontributin e dhënë para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, është e domosdoshme që të sigurohet statusi adekuat ligjor i tyre, natyrish duke mos cenuar të drejtat e bashkësive të reja fetare që mund të formohen në të ardhmen në pajtim me këtë ligj.

Çështja e tretë, ka të bëjë me mungesën e normës ligjore për të siguruar lirinë fetare të lëvizjes në vende publike, përfshirë edhe të gjitha institucionet arsimore në veshjen që paraqet normë fetare për qytetarin. Të nderuar deputetë, në muajt e fundit kemi qenë dëshmitarë të veprimeve joligjore të përjashtimit të vajzave dhe arsimtarëve nga shkollat e mesme të Kosovës vetëm për shkak të mbulesës në kokë. Është turp që në kohën kur kemi gojën plotë me standarde demokratike të privohet nga e drejta për arsimim nëna e ardhshme vetëm për shkak të zbatimit të një norme fetare. Kjo, të nderuar deputetë, nuk na shërbën për nderë dhe nuk guxon të lejohet më tutje.

Përvoja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si demokraci me zgjidhje më të avancuara në këtë lëmi, mund t'na ndihmojë me rastin e gjetjes së zgjidhjeve më të përshtatshme ligjore. Me qëllim të ballafaqimit sa më adekuat me sfidat e lartpërmendura dhe shumë të tjera në këtë sferë të jetës shoqërore, që nuk i përimenda, konsideroj se është e domosdoshme që në tekstin ligjor të parashihet edhe themelimi i ministrisë për çështje fetare, që do të mundësonë shfrytëzimin optimal të resurseve të mëdha psiko-sociale me të cilat disponojnë bashkësitë fetare në Kosovë për stabilizimin gjithpërfshirës të shoqërisë kosovare në transicion të rënd, mund të them lirisht – në transicion të rëndë dhe të pakontrolluar, sidomos në rrafshin psiko-social me pasoja alarmante e veçanërisht në lirinë e Kosovës për të cilat fatkeqësish jemi dëshmitarë të përditshëm.

Shpresoj se kësaj here, amendamentet e Partisë së Drejtësisë që do të propozohen në procedurën e mëtujtjeshme të miratimit të këtij ligji, do të gjejnë përkrahje edhe nga grupet parlamentare të Kuvendit si dhe nga deputetët e tjerë. Ju faleminderit për vëmendjen.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falëminderit. E ka fjalën profesor Mark Krasniqi, le të përgatitet Emrush Xhemajli.

## DEPUTETI MARK KRASNIQI:

I nderuar Kryetar, i nderuar Kryeministër, të nderuar deputetë, Ligji mbi lirinë e fesë dhe ligji mbi bashkësitë fetare është i mirëseardhur në këtë Parlament për ta vënë edhe këtë sektor shumë të rëndësishëm të pasurisë shpirtërore të popullit tonë në binarët e legislaturës moderne bashkëkohore. Populli shqiptar është i lidhur shumë me fenë, sepse ka një traditë shumë të lashtë si besimtar në fenë monoteiste në një zot. Disa popuj tjerë, që i kemi rrëth e përqark, pas 800 vjetëve e kanë pranuar këtë fe. Deri atëherë kanë pas paganizmin, kanë pas zotërit, perëndi të ndërtuara nga balta, kurse ne e kemi kultivuar shekuj me radhë që nga fillimi kulturën e lashtë të besimit në një zot. Unë me këtë rast vetëm disa vërejtje kisha me i pas lidhur me këtë propozim të ligjit.

Në nenin 2, është një emër ku thuhet  $\frac{1}{4}$  përmendet prifti. Nejse, s'po i lexoj këto se marr shumë kohë, prifti për të gjitha fetë, në kuptimin edhe të feve tjera. Prifti zakonisht te ne shqiptaret kuptohet se është i fesë katolike. Prandaj, unë kisha me zëvendësuar këtë me normën klerik - klerik ku përfshihet edhe prifti, edhe popi, edhe hoxha, edhe pastori - dhe të gjithë të përfshihen me këtë term. Prandaj, të mos bëhet ndonjë konfuzion.

Në nenin 13, bëhet fjalë për krijimin e shoqatave fetare. Feja ka të drejtë të formojë shoqata të ndryshme, por feja nuk ka të drejtë të formojë edhe parti politike, sepse feja mjafton si një ideologji dhe si një organizatë e cila ka parimet e veta, prandaj nuk ka nevojë që ta ketë edhe ndonjë parti brenda për ta përcarë fenë si e përcajnë partitë popullin, mjerisht.

Në nenin 14, emërtimi i bashkësive të degëve fetare, ku jepet mundësia këtu në ligj, që s'ka nevojë të përmendet Kosova; më duket se nuk është në rregull. Pse t'i jepnim ne këtu me ligj të drejtën që të përmendet edhe "Kosova e metohija", tek e fundit pse s'përmendet edhe Drenica, ose Podgorja, ose ndonjë tjetër, por për këtë do të flasim ndonjëherë tjetër ndoshta. Çka do të thotë kjo "metohija"? Kurgjo s'do të thotë për përcaktimin e të drejtës që ta sundojë Kosovën dikush në emër të "metohisë". Prandaj mendoj se Kosova duhet të jetë i vetmi emër i cili mund t'përdoret në aktet zyrtare dhe në këto tubimet publike.

Shkollat fetare, mirë që i kemi tash, ta kemi edhe klerin e të gjitha feve këtu të shkolluar, por unë mendoj - jo mendoj por insistoj që në asnjë mënyrë të mos lejohet mësimi fetar në shkollat laike, në shkollat shtetërore dhe private të cilat nuk janë fetare. Mjafton që të kemi shkolla fetare dhe atje kush të dojë le të mësojë, le të mësojë kuranin, ungjillin, zotin dhe të birin. E, përvèç kësaj, se Nekibja ma solli ndërmend. Mendoj se duhet ndaluar në të gjitha shkollat laike dhe shtetërore elementet të cilat zgjojnë dhe nxisin ndasinë fetare. Këtu është pak më vështirë të përcaktohet, sepse dikush e mbulon kokën, tjetri e rban kryqin rrëth qafe dhe këtu mund të krijuhet njëfarë tollovie, por ju e dini - kemi dëgjua dhe lexua se edhe në Francë populli ka një fe - fenë katolike dhe atje bëjnë përpjekje dhe ndoshta edhe ligjet i kanë të tilla që këto elemente të mos bëjnë përcarje në baza fetare.

Në nenin 29 - regjistrimi i bashkësive fetare. Mendoj se këto çështje, këto elemente... Nejse, edhe këto janë degë, tek e fundit, po më habit Nekibja po nejse... Ndër këto kërkesa tjera, unë nuk pash se kërkohet edhe për regjistrimin e këtyre bashkësive e degëve... bashkësive e degëve! - bashkësive fetare sepse jemi mësuar me këto politikat tona... Nuk e pash kërkend se kërkohet edhe numri, numri i besimtarëve. Në qoftë se kjo nuk përcaktohet me ligj, atëherë mund të kemi këtu edhe budistë, hinduistë e tjerë - njëqind fe, të cilat nuk kemi as letra e regjistra për t'i regjistruar. Prandaj, kur përcaktohet numri për partitë politike i cili është minimumi një mijë anëtarë të firmosur sipas Rregullores së OSBE pse të mos përcaktohet edhe numri i bashkësive fetare për t'i regjistruar në regjistrat e shtetit. Eh, këtu te regjistrimi e kam edhe një vërejtje shumë të rëndësishme, më duket mua. Sipas mendimit tim dhe sipas

interesit kombëtar, kryetari i bashkësisë fetare duhet të jetë shtetas i Kosovës. Diku kërkohet edhe të jetë shqiptar. Por meqenëse ne kemi tri fe këtu, atëherë nuk di a mund ta themi këtë që të jetë shqiptar gjithmonë sepse ortodoks nuk kemi këtu aq që ta bëjmë një shqiptar aty në krye të kësaj bashkësie....

(Ndërhyrje - zj.N.Kelmendi: Shqiptar - të fesë ortodokse...)

Të fesë ortodokse po them, kuptohet. Prandaj po them këtë kërkesë e ka pas edhe Zogu - Mbreti i shqiptarëve në statutin e tij. Këtë kërkesë e ka pas edhe Sali Berisha, por duket se kjo ia ndihmoj pak me ia thy qafen, kështu që kjo kërkesë... Jo, jo Sali Berisha nuk e theu qafën por i ndihmoj pak me u largue... Nejse. Prandaj po them duhet të kërkohet që të paktën të jetë shtetas shqiptar.

(Ndërhyrje - zj.N. Kelmendi: Shtetas shqiptar - i Kosovës...)

Po, po shtetas shqiptar i Kosovës. Këtë kërkesë e kam parasysh, pak po e zgjas ndoshta dhe po ju marr shumë kohë, por po marrë pjesë shumë rrallë në këto diskutime.... Këtë kërkesë e kanë pas priftët shqiptar në Lezhe më 1622 ku papa emëron një ipeshkv të kombësisë italiane për Lezhë. Edhe Lezha ka qenë - në atë kohë - ipeshkvi, por kur vjen ky kandidat - ky ipeshkv, e ka pas emrin Orsinjo, ai i dërgon një letër papës dhe thotë: "Unë këtu nuk jam i mirëseardhur si ipeshkv, sepse priftat shqiptar kanë lidhur besë që mos ta pranojnë ipeshkvin e kombësisë së huaj, por vetëm të kombësisë shqiptare".

Kur kjo në fillim të shekullit 17 kërkohet nga një grup priftash shqiptar në Lezhë, pse mos ta kërkojmë sot edhe ne, kur jemi në shekullin - në të cilin jemi, dhe kur kemi të gjitha këto përparsë, e tjera - e tjera, nejse.

Përveç tjerrave, këtë po e theksoj këtu sepse ne kemi edhe shembuj konkret në Shqipëri. Kryetar i Kishës autoqefale shqiptare është Janulla Tosi, i cili midis Tirane bën fjalimin dhe ceremoninë krejt greqisht. Po, po! Kështu që nuk është krejtësisht në favor të kombit që të kemi një situatë të tillë.

E - për këto ceremonitë fetare, nuk mund të hyjmë aty në kompetenca të këtyre bashkësive e degëve, por do të ishte mirë që të konsultohen.... bashkësitë e degëve, po de po: kështu iu kanë thënë - bashkësitë fetare dhe është mirë të këshillohen që ceremoniali fetar të jetë në gjuhën e shumicës së besimtarëve aty ku janë - në xhami, ku janë shumica... Po, po - edhe türq, pse jo - kur flasin turqisht pse mos të mbahet turqisht, por në xhamitë tjera ku janë shumica dërmuese...

(Ndërprenje nga regjia)

KRYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Le t'i lejohet diskutimi profesorit edhe pak.

DEPUTETI MARK KRASNIQI:

Mirë, më duket se edhe me kaq mjafton për t'u kuptuar diçka.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Emrush Xhemajli, le të bëhet gati Naxhije Doçi.

### DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI:

Inderuari Kryetar i Kuvendit, inderuari Kryeministër, të nderuar kolegë deputetë të pranishëm në sallë,

Kosova ka pas dhe ka nevojë të madhe për ligjin për liritë fetare për të mbushur zbrazësitë legislative që ekzistojnë në këtë fushë. E përkrahim në parim këtë Projektligj me disa vërejtje dhe plotësimë.

Te nenin 14 pika 2 dhe 3, që u përmend edhe nga disa të tjera, nuk dimë çka kanë menduar hartuesit e ligjit kur kanë paraparë që nuk është e domosdoshme që gjatë regjistrimit të figurojë termi "Kosovë". Kush paska hequr dorë nga Kosova. Mesa e dimë të gjitha bashkësítë fetare në Kosovë duhet ta kenë termin "Kosovë", dikush madje e quan djep, dikush zemër e dikush të shenjtë. Andaj kërkohjmë që qdo bashkësi fetare ta ketë termin e "e Kosovës" ose "në Kosovë", kur është pjesë e bashkësisë fetare me sili jashtë territorit të Kosovës.

Mendoj se nuk ka nevojë për nenin 25 pika 2 dhe duhet të hiqet, sepse është joprecize dhe lëhet vend për spekulime, shqetësimë, si dhe për ndasi, duke pas parasysh faktin se në Kosovë ka shumë bashkësi fetare.

Mendojmë se duhet të janë transparente mjetet financiare të bashkësive fetare që hyjnë nga jashtë dhe kuptohet nga besimtarët.

Mendoj se gjatë amendamentimit do të merren parasysh vërejtjet që u dhanë këtu, do të plotësohet dhe do të bëhet i gatshëm për t'u miratuar. Faleminderit.

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Naxhije Doçi, le të bëhet gati. Dedaj.

### DEPUTETJA NAXHIJE DOCI:

Inderuari Kryetar Daci, inderuari Kryeministër, të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë,

Përmes respektimit të të drejtave përlirinë e besimit fetar, Kosova tregon përkushtimin e saj përlirinë e ambientit të mirë, ku respektohen vlerat njerëzore, për shumëllojshmërinë e komuniteteve, të gjuhëve dhe të besimeve fetare. Duke u nisur ngajeta e përbashkët dhe trashëgimia kulturore në jetën fetare, si dhe mirëkuptimi dhe toleranca ndërmjet banorëve me besime të ndryshme fetare, dispozitat e këtij Projektligji paraqesin bazë juridike përrregullimin e lirisë së besimit të secilit njeri që është një prej të drejtave themelore të njeriut dhe një prej parimeve e standardeve të pranuara ndërkombtarisht.

Njëherit, me këtë Projektligji, bashkësítë fetare në Kosovë do të janë të barabarta sa u përket të drejtave dhe detyrimeve pa kurrfarë diskriminimi. Projektligji mundëson lirinë e krijimit dhe të funksionimit të institucioneve humanitare dhe të bamirësishë, lirinë e mësimbesimit fetar, lirinë e shkrimit dhe botimit të publikimeve në pikëpamje fetare, lirinë e respektimit të ditëve të caktuara të pushimit përfestimin e festave fetare si dhe lirinë e komunikimeve ndërmjet individëve e bashkësive fetare.

Me këtë Projektligji fuqizohet edhe më tepër çështja që njerëzit, pa marrë parasysh besimin fetar, janë të barabartë dhe gjëzojnë të drejtat e njëjtë në jetën e përditshme civile, arsimore, politike, ekonomike e sociale. Me këtë Projektligji ndalohet treptësishë fyerja e nëpunësve fetar, dëmtimi i objekteve fetare ose i pasurisë së bashkësisë fetare që ne si popull, përfatë

keq, e përjetuan që t'na rrënohen dhe shkatërrohen çdo gjë para nesh gjatë luftës së fundit. Tani në vend që të krenohemi me lashtësinë e tyre, duke i pasuar dhe begatuar këto vlera, duhet si shoqëri dhe si institucionet të ndajmë buxhet të madh për renovimin dhe rindërtimin e shumë objekteve fetare.

Edhepse në Kosovë toleranca fetare ishte dhe është vlerë me të cilën jemi krenuar si popull para të tjerrëve, rregullimi me ligj i tolerancës fetare dhe mospërgjimi i ushtrimit të veprimtarisë fetare konsideroj se është shumë i nevojshëm për një shoqëri demokratike. Formimi i një komisioni në kuadër të Qeverisë për rregullimin e marrëdhënieve fetare është urëlidhës ndërmjet këtyre mekanizmave kur dihet se edhe në të kaluarën e edhe sot bashkësitetë fetare kanë ofruar mbështetje të fortë humanitare dhe një ndihmë institucionale për tejkalimin e sfidave të mëdha që i kemi pas si popull për kohë të gjatë.

Është çështje jona që këto raporte ndërfetare - ndërshtetërore t'i forcojmë dhe pasurojmë, sepse janë vlera të cilat çojnë Kosovën në hap me kohën dhe drejt integrimeve ndërkombëtare.

Dispozitat e veçanta të këtij Projektligji rregullojnë ceremonitë fetare, ushtrimin e veprimtarisë arsimore fetare, themelimin dhe grumbullimin e fondeve si dhe realizimin e të drejtave dhe të detyrimeve të individëve që të ushtrojnë veprimtarinë kuadër të bashkësive fetare.

Kapitulli i tretë i këtij Projektligji ia mundëson bashkësisë fetare të sapoformuar të drejtën për t'u regjistruar. Në Ministri në regjistrin e bashkësive fetare në afat prej 60 ditësh pas paraqitjes së kërkuesës. Krahas kësaj, Ministria mund edhe të mos e regjistrojë këtë bashkësi fetare, ose - pasi ta regjistrojë ta ndalojë veprimtarinë e saj nëse ka fakte dhe të dhëna që ushtrimi i veprimtarisë bëhet në kundërshtim me të drejtën juridike e njerëzore dhe kur rrezikon të drejtat dhe liritë e besimtarëve, të qytetarëve si dhe kur rrezikon shëndetin dhe jetën e tyre.

Edhe ky Projektligj ka gabime gramatikore e sintaksore, se para së gjithash është një përkthim pak si i dobët. Prandaj, do të ishte mirë të eliminohen të metat e tillë për t'u bërë një ligj modern dhe funksional, sepse me këtë i tregojmë vetes dhe të tjerrëve për kulturën parlamentare dhe institucionale që kemi.

Projektligjin e përkrah në parim, sepse edhe një segmenti shumë të rëndësishëm dhe të ndjeshëm i krijohet baza juridike. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Gjergj Dedaj, le të bëhet gati Ibush Jonuzi.

#### DEPUTETI GJERGJ DEDAJ:

Faleminderit Kryetar,

Po mundohem vetëm sa për të dhënë një kontribut modest lidhur me këtë shqyrtim të parë të këtij Projektligji, konsideroj të rëndësishëm për shoqërinë kosovare dhe ecjes drejt demokracisë dhe integrimeve në botën demokratike. Në parim përkrah kolegut tim këtu Agani që duhet me qenë shumë fleksibil si shoqëri ndaj çështjes së barazisë gjinore që është njëra ndër vlerat dhe mund të them edhe standartet për hapjen e proceseve serioze të integrimit të Kosovës në Bashkimin Evropë-Rëndimor dhe Veriatlantik. Mirëpo, konkretisht ndoshta kisha pas me hezitu që çështja e lutjeve fetare nëpër institucionet publike e në shkolla publike të jetë si e akzeptuar sepse aty dihet që edhe institucionet publike, edhe shkollat, edhe strukturat tjera, domethënë - janë multireligioze dhe mund të them - atëherë ndoshta kishte me krijuar pakënaqësi dhe ndasi që askush në Kosovë nuk dëshiron.

Eshtë me rëndësi të potencohet se si shoqëri dhe si institucione duhet të respektojmë barazinë e plotë fetare dhe respektimin e të gjitha bashkësive fetare në mënyrë të barabartë dhe pse jo kur një ditë në festimin e Bajramit në Bashkësinë Islame kërkova që në Prishtinë të ndërtohet një xhami e madhe që qytetarët të mos falen – të luten përjashta në baltë dhe dikush për të mos e bë të madhe, mendoj se duhet të krijohen kushtet edhe të infrastrukturës që në kryeqytetin e Kosovës dhe në gjithë Kosovën njerëzit në mënyrë të shirishme dhe në mënyrë të komoduar t'i ushtrojnë besimet e tyre fetare, e pse jo ndoshta që në Prishtinë sa më parë të ndërtohet edhe katedrala, që në Prishtinë të riaktivizohen edhe kishat ortodokse, në mënyrë që sinqerisht të gjithë qytetarëve e Kosovës pa dallim feje t'u mundësohet ushtrimi i lirë dhe i akomoduar të besimit fetar.

Po ashtu mendoj se edhe themelimi i ministrisë për çështje fetare do të ishte i rëndësishëm dhe kjo mendoj nuk dëmon asgjë shoqërisht e Kosovës, aty do të merrin pjesë përfaqësuesit klerik të të gjitha bashkësive fetare në mënyrë që edhe ata domethënë si pjesë e shoqërisë së Kosovës do të jepnë kontributin e tyre për ndërtimin e mëtejme të demokracisë dhe të ardhmes së vendit.

Sa i përket veshjeve dhe simboleve fetare, unë mendoj se këto nuk duhet të janë pengesë, e them këtë si liberal, që duhet me pas një fleksibilitet të madh, nuk duhet të jetë pengesë nëse një nxënës - nxënësë ose student e vë kryqin në shkollë ose fakultet, sikur që nuk duhet të jetë pengesë nëse dëshiron dikush të vishet, domethënë ta mbulojë kokën dhe nuk duhet të jetë pengesë dhe ai për këtë të përjashtohet assesi nga procesi edukativ-arsimor, sepse ky është mohim i të drejtës elementare dhe i drejtës së çdo individi për t'u veshur dhe mbajt simbolet që ai i dëshiron dhe preferon.

Mendoj se këtu duhet të kihet paraqysh që në shqyrtimin e dytë këto rekomandime dhe sugjerime të merren paraqysh. Faleminderit shumë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit shumë. E ka fjalën Ibush Jonuzi, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi. Lus deputetët, pasi që kemi vetëm edhe dy diskutantë, që të kthehen në sallë, sepse do të shkojmë në shqyrtim të çështjes tjeter.

#### DEPUTETI IBUSH JONUZI:

Inderuari zoti Kryetar, zoti Kryeministër, deputetë të respektuar dhe ju të pranishëm, Meqë sot po debatojmë për Projektligjin për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare, shfrytëzoj rastin të shpreh bindjen time të plotë sepse fatmirësish në Kosovë asnjëherë nuk ka pas fërkime në mes besimeve fetare të ndryshme por, përkundrazi, çdoherë është treguar tolerancë, mirëkuptim dhe respekt reciprok.

Projektligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë siguron të drejtën e secilit qytetar të shprehë besimin dhe bindjen e vet të lirë fetare. Pra, ky Projektligj është i një rëndësie të veçantë, që tregohet edhe me vetë faktin se në hartimin e tij kanë punuar një numër prej 30 vetave të ekspertëve vendor dhe atyre ndërkombëtar.

Mirëpo, edhe pse Grupi punues ka punuar me përkushtim për ta dhënë versionin sa më cilësor të këtij Projektligji, prapëseprapë brenda tij vërehen lëshime të shpeshta e herë-herë edhe esenciale.

Unë do të ndalësha shkurt në disa raste, që mendoj se janë në interes të Projektligjit, që të bëhen disa plotësimë e korrigejme, dhe më konkretisht në nenin 3 - pikë c) duhet të rregullohet; nenin 4 duhet të korrigej; nenin 8 të plotësohet patjetër e po ashtu edhe nenin 16 duhet të plotësohet.

Mendoj se gjatë punës së vet Komisioni funksional do t'i ketë parasysh vërejtjet që u dhanë më lart, në mënyrë që të bëhet plotësimi i ligjit në fjalë dhe të jetë ligj shumë më funksional sesa që është dhënë në versionin e parë. Në parim, mbështes Projektligjin për t'u miratuar. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Ramadani Kelmendi dhe i fundit Ragip Zekollit, besoj do ta kenë shkurt. Urdhëroni Ramadani.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Inderuari Kryetar, Kryeministër dhe deputetë, Kosova si shoqëri demokratike, mendoj ka nevojë të madhe që me ligj të rregullojë lirinë fetare si një e drejtë themelore njerëzore, si dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në tërësi në Kosovë – liri dhe e drejtë të cilat, jemi dëshmitarë, decenje me radhë ishin cunguar, anatemuar dhe shkelur.

Me këtë propozimligj pretendohet të eliminohen: diskriminimi fetar, duke garantuar besimin fetar në tërësi si e drejtë themelore; të mundësojë lirinë e shprehjes së besimit dhe e ndërgjegjes të secilit rjéri, pa dallim, mbështetur në të drejtën individuale në tolerancë dhe mirëkuptim siç ka jetuar shekuj me radhë, por duke mos pas pasoja në jetën publike dhe në pozitën shoqërore të qytetarit. Mbështetur në këtë, duhet të mundësojmë afirmimin e lirisë dhe besimin, lirinë e mendimit dhe barazisë së tyre.

Unë mendoj se institucionet humanitare duhet të ndahen nga institucionet fetare, sepse edhe në këtë mënyrë dhe në mënyrën e organizimit e të financimit, dallojnë përbajtësisht dhe esencialisht.

Në këtë propozimligj nuk është përcaktuar e drejta e mbajtjes dhe përdorimit të simboleve e shenjave tjera të individit, gjë që shkakton pikërisht dilema që sot u prezantuan.

Mendoj se propozimligji nuk përcakton shkaqet, format dhe kriteret se kur mund të ndalojet një tubim fetar, në cilat vende dhe në cilat mënyra.

Me propozimligj duhet të rregullohet festimi i festave fetare si dhe të bashkësive fetare, të jenë të ndara nga pushteti publik dhe ai shtetëror. Dhe, mbështetur në këtë parim e këtë kriter, bashkësia fetare, si person juridik për rregullimin e marrëdhënieve ndërfetare, do të ishte mirë të kishte një organizim të nivelit zyrtar të besimit dhe marrëdhëni të ndërfetare.

Propozimligji nuk është i qartë në rastet kur përcakton përbajtjen e punës së bashkësive fetare në raport me rendin juridik dhe moralin publik.

Në këtë propozimligj nuk është përcaktuar mënyra dhe kriteret, si dhe tarifa e numri i anëtarëve të regjistruar, duke lënë mundësi që edhe shoqatat e ndryshme nga shtetet jashtë Kosovës të regjistrohen në Kosovë, që është shumë e dëmshme.

Jashtë këtij propozimligji mbeten shoqata të ndryshme të besimit, që shprehin besim dhe do të ishte mirë që mbishkrimet e bashkësive fetare, pa marrë parasysh të cilit besim, të kenë obligim emrin Kosovë dhe komunën, në kuadër të së cilës kryejnë veprimitarë e tyre fetare. Për ndryshe, do të konsideroheshin si me veprimitari ilegale.

Propozimligji nuk sqaron statusin juridik të shkollave fetare dhe raportin e shkollave të rregullta; nuk jep zgjidhje mbi pasurinë e tundshme e të patundshme të institucioneve fetare.

Mbështetur në të gjitha këto, mendoj se në këtë fazë duhet dhënë përkrahje të mëtujeshme për miratim. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Ragip, urdhëroni.

#### DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI:

Faleminderit zoti Kryetar. Unë do të mundohem të mos i përsëris kolegët në ato gjëra që i thanë, por është me rëndësi që edhe para një kohe të gjatë, po të kishim këtë ligj, sot do të vepronim më ndryshe. Bindja ime është kjo se vërtetë shumë fëmijë tanë, pastaj shumë persona dashtë e padashtë deri në aprovimin e ligjit apo të sjelljes së tij këtu - janë keqpërdorur në mënyra të ndryshme.

T'i kthehem konkretilisht ligjin. Tek nen 2, u tha se duhet zëvendësuar, domethënë fjala "prift" me "klerik"; ndërsa tek nen 3 nën g) duhet ndryshuar tërësisht tekstin sepse është shumë i pakuptueshëm. Neni 6, pasusi 3 te çështja e institucioneve shtetërore, gjithsesi duhet ekzistuar, u tha edhe nga të tjerët, emërtimi "Kosovë". Por, te ky pasus, te pasusi 3, tek fjalia e fundit, ku thuhet se "ndjenjat fetare dhe aktivitetet e rezervuara për partitë politike", unë mendoj se gjithsesi duhet t'i shtohet edhe fjalia "dhe institucionet shtetërore të Kosovës". Domethënë, njësoj - sikur partitë politike - dhe institucionet shtetërore, mos të janë të prekura nga feja. Nenin 8 po ashtu duhet rregulluar sepse është komplet nen pa asnë pikë. Do të thotë janë fjalitë e gjata dhe të pakuptueshme. Edhe nen 14 duhet rregulluar, duke përfshirë edhe te kjo çështja që u nxit nga shumë kolegë për emërtimin "Kosovë" që mund të ekzistojë apo mos ekzistojë - por duhet ekzistuar gjithsesi. Duhet shikuar edhe nenin 15, po ashtu thotë "Komisioni nga paragrafi 2 i këtij nen i përbëhet nga anëtarët e bashkësive fetare dhe qeverisë. Numri i anëtarëve përcaktohet me vendim të Qeverisë". Pastaj, do të ishte mirë të afatizohet në afat prej 30 apo 60 ditë prej miratimit për arsyen se në bazë të praktikës së gjertanishme dhe të ligjeve që janë miratuar këtu kanë kaluar edhe një e dy vite, ndërsa nuk janë nxjerrë udhëzimet përcjellëse apo diçka tjeter, të kësaj natyre.

Gjithashtu, edhe te nen 24, që përmendi profesor Hamiti shkëlqyeshm - çka do të bëhet nëse shkon PSSP prej Kosove, domethënë - kur i lëhet një e drejtë e rezervuar. Do të thotë, ne kur punojmë me ligje duhet të kemi parasysh që vërtetë këto ligje të kenë mbështetjen juridike dhe forcën e vendosjes që mund të jetë kompetent një organ relevant, ndoshta në këtë rast - po them - Gjykata Supreme, apo dikush tjeter. Ju faleminderit shumë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Dëgjuam debatin. Shkojmë në proces të vendimmarries.

Kush është për miratim në parim të Projektligjit? Ju faleminderit.,  
A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Të pranishëm janë 74 deputetë, mirëpo ndërkohe po shoh se po hyjnë deputetët dhe kemi kuorum përvendimtarje.

Komisionet që duhet ta shqyrtojnë këtë janë: Komisioni për gjyqësi, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për komunitete.

Tani kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës të kësaj Seance plenare:

- Shqyrtimi i Propozimrregullores së punës të Kuvendit.

Më lejoni të paraqes një përbledhje tretë kësaj pike. Komisioni për Rregulloren e punës, i formuar me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, me datë 22 dhjetor 2004, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2005, duke vëruar sipas përfundimit të Seancës plenare të datës 22 prill 2005, rishikoi tekstin e Propozimrregullores të punës së Kuvendit dhe lidhur me këtë vendosi që Kuvendit t'i propozojë miratimin e Propozimrregullores së punës sipas tekstit të datës 13 maj 2005.

Arsyetimin përfundim i këtë raportit do ta paraqet kryetari i Komisionit zotit Hajredin Kuçi. Urdhëroni profesor.

#### DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:

I nderuar Kryetar, i nderuar Kryeministër, të nderuar deputetë – zonja dhe zotërinj,  
Jam i nderuar që në emr të Komisionit për Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës të paraqes këtë raport pune.

Që në fillim dua të theksoj se nga mbledhja e kaluar, Komisioni ka mbajt mbledhje dhë ka konstatuar se ka pas ndërhyrje në Rregulloren e kaluar të punës të Kuvendit të Kosovës; i kemi evituar ato ndërhyrje dhe ndërkohe kemi ofruar draftin e rregullores të cilin edhe Komisioni sot e mbështet.

Në çdo vend demokratik, natyrisht kuvendi si organ i tij përfaqësues, ka përfundim që të ketë një organizim të mirë, një funksionim demokratik dhe një vend ku secili qytetar mund ta kuptojë rolin e Kuvendit të Kosovës, dhe mbi të gjitha procedurën e vendimtarjes. Po ashtu, shihet se në Kuvend duhet të dominojnë rregullat, ndoshta në veçanti në kohën kur në Kuvendit e Kosovës përfundimisht kemi rapportet pozitive dhe opozitë dhe mundësi apo formë që do t'i japë mundësi secilit deputetë të shpreh mendimet e veta – shpeshherë të kundërtat, por duke respektuar formën e vendimtarjes në përgjithësi. Këto ishin edhe qëllimet fillojse të Komisionit në hartimin e punës të kësaj rregulloreje.

Po ashtu, duhet të theksoj se kemi pas parasysh bazën juridike në Kosovë, e cila dominon – pra Kornizët kushtetuese përvetësuar që kjo Rregullore është e bazuar në tjerësi me dispozitat e asaj Kornize kushtetuese.

Në veçanti kemi marrë parasysh edhe draftin e ofruar nga tri institucionet ndërkombëtare, të cilin draft nuk e kemi shqyrtuar pikëpërpikë dhe kemi dhënë edhe mendimin tonë dhe natyrisht e kemi gërvhetuar me përvojën dhe nevojën që ka Kuvendi i Kosovës. Kemi tentuar që t'i vërejmë lëshimet që kanë qenë në Rregulloren e kaluar të punës së Kuvendit dhe kemi tentuar që ato lëshime të mos përsëriten tash e tutje dhe kemi ofruar një rregullore e cila, mendojmë se ka apo tenton tu avancojë funksionimin demokratik të Kuvendit.

Komisioni, natyrisht një trajtim të veçantë i ka dhënë që në fillim terminologjisë së dokumenteve dhe akteve të Kuvendit. Për dallim nga rregullorja e mëhershme, kemi bindjen se kjo Rregullore ka krijuar disa risi dhe mundësi për organet e Kuvendit. Një organizim, që do të jetë më i mirë në mes të organeve të Kuvendit, sidomos një organizim i sistemit funksional në raport me Kryesinë e Kuvendit, grupet parlamentare, komisionet dhe administratën. Pra, me fjalë të tjera, kemi tentuar që nga puna apo fillimi i punës së Kuvendit deri në kohën e vendimmarjes të dihet apo të organizohet në mënyrë të qartë kjo punë.

Roli i Kryesisë së Kuvendit është trajtuar në veçanti duke trajtuar edhe si organ të Kuvendit dhe koordinator kryesor në punën e Kuvendit, duke përcaktuar mandatin e tyre, detyrat, mbledhjet dhe përgjegjësitë e saj. Është thënë njëkohësisht se Kryesia paraqet edhe organin kryesor menaxhues të Kuvendit.

Grupet parlamentare kanë një trajtim të veçantë në këtë Rregullore, duke përcaktuar kushtet e formimit të tyre, statusin dhe financimin, që është dukshëm i avancuar si në rregulloren e kaluar, dhe kemi tentuar të krijojmë kushte më të mira për grupet parlamentare dhe mundësi për ndikim në çështjet që procedohen në Kuvend.

Në kuadër të kësaj, është paraparë edhe roli i deputetit dhe të drejtat e tij. Natyrisht kemi paraparë një formë të imunitetit dhe mandatit të deputetit, i cili me siguri se nuk është i ngashëm me deputetët e vendeve të tjera të cilat janë apo veprojnë në shtete të pavarura.

Natyrisht, duke parë pozitën me Kornizën kushtetuese, janë paraparë edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë: me Kryetarin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës, mënyrën e zgjedhjes së tyre dhe sidomos raportin e tyre në Kuvendin e Kosovës.

Risi në këtë Rregullore do të quajmë janë nënkomisionet si grupe punuese në kuadër të komisioneve, që të jenë sa më funksionale për çështje ktuara.

Njëkohësisht edhe çështja e komisionit përgjegjës është me rëndësi dhe është përcaktuar si një komision i cili raporton për çështje të caktuara para Kuvendit të Kosovës – për çështje që autorizohet mu nga ky Kuvend.

Është tentuar që puna e Kuvendit të jetë tërësisht transparente dhe të mbahet evidencë e rregullt për punën e tij dhe njëkohësisht kjo evidencë të jetë e përhershme dhe transparente para qytetarëve të Kosovës.

Janë disa çështje apo dy çështje, të cilat kanë krijuar dilema në Komision. E para është çështja lidhur me Komisionin për persona të pagjetur, edhe pse unë personalisht nuk mendoj se duhet të jetë ky emërtim, i cili është në kuadër të Komisionit për shëndetësi. Është menduar në Komision ndoshta një variant që të jetë një komision i përkohshëm i Kuvendit të Kosovës nga se mendojmë që komision të përhershëm me siguri me gjetjen apo me verifikimin e fatit të tyre ndoshta nuk do të ketë nevojë të ketë në të ardhmen. Sido që të jetë, kjo është kompetencë e Kuvendit.

Dhe, çështja tjeter, lidhur me të cilën besoj e keni marrë edhe një shkrim nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, është Rregulla 16 pikë 2 për të cilën është menduar që në rregullën paraprake apo në dispozitat e Kornizës kushtetuese dhe të harmonizohet me të, duke tentuar që "partia për kandidatin për president", jo "partia që ka 25" por ata që kanë mbështetjen e "25 anëtarëve të Kuvendit".

Mendoj se përbajtja e kësaj Rregulloreje, në përgjithësi, mund të trajtohet si një punë serioze e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare dhe drafti që keni sot para veti është arritur me një konsensus maksimal në kuadër të Komisionit, natyrisht rrëth debateve dhe formave tjera.

Ne që në fillim kemi menduar se kjo Rregullore nuk i takon asnjë grupi parlamentar në veçanti, por i takon Kuvendit në tërësi dhe trajtimi apo qëllimi ynë ka qenë që të funksionojë Kuvendi si tërësi në kuadër të cilit janë edhe grupet parlamentare.

Krejt në fund, kam kënaqësinë të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për një kohë edhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit që kanë dhënë kontribut në hartimin e kësaj Rregulloreje, dhe në veçanti secilin anëtar të Komisionit. Faleminderit për vëmendjen.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë do ta pyetja kryetarin e Komisionit, meqë përfundimi i mbledhjes së kaluar ka qenë qysh ka qenë, a keni menduar a hapet debat i përgjithshëm apo keni ndonjë propozim që ju si Komision e keni formuluar ose grupet parlamentare dhe ta dimë këtë sa për të proceduar. Lus edhe një herë profesor Kuçin, ose ndokënd tjetër ta sqaroj këtë çështje. Urdhëroni...

#### DEPUTETI HAJREDIN KUCI:

Faleminderit zoti Kryetar. Ne kemi menduar se kjo çështje tash i takon Kuvendit që të vendosë. Ne e kemi ofruar për miratim dhe natyrisht presim kontributin e Kuvendit respektivisht të deputetëve në këtë drejtim. Është e drejtë e Kuvendit të vendosë për mënyrën se si mendon ta procedojej më tutje. Faleminderit.

#### KRYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën profesor Alush Gashi, në emër të LDK.

#### DEPUTETI ALUSH GASHI:

Inderuari zoti Kryetar. Përgëzojmë Grupin i cili me një punë të mirë, në mënyrë konsensuale, ka ofruar një tekst të Rregullores së punës të Kuvendit, të cilin Grupi Parlamentar i LDK e mbështet dhe nëse na ftoni për votim – ne do të votojmë për. Faleminderit.

#### KRYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Gjylnaze Syla nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

#### DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

Faleminderit zoti Kryetar. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë për.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Grupi ORA, kush është në emër të Grupit, le të urdhërojë.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Inderuari zoti Kryetar, tē nderuar kolegë deputetë, Komisioni pér Rregullore tē punës, pajtohem me zotin Kuçi, se ka punuar në mënyrë intensive dhe - jo gjithmonë me një harmoni tē plotë, por gjithsesi konsensusi është ndërtuar gjatë punës së tij.

Më duhet tē shpreh përkrahjen pér dokumentin, pérderisa është dokument final, i përfunduar dhe i miratuar në Komision. Nuk shpreh përkrahjen pér raportin e dhënë, sepse Komisioni ka konstatuar se ka pas disa ndërhyrje, mirépo ky konstatim nuk mjafton. Ndërhyrje ka pas edhe nga ana e Komisionit në atë dokument themelor që kemi pas, por ka pas ndërhyrje tē paautorizuara. Për, është dashtë tē thuhet ka pas ndërhyrje tē paautorizuara në dokumentin e Komisionit, e tē cilat juridikisht quhen: falsifikime.

Pra, ne shprehim përkrahjen pér këtë dokument që kemi përparrë dhe do ta votojmë – sigurisht, por është dasht që raporti tē plotësohet dhe tē saktësohet. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Grupi 6+? Mahir Jakxhillar...

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR:

Ju faleminderit edhe një herë. Edhe ne si Grup Parlamentar 6+ e përkrahim tërësisht raportin e zotri kryetarit të Komisionit dhe i japim përkrahje Rregullores.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Meqë katër grupet parlamentare u shprehën ... Së pari Gjergj Dedaj, Sabri pastaj ju... Urdhëroni Gjergj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ:

Faleminderit shumë. Unë mendoj se përkundër respektit pér Kryesinë e Kuvendit, ajo më shumë duhet tē jetë një trup logistik i cili parapërgatit punën e Kuvendit. Kryesia e Kuvendit ka bërë edhe një shkelje me rastin e financimit tē partive tē vogla me nga një deputet. Në mandatin e kaluar ka qenë 10% në mënyrë lineare, pastaj është marrë një vendim pér 20%, pastaj e kanë lëshuar në zero me dëshirën e tyre dhe pa e diskutuar fare në Parlament. Në këtë mënyrë ia kanë marrë partive tē vogla, mos me thënë – na i kanë vjedhë – nga 20.000 euro.

Çështja tjetër, pér tē cilën dua tē diskutoj, përkitazi me këtë Rregullore, është kontestimi te kreu i katërt pika 6 ku thuhet se me vendim tē Kryesisë grupeve parlamentare përvèç që iu jepet domethënë ato shtesa – tē hollat dhe iu jepen edhe fonde vjetore që mendoj se është e papranueshme dhe presedan...

Një çështje tjetër, që nuk pajtohem me këtë Rregullore... Unë mendoj se kam tē drejtë tē shpreh mendimin dhe do ta shpreh gjithmonë ashtu siç mendoj vetë. Ndërsa, çështje tjetër është çështja e Komisionit pér tē zhdukurit, pa marrë parasysh se deri kur do tē gjendet i zhdukuri i fundit, mendoj në kuadër të Parlamentit tē Kosovës duhet tē ekzistojë Komisiozi pér zbardhjen e fatit tē personave tē kidnapuar, tē arrestuar, tē vtarë e tē zhdukur tash e gjashtë vjet. Edhe pér çështjen e komisioneve parlamentare, konsideroj dhe këmbëngul se në tē gjitha komisionet

parlamentare, domethënë së paku një deputet që përfaqëson një parti politike - të jetë anëtar i njërit prej këtyre komisioneve.

Injorimi, anashkalimi dhe mosmundësia që partitë e vogla parlamentare të janë në asnjë komision prej 12 komisioneve që kanë 120 anëtarë, prap mendoj është presedan dhe i papranueshëm dhe nuk është në favor të demokracisë apo të frysës demokratike të punës të këtij Kuvendi të Kosovës. Ju falemnderit shumë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Berat, më fal, Sabria shkurt, pastaj Berat Luzha, në emër të PDK...

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

Unë nuk kam çka të them. E respektoj mendimin e kryetarit të Grupit Parlamentar që ne do ta votojmë dhe, më në fund jemi të kënaqur që kemi arrit momentin ta votojmë. Unë, megjithatë, e kam lexuar shumë kujdeshëm edhe variantin e fundit dhe ekzistojnë disa pasaktësi në formulimet të cilat as që duhet t'i lexojë, por ekziston Komisioni... Më në fund, kjo s'është rregullore e përsosur totalisht dhe e ka të drejtën Kuvendi që në momente të caktuara, me shumicë ta ndryshojë atë formulim.

Po them edhe një herë, kur të lexohet mirë, janë nja dy-tri pika, që nuk janë shumë të qarta. Unë nuk po insistoj, do ta votoj. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit profesor. Berat...

#### DEPUTETI BERAT LUZHA:

Në mbledhjen e kaluar u konstatua edhe nga kryetari i Komisionit se ka pas ndërhyrje në tekstin e Rregullores të përgatitur nga Komisioni të cilat u klasifikuan si falsifikime. Do të ishte mirë që Komisioni t'na shpjegojë se vërtetë kush e falsifikoi tekstin e Rregullores dhe pse e falsifikoi.

Propozoj që në Kreun e gjashtë – Rregulla 16 – Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës, pas pikës 5, së shtohet edhe një pikë – pika 6, e cila do të kishte këtë përbajtje: "Nëse edhe në votimin e tretë kandidati nuk merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, procedura kthehet nga fillimi me kandidatë të tjere".

Edhe një tjetër lutje kisha pas, që Kryesia ta merr përsipër botimin e Rregullores në një skriptë dhe deri në mbledhjen e ardhshme t'ia shpërndajë deputetëve.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, pastaj Zef Morina.

#### DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLCAKU:

Në emër të Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, përkrah mendimin e kryetarit të Komisionit për Rregullorë të punës që Komisioni për personat e kidnapuar, dhe të

zhdurkur të jetë si Komision i veçantë apo komision ad hoc, dhe të mos i bashkëngjitet Komisionit për shëndetësi. Ky është propozimi ynë... Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Zef Morina dhe Nait Hasani i fundit. Urdhëroni....

#### DEPUTETI ZEF MORINA:

Faleminderit shumë. Zoti Kryetar, zoti Kryeministër, kolegë deputetë, Duke pas parasysh rëndësinë e kësaj Rregulloreje, gjithashtu duke pas parasysh edhe rëndësinë e komisioneve të cilët do ta bënin shumë më efikas punën e Kuvendit në përgatitjen e ligjeve, mendoj se Rregulla 48, e cila ka të bëjë me formimin e komisioneve, duhet të ndryshojë. Pajtohem me atë që thotë zoti Dedaj, sepse më mirë do të ishte sikur të gjithë deputetët të merrnin pjesë në komisione të ndryshme, secili deputet në një komision dhe të mos ketë vend ku kemi dy apo tre në tri komisione një individ. Kemi rastin këtu, kemi kryetar komisioni, kemi edhe në komisionet tjera anëtarë të komisioneve. Nuk e di, ndoshta për këtë është bërë ndonjë lëshim nga formimi i komisioneve prej grupeve parlamentare, por sido që të jetë, mendoj se edhe kolegët deputetë do ta mbështesin këtë qëndrim, sepse kjo do të ishte në të mirë të punës të Kuvendit dhe gjithashtu t'i jepet mundësia secilit deputet të jepë kontributin dhe të tregojë angazhimin e tij qoftë në ligje qoftë në punën e mëtutjeshme të Kuvendit.

Nuk besoj se këto komisione apo këta individë janë futur nëpër komisione vetëm sa për të marrë shtesa apo paga më të mira, por për të kontribuar në mbarëvajtjen e punës së Kuvendit. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe i fundit Nait Hasani... Urdhëroni.

#### DEPUTETI NAIT HASANI:

I nderuar Kryetar, unë kam dy propozime këtu. Në Kreun e dytë te konstituimi i Kuvendit dhe te fjala e betimit, ku në rreshtin e fundit – fjalia e fundit, thuhet: “dhe me standardet evropiane”. Mendoj se është e tepër të shtohet kjo kur e dimë se të gjitha ligjet janë në pajtim me standardet evropiane. Kurse në tjetër, këtu thuhet “në pajtim me ligjet e vendit”. Të gjitha ligjet e vendit janë në pajtim me standardet evropiane dhe s'ka nevojë të prezantohet edhe një herë: “standardet evropiane”.

Dhe, pika e katërt, Rregulla “zgjedhja e Kryesisë” – pika e tretë, ku thotë “kryesuesi kërkon nga përfaqësuesi i etnitetit politik”. Mendoj nuk duhet të jetë “etnitet politik” sepse ne këtu jemi të gjithë shqiptarë, ka edhe tjerë, por në Parlament jemi të përfaqësuar si grupe politike. Nuk jemi të përfaqësuar si etnitete të veçanta dhe mund të them, për shembull: Partja Demokratike, Lidhja Demokratike, Aleanca, e tjera... Si do t'i prezantojmë si etnitete këtu, kur mund ta zëvendësojmë këtë fjalë: grup ose me të parti politike. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Edhe Hydajet Hyseni – me ID të Sala Ahmetit.

DEPUTETI HYDAJET HYSEN;

Faleminderit zoti Kryetar. Bëre mirë që kësaj radhe ma dhe fjalën se .... Do të kishte bërë mirë, edhe më mirë sikur edhe dje edhe sot në pikën e mëparshme t'ma kishit dhënë fjalën se e kisha ndërmend të propozoj diçka. Ishte procedurale, dhe si përfaqësues i Komisionit, që ishte edhe një mënyrë Komisioni më i afërt me çështjen që bisetonim, ishte diçka që edhe më përkiste. Mirépo, më besoni – keqardhja më e madhe ishte se prishej në njëfarë mënyre ajo përshtypja e përgjithshme se shkonte mirë edhe udhëheqja e Seancës së djeshme, e na ndodhë nganjëherë – siç thuhet - ajo në fund pastaj derdhet.... Megjithatë, më falni për këtë ndërhyrje.

Unë e mora fjalën për të propozuar diçka për strukturën e komisioneve dhe propozimi im i parë që ka qenë shtruar edhe në Komision, e që tani imponohet edhe me ndryshimin që u bë, do të thotë me propozim që Komisioni për mandat dhe imunitete t'i bashkëngjitet strukturës së komisioneve. Nuk e kemi këtë, prandaj unë propozoj, dhe jam i bindur se shpreh edhe qëndrimin e Komisionit, që ky Komision të bashkohet me Komisionin për Rregulloren e punës dhe Komisioni për rregulloren e punës të vazhdojë të jetë Komision funksionues dhe këtij komisioni, do të thotë - përmendante, imunitete, rregullore të punës - t'i bashkëngjitet edhe çështja e peticioneve dhe ankesave. Do të ishte taman një komision funksional.

Dhe, e dyta – është terminologjike, ju lutem për mirëkuptim. Komisioni, të cilin e kryesoj unë, quhet për çështje gjyqësore, Kornizë kushtetuese, legislative, për të drejtat e njeriut, barazi gjinore e tjera... Është thjesht i papërdorshëm. Ne në Komision kemi marrë një qëndrim që t'i propozojmë Seancës plenare që të reduktojmë emërimin e Komisionit, do të thotë është diçka thjesht teknike, dhe të quhet: Komisioni për çështje legislative, kushtetuese dhe juridike. Ju lutem për mirëkuptim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI;

Faleminderit. 93 deputetë janë prezent në sallë. Para se të votojmë, besoj se e kam përkrahjen. Komisioni përkatës, në qoftë se votohet përm, duhet t'i hyjë redaktimit në kuptim të mosndryshimit por përm atë që tha Nait Hasani – Hydajet., do të thotë në mënyrë që t'mund pastaj të jepet në botim dhe si broshurë pastaj ta kenë deputetët.

Ju ftoj të votojmë.

Kush është përm ta miratuar Propozimrregulloren e punës të Kuvendit? Ju faleminderit.

A ka votë kundër. Të numërohen votat, ju lutem. Janë 3 vota kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim.

Konstatoj se është e aprovuar Rregullorja dhe le të kryhet puna rrëth redakturës së saj.

Ju faleminderit. Shihemi në Seancën e radhës.

Seanca përfundoi punën në orën 15.15.